

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T I
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 28 e 29. 6. 2007

T R A N S K R I P T
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 28. i 29. 06. 2007. GODINE

QERSHOR - JUN 2007

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 21 qershorit 2007,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Debat për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së,
4. Debat për rininë në Kosovë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së,
5. Debat për zbatim të Rekomandimeve të Kuvendit dt. 7 korrik 2005 për çështjen e pensionistëve në Kosovë,
6. Debat për ndërtimin ilegal të banesave kolektive nga Qeveria e Serbisë në lagjet veriore të Mitrovicës, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDD-së,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimit hapësinor,
9. Miratimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri Energjetikë dhe Telekomunikacion lidhur me dhënien e licencës për hulumtime minerare kompanisë
“Kosovo Resorce Company L.L.C.”

DNEVNI RED

1. Usvajanje zapisnika sa predhodne sednice od 21 juna. 2007 gogine.,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Debata o popisu stanovništva, porodičnih domaćinstava i stanova na Kosovu, po zahtevu PG LDK,
4. Debata o omladini na Kosovu, po zahtevu Parlamentarne grupe PDK,
5. Debata o sprovođenju preporuka Skupštine od 7.jula 2005. godine o pitanju penzionera na Kosovu,
6. Debata o ilegalnoj izgradnji kolektivnih stanova od Vlade Srbije u severnim naseljima Mitrovice, po zahtevu Parlamentarne grupe LDD,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o tretiranju bezpravnih gradnji,
8. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona o prostornom planiranju,
9. Usvajanje Preporuke Komisije za privredu, trgovinu, industriju, energetiku i telekomunikacije u vezi davanja licenci za mineralna istraživanja kompaniji „Kosovo Resorce Company L.L.C.”

KRYETARI KOLË BERISHA – Të nderuar deputetë. I nderuari kryeministër dhe Kabinet Qeveritar. Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës. Ju njoftoj se në seancë marrin pjesë 76 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar me punë.

Që në fillim ju njoftoj se në pajtim me rregullën 6.2 dhe 23 të Rregullores së punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit i ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme plenare. Në ndërkohë, Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim, Rural, Ambient dhe Planifikim Hapësinor ka propozuar me shkrim që të hiqet nga rendi i ditës pika e shtatë e rendit të ditës- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje, për shkak të mungesës së raportit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve.

E hedh në votim propozimin. Urdhëroni z. Gjini.

MINISTRI ARDIAN GJINI – Faleminderit z. kryetar, z. kryeministër, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës. Pa pasur qëllim që të ndërhyj në procedurat e Kuvendit të Kosovës duhet t'ju them se ky ligj është tejet i rëndësishëm për popullin e Kosovës, për komunat për Qeverinë, për të gjithë ne do të thotë. E kisha lutur Komisionin në fjalë me qenë se deri më sot nuk e ka raportin me vërejtjet dhe sugjerimet e veta që ta ketë sa më shpejtë që të jetë e mundur, për shkak se jemi në një situatë në cilën mund të dërgojmë mesazhe të gabueshme te ata të cilët kanë ndërtuar pa leje. Unë edhe një herë i lus deputetë që ta ndjekin procedurën dhe juve kryetar. Nuk mund të ndërhyj po ju lus edhe një herë që ky ligj sa më shpejtë që të jetë e mundshme të votohet nga Kuvendi për shkak se është tejet me rëndësi. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Urdhëroni Gjylnaze.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit z. kryetar. Duke u bazuar në rregullën 23.2 të Rregullores së punës së Kuvendit dhe konform kësaj rregulloreje unë ua kam dërguar me shkrim juve kërkesën e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për tërheqjen e pikës së gjashtë të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me debatin për ndërtimin ilegal të banesave kolektive nga Qeveria e Serbisë në lagjet veriore të Mitrovicës, që është kërkesë e Grupit Parlamentar të LDD-së. Kërkesa jonë është e bazuar në mbështetjen e kërkesës së ministrit se në mungesë të materialit dhe të informacioneve debati të shtyhet në njërin nga seancat e radhës. Konsiderojmë se është një çështje shumë e rëndësishme e ndjeshme dhe komplekse, e cila kërkon një informim adekuat dhe të saktë. Prandaj ju lutem z. kryetar veni në votim. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – E kemi në radhë edhe atë. Urdhëro Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit. I nderuari kryetar, i nderuar Kabinet qeveritar. Mendoj se kërkesa e paraqitur tani jo vetëm pse është e pabazë, është e pakuptimtë në tërësi dhe nuk ka argumente. Cilat fakte i donë më shumë se kur vetëm mbrëmë është shit shtëpia nga një kryetar i një nëndege atje dhe është festuar. Unë e kam dorëzuar materialin që dy muaj ditë. Janë edhe propozimet edhe sugjerimet se si duhet të

vepruar. A jemi të zotë t'i mbrojmë ne ato qëndrime dhe veprime është krejt çështje tjetër, por të hiqet nga rendi i ditës vërtet është pa justifikim, pa argumente dhe një çështje e tillë duhet të trajtohet së paku këtu në Kuvend. Ne jemi ata që duhet t'i mbajmë edhe ata pak shqiptarë që kanë mbet atje. Përndryshe, nëse për dike jam pa rëndësi 18.72% të territorit dhe 23.800 shqiptarë të shpërngulur pas lufte. atëherë dihet se çka po presim ne dhe çka mendojmë lidhur me çështjen e Mitrovicës. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. E hedh në votim propozimin e Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Ambient dhe Planifikim Hapësinor, që ka propozuar me shkrim që të hiqet nga rendi i ditës pika e shtatë e rendit të ditës- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Kush është për?

Për shumica;
Kundër 1;
Abstenim nuk ka

Konstatohet se me shumicë votash hiqet nga rendi i ditës pika e shtatë e rendit të ditës.

Grupi Parlamentar i AAK-ës propozon që të hiqet nga rendi i ditës pika e gjashtë- Debat për ndërtimin ilegal të banesave kolektive, nga Qeveria e Serbisë në lagjen veriore të Mitrovicës.

E hedh në votim. Kush është për?

Për..... 32;
Kundër..... 17;

Konstatohet se shtyhet kjo pikë e rendit të ditës për një mbledhje të ardhshme.

Fjalën e ka z. Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, z. kryeministër, të nderuar deputetë. Jemi bërë nganjëherë po më duket robër të ndonjë rregullore dhe atëherë kur po dëmtohet shumëçka në Kosovë. Unë e kam tërhequr vërejtjen para sa kohe që disa tema mos të shtyhen, po të trajtohen në kohën e duhur se mund ne të bisedojmë, por bisedojmë si thuhet një fjalë pasi veç të jenë në kryer punët dhe debati nuk do të kishte më kuptim. Mendoj, që edhe për çështjen e ndërtimit në Mitrovicën e Veriut ne mund të debatojmë, por atëherë kur s'kemi pse të debatojmë.

Prandaj, unë kam një kërkesë që sot Kuvendi i Kosovës të përcaktohet për të mbajtur një debat që lidhet me procesin politik. Gjithë bota është duke biseduar për shtyrjen dhe mos shtyrjen e procesit politik, për njohjen ndërkombëtare të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës. Mendoj që është koha që në Parlamentin e Kosovës të debatohet. Po thuhet se procesi politik do të shtyhet për 4 muaj dhe pas 4 muajve me automatizëm do të pranohet propozimi i presidentit Ahtisari.

Megjithatë ky Parlament duhet të deklarohet- Çka nëse pas 4 muajve përsëri nuk definohet, me automatizëm nuk pranohet dokumenti i Ahtisarit? Mendoj që për këtë

çështje Kuvendi i Kosovës, nëse jo nesër, në javën e ardhshme duhet të organizojë një debat. Një çështje tjetër mendoj që lidhet po me procesin politik e që ndoshta u shtyra nga shtypi se “cubat u ndalën në kufirin e Kosovës.” Vërtet në cilin kufi të Kosovës u ndalën cubat? A u ndalën në kufijtë administrativ që i ka Kosova apo u ndalën në Ibër? Edhe për këtë duhet vërtet dikush të jep përgjigje. Sipas asaj, sipas ndërhyrjes së kryeadministratorit që ndaloj Gardën e Car Llazarit për të ardhur, për të festuar Vidovdanin. Ku u ndal ajo gardë, në cilin kufi të Kosovës?

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Kemi votuar për rendin e ditës. Po e patët fjalën Ramadan.

(Polemikë)

S’ka mundësi. Edhe ju e patët fjalën Gjylnaze. Për çka është fjala? Po ne votuam për të. Po krejt është e qartë, ne votuam për te. Shkojmë më tutje. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. Për të gjithë është e qartë ,sepse kemi votuar. A e ke rreth rendit të ditës?Kemi votuar për te. Është votuar për rendin e ditës dhe nuk ka. Po s’është e drejtë Fadil. Merre rregullojeni, është votuar për rendin e ditës, të vazhdojmë më tutje. Fadil nuk ke të drejtë sinqerisht po them, sepse është miratuar rendi i ditës. Urdhëro Fadil.

DEPUTETI FADIL GECI – Faleminderit kryetar. Unë mendoj që vetë propozimin që e bërë, e bërë një gabim. Është hyrë në rend dite. Ne e dimë për Mitrovicën kemi çka me fol. E dimë gjendjen çfarë është. E dimë çfarë gjendje kem popullatën në Mitrovicë edhe në atë pjesën Veriore. E dimë kush është fajtor për atë gjendje. Unë jam i detyruar, e ndjej në ndërgjegje, dua me pastrua veten edhe dua me u orientua përgjegjësin ku është faji për Mitrovicën. Unë ju them juve që faji për Mitrovicën është pak te Lutfi Haziri, te Bajram Rexhepi që është këtu e te Grupit të Unitetit në përgjithësi. Këtë po e them pse të këta, se Bajram Rexhepi më ka citua mu, më ka thënë që unë e kam hap si propozim ,por ky propozim është i imi po është miratuar nga Grupi i Unitetit. Prandaj,, përgjegjësinë për të gjitha këto, jo vetëm për Mitrovicën, por edhe për punët e tjera e keni ju kryetar dhe jeni tu gabuar. Prandaj, unë mendoj që koha është që mos të punoni pa Rregulloren, mos punoni pa ligj dhe të kuptoni që jeni tu hy në rrugë pa krye. Edhe më herët ju kam thënë dhe tani po ju them, jeni tu hi në rrugë pa krye. Prandaj, ju jeni t’u bërë përpjekje me tregua se cili jeni, na e përdorim një fjalë më katolik se Papa. Cili po na bie historinë, cili po na bie pavarësinë duke vrapuar, cili është baba i shqiptarisë, po, po shihet që jeni t’u gabua rëndë , kryetar.

Prandaj, unë e kam propozimin e fundit. Kërkoj që të bisedohet për shtyrjen e statusit të Kosovës dhe përgjegjësinë e Grupit të Unitetit në përgjithësi. Kërkesa ime është që të hidhet në votim, që të kërkohet për shtyrjen e statusit të Kosovës dhe në përgjithësi punën e Ekipit të Unitetit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Le të bëhet kërkesa me shkrim,në procedurë të rregullt..

DEPUTETI FADIL GECI – Mirë, edhe kërkoj ndërgjegjia të jetë e deputetëve. Ju lutem ,më të ndërgjegjshëm kanë qenë deputetët në kohën e Rrahman Morinës se sot. Po ju them këtu, po flas si koleg, më të fortë kanë qenë për qëndrime me punë. Prandaj, situatën e kemi çfarë e kemi. Unë kërkoj nga të gjithë kolegët, jemi shokë ,që të jenë ndërgjegjshëm dhe të shohin çfarë situatë jemi.

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit. Shkojmë më tutje. Pika e parë e rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca plenare 21 qershor 2007

Procesverbali i seancës plenare të datës 21 qershor 2007 u është shpërndarë deputetëve. Pyes deputetët a kanë vërejtje? Nuk ka. Ju faleminderit.

Konstatohet se Kuvendi miratoi procesverbalin e seancës plenare të 21 qershorit 2007. Pika e dytë e rendit të ditës.

2. Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në pajtim me rregullën 26.1 të Rregullores së punës të Kuvendit koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta. Në afatin e paraparë janë parashtruar 10 pyetje parlamentare. Pyetjet të cilat nuk arrijnë të procedohen sot do të radhiten për seancën tjetër të radhës.

Fillojmë me pyetjet. Deputeti Xhavit Bislimi s'është këtu. Deputetja Sala Berisha – Shala ka pyetje për ministrin Blerim Kuçi. Nuk është as ai këtu. Urdhëroni.

DEPUTETJA SALA BERISHA.- SHALA – Faleminderit z. kryetar. Këtë pyetje e kam shtuar edhe në seancën e kaluar. Ministri ishte këtu dhe ishte një arsyetim i tij se nuk jam përgatit me t'u përgjigj. Unë megjithatë e ndiej një obligim moral para qytetarëve të Drenasit ta shtroj pyetjen këtu në Kuvend e ministri ndoshta është diku duke e ndjek seancën dhe le të përgatitet. Është një çështje e cila mendoj që është gjithkund në Kosovë jo vetëm në komunën e Drenasit, tash e sa kohë, por që më tepër e rëndon këtë komunë. Çështja është se në këtë vapë të madhe qytetarët e moshave të ndryshme në Drenas për çdo ditë presin me orë të tëra para Zyrës së regjistrimit civil. Stafi ekzistues është i pamjaftueshëm për të përballuar volumin e punëve në këtë drejtim, sidomos në këtë sezon dhe periudhë kur qytetarët për shërbimet e tilla janë më shumë se zakonisht dhe krijojnë kaos para sporteleve. Është fluksi i madh i maturantëve që u duhen dokumentacionet ,po një çështje që është shumë me rëndësi është koha kur mërgimtarët kërkojnë shërbimet e tilla dhe pushimet u kalojnë pranë sporteleve të Zyrës së regjistrimit civil. Pyetja është se çfarë mase ka marrë Ministria që radhët e gjata para zyrës së regjistrimit civil të zbuten sado pak?

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Ministri është në vizitë zyrtare në Shqipëri. Deputetja Zylfije Hundozi ka pyetje për ministrin Blerim Kuçi, për Qemajl Ahmetin. Urdhëroni z. Hundozi. Deputetja Hundozi e ka fjalën me kartelën e Gjylnaz Sylës.

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI – Rruga Xërxe- Ratkoc- Kramovikë është rrugë e një rëndësie të veçantë, nëpër të kalojnë 20 mijë udhëtarë të asaj ane. Kjo rrugë është në rajonin më të zhvilluar bujqësor të Kosovës e me gjithë këtë është tërësisht e shkaktuar, kështu që i shkatrron edhe automjetet të cilat kalojnë nëpër të dhe e ngadalëson qarkullimin e tyre. Pyes ministrin e Transportit dhe Telekomunikacionit -A ekziston plani për ndërtimin e rrugës Xërxe- Ratkoc- Kramovik e cila është e gjatë 17 kilometra dhe kur do të zbatohet ai? Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit. Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI QEMAJL AHMETI – I nderuari kryetar i Kuvendit, i nderuari kryeministër, të nderuar deputetë, të nderuar deputete. Procedurat kur ekziston plani këtë vit ka qenë në prioritet të ndërtimit të kësaj rruge. Janë kryer procedurat e prokurimit. Kujtoj që sot është afati i fundit ose mbrëmë ka qenë afati i fundit i ankesave. Nëse s'ka ankesa gjatë javës, sot, nesër nënshkruhet kontrata dhe javën e ardhshme fillojnë punimet. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit. A ka pyetje shtesë? Ju lutem a keni pyetje shtesë? Mirë, faleminderit. Deputeti Nait Hasani, ka pyetje për ministrin Haraqija. Urdhëroni z. Hasani. Ju lutem Nait Hasani e ka fjalën. Regjia, ju lutem deputeti Nait Hasani e ka fjalën. Nait urdhëroni këtu ju lutem.

DEPUTETI NAIT HASANI – Faleminderit kryetar. Unë kam pyetje për ministrin e Kulturës z. Astrit Haraqija. Në bazë të Rregullores, çështja është në fshatin Vrellë, komuna e Istogut ka ndodhur fatkeqësi natyrore të themi- vërshime nga të reshurat atmosferike. Ka pasur vërshime nga i ashtuquajtimi Lugu i Marrë kur arat e livadhet janë mbuluar me ujë dhe rërë, muret e oborreve janë rrëzuar. Nga këto vërshime pas dëmeve të mëdha që i janë shkaktuar banorëve të fshatit Vrellë, ka ndodhur edhe një gjë e jashtëzakonshme. Në sipërfaqe të tokave kanë dalë dhe janë zbuluar disa relikte që i përkasin Mesjetës. Këto elemente janë prej më të ndryshme si pllakat dhe figurat njerëzish që sipas arkeologëve mbi 1800 vite të vjetër, pastaj gjilpëra, gypa me elementet e ndryshme që tregojnë qartë për vendbanimin e në këtë fshatë. A është në dijeni Ministria juaj rreth këtyre ndodhive në këtë fshat dhe çfarë ka ndërmarrë për të vërtetuar ekzistencën e këtyre zbulimeve që janë bërë nga natyra dhe cilat ishin hapi i juaj nëse do të vërtetohet se kemi të bëjmë me një zbulim i cili tregon e popullit tonë në këto treva.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Urdhëroni z. ministër e keni fjalën.

MINISTRI ASTRIT HARAQIJA – I nderuari kryetar i parlamentit, i nderuari kryeministër të nderuar deputetë. Lidhur me pyetjen e deputetit Nait Hasani rreth gjetjeve në fshatin Vrellë të Istogut mund të them me sa vijon. Ministria e Kulturës është njoftuar me kohë rreth rastit në fshatin Vrellë të Istogut dhe menjëherë ka marrë masa të nevojshme dhe menjëherë ka formuar një grup punues të përbërë nga ekspertë e fushës nga Ministria, nga Instituti Arkeologjik i Kosovës, nga Instituti Për Mbrojtjen e Monumenteve të Pejës si dhe përfaqësuesit e Kuvendit Komunal të Istogut. Pasi ka dalë në vendi ku pretendoj se mund të ketë gjetje arkeologjike grupi i ekspertëve ka parë se

pas vërshimeve të datës 6 qershor në fshatin Vrellë nga një banorë i fshatit është gjetur një gurrë i gdhendur me përmasa të gjatësisë 66 cm 47 cm i gjerë dhe një trashësi rreth 17 cm. Ky gurë karakterizohet me elemente kulturore sipas vlerësimeve të para. Mund t'i takojë takoj periudhës antike të shekullit të dytë dhe të tretë të Erës sonë. Grupi i ekspertëve me këtë rast ka vizituar edhe shtëpinë e banorit Esat Dana nga ai janë informuar se ky posedon një koleksion privat të gjetjeve po në të njëjtin vend të cilat i ka mbledhur gjatë tri viteve të fundit. Ky koleksion përbëhet nga katër vazo prej qeramike të dimensioneve mesatare një gurrë për bluarje i punuar si dhe një gjilpërë prej bronzit me një gjatësi prej 10 deri 12 cm. Duke theksuar këtë për këto gjetje ky qytetar nuk ishte lajmëruar asnjëherë në institucionet përkatëse.

Ekipi i ekspertëve përveç informatave të nevojshme në teren ka bërë edhe fotografimet dhe incizimet e këtyre eksponateve. Ndërsa për hulumtimin e mëtejshme në këtë lokalitet duhen të merren masa përkatëse nga institucionet dhe ekspertët përkatës të fushës si dhe të bëjnë hulumtimet e sondazhit arkeologjik. Shumë shpjegimet ekspertët tanë do ta vazhdojnë ta realizojnë dhe të studiojnë këto gjetje dhe do të dalin në përfundimin e saj dhe procedura më tej. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Ka pyetje shtesë.

DEPUTETI NAIT HASANI – Pyetje shtesë për ministrin është. Cilët janë afatet kohore që do ta bëjë ky këtë dokumentim që ky vend i takon kësaj date dhe cilët do të jenë ato zbulime që do t'i bëjë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit. Ministër a keni përgjigje?

MINISTRI ASTRIT HARAQIJA – Z. Hasani, ky nuk është tender në afat 30 ditë po kjo është çështje e fushës së ekspertëve ata do ta vlerësojnë unë thash edhe shumë shpejtë do ta keni informatën.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Pyetje tjetër Nait Hasani ia drejton ministrit Tomë Hajdaraj, mbetet për seancën tjetër sepse nuk është këtu prezent. Deputetja Hatixhe Hoxha ka pyetje për ministrin Qemajl Ahtemi. Urdhëroni z. deputete.

DEPUTETJA HATIXHE HOXHA – Z. Kryetar, z. ministër. Duke e ditur gjendjen e vështirë në hekurudhat e Kosovës të këtij segmenti me shumë rëndësi e veçmas duke pas parasysh dëmtimet që po i shkaktohen kohëve të fundit infrastrukturës hekurudhore pyes. Çfarë keni ndërmarrë ju për ta parandaluar një veprim të këtillë si dhe për të mirëmbajtur infrastrukturën hekurudhore.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI QEMAJL AHMETI – Faleminderit e nderuara deputete. Çështja e infrastrukturave rrugore përkatësisht hekurudhore nuk është përgjegjësi e Qeverisë është ende përgjegjësi e rezervuar nuk po i marrim ato përgjegjësi. Është e vërtetë që kemi një dëmtim të hekurudhave të Kosovës por në bashkëpunim me Drejtorinë edhe me Shtyllën

e IV normalisht kemi kërkuar nga Shërbimi Policor i Kosovës që të ketë një punë më të madhe rreth ruajtjes si dhe vetë punëtorët e hekurudhave të bëjnë atë që mundet. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit ministër. A ka pyetje shtesë? Urdhëroni.

DEPUTETJA HATIXHE HOXHA – Z. ministër. dëmtimet e infrastrukturës hekurudhore në Kosovë sipas shënimeve nga janari deri në shtator 2006 kanë qenë 185 mijë e 241 euro dëmtimet janë shumë të mëdha këto kanë shumë foto edhe nuk dakordohen me ato që thoni vetëm është punë e re për fatin se atje i kemi menaxherët vendor, keni edhe brenda ministrisë dhe departamentit për hekurudha dhjetëra dhjeta fotografi shihen për dëmtime të mëdha të hekurudhave, do t'i ofrojë kryetarit të Parlamentit edhe shefave të grupeve parlamentare. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit! Keni përgjigje, urdhëroni z. Ministër.

MINISTRI QEMAJL AHMETI – Unë nuk i kontestoj dëmtimet e hekurudhave. Unë isha shumë i qartë. Është përgjegjësi e Shtyllës së Katërt, është përgjegjësi e rezervuar, I kam unë të gjitha këto informata që thoni ju zonja deputete, unë mund t'ju ofrojë kësaj here,..por sa i përket asaj që kemi Departamentin për Infrastrukturë Rrugore ,përkatësisht hekurudhore, ne i bëjmë politikat po nuk i mirëmbajmë hekurudhat. Kemi edhe menaxher.... por nuk e mirëmbajmë hekurudhën e Kosovës, Nuk bëjmë dëmtimet, por i kemi të evidentuara si të dëmtime ato dhe një të ardhmen nëse ajo bie në përgjegjësi të Qeverisë, atëherë duhet me i marrë edhe përgjegjësitë e tjera. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit! Deputetja Safete Hadergjonaj ka pyetje për ministrin Qemajl Ahmeti.

DEPUTETJA SAFETE HADËRGJONAJ – Ju faleminderit z. kryetar. Në seancën e 22 shkurtit të vitit 2007, ministri ka deklaruar se është dashur të bëhet një intervenim ad hoc në kryerjen e rrugës së magjistrales Prishtinë – Pejë për të eliminuar pasiguri në rrugë, për shkak të deformimeve të mëdha. Deformimet nuk janë eliminuar, por përkundrazi janë shtuar gropat, është rritur pasiguria në rrugë. Pyetja ime është: A ka qenë pjesë e projekteve të parapara për vitin 2006 kryerja e kësaj rruge? Nëse po, sa është vlera e këtij projekti? Nëse jo, sa ka kushtuar kjo grryerje dhe kush e ka fituar tenderin për kryerjen e kësaj pune?

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit! Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI QEMAJL AHMETI – Ju faleminderit zonja deputete. Gërryerja e magjistrales Prishtinë – Pejë nuk ka qenë projekt i veçantë, por është në kuadër të mirëmbajtjes verore dhe gërryerja është ad - hoc në kuptimin e mirëmbajtjes verore dhe posa të kryhen procedurat që janë në rrjedhë e sipër përcaktimit të fituesit për mirëmbajtjen verore do të evitohet, kështu që nuk ka pas projekt të veçantë në mënyrë që të caktohet kush e ka pas këtë e tjera. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit! A ka pyetje shtesë? Nuk ka. Urdhëroni Safete Hadërgjonaj.

DEPUTETJA SAFETE HADËRGJONAJ – Kjo çka po e deklaron ministri është një lloj papërgjegjësie nga ana e ministrit, sepse edhe mirëmbajtja e rrugës duhet të planifikohet dhe parashikohet. Z. ministër, si e shpjegoni faktin që rruga është gërryer në vitin e kaluar dhe ende nuk është bërë shtruarja e kësaj rruge.? Ju keni deklaruar që në fillim të këtij viti do të merren të gjitha masat që kjo rrugë do të jetë e gatshme, asgjë nuk është bërë në këtë rrugë. Do të kisha pyetur kush ua kompenson dëmet qytetarëve të cilat u shkaktohen nga kjo prishje e rrugës dhe aq më keq kush ua kompenson jetën e njerëzve të cilët rrezikohen për shkak të ikjeve nga gropat të cilat ndodhen në këtë rrugë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit! Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI QEMAJL AHMETI - Ju faleminderit shumë. Unë nuk jam fajtor pse procedurat e prokurimit vonohen, sepse Ligjin e prokurimit s’e ka miratuar vetë as Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, që i shqyrton këto punë, as parregullsitë që ndodhin në tërësi në Kosovë. Nëse doni unë të jap vetëm një fakt. 46 kompani kanë konkurruar në mirëmbajtjen verore, Kur motifikohet në 15 lloje dalin 154 kompani. Prej të gjitha këtyre procedurave është ankuar vetëm një kompani dhe ajo kompani më vonë është parë që e papërgjegjshme, Komisioni Rregullativ e kthen në rishqyrtim tenderin dhe vonon që një muaj e sa. Unë nuk ndihem aspak fajtor. Sa i përket çështjes së rrezikut në këtë rrugë, rrezikshmëria ose pasiguria në rrugë nuk varet vetëm prej rrugës a është e mirë a e keqe varet edhe prej vozitësit. Vozitësi nuk ka nevojë me i ikë gropave, por duhet ta ndalë shpejtësinë nëse do t’i ikë rrezikut. Pra, nuk ka nevojë me dalë në arëa atje siç po ndodhë. Do të thotë vozitja duhet t’i përshtatjeve kushteve të rrugës dhe gjithmonë nuk është fajtor rruga, Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit! A ka pyetje shtesë. Ju lutem, deputetja Safete Hadërgjonaj ka pyetje për kryeministrin Çeku, por, kryeministri Çeku ka kërkesën që kjo pyetje të kalojë për seancën tjetër të radhës dhe kështu përfundojmë.....

Kalojmë në pikën e 3 të rendit të ditës.

3. Debat për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë, sipas kërkesës së Grupi Parlamentar të LDK-së,

Ftoj ministren Melihate Tërmkolli ta marrë fjalën. Më falni, paraqitësi i Grupit.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Ju faleminderit z. kryetar, Lidhja Demokratike e Kosovës përmes Grupit Parlamentar të LDK-së në Kuvendin e Kosovës, sipas Rregullores së punës dhe procedurat e saj ka kërkuar që sot të debatohet lidhur me regjistrimin dhe ne jemi falënderues dhe mirënjohës për gjithë deputetët e grupit parlamentare që e kanë mbështet këtë kërkesë dhe kjo çështje të jetë në rend të ditës sot.

I nderuari z. kryetar, z.kryeministër, ministra dhe deputetë të çmuar. Që nga viti 1981 në Kosovë nuk është bërë regjistrimi i popullsisë .i ekonomive familjare dhe banesave. Pra janë 26 vjet pa regjistrim legjitim. Gjatë 26 vjetëve në Kosovë ka ndodhur një varg zhvillimesh, dyndje të popullsisë jashtë vendit si pasojë e represionit dhe diskriminimit sistematik të regjimit serb, luftës dhe spastrimit etnik , si dhe lëvizjet nga fshati në qytet. Në mungesë të regjistrimit nuk kemi të dhëna statistikore të kompletuara ku përfshihen numri i përgjithshëm, struktura dhe shtrirja gjeografike, punësimi, bizneset, prona, përdorimi i tokës dhe trendët zhvillimore në aspektin social, kulturor, ekonomik etj. Regjistrimi i popullsisë është prioritet i Kosovës. Për të pasur një pasqyrë reale të gjendjes demografike në vend, por edhe për të përcaktuar synimet tona sociale, ekonomike dhe zhvillimore në nivel lokal dhe qendror, aktualisht veprohet vetëm në bazë të vlerësimeve. Në regjistrim do të kemi një sistem statistikor të besueshëm për ne, por edhe për faktorin ndërkombëtar. Z. kryetar, Grupi Parlamentar i LDK-së vlerëson punën e Entit të Statistikave të Kosovës në bashkëpunim me konzerciumin teknik ndërkombëtar për përgatitjet cilësore për mbajtjen e regjistrimit të përgjithshëm. Këto përgatitje janë vlerësuar lart edhe nga Eurostat, i cili ka monitoruar regjistrimin e dytë testues., si dhe gjithë procesin e përgatitjeve për mbajtjen e regjistrimit. Ne e përgëzojmë Ministrinë e Shërbimeve Publike dhe kryesuesen e saj ministreshën z. Melihate Trmkolli, e cila i ka dhënë shtytje këtij procesi në harmoni me standardet ndërkombëtare. Grupi Parlamentar i LDK-së inkurajon të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e përgatitjeve që të vazhdohet me seriozitet, në mënyrë që të ketë regjistrim të përgjithshëm në harmoni të plotë me standardet ndërkombëtare dhe pjesëmarrje të gjithë qytetarëve të Kosovës. Duke mbështetur punën e Komisionit Qendror për Regjistrim, Entit të Statistikave dhe mekanizmave ndërkombëtarë që janë duke u ndihmuar në përgatitje për regjistrim cilësor kredibil në përfshirje të gjithë qytetarëve të Kosovës, në përputhje të plotë në standardet ndërkombëtare, ne jemi kundër politizimit të këtij procesi dhe inkurajojmë të gjithë qytetarët e Kosovës që të marrin pjesë në këtë proces të rëndësishëm për vendin tonë. Propozimi i Entit të Statistikave të Kosovës për datën e mbajtjes së regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave është bazuar në vlerësimet profesionale, teknike të Zyrës së regjistrimit dhe konzorciumit teknik, përgatitjet cilësore që janë zhvilluar dhe gatishmërinë e tyre që regjistrimi të bëhet në nëntor të këtij viti. pra. në nëntor të vitit 2007. Aq më tepër kur janë edhe vlerësimet pozitive të institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare për përgatitjet e mijëra që janë bërë për regjistrim.

Ritheksojmë se pikëpamjet profesionale teknike bazuar në vlerësimin e Entit të Statistikave nuk kanë ndonjë pengesë që regjistrimi të bëhet në vjeshtë të vitit 2007.

Jemi të inkurajuar me faktin se institucionet e Kosovës kanë bërë përgatitjet e nivelit të lartë për mbajtjen e regjistrimit gjatë këtij viti. I nderuari z. kryetar, Kuvendi i Kosovës

merr qëndrim lidhur me mbajtjen e regjistrimit të popullsisë .të ekonomive familjare dhe banesave dhe përcakton datën e regjistrimit.

Mbajtja e regjistrimit gjatë këtij viti është në dobi të proceseve zhvillimore në vend, në dobi të gjithë qytetarëve pa dallim dhe në dobi të hapjes së perspektivave të reja për Kosovën dhe qytetarët e saj.

Hezitimi i realizimit të këtij projekti të rëndësishëm për Kosovën ngadalëson shumë procese zhvillimore dhe civilizuese në vend. Z. kryetar, Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet nismën e Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe Entit të Statistikave të Kosovës që regjistrimin e popullsisë,të ekonomive familjare dhe të banesave ta mbajmë në vjeshtë të këtij viti ashtu si është paraparë me propozim të entit të statistikave të Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit! z. Gashi, fjalën e ka ministria Tërmkolli.

MINISTRESHA MELIHATE TËRMKOLLI – I nderuari zotëri kryetar i Kuvendit, i nderuari zotëri kryeministër, të nderuar deputetë, të nderuar pjesëmarrës në këtë seancë.

Unë jam e nderuar që të paraqes sot në Kuvendin e Kosovës, zhvillimet më të rëndësishme rreth përgatitjeve për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave. Njëkohësisht falënderoj Grupin Parlamentar të LDK-së ,por edhe grupet e tjera parlamentare që janë pajtuar që kjo çështje të trajtohet në Kuvendin e Kosovës. Them që projekti i regjistrimit të popullsisë ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë është ndër projektet më të rëndësishme të institucioneve të Kosovës dhe atë së paku në dy aspekte. Së pari ngase ky projekt realizohet pas 26 vjetësh të cilat në Kosovë karakterizohen me lëvizje shumë dinamike, demografike, ekonomike politike dhe sociale. Standardet ndërkombëtare kërkojnë që regjistrimi i popullsisë të mbahet çdo 10 vjet në gjitha vendet, madje edhe në ato që i karakterizon stabiliteti lartë në gjitha sferat e jetës shoqërore. Që nga viti 99 në Kosovë janë ndërmarrë një numër i madh i vlerësimeve ad hoc që kanë tentuar që të japin të dhëna sa do pak të sakta në sferat e veçanta me të cilat janë marrë hulumtuesit, donatorët apo edhe investitorët. Që të gjitha këto hulumtime kanë qenë të pjesshme dhe të pamjaftueshme. Në projektin e regjistrimit të popullsisë institucionet dhe qytetarët e Kosovës do të pasqyrojnë për veten e tyre të dhënat përkatëse në mënyrë profesionale neutrale dhe në përputhje me standardet evropiane në mënyrë që të krijohet baza e plotë statistikore e vendit.

Së dyti, përveç krijimit të bazave të dhëna statistikore, më se e nevojshme për hartimin e politikave zhvillimore në Kosovë, institucionet vendore gjithashtu tregojnë pjekurinë politike që të udhëheqin dhe realizojnë një projekt aq kompleks dhe aq të rëndësishëm për vendin. Regjistrimi i popullsisë,i ekonomive familjare dhe banesave paraqet, po ashtu. edhe realizimin e të drejtës elementare të qytetarëve të Kosovës për të dëshmuar identitetin , pasurinë dhe përkatësinë individuale dhe kolektive të tyre dhe njëkohësisht paraqet detyrimin e institucioneve për të garantuar ruajtjen e fshehtësisë së këtyre të dhënave. Ministria e Shërbimeve Publike ka arritur që me punën dhe angazhimin e

deritanishëm në përgatitje për regjistrimin e popullsisë të fitojë përkrahjen e organizatave dhe institucioneve eminente ndërkombëtare në radhë të parë të Eurostatit për këtë projekt të rëndësishëm për vendin. Ministria e Shërbimeve Publike dhe Komisioni qendror i regjistrimit janë vendosur që të gjitha përgatitjet të bëhen në atë mënyrë që regjistrimi të jetë i vlefshëm dhe kredibil në planin e brendshëm, por edhe në atë ndërkombëtar mbi bazat e parimeve dhe standardeve ndërkombëtare.

Mund të them se bazën ligjore për mbajtjen e regjistrimit të popullsisë e paraqet ligji të cilin e ka miratuar Kuvendi i Kosovës dhe që është fuqizuar përmes Rregullores së UNMIK-ut 2004/53 të nënshkruar nga Përfaqësuesi Special në dhjetor të vitit 2004. Mund të them që nga miratimi i ligjit është themeluar Komisioni Qendror i Regjistrimit të Popullsisë i propozuar nga Qeveria e Kosovës dhe i miratuar po ashtu nga Kuvendi i Kosovës dhe nga Qeveria janë themeluar të gjitha komisionet komunale në gjitha komunat e Kosovës ,përveç në tri komuna të cilat nuk janë ende të kyçura në procesin përgatitjeve të regjistrimit të popullsisë. Mund të them se përveç Ligjit për regjistrimin e popullsisë dhe planit të regjistrimit janë dy dokumente bazë mbi të cilat po zhvillohen përgatitjet për regjistrim. Këto janë rekomandimet ndërkombëtare dhe memorandumit i mirëkuptimit në mes institucioneve më të larta evropiane, Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës dhe UNMIK-ut dhe së fundi këtyre dokumenteve i është bashkangjitur edhe dokumenti i presidentit Ahtisari.

Duke qenë pjesë e përgatitjeve për regjistrim të përgjithshëm të popullsisë më 31 dhjetor deri më 14 nëntor në Kosovë është mbajtur regjistrimi i parë testues. Qëllimi kryesor i regjistrimit testues ka qenë testimi i instrumenteve edhe vetë procesit të regjistrimit nga aspekti i funksionimit të pyetësorëve dhe udhëzuesve hartografisë, aspektet trajnuese, fushatës sensibilizuese, aspektet e logjistikës , programi softuerik edhe të tjera. Në regjistrimin e parë testues janë përfshirë një numër i caktuar i komunave të Kosovës dhe disa qarqe regjistruese nga 6 komuna të zgjedhura, por janë përfshirë 50 qarqe regjistruese, 20 prej të cilave urbane dhe 30 rurale. Konkluzionet e dala nga regjistrimi i parë testues tregojnë pjesëmarrje të plotë të popullatës, pra të qytetarëve nga të gjitha komunitetet që janë përfshirë në këtë regjistrim. Funksionimi i fushës së hartografisë, respektivisht përdorimi i hartave në terren është treguar shumë i suksesshëm. Më pak të suksesshme janë treguar fusha e trajnimit dhe fushata senzibilizuese. Të gjitha mundësitë që kanë dalë nga regjistrimi i parë testues janë shndërruar në objektiva për evitimin e problemeve të natyrës teknike në vazhdim të përgatitjeve për regjistrim të përgjithshëm të popullsisë. Kështu në vitin 2006 kanë vazhduar përgatitjet për regjistrimin e më tutjeshëm, do të thotë, përgatitjet e më tutjeshme për regjistrimin e popullsisë. Për realizimin e këtij projekti që nga fillimi i përgatitjeve në Entin e Statistikave funksionon Zyra e Regjistrimit e cila udhëheqë grupet punuese nga fusha e demografisë hartografisë, logjistikës, sensibilizimit teknologjisë informative dhe administratës. Nga janari 2006 kjo zyrë ndihmohet nga asistenca teknike e konsorciumit të përbërë nga ekspertët e Instatit dhe nga Universiteti i Romës, si dhe si donacion i Këshillit të Evropës i menaxhuar nga AER-i. Mund të them që gjatë vitit 2006 pas sugjerimeve që kanë dalë nga regjistrimi parë testues dhe asistenca teknike ndërkombëtare janë finalizuar pyetësorët udhëzimet metodologjike dhe hartografia në përputhje me standardet ndërkombëtare, dhe si rezultat

i kësaj pune është rishikuar edhe kostoja e tërësishme e realizimit të regjistrimit të popullsisë e cila kap shumë prej 5 milion 998250 euro.

Natyrisht që nga viti 2006 ne kemi edhe në procesin e përgatitjeve të regjistrimit të popullsisë është formalizuar përfshirja e Misionit Monitorues Ndërkombëtar me nënshkrimin e memorandumit. Mekanizmat e Misionit Monitorues kryejnë një emision të bashkuar me objektivin e përgjithshëm për të kontrolluar numrin e drejtë dhe të paanshëm dhe të pos numërimit të popullsisë në Kosovë ,në përputhje me standardet ndërkombëtare të regjistrimit, parimet themelore të statistikave zyrtare dhe standardeve për mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetin, si dhe për të vlerësuar metodologjinë e përgatitjes së regjistrimit. Deri tani mund të them se kemi pas disa rekomandime të Grupit Monitorues Ndërkombëtar për harmonizimin e përgatitjeve me standarde ndërkombëtare. Çështja kryesore që është rekomanduar në këtë ka pas të bëjë me rekomandimet e komisionit drejtues lidhur me ndryshimin e ligjit për regjistrimin e popullsisë ekonomike familjare dhe banesave dhe mund të them që këto rekomandime për ndryshime në ligj janë të lidhura me Rregulloren 2004/53, e cila i ka mundësuar dhe i mundëson Përfaqësuesit Special që bashkë me Qeverinë të bëjë ndryshime në harmoni me standardet e parapara ndërkombëtare për regjistrimin e popullsisë dhe këto janë ende në procedurë në Zyrën Ligjore të Përfaqësuesit Special.

Nga 30 tetor deri më 14 nëntor 2006 është mbajtur regjistrimi i dytë testues në tri komuna, Pejë, Kamenicë dhe Shtërpçë. Gjatë regjistrimit testues komisionet komunale në këto komuna kanë qenë shumë funksionale dhe në përputhje me kompetenca dhe detyrat e tyre ligjore. Mund të them që janë realizuar në tërësi parashikimet që kanë qenë të lidhura me përgatitjet për regjistrimin e popullsisë. Natyrisht që mangësia në regjistrimin e dytë testues ajo që është vërejtje kryesore ka qenë mospjesëmarrja e komunitetit serb apo e qytetarëve serb dhe në një pjesë edhe rom, në këtë proces edhe për kundër asaj që institucionet e Kosovës plotësisht e kanë kryer punën dhe angazhimin e tyre , me qëllim që të gjitha etnitetet e përfshira në regjistrimin testues marrin pjesë në këtë proces. Përkundër pjesëmarrjes së plotë të këtyre dy komuniteteve në të gjitha fazat e përgatitjeve për regjistrimin testues, pra ka funksionuar komisioni komunal në Shtërpçë deri në ditën ku është mbajtur regjistrimi testues , është bërë rekrutimi i regjistruarve kontrollorë dhe monitoruesve. Kanë marrë pjesë të gjithë në trajnimet e organizuara nga Enti i Statistikës së Kosovës, janë deklaruar se me urdhrin e Beogradit për bojkot, kanë refuzuar pjesëmarrjen e tyre në regjistrimin testues në ditën e mbajtjes së regjistrimit.

Prandaj, është e qartë prapavija politike e mos përfshirjes së qytetarëve serbë në këtë proces edhe institucioneve që udhëheqin ata. Megjithatë dua të them se institucionet e Kosovës., veçanërisht Ministria e Shërbimeve Publike , por edhe të tjerat Enti i Statistikës së Kosovës, do të vazhdojnë angazhimin dhe përkushtimin e tyre të plotë që në regjistrimin e tyre të përgjithshëm sigurohet pjesëmarrja e gjithë qytetarëve në këtë proces aq të rëndësishëm për zhvillimin e vendit.

Një moment i ri në përgatitje për regjistrimin e popullsisë është përfshirja e regjistrimit të popullsisë në pakon e presidentit Ahtisari. Edhe përkundër përpjekjeve të institucioneve të Kosovës që mos të politizohet kjo çështje që duhet të ketë karakter

zhvillimor edhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, në pakon e z. Ahtisari ky proces ka marrë një dimension politik. Në dokumentin e presidentit Ahtisari regjistrimi i popullsisë trajtohet në nenin 14, ku thuhet që një vit pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes për Kosovën, Kosova në këshillim me Përfaqësuesin Ndërkombëtar Civil do të bëjë regjistrimin e popullsisë, që do të kryhet në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe t'i nënshtrohet vëzhgimit ndërkombëtar. Dhe më tej vazhdohet. Në këtë kontekst Republika e Serbisë dhe shtetet e tjera fqinje do të autorizojnë regjistrimin përmes një Agjencie Ndërkombëtare të Refugjatëve dhe Personat e Zhvendosur që dëshirojnë të kthehen në Kosovë.

Në letren e datës 9 shkurt 2007 të cilën ua kam dërguar Ekipit të Unitetit Zyrës së UNSE-kut dhe Qeverisë së Kosovës, Ministria e Shërbimeve Publike ka kërkuar që tekstin brenda nenit 14.1 të ndryshohet në formulimin e ri, që në vend -të pas një viti- të thuhet: brenda një viti”, do të thotë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes të realizohet regjistrimi i popullsisë, ndërsa vazhdimi tjetër i tekstit të fshihet në tërësi, sepse prek thellësisht në standardet ndërkombëtare për të cilat vetëm në një nen më herët dokumenti i presidentit Ahtisari ka sugjeruar dhe ka propozuar. Në fund të fundit kjo nënkupton edhe një politizim të krejt këtij procesi, për çka Kosova nuk ka qenë dhe as nuk është e interesuar ta bëjë. Deri më sot mund të them që as MSHP-ja dhe askush nuk ka marrë ndonjë përgjigje nga asnjë instancë, madje as informatën më të vogël se a është trajtuar kjo çështje a është biseduar apo jo lidhur me këtë.

Dhe po ashtu si ministri kemi dërguar edhe grupet menaxhuese të Eurostatit, një shkresë në të cilën tërhiqet vërejtja për mospërputhshmërinë e nenit 14.1 në dokumentin e presidentit Ahtisari me standardet ndërkombëtare, gjë që edhe Eurostat ka qenë i obliguar sipas detyrës zyrtare ta bëjë dhe të mos të lejojë që kjo të futet në dokumentin e presidentit Ahtisari. Dhe sa i përket aspektit financiar e përmenda edhe më herët shumë do të thotë mjeteve financiare, mund të them që janë paraqitur deri më tani disa raporte të Misionit Monitorues të Eurostatit. Vlerësimi i fundit pas regjistrimit të dytë testues është se janë bërë përgatitjet teknike dhe profesionale dhe minimum për 6 muaj institucionet e Kosovës mund ta mbajnë regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave. Kjo natyrisht është harmoni edhe me ligjin për regjistrimin e popullsisë sipas të cilit nga përcaktimi i datës deri në mbajtjen e regjistrimit duhet të kalojnë së paku 6 muaj.

Dhe në fund do të sjellë para jush disa konstatime që institucionet përkatëse, Ministria e Shërbimeve Publike, Enti Statistikës së Kosovës, zyrat komunale e regjistrimit dhe mekanizmat tjerë janë të përgatitura në planin teknik dhe profesional që regjistrimi i popullsisë, i ekonomive familjare dhe banesave të mbahet në vjeshtë të këtij viti.

Në bazë të përgatitjeve të deritanishme afati optimal për mbajtjen e regjistrimit të përgjithshëm është nëntori 2007. Duke pasur parasysh përgatitjet e deritanishme dhe rekomandimet ndërkombëtare, Kuvendi i Kosovës shqyrton këtë çështje dhe merr vendim të drejtë për datën mbajtjes së regjistrimit të popullsisë në Kosovë, duke i vlerësuar të gjitha rrethanat. Në bazë të Ligjit për regjistrimin e popullsisë ekonomive familjare dhe banesave kuvendi në bashkëpunim me PSSP-në e përcakton datën e mbajtjes së

regjistrimit, prandaj kujtoj që është e nevojshme që Kuvendi ta përmbushë këtë obligim. Dhe krejt në fund më lejoni të them se ne ditëve të fundit kemi parë një trusni dhe një sugjerim të madh të bashkësisë ndërkombëtare dhe përfaqësuesve të tyre të Këshillit të Evropës, të miqve tanë ndërkombëtar që Kosova të realizojë të gjitha ato çështje që mund të realizohen. Dua të them që një nga ato çështje që mund të realizohen është pikërisht regjistrimi i popullsisë. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të PDK-së Fehmi Mujota.

DEPUTETI FEHMI MUJOTA – Ju faleminderit z. kryetar, z. kryeministër të nderuar ministra, të nderuar deputetë dhe deputete. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka mirëpritur informatën nga Ministria e Shërbimeve Publike për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe banesave dhe natyrisht ka mirëpritur këtë debat që sot do t'i japë sigurisht një zhvillim të ri këtij procesi kaq të rëndësishëm në Kosovë. Jemi të vetëdijshëm që nga viti 1981 nuk kemi pas regjistrim të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave, me çka është dëmtuar përgjithësisht zhvillimi strategjik i Kosovës dhe do të thosha që nga niveli lokal e deri tek niveli qendror, por këtë proces mendojmë si grup parlamentar i PDK-së duhet shikuar mbi bazën e rrethanave të përgjithshme në Kosovë. Për ne është e mirëseardhur që gradualisht po krijohen rrethanat politike për të ndodhur ato ngjarje të cilat jetësojnë shtetin e Kosovës dhe gradualisht po tërhiqen ata faktorë politik dhe rrethanat politike të cilat kanë pamundësuar një veprim të tillë.

Por, edhe në këtë moment për Grupin Parlamentar të PDK-së regjistrimin nuk duhet shikuar si një çështje emocionale, si një çështje e cila mund të jetë në një anë apo në tjetër në ndikime që do të mund të kishin efektet e veta pas statusit.

Duhet të jemi shumë të ndërgjegjshëm që kjo çështje është mirë që është përgatitur deri në këtë masë. Ne e mirëpresim këtë angazhim të deritashëm të gjithë mekanizmave ndërkombëtarë dhe të këtyre vendorë për regjistrimin e popullsisë civile, por ende nuk janë si të them përballuar të gjitha vështirësitë për të ndodhur ky proces.

Dhe çdo vendim i saktë të një date të caktuar çfarë po ndodh në këtë rast në Kuvendin e Kosovës mendojmë që do të mund të sillte një datë jo krejt të realizueshme. Pra fjala është aty që dokumenti i Ahtisarit duhet të ketë ndikimet e veta edhe në këtë proces. Dhe nuk duket shumë korrekte që Kuvendi i Kosovës të caktojë saktë datën e mbajtjes së regjistrimit dhe të popullsisë civile dhe të mos i përmbahet kësaj date. Rruga më e mirë do të ishte që në konsultim me Përfaqësuesin Special të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe në autorizime çka Kuvendi për të bërë për këtë proces këto vijnë tek propozimi i saktë i datës dhe më pas i Kuvendit të marrim mendimin, në mënyrë që të jetë i realizueshëm në kohën e duhur.

Si do qoftë këto janë çështje teknike që duhet rregullojë Kuvendi, por Grupi Parlamentar i PDK-së edhe enë debatin që ka organizuar me Ministrinë e Shërbimeve Publike, që para një viti e gjysmë ka pas qëndrimin që në momentin që të vijë propozimi në Kuvendin e

Kosovës për mbajtjen e regjistrimit mbështetja e Grupit Parlamentar të PDK-së do të jetë e plotë ashtu si do të jetë e plotë edhe mbështetja nga gjitha grupet parlamentare të Kosovës, sepse kjo nuk është një çështje parciale ,por është një çështje globale, do të thosha një çështje të them një çështje etike për Kosovën.

Të nderuar kolegë, faktorët të cilët kanë ndikuar në shtyrjen e deritashme të kësaj çështje kaq të rëndësishme sigurisht që ne i dëgjuam dhe me siguri të gjithë me kujdesin me kujdesin më të madh ose me kujdesin maksimal do t'i qasemi kësaj problematike, por ajo që vlen të thuhet ndoshta në këtë moment është që fjalitë politizim duhet t'i shmangim nga kjo foltore, meqë regjistrimi nuk ka të bëjë asgjë me politikën dhe politizimin ,por ka të bëjë me një çështje jetësore për një vend. Prandaj ne inkurajojmë edhe atë grup ose atë pjesë të qytetarëve të Kosovës ,të cilët ende nuk janë bindur për të marrë pjesë proceset normale në Kosovë . Ne shpresojmë do t' i bashkohen këtij procesi kaq të rëndësishëm ,ashtu sipas obligimeve ligjore që dalin në Kuvendin e Kosovës.

Pra, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, mbështet këto përpjekje, këto përgatitje të bëra për regjistrimin e popullsisë civile. Përkrah vendimin e Kuvendit për caktimin e datës për mbajtjen e regjistrimit, në përputhje me të gjitha dokumentet që kemi në fuqi dhe natyrisht edhe me fuqinë ligjore që aktualisht në Kosovë ekziston. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, në emër të AAK-së deputeti Naim Maloku,

DEPUTETI NAIM MALOKU – Ju faleminderit zoti kryetar, i nderuari zoti kryeministër, ministra, të nderuar deputetë!

Grupi Parlamentar i AAK-së ka mirëprit vënien në rend të ditës dhe për debat të kësaj çështje jashtëzakonisht të rëndësishme për Kosovën dhe qytetarët e saj. Grupi Parlamentar i AAK-së vlerëson punën e gjertanishme të Ministrisë së Shërbimeve Publike të Komisionit Qendror për Regjistrimin Popullsisë dhe të Entit të Statistikave të Kosovës në punët përgatitore që ky proces të jetë korrekt dhe në kohë kur Kuvendi cakton datën.

Të nderuar deputetë! Historia e Kosovës tregon që gjithmonë në të kaluarën regjistrimi i popullsisë është politizuar. Pasojat nga politizimi i regjistrimit të popullsisë i ka pësua populli i Kosovës, posaçërisht shqiptarët që kanë qenë gjithmonë shumica absolute në Kosovë. Grupi Parlamentar i AAK-së, është kundër politizimit të regjistrimit të popullsisë,të ekonomive familjare dhe të banesave. Grupi Parlamentar i AAK-së, përkrah iniciativën e Grupit Parlamentar të LDK-së që Kuvendi i Kosovës të dalë sot me një datë të caktuar për mbajtjen e regjistrimit të popullsisë, duke konsideruar këtë si një veprim që duhet kryer sa më shpejtë për shkak se, nga regjistrimi i popullsisë dhe statistikave e sakta varet edhe zhvillimi ekonomik, planifikimi i zhvillimit ekonomik të Kosovës. Kosova ka përjetuar, të nderuar deputetë, në një 20 vjetët e fundit migrime të mëdha të popullsisë, qoftë brenda territorit të Kosovës, por edhe jashtë në faza të ndryshme dhe posaçërisht migrimet fshat-qytet në 10 vjetshin e fundit. Mungesa e

statistikave të sakta është krijuar si pengesë e patejkalueshme në planifikimin e zhvillimit ekonomik të Kosovës që nga komunat edhe nga ai qendror.

Ftoj deputetët e Grupit Parlamentar të AAK-së, që të marrin pjesë në debat me sugjerimet për këtë proces. Edhe një herë po e përsëris Grupi Parlamentar i AAK-së, mbështet vendimin që regjistrimi të popullsisë së mbahet në nëntor të këtij viti. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit në emër të ORA-s Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI- I nderuari kryeministër, kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë!

Është një fjalë e urtë popullore e cila thotë: Ku nuk ke çka me ba luaje derën. Më duket se ky debat i sodit i ngjet kësaj fjale të urtë popullore vetëm se na kemi shumë çka, çka me bë. Pra nuk e kemi komoditetin që të merremi me luajtje të derës djathtas e majtas. Kemi shumë punë të rëndësishme përpara.

Po shprehem në emër të grupit tim parlamentar, grupi im parlamentar debatin për këtë temë në këtë moment nuk e mirëpret. Është një debat i parakohshëm, i jashtëkohshëm ose i pakohshëm, kurrësi i kohëshëm. Nuk është i kobshëm, pikërisht për shkak të zhvillimeve politike, të cilat u artikuluann këto nga dy përfaqësues të grupeve parlamentare, nga Grupi Parlamentar i PDK-së dhe nga Grupi Parlamentar i LDD-së lidhur me zhvillimet rreth statusit të Kosovës.

Mendoj se para se të debatojmë për çështjet të cilat janë teknike, siç është regjistrimi, po edhe politike, këtu kemi një konfuzion pozicionimesh përderisa, ministrja tha është politizuar PDK-ja tha nuk është politik. AAK-ja tha është politik edhe ne mendojmë se është teknik dhe politik kur nuk mund të shmanget dimensionin politik i regjistrimit të popullsisë dhe pasurisë në një vend. Të gjithë e përmendëm që nga viti 1981 në Kosovë nuk është bërë regjistrimi i popullatës, po asnjëri nuk e tha pse nuk është bërë që nga viti 1981, për shkak të zhvillimeve politike në Kosovë. Në vitin 1991 Serbia ka pasur regjistrim, po në Kosovë regjistrimi nuk ka mund të zhvillohet pikërisht për shkak të zhvillimeve politike. Të insistohet sot në këtë moment, i cili është kaq delikat për mbarë procesin e definimit të statusit të Kosovës, të shkohet përpara me regjistrim të popullatës është mendoj një në vazhden e asaj që thashë në fillim - luaje derën, ose edhe një tjetër që ekziston më e mirë thotë “Shtëpia digjej, plaka krihej”.

Mendoj se është krehja e plakës në këtë moment të insistohet me e fillua procesin e regjistrimit të popullatës, duke pasur parasysh që Garda e Car Llazarit, në Mitrovicë ka ardhur, pavarësisht që pa armë. Gjithçka fillon pa armë, po armët janë element i fundit i tragjedisë dhe duke qenë se pozicionimet rreth Kosovës, për Kosovën madje edhe në Kosovë nga vetë kosovarët për Kosovën janë kaq konfuze, kaq dramatike, mendoj se Kuvendi i Kosovës duhet një orë e përpara ta hapë debatin lidhur me zhvillimet që po ndodhin këtu në Kosovë dhe rreth Kosovës, kurse posaçërisht duhet të hapet debati lidhur me uzurpimin e të drejtës së Kuvendit për ta shpallur konkursin për simbolet e Kosovës.

Uzurpimi i të drejtës së Kuvendit të Kosovës nga ana e Grupit të Unitetit për t'i shpallur simbolet e Kosovës në mënyrë institucionale ashtu siç parashohin

(ndërrhyrje kryetari, Kthehuni në temë ju lutem) Jam në temë, si nuk jam në temë, (unë po them se nuk je në temë) Uzurpimi i të drejtë së Kuvendit të Kosovës për ta shpallur konkursin për simbolet e ardhshme të Kosovës, mendoj se është një skandal kushtetues e juridik. Nuk ka shtet të së drejtës aty ku anashkalohen institucionet kushtetuese dhe institucion kushtetues në këtë vend është Kuvendi dhe nuk është Grupi i Unitetit. Prandaj ai që ka marrë vendim, ose ata që kanë marrë vendim që konkursi të shpallet përmes Grupit të Unitetit e ka anashkalua institucionin më të rëndësishëm të Kosovës që është Kuvendi i Kosovës dhe në këtë mënyrë nuk mundet me obligua Kuvendin e Kosovës me përzgjedh një dokument, i cili nuk e ka vulën e këtij Kuvendi.

(Ndërrhyrje kryetari –siç po e anashkaloni rendin e ditës),

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë duhet të merremi me çështje esenciale, të cilat janë të rëndësishme për momentin ,që janë,të mos them ashtu dramatike dhe jo të merremi me çështje të cilat janë të rëndësishme, por duhet tek të vijmë më pastaj. Mendoj se prioriteti i çështjeve. i problemeve ose mos prioritet e problemeve , i çështjeve është ajo që Kosovën aktualisht është duke e munduar më së shumti. Më falni që dola prej teme.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Nga Grupi Parlamentar 6+ deputeti XHezair Murati.

DEPUTETI XHEZAIR MURATI – Hvala gosp. Predsedniće, Evo prilika da pozdravim prisutne, premijera, ministre, kolege i da pozdravim inicijativu Ministarstva javnih službi što je pokrenula ovo važno pitanje za svako demokratsko društvo, koje treba da zna koji broj stanovnika živi u njemu, po godotu nakon pauze kako već svi znamo od punih 26 godina nakon propnih popisa koji su urađeni ovde stoji kao za svaku pohvalu, a na terenu ne stoji takva ocena dakla pohvala za inicijativu ali i prilika da se malo pozabavimo i važnošću popusa gospodo.

Mi ovde imamo našeg doajena profesora doktora Marka Krasnićija, geografa, koji zna iz struke šta znači popus stanovništva i demografija. I moja malenkost se bavi geografijom i ovaj svedok sam dosta popusa po kojima je i moj prethodni ulaženi kolega ogovorio, proces popusa je jedna važnost društvena zadaća, ja bih rekao zadatak dakle, i naše društvo u ovom momentu zaokupljeno mnogo važnim problemima smatram onom narednu izrekuću spomenuti, znate kaže shuma gora a baba se češlja. Čuna gori e neko e na njoj greje, nema mogućnosti kako da je ugasi. Zaokupljeni problema sa kojima se ... zaokupljeni, produžavanjem konačnog statusa Kosova, problemima koji nam se dešavaju na teritoriji, tekstem na mom maternjem jeziku koji nijedan nastavnik ne bi ocenio pozitivnom ocenom.

Možda je ministarka odrešila kecu i platila prevod ali je ovo katastrofalan prevod, ne znam ime i prezime čoveka koji je ovo radio, ali on blage veze sa jezikom nema. Ovaj dokumenat ja za razliku od vas kolege nisam mogao dobro da koristim. Prati sam probleme popuse, ali ovo je katastrofalno ovde nema ama baš nikakve veze sa formulacijama, sa sažetošću, sadržajem i takodalje. No ajde i ja ovim da se ne bavim, smatram formalnim, ja generalno gledano podržavam stavove mog prethodnog diskutanta kolege Jašarija, i

smatrajući da je popis stanovništva proces koji treba poduže da traje, po gotovu kad se u pitanju manjinske zajednice gospodo, koliko god se mi bavimo poslasticama koje imala većinska zajednica u problemima koje imala sa nenarodnim režimom. Zbog čega je došlo do pauze od 26 godina.

U demokratskim zemljama dobro ovde stoji, pravilo je svake prve decenije da se obavi popis. Međutim, da bi došli do priprema, ja ovde nisam uopšte video kako ćemo popisati građane Kosova koji se nalaze van Kosova, ja ne vidim ovde rešenje, a ako ne znamo koliko građana imamo van Kosova, o čemu mi to govorimo, ko će drugi da nam zna, dali treba da uradimo popis radi popisa ili treba popis da imamo radi efekta koji im treba .. znate ona francuska Lar Purlar, umetnost radi umetnosti, crtamo da bi slikali ali šta koja će slika izaći, biće apstraktna neka i pop arti i tako dalje, ja nisam umetnik ali evo.

Gospodo ja kažem da mi treba da ne žurimo sa ovim, slučajno sam nedavno gledao jednu debatu na javnom servisu televizije Bosne i Hercegovine, rat je tamo završen četiri godine pre rata na Kosovu, još nisu imali popis, i kad sam video demografe statističare i ostale društvene političke radnike koji su govorili o popisu, video sam i odmah sebe pravio, doveo u jednu paralelu i naše probleme, ja mislim da mi nismo spremni da sprovedemo propis onako kako međunarodni standardi zahtevaju i ako postoji podrška među narodne zajednice da obavim. Ja ne znam kako čemu mi znati gde su građani iz moje zajednice koji su otišli u vreme ratnih sugoba, predratnih itd. Nemamo mi ovde uopšte mogućnosti dalje ako i dođe do popisa, mi nismo protiv onoga što će voditi napred ovo društvo. Ali ja zahtevam da mi to učinimo na najdemokratski način uz uključivanje u proces popisa predstavnika moje zajednice i svim sredinama tamo gde žive predstavnici manjinske zajednice. Mislim da je to jedno ljudsko i demokratsko načelo koje treba da prihvatimo. Mislim da neće niko imati protiv ovakvog jednog mog zahteva, dakle unačelu mi jesmo za popis ali za popis koji će istinski da reši sva pitanje koja se njime traži. Ali u ovom momentu opterećni mnogo čine što nam je možda gori pod nogama, ne vidim da on može biti tako sadržajno i bogato i odnosno i objektivno biti urađen. Hvala vam!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, në emër të Grupit për Integrim Numan Baliq

DEPUTETI NUMAN BALIQ - Ju falemiderit zoti kryetar,

Jaču u ime grupe za integraciju i u svoje osobno ime nastojati da iznesem neke stavove koji su pre svega fragmatični, naravno naj pre da sve selamim, i poželim vam uspjeh u radu, i da kažem neke stvari koji smatram da su veoma ozbiljnima. Dali nam treba popis, naravno da nam popis treba, popis je trebao odavno da se uradi, i mišljenje moje grupe i osobnog moje mišljenje da i status Kosova i popis Kosova su trebali davno da se obave. Stataus je trebao da se reši 99. priprem za popis su trebale biti 2000 a popis je trebao biti 2201 i naravno taj popis koji će biti neće biti jedini u narednih 50 godine, imaćemo ponovo popis. Pa ako taj naredni popis koji budemo bavili ne bude potpun, možemo imati dopunski popis ili novi popis za 5 godina. Ali da se bavimo malo značajem popisa u ukupnoj ulozi društvenog života svih nas kosovara.

Nijedana ozbiljan posao koji se tiče istraživanja, ulaganja, preduzimanja svih vrsta poslova i institucija na centralnom nivou, vladinom nivou, u svakom nivou u svim sektorima, ne može se obaviti bez statistike, ne može se baviti bez procene stanovnika i ne samo stanovnika, nego i imovine, vrlo često polazimo o toga jer imamo u vidu stanovništva, zaboravljamo imovinu, onda sporo imovine itd. Itd. Šteta koje smo do sada imali je nesaglediva, šteta se rpe svega tiče ne samo zajednica koja su godovi svih zajednica, posobno malo brojnih zajednica bošnjaka, roma, egipčana itd. govora na kojih je veliki broj van Kosova, ali se takođe tiče i većinske zajednice, i velikog broja albanaca koji su, stotina hiljada koji su van Kosova i njihova imovina koje ovde. Po tom se problem tiče Mitrovice enklava, zaboravili smo da naše stanovništvo koji živi u velikom broju u severom Kosovu, u Mitrovici, u enklavama je takođe taoc neobavlejnog popisa, mi ne znamo koliko ima naših ljudi u Mitrovicu koliko u Leposaviću, koliko drugim opštinama, ne možemo zaboraviti te delove Kosova.

Naravno da ne želim da ovime ne patriotiziram bilo što ali govorim o fragmatičkim efektim ovog pitanja. Mislim da su međunarodne organizacije trebale pokazati mnogo više sluha, mislim da je UNMIK i na ovom pitanju ponovljao, mislim da je Evropska zajednica Američka kancelarija zapadna kancelarija takođe ponavljali na ovom i debelo ponavljali na ovom pitanju, mislim da domće institucije sve redom počev od onih privremeni posle rata, pa onda prva vlada i ova aktuelna Vlada, da su takođe ponavljale na ovom pitanje, jer to trebalo ozbiljno da se razmatra i da ne zaborivim, na žalost ovo će biti jedna od polemika koje nisu ozbiljne. Očigledno je. Većina politički partija nastupala tako da bi zadovoljila svoje glasače da bi rekla ono što je lepo reći, niko ovde neće konkretno janso i odlično reći mi ovo moramo uraditi i mi ćemo uraditi na ovaj i ovaj način, a ako nam, ne bude dozvolili specijalni predstavnik i neko drugi štaćemo radi u tom smislu.

Do sada nemamo takvih predloga, dakle očigledno da je na temu još jedna od rasprava koja će se održati red radi. I da se vratim na ove praktične momente, takođe jaću poči od ovog famosnog člana 14.1 u Ahtisariom paketu, i počiću od onog drugog pasusa koje manje važno, ali u stvari za sve zajednice je veoma važno. Ali drugi pasus govori o ulozi Republike Srbije u budućem popisu. U Bosanskoj verziji je jako loše prevedeno, tako da ću citirati albansku verziju koja kaže do.. sledeće: „në këtë kontekst Republika e Serbisë dhe shtetet tjera fqinjë do të autorizojnë regjistrimin përmes një agjensie ndërkombëtare të refugjatëve dhe personave të zhvendosur që dëshirojnë të kthehen në Kosovë“.

Ovde se samo spominje Republika Srbija i uzgred se spominju druge susedne države. Molim vas, za nas je veoma važno zar su samo druge zajednice pdetstavja na srpskom zajednicom, zar ne postoji problem oseljenih i izbegleh u Bosnji, Sandžaku, Crnoj Gori, Makedoniji, Albaniji i diljem evrope. Zar nije više od 60%, bošnjaga, gorana, roma, egipčana i aškaljija iseljeno ili prognano u zemljama koje sam spomenu, i u evropskim zemljama. Više od 60% blizu 80'90 hiljada bošnjaka, roma, gorana, egipčana itd. Nalazi se u ovim zemljama. Mi smo jako zainteresovani time i mislim da svi treba biti zainteresovani. Kao što smo takođe zainteresoani i velikim brojem stotina hiljada albanaca koji su već nekoliko dekada iseljeni van Kosova. Takođe smo svi jako

zainteresovani šta sa stanovništvom i imovinom, u bošnjačkoj mahali, u severnoj Mitrovici, u Leposaviću, u opštinama na severu Mitrovice u enklavama.

Jesmo li mi te opštine i te djelove Kosova prosto zaboravili, samo da vam kažem da na severu Mitrovice živi 1150 bošnjaka i značajem broj albanaca. Potpuno se slažem naravno da u oni pitanjem koji gospodin Keljmeni poteknuo na prošloj sednici parlamenta, sa tim što je mnogo manje govoreno o proplemima bošnjaka, turaka roma i drugih zajednica, dakle imamo jedan strahovit problem o kome moramo dogovoriti, moramo govoriti, i sada sa vraćm na suštinu pitanja, glavno pitanja na nedoslednost koji smo pokazali mi kao poslanici a pre svega nažalost vođe institucije Kosova i članovi grupe uniteta, ja i definitivno zovem dozvolitemi takozvane grupe uniteta. Nije moguće da ovaj parlament izglasa Atisarijev paket, u kome jasno stoji sledeće: da se godina dana nakon usvajanja paketa ili rešavanje statusa Kosova rešjava pitanje obavlja pitanje popisa. I da taj isti parlament danas tako neozbiljno i smješno raspravlja o pitanju koje već usvojio. Raspravlja o popisu.

Pa gospodo moja, hoćemo li mi se predržati onoga što parlament usvojio ili ćemo ponovo razmatrati o nećemu drugog. Ako mene pitate mos osobni stav je dali treba popis, da popis treba, ali ako hoćemo popis onda stegnite kaiševe pa onda hamo da oborima Ahtisarijev paket i da donesemo odluku da hoćemo da obavimo popis, i naravno poništimo odluku parlameta koju je ovaj parlament doneo. Ne možemo se igrati, uprotivnom delovima neosbiljno sami prema sebi i smješni, znači parlament će zasjediti onda kako nama odgovara. Jednom ćemo doneti odluku da je Kosovo potpuno nezavisno, drugi put kad nas nam govori gospođa Kajdanov, donećemo odluku da Kosovo treba biti uslovno nezavisno odnosno nadgledano nezavisno nezavisnost, posle toga ćemo donjeti odluku da ćemo držati izbore a Ahtisarijev paket smo usvojili i on kaže jasno, izbora nema do godinu dana posle rešavanja satusa Kosova, ove nedoslednosti mi moramo rješiti, dakle, ja predlažem, mi ćemo dati puni doprinos, ja predležem da ozbiljno preispitamo ukupnim situaciju.

Ja predlažem da se parlamentarni život vrati parlamentu Kosova, ja molim gosp. predsedavajućeg Kolje Berišu, predsednika Berišu da pusti poslanike neka pričaju, ne moj mu ograničavati, neka pričaju o čemu oni žele, hajmo da se dogovorimo o važnim posla na kojim se tiću naroda Kosova ali budemo dosljeni i budimo ozbiljni. Mi smo spremni da damo doprinos. Hvala vam ljepo.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, në emër të LDD deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit. I nderuari kryetar, i nderuari kryeministër, ministra të pranishëm dhe kolegë deputetë të nderuar.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, duke përkrahur propozimin për debat kuvendor për regjistrimin e popullsisë dhe ekonomisë familjare, përkrah Ministrinë e Shërbimeve Publike dhe Entin Statistikor të Kosovës, për punën dhe përgatitjet e bëra deri më tani në këtë projekt për regjistrimin e popullsisë dhe ekonomisë familjare si një projekt me rëndësi të madhe për Kosovën dhe në veçanti në rrethanat e paraprkashme

dhe ato që do të pasojnë pastaj. Grupi Parlamentar i LDK uron sukses që ky projekt të realizohet për t'i eliminuar dilemat e shumta të cilat sot u diskutuan këtu dhe shumë dilema për çka vërtet Kosova dhe popullata e saj dhe institucionet e Kosovës nuk mund të punojnë në mënyrë as shkencore as parimore dhe përmbajtjesore, që nga numri i popullatës, numri i ekonomive familjare, vërtetimi i gjendjes pronësore, numri i mërgatës, numri real i popullsisë, struktura profesionale dhe shkollore e popullatës së Kosovës, gjendja e bujqësisë, gjendja në blegtori e Kosovës, dëmet e shkaktuara gjatë luftës dhe një mori kompleksesh dhe problemesh që kanë të bëjnë me ekonominë familjare dhe me popullin tonë.

Regjistrimi i popullsisë dhe i ekonomisë familjare në rrethanat normale bëhet, u theksua këtu në çdo dhjet vjet dhe kaluan aq kohë nuk u bë. Për këtë, të gjithë jemi të informuar, këtë e dimë. Duke përkrahur iniciativën për mbledhjen e shënimeve ne mendojmë se ato jo vetëm duhet mbledhur, por duhet përpunuar në mënyrë profesionale dhe në aspekt shkencor, për të dhënë pastaj publikime dhe orientime si mbi bazën ekonomike, mbi bazën demografike dhe mbi bazën statistikore. Natyrisht, ne mendojmë se regjistrimi i popullsisë dhe ekonomisë familjare duhet përfshirë tërë territorin e Kosovës. E theksoj këtë në veçanti, sepse pikërisht këtu kemi deputetë të cilët kanë dalë me deklaratat se ndarja e Mitrovicës është e mundshme nëpërmes vijës së lumit Ibër, sot nuk po ia them emrin në mbledhjen e ardhshme po, Kemi konstatimin tjetër se Veriu i Kosovës duhet falur për hir të Kosovës dhe atje duhet bërë regjistrimi dhe konstatimi i fundit që doli - u tentua të demantohet por është shumë real se Kosova Veriore do të ketë një autonomi substanciale dhe ata që e dinë që është autonomia substanciale nuk do të pajtohen, prandaj duhet bërë regjistrimi edhe atje. Ky regjistrim duhet bazuar në standardet ndërkombëtare, duke përfshirë të gjithë qytetarët edhe mërgatën, por specifikat e Kosovës, nuk lejojnë, jam thellësisht i bindur se me profesion përveç tjerash jam edhe gjeograf, të përmbushen të gjitha kriteret e standardeve ndërkombëtare, se çdo standard ndërkombëtar është thye në Kosovë dhe nuk punohet në bazë të këtyre standardeve.

Prandaj, standardet janë bazë kufizuese për ta realizuar regjistrimin e popullsisë dhe ekonomisë familjare. Ne përkrahim që regjistrimi të bëhet, siç u theksua këtu në nëntor, formularët duhet të jenë në nivelin e lartë, duke përfshirë edhe rubrikën e vendbanimit paraprak dhe jo të vendqëndrimit, dhe pikërisht kjo vlen për pjesën Veriore të Kosovës nëse dëshirojmë t'i kem të dhënat të vërteta, reale, ashtu siç duhet të jetë një regjistrim në shoqëri demokratike. Të bëhet përgatitja për trajnimin u theksua se është arritur, por regjistrimi kërkon edhe trajnim edhe profesionalizëm dhe përpunim të tyre. Të sensibilizohet popullata, natyrisht për këtë projekt kaq të rëndësishëm. Duke përkrahur edhe një herë Ministrinë për punën që ka bërë dhe në veçanti për komentimin që sot dha këtu rreth nenit 17, regjistrimi duhet të bërë brenda një viti dhe jo të lejohet pas një viti. Dhe ne konsiderojmë se ky regjistrim nuk duhet politizuar, por me vetë faktin se i mundësohet Serbisë për të bërë regjistrim në Kosovë përmes një agjencie të specializuar dhe gjitha agjencitë e specializuara të pa-specializuara dhe çfarëdo funksioni të themi është ndërhyrje e drejtpërdrejtë në kompetencat e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë dhe në veçanti në kompetencat e institucioneve tona lokale dhe ato qendrore dhe si e tillë është politike. Ne përkrahim regjistrimin dhe dëshirojmë që ky të realizohet sa më shpejtë për karshi problemeve që u theksuan. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu, le të përgatitet deputetja Qibrije Hoxha

DEPUTETI ALI SADRIU – Ju faleminderit zoti kryetar i Kuvendit, përshëndetje për ju ,kryeministrin, ministrat dhe kolegë deputetë përgjithësisht.

Debatin për regjistrimin e popullatës e mirëpres si një rast ku duhet të diskutojmë për proceset negative apo pozitive, që janë si rrjedhim i mos regjistrimit të periudhe afatgjate. Është krejt e natyrshme që Organizata e Kombeve të Bashkuara përmes mekanizmave të vet, obligon të gjitha shtetet që në çdo dhjetë vjet të bëjë regjistrimin e popullatës dhe të ekonomive familjare edhe të pasurisë në përgjithësi. Kjo është një databez, një bazë për çdo analizë, për çdo veprim dhe mungesa e një dokumenti të tillë në Kosovë, në periudhën pas lufte ka sjell shumë probleme dhe pakënaqësi.

Ata që me këtë veprim nëse i kanë kontribuu që të zhagitet dhe të mos ndodhë menjëherë pas luftës, me mendimin se po ndihmon në një proces cili do qoftë ai, i përgjithshëm apo i veçantë, do thosha se e ka dëmtua procesin e përgjithshëm dhe procesin në veçanti. Këtë nuk e them rastësisht, sepse që në janar të vitit 2000, në një strategji të hartuar për zhvillimin ekonomik të Kosovës, figuron databezi i disa të dhënave që për mua kanë qenë habitësh dhe ndër të tjera ju citoj një element ku thuhet se Kosova është një bashkësi multietnike me 30% etnitete. Këtë realitet në asnjë regjistrim nuk e kam hasur që ka ndodhur ,qoftë nga institucionet e Kosovës në atë kohë, apo edhe para institucioneve kur Serbia edhe aty ka pasur gjithë mekanizmin e vet veprues, ka pasur edhe disa rrjedha të tjera dhe them se një e dhënë e tillë, një dokument i tillë ka sjell probleme të mëdha në hartimin e politikave buxhetore, qoftë vjetore apo afatmesme, të mos flas për ato afatgjate. Problemet kanë lindur përmes ndarjes fer nëpër kuvende komunale, i dinë kuvendet komunale . Mua më habit reagimi i disa njerëzve të cilët në një kohë kanë kryer ato funksione dhe i dinë ato probleme që kanë qenë rrjedhim i një statistike joreale në debate ku është dashur shumë herë të intervenohet nga pushteti qendror. Pa një regjistrim të mirëfilltë të popullatës, a t’ju përkujtoj se në Kosovë është operuar pas luftës me të dhëna se Kosova ka popullatë 1.700.000 deri në 2.300.000 banorë. Ky është ndryshim tepër i madh dhe në bazë të këtyre të dhënave është e pamundur të hartosh çfarëdo politike që do të jetë afër realitetit. Në këtë kontest politikat buxhetore, flas nga prizma e politikave buxhetore, qoftë politikave të arsimit, qoftë politikave të shëndetësisë, qoftë të politikave të pensioneve apo të mirëqenies sociale, këto të dhëna kanë qenë një hendikep i madh për të nxjerrë politika të arsyeshme dhe reale në ato periudha. T’ju përkujtoj se është mirë e ditur se në Kosovë është dashur të ndodhë kjo menjëherë pas luftës jo vetëm për arsye se nga viti 1981 nuk ka pasur regjistrim, por Kosova edhe para luftës, po në veçanti gjatë luftës ka pësuar ndryshime demografike, dramatike dhe ato po i paguajmë ne e në veçanti me politikat e arsimit dhe në politikat e shëndetësisë.

Unë mendoj se deputetët e Kosovës në këtë debat e kuptoj se janë të ngarkuar me ngjarjet dhe zhvillimet shpeshherë që i përdorin dramatike, e unë do të thosha tepër të rëndësishme, janë ato të cilat duhet të merren , por dua t’ju përkujtoj se nuk është hiq më pak e rëndësishme politika në përcaktimin e një realiteti në Kosovë, qoftë të numrit të njerëzve që jetojnë në te, etnive, prezenca e tyre këtu dhe kudo që janë ashtu edhe të

ekonomive familjare të tyre dhe pasurive në përgjithësi. Mungesa e një elementi të tillë dhe mungesa e dokumentacionit tjetër kadastral që e bëri Serbia ku nuk e bëri asnjë pushtues tjetër kudo në botë e mori dokumentacionin me vete dhe është shumë e vërtetë po e cekim që tani falsifikohet dokumentet origjinale të ndërrimeve të periudhës së viteve 90 rreth pasurisë dhe Kosova do të gjendet në të Ardhmen një problematikë tepër komplekse dhe në një problematikë që do të ketë shumë vështirësi të riparojë atë çka ka ndodhur, çka po ndodh dhe çka po ndodh në emër të atyre dispozitave. Në këtë drejtim do t'ju them se drejtpërdrejtë është mirë e njohur që Qeveria e Kosovës në vit paguan diku 4 milion euro qira. Në anën tjetër me një analizë që e kemi bërë në vitin 2003 si Qeveri në Prishtinë kemi gjetur 16 objekte publike në të cilat janë të vendosur jo vetëm institucionet ndërkombëtare, por edhe bizneset private. Ata shfrytëzojnë objektet publike dhe Qeveria angazhon dhe blen hapësira për të kryer punën e vetë normale. Këta janë disa indikatorë nëse duam që problemin ta trajtojmë ashtu si duhet dhe me bazë. Në këtë drejtim mendoj se bashkësia ndërkombëtare jo që nuk është dashur ta pengoj; këtë dhe nuk duhet ta pengoj; me asnjë gjë tjetër nëse nuk ka në vetëdijen e vetë ndonjë manipulim politik. Po them ndonjë vendim për manipulim, përndryshe regjistrimi i popullatës, me të drejtë e tha ministrash absolutisht nuk ka të bëjë me politikën. Ka të bëjë me një element bazë të përcaktimit të politikave reale të mirëqenies së gjithë njerëzve. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Qibrije Hoxha, kurse le të përgatitet deputeti Ferid Agani.

DEPUTETJA QIBRIJE HOXHA – Ju faleminderit i nderuari kryetar. I nderuari kryeministër, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputet;

Së pari më lejoni që ta përgëzoj ministren e Shërbimeve Publike për kontributin që po jep për realizimin e regjistrimit të popullsisë. Më lejoni që për regjistrimin e popullsisë të përqendrohemi në rëndësinë e regjistrimit të diasporës. Në bazë të Ligjit për regjistrimin e popullsisë 2003/16 si popullsi vendase llogariten edhe ata të cilët përkohësisht jetojnë jashtë Kosovës. Jashtë Kosovës gjendet një numër i madh i popullsisë së Kosovës, të cilët e lëshuan Kosovën pa vullnetin e tyre dhe nga dhuna e regjimit në periudha të ndryshme kohore. Rreth numrit të qytetarëve të Kosovës që gjenden jashtë Kosovës, ka vetëm supozime. Të pakta janë ato familje të Kosovës të cilat nuk janë prekur nga ky largim i pavullnetshëm në pjesë të ndryshme të botës, në shtetet e Evropës, në SHBA, në Australi etj. Këta njerëz kurrë nuk janë shpëputur nga Kosova, as emocionalisht as materialisht, as familjarisht e as në aspektin human. Arsyeja është sepse ata e lëshuan Kosovën kundër dëshirës së tyre. Pra, po flas për këtë kategori të popullatës tonë e cila u dëbua, u largua nga Kosova pa vullnetin e vet.

Tani kur në Kosovë me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare po krijohet shteti ligjor, këta njerëz kanë të drejtën ligjore që të trajtohen si popullatë vendase. Diaspora jonë si e quajmë ndryshe, kategoria e bashkëkombësve tanë për të cilët po flasim, kanë nevojë për trajtim dinjitoz nga shteti i Kosovës. Si e drejtë e tyre elementare, regjistrimi i diasporës tonë nuk ka rëndësi vetëm në aspektin emocional e që lidhet me rikthimin e dinjitetit të tyre si qytetarë të barabartë të Kosovës, por regjistrimi i diasporës tonë ka rëndësinë e vet në krijimin e politikave të drejta për investime të bashkatdhetarëve tanë në Kosovë, si

për lobim për zhvillim të përgjithshëm ekonomik të Kosovës dhe për të drejtën e pajisjes me dokumente të ndryshme personale.

Të nderuar kolegë deputete

; Para Qeverisë tonë dhe para bashkësisë ndërkombëtare qëndron një sfidë lidhur me regjistrimin e atyre që për një periudhë më të gjatë gjinden jashtë Kosovës. Thuhet se sipas standardeve ndërkombëtare në regjistrimin e popullsisë nuk mund të marrin pjesë ata të cilët gjinden jashtë vendit për më shumë se 12 muaj. Mirëpo standardet ndërkombëtare bëjnë fjalë për individë, për persona të cilët për ndonjë arsye dhe vullnetarisht jetojnë jashtë vendit në periudha më të gjata kohore, kurse diaspora jonë e cila numëron numër të madh prej qindra mijëra njerëzish u largua nga dhuna në grupe të mëdha thuajse kolektivisht dhe për këtë arsye ajo mbetet e lidhur dhe e pashkëputshme me Kosovën në shumë aspekte. Ata bashkatdhetarë që ne i quajmë diaspora e Kosovës e ndihmuan Kosovën që të mbijetojë, pra jetuam në mënyrë më modeste, ndanë para për Kosovën nga djersa e tyre sepse ndjehen se janë përkohësisht jashtë Kosovës dhe kanë të drejtë të kthehen aty ku kanë lindur, aty ku kanë jetuar dhe aty ku i kanë shtëpitë e veta, ndihma e diasporës nuk ishte vetëm ndihmë materiale, por diaspora ishte pjesëmarrëse aktive në ndërtimin e shtetit të Kosovës dhe proceseve demokratike. Diaspora jonë veprimi në mënyrë të organizuar dhe të gjithë veprimtarinë e vetë e bëri në koordinim të vazhdueshëm me qendër në Prishtinë. Bashkatdhetarët tanë krijuan miq anë e mbanë rruzullit tokësor për të ndihmuar dhe realizuar lirinë dhe pavarësinë e Kosovës të Kosovës së tyre pjesë e së cilës kanë të drejtë të jenë. Diaspora jonë duke ndihmuar, nuk i bëri shërbim vetëm familjeve të veta, por i bëri shërbim të mirë edhe shteteve demokratike të Evropës, sepse parandaloi katastrofë humanitare në Kosovë për 10 vite me radhë, po të mos ishte diaspora jonë barra do t'i binte mbi shtetet e Evropës që të mbante gjallë Kosovën e pa punë, Kosovën pa shëndetësi, Kosovën pa arsim, pra diaspora kurrë nuk u shkëput nga Kosova ishte faktor i rëndësishëm i ndërtimit të Kosovës së re, të Kosovës e cila jo vetëm që do ta numëroj atë, por edhe do të përkujdeset për të si një pjesë e pandashme të saj. Sot Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare kane obligim ta dijë se ku gjendet diaspora e saj, sa njerëz janë, cilat janë format e organizimit të tyre, këto të dhëna i mundësojnë Qeverisë tonë në hartimin e politikave më të mira të zhvillimit ekonomike të Kosovës, sepse regjistrimi i diasporës tonë mundëson ta dimë se cilat janë mundësitë e tyre për të investuar në Kosovë. Cilat janë mundësitë e tyre për të tërhequr investitorët e jashtëm. Regjistrimi i diasporës tonë do të bëjë të mundshme ta dimë se cilat janë nevojat e saj për organizimin e tyre më të mirë, për ruajtjen e gjuhës dhe traditave dhe kulturës tonë kombëtare.

Regjistrimi i diasporës tonë do të krijoj atyre besimin ndaj shtetit të Kosovës, obligimin ndaj shtetit si dhe vetëbesimin më të mirë për vetën e tyre dhe familjeve të tyre, regjistrimi i diasporës tonë do t'ju mundësojë bashkatdhetarëve tanë që ta gëzojnë të drejtën e votës për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë dhe kështu Kosova do të ketë mundësi që të zhvilloj proces më demokratik zgjedhor pa i përjashtuar qytetarët e vetë kudo që ata ndodhen. Regjistrimi i popullsisë në Kosovë është element i rëndësishëm në procesin demokratik të shtet formimit dhe njëkohësisht paraqet garanci për zhvillim normal ekonomik në partneritet me bashkësinë ndërkombëtare dhe diasporën tonë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ferid Agani, kurse le të përgatitet deputeti Ibush Jonuzi.

DEPUTETI FERIDA AGANI – Faleminderit z. kryetar.

Fillimisht dëshiroj që në cilësinë e shefit të Grupit Parlamentar për Integrim të bëj një distancim nga një pjesë e diskutimit të anëtarit tonë të Grupit Parlamentar deputetit Baliq ku i referohet Zyrës Amerikane në Prishtinë dhe udhëheqëses së sajë znj. Tina Kajdanov. Një pjesë e deklaratës e cila lënë mundësi që të interpretohet si një sugjerim për manipulimin eventual të mundshëm të Kuvendit të Kosovës nga kjo zyre, që nuk reflekton qëndrimet e deputetëve të Grupit Parlamentar për Integrim lidhur me këtë çështje. Le të kuptohet kjo pjesë si një deklaratë si një qëndrim personale e deputetit Baliq. Njëkohësisht po e ritheksoj qëndrimin e Grupit Parlamentar për Integrim lidhur me mungesën e konsekuencës së Kuvendit të Kosovës kur është në pyetje çështja e vendosjes së datës për mbajtjen e regjistrimit të popullatës së Kosovës. Në qoftë se ne me veprimet tona në këtë mënyrë fillojmë të shprehim nervozizëm dhe një lloj pakënaqësie në përmbajtjen e pakos së Ahtisarit që e kemi miratuar në këtë Kuvend, atëherë legjitimojmë edhe kërkesat e tjera për pakënaqësitë e tjera në përmbajtjen e kësaj pakoje. Prandaj, unë mendoj se Kuvendi i Kosovës duhet të jetë në nivel të përgjegjësisë dhe që me veprime të ngutura të mos prejudikojë në asnjë mënyrë diskrepancën e qëndrimeve të tij. Ndonëse është shumë e qartë që edhe regjistrimi i popullatës si njëri prej veprimeve më të rëndësishme, si njëri prej akteve më qenësore për planifikimin senzik dhe për përfitimin e politikave zhvillimore të endit është peng zgjidhja e statusit politik të Kosovës, është shumë qartë një gjë e tillë, prandaj për kundër dëshirës së mirë me siguri të iniciuesit të debatit, mendoj se kjo çështje nuk guxon të shërbej si një moment ku do të hapen dilema rreth përcaktimit të Kuvendit të Kosovës në procesin e statusit politik sa i përket dokumentit të Ahtisarit që paraqet bazën e këtij procesi. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ibush Jonuzi, kurse le të përgatitet deputeti Nexhat Rexha.

DEPUTETI IBUSH JONUZI – Faleminderit. I nderuari kryetar i Kuvendit të Kosovës, i nderuari kryeministër, ministra të pranishëm, të respektuar kolegë deputetë, zonja dhe zotërinj. Përgatitjet për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë, të ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë do të doja që në fillim ta përgëzoja Ministrinë e Shërbimeve Publike për punën e madhe për t'i bërë përgatitjet për regjistrimin e përgjithshëm në Kosovë të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave. Raporti në mënyrë kronologjike prezanton ecuritë nëpër të gjitha fazat e përgatitjeve dhe monitorimet ndërkombëtare. Është fascionuese që Ministria e Shërbimeve Publike ka bërë një regjistrim testues sipas rekomandimeve më të fundit ndërkombëtare dhe se mekanizmat vlerësues ndërkombëtar janë shprehur edhe publikisht të kënaqur me rezultatet e arritura. Mendoj se ky është njëri nga sukseset më të mëdha të institucioneve tona në periudhën e pasluftës. Është mëkat që për shkak të influencës politike jashtë Kosovës nuk ka participuar një pjesë e popullatës në Kosovës. Mendoj se është detyrë e Qeverisë së Kosovës, Kuvendit të Kosovës dhe Institucioneve ndërkombëtare të pranishme në Kosovë që të punojnë më shumë për të krijuar atmosferën e volitshme, e cila do të shpinte drejt një regjistrimi gjithëpërfshirës si premisë relevante për të fituar figurën

reale të numrit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë, informata kam mbase të rëndësishme për zhvillimin e politikave reale në vendimmarrje të institucioneve tona, e në veçanti në ndarjen e buxhetit, por edhe ndërtimin e çerdheve, shkollave të reja, ndërtimin e infrastrukturës. E tërë kjo do të kishte impakt edhe në infrastrukturën nominale që është e rëndësishme për këtë fazë. Gjithashtu dua të besoj se Kuvendi i Kosovës duhet që ta ndihmojë regjistrimin e popullsisë me infrastrukturën adekuate, konform rekomandimeve më të reja të OKB-së për regjistrimin e popullsisë. Është e rëndësishme që Kuvendi i Kosovës të shfrytëzojë të gjitha potencialet e veta për të eliminuar të gjitha barrierat që shfaqen përballë regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe banesave.

Mbajtja e suksesshme e regjistrimit sipas rekomandimeve ndërkombëtare të shoqëruar me një vëzhgim nga Komisioni Monitorues Ndërkombëtar, i cili u shpreh i kënaqur me demonstrimin e kapaciteteve të mjaftueshme të Entit Statistikor të Kosovës për regjistrimin e përgjithshëm dhe konfirmimit të Divizionit të Statistikave të OKB-së me një konferencë ndërkombëtare për regjistrimin e popullsisë. Kosova ka mbajtur një regjistrim sipas standardeve më të fundit ndërkombëtare. Është për ta përgëzuar Ministrinë e Shërbimeve Publike për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar në këtë proces dhe për fund kam këto pyetje:

1. Regjistrimi testues nëntor 2006 ishte sipas standardeve ndërkombëtare, por regjistrimi i përgjithshëm është tanguar nga pakoja e Ahtisarit si dhe nga disa impakete politike. Si do të tejkalohen këto?
2. Cilat janë avantazhet e regjistrimit të dytë pilot në raport me të parin?
3. Prej regjistrimit testues e deri më tani çfarë është bërë drejt sigurimit të pjesëmarrjes së tërë popullsisë në regjistrimin e tërësishëm në Kosovë?
4. Po që se nuk ka asistencë teknike nga jashtë, a është në gjendje që vet ta zhvillojë regjistrimin e përgjithshëm Enti Statistikor i Kosovës?

Dhe në fund e mbështes listën e Ministrisë së Shërbimeve Publike që regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë, i ekonomive familjare dhe i banesave të bëhet në këtë vit. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Nexhat Rexha, kurse le të përgatitet deputeti Bislim Hoti.

DEPUTETI NEXHAT REXHA – Faleminderit z. kryetar, kryeministër, ministra dhe të nderuar kolegë deputetë Të gjithë ne jemi të vetëdijshëm se regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë është i rëndësishëm, i nevojshëm, sepse regjistrim që njihet ndërkombëtarisht në Kosovë nuk është bërë që nga viti 1981, edhe pse në Kosovë në vitet 90-ta janë bërë regjistrime nga më të ndryshmet për popullatën shqiptare që ka jetuar në Kosovë, nga partitë politike, duke i përfshirë edhe shumë elemente tjera të cilat kanë shërbyer për nevojat të përgjithshme. Por ato regjistrime nuk janë njohur ndërkombëtarisht, prandaj edhe rëndësia e tyre ka qenë e vogël dhe nuk ka qenë sa duhet funksionale. Pra, duke pasur parasysh këtë periudhë 26 vjeçare, pa regjistrimi për të gjithë qytetarët që jetojnë në Kosovë dhe për të hequr dilemat e ndryshme e në shumë raste edhe manipuluese nga Serbia, gjithnjë në dëm të qytetarëve shqiptar të Kosovës dhe është krejt e natyrshme që të pranohet arsyeja se janë pjekur

kushtet për një përmbledhje të numrave me një emërues të përbashkët e kjo çështje mund të bëhet ,duke i përmbledhur në këtë. Të gjitha dokumentet e miratuar në Kosovë ,si ato vendore dhe ato ndërkombëtare,tregojnë se është përgatitur baza ligjore për fillimin e regjistrimit të popullsisë në Kosovë. Të gjithë jemi të vetëdijshëm se regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë është domosdoshmëri e kohës, me të cilën saktësohet ana teorike dhe praktike e popullsisë. Pastaj është me rëndësi për të ardhmen e Kosovës që të përfshihen edhe komunat të cilat në këto vite i kanë ikur obligimeve dhe përgjegjësi të institucioneve të Kosovës. Regjistrimi i parë testues dhe ai i dytë ka dëshmuar se ishte i suksesshëm dhe është me rëndësi të bëhet regjistrimi i popullsisë, me qëllim që të hiqen dilemat që e pengojnë zhvillimin e vendit tonë në shumë pikëpamje. Gjatë regjistrimit testues në disa komuna të Kosovës është konstatuar edhe më tej politika e Beogradit si pengesë për vetë minoritetin serb që dëshiron të jetoj në Kosovë, kështu që me këto direktiva pengohet procesi i vetë zhvillimit të këtyre familjeve, edhe njëfarë mënyre Serbia krijon dilema për serbët në Kosovës. Duke i parë këto shenja në praktikë, institucionet e Kosovës dhe ato ndërkombëtare duhet të ndërmarrin hapa konkretë për këtë sferë shumë të rëndësishme në krijimin e shtetit të Kosovës ,që garanton tretman të njëjtë për të gjithë qytetarët e saj. Pas sigurimit të mjeteve financiare të tërësishme, të cilat do të garantojnë fillimin dhe mbarimin e punës funksionale në terren për regjistrimin e popullsisë në Kosovë dhe në harmoni me rrethanat politike në Kosovë dhe regjistrimi mund të jap rezultate konkrete, sepse të gjithë ne jemi në ankth të pritjes së zgjidhjes së drejtë të statusit të Kosovës. Unë konsideroj se regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave duhet të bëhet në konstelacion të rrethanave ekzistuese në harmoni të zgjidhjes së statusit të Kosovës për të marrë kuptimin politik, ekonomik dhe zhvillimor për një Kosovë, ashtu siç i duhet banorëve të saj që jetojnë dhe veprojnë në të. Pra,është me rëndësi të veçantë historike dhe politike që ky regjistrim i popullsisë të jetë i pranuar edhe ndërkombëtarisht, duke i plotësuar standardet e mirëfillta të regjistrimit të një shteti. Unë konsideroj se sa më parë që të bëhet regjistrimi i popullsisë aq më mirë do të jetë për të gjithë ne. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË VERISHA - Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Bislim Hoti, le të përgatitet deputeti Ymer Halimi,i fundit.

DEPUTETI BISLIM HOTI – Ju faleminderit .I nderuari kryetar, i nderuar kryeministër dhe ministra dhe ju të nderuar kolegë deputetë.

Sot para veti kemi një raport që ka të bëjë me regjistrimin e popullsisë, të ekonomisë familjare, të objekteve për banim, i cili vjen në Kuvend nga Qeveria e Kosovës, respektivisht nga Ministria e Shërbimeve Publike. Duke u bazuar në të dhënat që paraqet ky raport, ndoshta jo edhe aq i kompletuar, por mbështes fuqishëm pasi na bën të kuptojmë se me regjistrimin e popullatës, të ekonomive familjare, objekteve banesore, krijohet një bazë e plotë statistikore ,e cila i ka munguar Kosovës tash e sa vite. Njëkohësisht e nderuara ministresh dua t'ju përgëzoj sepse ky raport deri më tani për mua është njëri ndër raportet më të kompletuara dhe më i sqaruar.

Pa shtet nuk ka identitet, por pa realizimin e këtij projekti nuk do të ketë vlerë as shteti, sepse me këtë do të dëshmojmë identitetin, pasuritë, përkatësitë e posaçërisht numrin e saktë për të gjithë banorët e Kosovës. Ju them të drejtën para marrjes së këtij raporti unë nuk kamë pasur shumë njohuri sa i përket regjistrimit testues që është bërë nga 31 tetori e

deri më 14 nëntor 2005 e më pas, por ne jemi të kënaqur dhe ju përgëzojmë për punën e bërë, sepse shumë qartë i kemi përmendur të gjitha komunitetet e posaçërisht komunitetin egjiptian pa e ngatërruar me të tjerët ,siç kanë synuar të tjerët që ta klasifikojnë si identitet rajë, që kjo fjali për ne është e mallkuar. Ajo që do të ishte kërkesë jona, që të bëni përgatitjen e hapjes së zyrave në të gjitha komunat e Kosovës, të themeloni me kohë stafin e këtij komisioni. Të bëhet trajnimi i stafit ,në mënyrë që të jenë sa më profesionalë, por njëkohësisht në këtë staf të ketë edhe anëtarë nga komunitetet tjera , posaçërisht edhe të komunitetit egjiptian ,pasi që ky komunitet jonë bën në të gjitha komunat e Kosovës. Posaçërisht kërkohet nga ju, nga kjo Ministri që para finalizimit të pyetësorëve, udhëzimeve aplikacioneve dhe dokumenteve të tjera të gjendet edhe emri egjiptian. Me të gjitha këto që them ju përkrahim, njëkohësisht do të japim kontributin tonë deri te finalizimi i kësaj çështje madhore që shpresoj se duhet të përfundojë deri në fund të këtij viti. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ymer Halimi

DEPUTETI YMER HALIMI – Ju faleminderit kryetar. Të nderuar ministra dhe deputetë.

Një projekt tepër i rëndësishëm i Qeverisë së Kosovës, me një interes gjithëpërfshirës për shtetin, është regjistrimi popullsisë, i ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë. Prandaj, në shkallën e kësaj përgjegjësie edhe MSHP na ka sjellë një material përmbajtjesor më të dhëna te mjaftueshme nga shihet përpjekja e Qeverisë dhe MSHP që të jetë sa më përgatitur për projektin e regjistrimit të popullsisë. Projekti shihet se e ka mbështetjen e institucionet ndërkombëtare, që është një efekt mjaft e rëndësishme. Me regjistrimin e popullsisë shteti krijon te dhëna statistikore që kanë të domosdoshme për politikën e planifikimit dhe të hulumtimeve te ndryshme ekonomike po edhe për shkenca shoqërore dhe humane. Mëgjithkëtë, regjistrimi në vete ka disa komponent, që për kushte tona në Kosovë janë edhe të komplikuar. Prandaj, unë po theksoj ato që mendoj se janë me interes:Së pari, regjistrimi ka koston e vetë financiare, e qe nga referati i ministres, po edhe nga materiali i shkruar shihet saktë çmimi i projektit po edhe si i sigurohen financat. Se dyti, përgatitjet teknike dhe profesionale te personelit regjistruar, sensibilizimi i opinionit publik dhe sigurimi i monitorimit ndërkombëtar për njohje ndërkombëtare të regjistrimit janë tepër të rëndësishme. Raporti i MSHP këto i pasqyron dukshëm. Qeveria ka formuar Komisionin Qendror të Regjistrimit, po edhe MSHP ato në nivel komunal. MSHP ka realizuar dy projekte të regjistrimit testues në intervale kohe të ndryshme që është qenësore dhe në qendra banimi te ndryshme dhe ka eliminuar dobësitë e regjistrimeve provuese të nga i pari, në regjistrimin testues te dytin.. Kjo është mjaft domethënëse.Dhe se treti, do ta quaja kushti themelor që është: Infrastruktura ligjore dhe qëndrimi politik për regjistrimin e popullsisë,të ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë.Sa duket kjo pjesë apo thënë më konkretisht është “Thembër e Akilit” tek regjistrim në Kosovë. Tash kemi edhe një fazë politikisht të komplikuar, por duhet qëndrimi dhe qëllimi politik tepër i qartë. Prandaj, duhet kap arsyen politike që regjistrimi gjithsesi te ndodhë, sepse ku është një detyrim ligjor që duhet përmbush për qytetarët e Kosovës dhe siç u cek është i domosdoshëm për shumë fushëveprime te politikave të brendshme.Mendoj , më mirë është një regjistrim i pjesshëm se sa pa regjistrim.Ju lutem, hezitimi i serbëve në Kosovë për t’u kyçur ne regjistrim është një

trusni politike që vjen nga Beogradit. Sepse Beogradi, tash e 150 më parë ka manipuluar me numrin e serbëve në Kosovë. Po e theksoj një të dhënë shkencore se kur serbet e kanë pushtuar Kosovën, në statistikën Osmane kanë ekzistuar vetëm 2% banorë e popullatës serbe në Kosovë, por, atë kohe Evropa ishte tepër pa drejtë ndaj shqiptarëve.

Bashkësia ndërkombëtare nuk duhet të hezitojë në mbështetje të Regjistrimit të popullsisë ekonomike familjare dhe banesave në Kosovë edhe përkundërt bojkoti të serbëve.

Pastaj, po theksoj për njerëzit tanë që jetojnë e veprojnë tash e sa vite jashtë Kosove, regjistrimi i tyre duhet të përcaktohet saktë. Vetëm të theksoj atë, që FMN-ja referon se: mbi 200 000 mijë kosovarë, e mendoj të gjitha nacionaliteteve për çdo vit në Kosovë dërgojnë mjete financiare 3000 deri 6000 euro ,d.m.th. 600 milion deri në 1 miliard euro për shtetin.. Prandaj, ata janë pjesë e pandashme e Kosovës dhe pa marrë parasysh statusin e tyre në vendin ku jetojnë ,gjithsesi regjistrimi duhet të ndodhë edhe për ta. Bile, të aplikuar se fundi a dyshtetësia dhe as se si të eliminohen nga regjistrimi si qytetarë të Kosovës. Të dhënat e regjistrimit duhet të digjitalizohen, dhe ato që janë për qasje publike, të jenë hapura në çdo kohë për sisteme bankare, institucione shkencore dhe qytetar. Duhet të digjitalizohen edhe të dhënat e zyrave të statusit civilë.

Prandaj, Kuvendi i Kosovës duhet sot të dalë me qëndrim: që të plotësojë infrastrukturën ligjore dhe të përcaktoj kohën kur duhet bërë regjistrimin dhe duhet dhënë mbështetje regjistrimit në mundësitë që ka. Është koha për të vepruar e jo për të improvizuar shtetin, prandaj e përgëzoj MSHP për punën e bërë. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka ministresha Melihate Termkolli.

MINISTRESHA MELIHATE TERMKOLLI - Faleminderit z. kryetar. Unë falënderoj të gjithë deputetët që në mënyrë aktive kanë kontribuar në trajtimin e kësaj çështje të rëndësishme, por edhe të gjithë ata të tjerët të cilët në një mënyrë, qoftë direkte apo indirekte janë pjesë e punës së përbashkët dhe pjesë e këtij Parlamenti që trajton çështjet me rëndësi për Kosovën. Ndoshta ka nevojë që të sqarohen disa çështje, me sa po e shoh ka nevojë të sqarohen disa pika këtu dhe gjithsesi besoj se Kuvendi i Kosovës do të marrë një qëndrim të drejtë dhe një qëndrim si institucioni më i lartë i vendit. Së pari unë pajtohem absolutisht që të mos ngatërrohen çështjet e politikës dhe politizimet, çështjet e veprimeve politike në politizim le ta kryejnë punën e vetë. Pajtohem me të gjithë ata, është e qartë që jo veç regjistrimi i popullsisë, por çdo veprim që bëhet në Kosovë ka një lloj politike, por kjo nuk do të thotë që duhet të politizohen, prandaj edhe unë në fjalën time thash që nuk është i pranueshëm në asnjë mënyrë politizimi i këtij akti të rëndësishëm që më në fund të fundit është i domosdoshëm për Kosovën dhe sjell të dhëna edhe profesionale edhe tjera që janë të nevojshme sipas ligjit. Pajtohem me atë që mos të kuptohet rasti si çështje emocionale absolutisht është çështje gjithsesi profesionale dhe të gjitha punët që janë përgatit deri më tani janë në funksion të kësaj, të zbatimit, të profesionalizmit. Do të bëj një sqarim për qytetarët jashtë Kosovës. U përmend këtu edhe nga përfaqësuesit e partive të ndryshme që janë në Parlament etj .dhe dua të njoftoj Parlamentin që mbi bazë të konceptit të regjistrimit të popullsisë dhe duhet ta kemi të

qartë konceptin e regjistrimit. Regjistrohen të gjithë qytetarët që janë në Kosovë dhe ata që janë jashtë më pak se 12 muaj. Qytetarët që janë jashtë më shumë se 12 muaj hyjnë në procesin e numërimit. Ka qenë një përpjekje e jashtëzakonshme edhe personale edhe e Entit të Statistikës edhe e Ministrisë që në raport me ndërkombëtarët me gjithë atë të bëjmë një formular të veçantë për qytetarët tanë që janë jashtë, pikërisht për shkak të kontributit të jashtëzakonshëm që kanë dhënë dhe japin edhe më tutje në Kosovë dhe më tutje janë pjesë e zhvillimit të përgjithshëm të vendit, prandaj kemi bërë një formular të veçantë për qytetarët që janë jashtë dhe do të jenë pjesë e pasqyrës së përgjithshme të qytetarëve të Kosovës që do të jenë pjesë e regjistrimit të popullsisë, natyrisht nga ajo që përfshinë pjesën zyrtare të regjistrimit. Edhe një çështje do t'ju lutesha shumë, regjistrimi i popullsisë duhet të dallohet nga regjistrimi civil. Le të jetë shumë e qartë që një qytetar i yni qoftë madje edhe brenda ,sepse gjatë regjistrimit mund të ndodh që të mos regjistrohet edhe një qytetarë është brenda vendit, nuk ja humb të drejtën asnjë qytetari për regjistrim civil, pra për të fituar të drejtën e tij dhe statusin e tij të qytetarit të Kosovës dhe shtetësisë së Kosovës, kjo le të jetë e qartë, pra mungesa në regjistrimin e popullsisë nuk i mohan as nuk ja jep askujt të drejtën nëse ata që regjistrohen dhe thuhet automatikisht se e kanë të drejtën e shtetësisë së Kosovës, pra t'i bëjmë këto dallime, regjistrimi civil është regjistrim që ka rregulla të përcaktuara sipas standardeve të përcaktuara dhe që prodhon efekte të caktuara në hartimin e planeve zhvillimore të vendit, ndërsa regjistrimi civil, e drejta e shtetësisë e qytetarit të Kosovës është një diçka krejt tjetër dhe një element tjetër, të gjithë ata qytetarë që jetojnë më shumë se 12 muaj jashtë vendit me rregulla ndërkombëtare regjistrohen në atë vend ku jetojnë dhe me rregulla ndërkombëtare nuk lejohet dyfishimi i regjistrimit të popullatës, nëse kjo do të lejohet sigurisht që në botë do të kishim një numër shumë më të madh të qytetarëve nga ajo që realisht ekzistojnë në botë, prandaj dua të them me gjithë dëshirën më të mirë dhe vullnetin që e kemi shprehur, fillimisht e kamë shprehur edhe vetë, e kanë shprehur që të gjithë të tjerët, jemi konsultuar shumë edhe me shumë përfaqësues dhe ekspert edhe të tjerë, por ka rregulla ndërkombëtare dhe këtu natyrisht këtu si Kosovë ne kemi dalë para një qëndrimi se a duhet t'ju përmbahemi këtyre standardeve dhe rregullave ndërkombëtare të cilat duhet t'i pranojmë dhe të jemi pjesë e statistikave ndërkombëtare që besojmë se me këtë regjistrim Kosova automatikisht do të hyjë si pjesë e statistikave ndërkombëtare dhe rrjetit ndërkombëtar të statistikave apo do të bëjë një regjistrim sipas disa kërkesave dhe nevojave që ne mendojmë se janë më të mirat dhe në fakt ai regjistrim të mos i duhet askujt, të mos jetë i pranueshëm etj dhe më në fund të fundit të mos i jep ato rezultate të cilat ne i dëshirojmë, prandaj dua të them se i jemi përmbajtur rregullave, standardeve ndërkombëtare dhe mendoj se kemi bërë një hap të mirë, unë besoj fuqishëm që Parlamenti i Kosovës gjithsesi është i përkushtuar që t'i përmbahen rregullave dhe standardeve ndërkombëtare. Atë që Parlamenti i Kosovës dhe asnjë tjetër nuk guxon ta bëjë është që të mos i pranojmë standardet e dyfishta, e kam bërë shumë të qartë në këtë Parlament, për fat të keq asnjë fjalë nuk e kamë dëgjuar, as nga Parlamenti e as nga askush tjetër, dokumenti i presidentit Ahtisari sjell standarde të dyfishta, një palë standarde për shqiptarët, dhe për të tjerët një palë standarde, prandaj unë në këtë drejtim unë mendoj se duhet të kemi kujdes dhe do të shohim se si do t'i zhvillojmë këto çështje më tutje, çështjet që u përmendën këtu tek qytetarët ne kemi përdorur një metodologji edhe në regjistrimin testues edhe qytetarët që janë brenda d.m.th kemi përdorur metodën e komunikimit të drejtpërdrejtë, pra regjistrimi të drejtpërdrejtë

nga regjistruerit që do të dalin në terren, do të dalin në çdo familje, shtëpi etj dhe qytetarët do të regjistrohen përmes qytetarëve të cilët janë brenda në Kosovë, unë kisha me ju lut shumë të më sjellni ndonjë krahasim me Bosne apo diçka tjetër, Kosova nuk ka absolutisht asnjë nevojë me marrë model Bosnjen në këtë rast, sepse Bosna jo vetëm në regjistrim, por edhe në shumë gjëra tjera është mbrapa Kosovës dhe nuk na bën hiq nder me marrë as shembull dhe asgjë tjetër, Kosova ka hequr fuqishëm në shumë drejtime e edhe në përgatitjet për regjistrimin e popullsisë, prandaj në këtë drejtim e kemi marrë modele që janë më të avancuara dhe janë pak më të mira edhe në kuptimin e dinamizmit të punës, por edhe të standardeve etj. Në këtë drejtim unë do të thosha që thjesht, por me gjithë atë është e drejtë e plotë e Kuvendit të Kosovës që të jap mendimin rreth përcaktimit të datës së regjistrimit, por një çështje po ashtu besoj që të gjithë e kemi të saktë, është e vërtetë se në mënyrë diskrete nuk hynë ndonjë ndikim të regjistrimit të popullsisë me zgjedhjen apo njohjen e pavarësisë së Kosovës, sado që në mënyrë indirekte nuk mund t'i shmanget d.m.th edhe ndikimeve të natyrës së tillë, por unë kujtoj se edhe një fakt duhet ta kemi të qartë ne ende nuk kemi një pranim ndërkombëtar të dokumenti të presidentit Ahtisari, ky dokument ende nuk është bërë formal në kuptimin juridik ndërkombëtar, prandaj në këtë drejtim unë mendoj se Kuvendi i Kosovës, por edhe subjektet nëse i lejojnë vetes që pa u miratuar ky dokument të flasin dhe punojnë për zgjedhjet qoftë për ato nacionale dhe të tjera, ka vend që në këtë drejtim të punohet edhe për punën e regjistrimit të popullsisë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit shumë. Ftoj përfaqësuesin e mocionit ta marrë fjalën.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar i Kuvendit. Debati konstruktiv që u zhvillua sot në Kuvendin e Kosovës lidhur me çështjen e regjistrimit të propozuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së tregon se sa i rëndësishëm është ky proces. Ju falënderoj si pozitës, ashtu edhe opozitës për qasje konstruktive dhe për debate përmbajtjesore nëse merret aty këtu dhe përjashtohet ndonjë diskutim i cili mund të jetë i papërgjegjshëm, që ndodh edhe në vendet e tjera ndonjëherë. Serioziteti dhe rëndësia e regjistrimit të popullsisë dhe pronave të një vendit është i pakontestueshëm për çdo vend ashtu edhe për vendin tonë. Niveli i kulturës së bashkëpunimit të Kuvendit të Kosovës me institucione ndërkombëtare është i lakmueshëm edhe në përmasa dhe aranzhimeve kushtetuese që ne i kemi. Natyrisht ne jemi të vetëdijshëm se si Kuvend sovraniteti jonë është i limituar, ndërsa përcaktimi jonë është i plotë se regjistrimin ta kemi, ta kemi ashtu siç u bisedua sot, sa më parë që të jetë e mundshme. Ne kemi mbështetur një propozim të një institucioni tonë të respektuar, të Entit të Statistikave të Kosovës, por ne natyrisht jemi në një proces shumë serioz për kah rëndësia të rëndësishme për të gjitha grupet njëjtë se është proces i fatit të vendit tonë, andaj z. kryetar ne ju lusim që në bashkëpunim me Përfaqësuesin Special, në bashkëpunim me presidentin e Kosovës dhe Qeverinë që të bëni përpjekje maksimale që këtë projekt dhe këtë përgatitje të shkëlqyeshme që e ka bërë Ministria e Shërbimeve Publike së bashku me Entin e Statistikave si dhe me Eurostatin që ky projekt të realizohet sa më parë që të jetë e mundshme. Ju falënderoj për debat.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit.

Shkojmë në pauzë deri në orën 14,00.

KRYETARI KOLË BERISHA – Fillojmë me punë. Pika e katërt e rendit të ditës

4. Debat për rininë në Kosovë

Në pajtim me Rregullorën e punës, Grupi Parlamentar i PDK-së, ka kërkuar debat lidhur me rininë e Kosovës. Për ta përgatitur sa më mirë këtë debat, Kryesia e Kuvendit e ka ngarkuar Qeverinë, përkatësisht Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport ta përgatitë një informatë si material bazë për debat.

Informata e Ministrisë për gjendjen e rinisë në Kosovë u është shpërndarë deputetëve. Ftoj përfaqësuesin e parashtruesit të mocionit të Grupit Parlamentar të PDK-së që ta marrë fjalën. Urdhëroni z. Krasniqi

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Zoti kryetar, të nderuar deputetë. Është e njohur se ne jemi vendi me popullsi më të re në Evropë, gjysmën e popullsisë e kemi nën moshën 25 vjeç. Vetëm të rinjtë e moshës prej 15 deri 25 vjeç përbëjnë rreth 21% të popullsisë. Kjo është sfidë, por mund ta shndërrojmë edhe në shancë dhe perspektivë të madhe për zhvillimin dhe përparimin e vendit tonë.

E kemi kërkuar këtë debat, jo për të kritikuar punën e dobët të Qeverisë për të cilën kemi folur shumë herë deri më tani, por edhe për të bërë të njohur opinionin publik, angazhimin e seriozitetit tonë për rininë, të ardhmen tonë, për t'i bërë publike përpjekjet tona nëpërmjet rekomandimeve për Qeverinë e Kosovës.

Institucionet tona në përgjithësi e Qeveria në veçanti duhet t'i përpunojmë të gjitha hulumtimet që bëhen për pozitën e qytetarëve tanë në përgjithësi, e veçanërisht për ato që bëhen për rininë, pasi të gjitha flijimet e brezave janë bërë për një jetë ndryshe të brezave që u përket e ardhmja. Ne jemi të bindur se në Kosovë duhet të ketë një politikë kombëtare për edukimin, për arsimin, për shëndetësinë dhe punësimin e rinisë. Gjatë këtyre 8 vjetëve institucionet e Kosovës dhe ato ndërkombëtare, kanë bërë tepër pak për të ndryshuar kualitetin e jetës, të mësimin, të edukimit, të studimit, të shëndetit, si dhe të punësimit për njeriun tonë të ri. As gjatë këtyre 8 vjetëve nuk kemi arritur të krijojmë ambient të sigurtë, perspektivë për gjeneratën e re, për jetën e saj në Kosovë. Përkundrazi, gjeneratat tona të reja perspektivën po e kërkojnë jashtë kufijve tanë, duke u bërë kështu eksportues të fuqisë njerëzore, intelektuale dhe fizike, e cila në të shumtën e rasteve nëpërkëmbet në formë të ndryshme. Kujtoni storiet televizive të këtyre ditëve, që na sollën pamje trishtuese e degraduese të fëmijëve tanë në stacionet e policisë në Greqinë fqinje. A mund t'u ofrojmë perspektivë gjeneratave të reja me këtë nivel të arsimit e të edukimit, të punësimit, të kualitetit të jetës, të sundimit të ligjit e të qeverisjes? Për atë përbuzje e denigrim primitiv që nuk ndodh vetëm në Greqinë e anëtarësuar në Bashkimin Evropian, nuk mund të amnistohen as politikanët shqiptarë në përgjithësi. Prandaj, në këtë rast ne do t'i bëjmë disa rekomandime, veçmas për ekzekutivin:

1. Sipas principit të mundësive të barabarta, ne duhet ta shndërrojmë në prioritet kombëtar politikën e shkollimit dhe të punësimit të të rinjve, duke bërë përmirësimet e

nevojshme në Ligjin e punës dhe në ligjet që rregullojnë sistemin e arsimit fillor, të mesëm, të lartë, me qëllim të sigurimit të kushteve që çdo i ri të jetë në shkollë ose në punë dhe jo në rrugë e i pa perspektivë.

2. Në Kosovë janë të regjistruar 1440 studentë në 100.000 banorë. Kjo është sa një e katërta e Sllovenisë, sa një e dyta e Maqedonisë, sa dy të tretat e Shqipërisë. Rreth dy të tretet e numrit të të rinjve që dëshirojnë t'i vijnë studimet në arsimin e lartë janë të privuar nga kjo mundësi dhe e drejtë.

3. Në kuadër të masave prioritare të arsimit duhet të hyjnë edhe përshtatja e sistemit të edukimit me nevojat e tregut të punës dhe harmonizimi i plan-programeve apo i kurikulave ,siç po thuhet me ato të vendeve të përparuara perëndimore.

4. Ne nuk mund të lejojmë që të prodhojmë çdo vit armatë të papunësh për të cilët nuk kujdeset askush.

5. Për te rejat dhe të rinjtë që braktisin shkollën është e nevojshme që Qeveria e Kosovës ta hartojë planin për organizimin e kushteve profesionale që plotësojnë njohuritë dhe u japin atyre një shansë të dytë për të studiuar ose për të hyrë në tregun e punës.

6. Shkalla e punësisë është shumë më e lartë e të rinjve se sa te moshat e tjera. Janë të mundshme një numër masash efektive për ta zbutur këtë problem si: hapja e mundësive për punësimin sezonal në vendet që tregojnë gatishmëri për këtë; afrimi i mundësive për punësim me orar të shkurtuar; organizimi i trajnimeve për profesionet e dyta, në goftë se profesionet primare nuk premtojnë punësimin e të rinjve.

7. Po ashtu, buxheti i Kosovës duhet të racionalizohet për të siguruar së paku një kuotë minimale ndihmë prej 50 eurosh për të rinjtë e regjistruar në entet e punësimit si punëkërkuës.

8. Duke pasur parasysh që se niveli i shkollimit ndikon dukshëm në hapjen e mundësive për punë, duhet ndërmarrë masa institucionale për zvogëlimin e shkallës së braktisjes së shkollimit fillor dhe të mesëm.

9. Të rritet numri i nxënësve me arsimin profesional, të shtohen mekanizmat institucional për informimin dhe orientimin e të rinjve rreth mundësive të shkollimit dhe punësimit. Të inkuadrohen dhe mbështeten të rinjtë nga institucionet shtetërore për të hapur ndërmarrje private etj.

10. Të rinjtë duhet të përfshihen në institucionet publike shoqërore. Ata kanë energji, vullnet dhe aftësi për ta bërë këtë gjë. Atyre duhet besuar më shumë në detyrat vendimmarrëse, në institucionet tona publike dhe shoqërore në Parlament, Qeveri dhe parti.

Po ju përkujtoj , të nderuar deputetë, para pak kohe ne miratuam për Institutin e Jurispodencës, për Bordin e Jurispodencës tetë kandidatë. 6 prej tyre ishin mbi moshën

60 vjeçare. Nuk ishte asnjë i ri. Mendoj që kjo nuk është një qasje e drejtë ndaj gjeneratës së re, e cila megjithatë është më e përgatitur dhe më profesionale.

11. Megjithëse në krahasim me vendet përrreth Kosovës dhe vendin e fundi për nga konsumi i substancave narkotike dhe shkalla e sëmundjeve të transmetueshme seksuale si AID –si hiv, paraqitja e rasteve të tilla duhet të jetë sinjal për Ministrinë e Shëndetësisë dhe gjithë shoqërinë kosovare, që të merren masat nevojshme për parandalimin e përhapjes së dukurive të tilla përmes programeve informative dhe shpjeguese në shkolla dhe në Universitet.

Ruajtja e shëndetit të rinisë është interes vital për ne si shoqëri me njerëz të rinj.

12. Shteti duhet të subvencionojë në krijimin e familjeve të reja ,duke u krijuar atyre kushte banimi, këshilldhënie për nënat e reja, për menaxhimin e buxhetit familjar, si edhe kredi preferenciale.

Duke përfunduar, më lejoni të theksoj se ne nuk duhet vetëm të krenohemi me rininë e Kosovës me fjalë. Ne kemi marrë obligim t'i hapim asaj perspektivat për të jetuar e ndryshuar kualitativisht këtë vend, për të jetuar me dinjitet në vendin e vet. Nuk mjafton të themi: rinia është kapitali ynë më i madh, ajo sinjalisht edhe vendosmërisht duhet të trajtohet si pasuri jona kapitale nga e cila varet e gjithë perspektiva dhe zhvillimi i Kosovës. Ajo ka kontribuar shumë për lirinë e Kosovës, para dhe gjatë luftës. Ajo ka ndihmuar shumë në rindërtimin e vendit pas luftës dhe po zhvillohet sot me një hov më të madh se përpara. Ajo është një shansë më e mirë për ne, që si shoqëri me energji të reja për ndërtimin e së ardhmes të sigurt të këtij vendi dhe populli.

Ju falënderoj për vëmendje!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Ftoj ministrin Haraqija që ta paraqet qëndrimin e Qeverisë lidhur me këtë çështje.

MINISTRI ASTRIT HARAQIJA - I nderuar kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj

Debati i sotëm për rini dhe gjendjen në të cilën ndodhet ajo, është i qëlluar dhe vjen në momentin kyç dhe tejet të rëndësishëm nëpër të cilën po kalon vendi ynë. Jam fare i sigurt, ndërkaq se problemet dhe sfidat që i karakterizojnë kategorinë më të rëndësishme të shoqërisë sonë rininë, meriton qasje me të thellë dhe më analitike për t'i analizuar ato, nëse duam që identifikojmë veç e veç të arriturat, problemet, synimet tona si institucione edhe shoqëritë demokratike.

Kosova vlerësohet se ka popullsinë më të re në Evropë. Rreth gjysma e popullsisë te ne është nën moshën 25 vjeçare, ky është një fakt inkurajues, por njëkohësisht e bën të vështirë dhe ndërmarrjen e hapave më të shpejtë për t'i zgjidhur problemet e shumta të rinisë dhe kërkesat e tyre, sidomos ato për arsimim dhe integrimin e gjeneratave të reja, shumica pa punë dhe e pakënaqur. Shikuar me një optikë reale, pas luftës e këndeje është vërejtur një pjesëmarrje e ulët e të rinjve në jetën publike në përgjithësi e në vendimmarrje, në veçanti. Ne me kohë kemi ndërmarrë të gjitha veprimet në bashkëpunim me partnerët tanë të gjerë me organizata dhe me institucione të ndryshme për t'u qasur në mënyrë integrale kërkesave dhe nevojave të rinisë. Tashmë e kemi

përfunduar hartimin e dy politikave afatmesme të rinisë siç janë: plani kosovar i veprimit për rini 2007 -2010 dhe plani aksionar i punësimit të të rinjve , po ashtu, për periudhën 2007 -2010. Këto dhe disa politika të tjera janë arritur të ndërtohen në bashkëpunim me partnerët e qëndrueshëm dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe institucionet vendore, siç janë: OSBE-ja, UNICEF-i, ... UNIFEM-i, IOM, GTZ, Banka Botërore, UNDP-a si dhe institucionet e tjera vendore si Ministria e Arsimit, Ministria e Tregtisë, dhe Industrisë, Ministria e Planifikimit dhe e Mirëqenies Sociale, Shërbimi Policor, Sindikata e Pavarur, Oda Ekonomike e Kosovës dhe shumë organizata joqeveritare rinore.

Është me rëndësi të thuhet në këtë moment se për zhvillimin dhe përkrahjen e rinisë gjatë vitit 2006, organizatat e ndryshme ndërkombëtare kanë dhënë ndihmë të konsiderueshëm nëpërmjet donacioneve. Kështu për shembull: Banka Botërore, OSBE-ja, GTZ-ja, UNDP-a UNICEF-i dhe IOM-i vitin e kaluar kanë ndarë donacion në shumën rreth 1 milion e 279 mijë euro. Këtu duhet pasur parasysh se projekti i Bankës Botërore, si donacion prej rreth 1 milion euro për zhvillimin e rinisë do të implementohet në periudhën e ardhshme 3 vjeçare.

Edhe gjatë këtij viti, disa organizata ndërkombëtare kanë vazhduar me donacione edhe pse me shkallë pak më të ulët. UNDP-ia për rininë ka dhënë 342 mijë dollarë, UNICEF-i po ashtu, GTZ-ja mbi 70 mijë euro. Duke pasur parasysh partneritetin e qëndrueshëm me organizatat e huaja presim që deri në fund të vitit donacionet të shënojnë rritje.

Departamenti i Rinisë ditë më parë ka fituar edhe një grant nga Kolegji i i botës, i cili ka të bëjë me sigurimin e katër bursave për nxënësit e shkollave të mesme, që studiojnë në disa vende të ndryshme të botës. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërkaq gjatë vitit 2006 për zhvillimin dhe përkrahjen e rinisë dhe mbrojtjen dhe integrimin e saj ka investuar rreth 400 mijë euro, ndërsa vetëm për 6 muajt e parë të këtij viti për aktivitetet e ndryshme rinore janë dhënë mbi 100 mijë euro. Ky bashkëpunim dhe partneritet është kurorëzuar, siç thamë edhe me thithjen e shumë donacioneve karshi 250 mijë euro sa ishte buxheti për rininë vitin e kaluar, rreth 1 milion që janë siguruar nga donacionet dhe që janë ndarë organizatave të ndryshme ndërkombëtare. Këto mjete dhe të tjera që u siguruan më vonë janë shfrytëzuar kryesisht për mundësinë, për promovimin dhe zhvillimin e pjesëmarrjes të të rinjve në jetën aktive shoqërore në Kosovë.

Në epiqendër të veprimeve tona kemi pasur edhe rrjetëzimin dhe informacionin publik për sektorin rinor, promovimin rinor, fuqizimin e OJQ-ve rinore, politikat rinore, edukimin joformal, participimin dhe integrimin e rinisë, edukimin shëndetësor dhe punësimin e të rinjve. Ministria e Kulturës dihet se harton politika rinore, ndërsa ato i zbaton në bashkëpunim me organizatat e tjera qeveritare dhe joqeveritare. Aktualisht në Kosovë ekzistojnë rreth 150 organizata joqeveritare, të cilat po thuaj në tërësi implementojnë edhe buxhetin e konsoliduar të Kosovës për rini si dhe mjetet e ndara nga donatorët. Pra, ne nuk zbatojmë politika të punësimit të të rinjve, por bashkëpunojmë me të tjerët për ta zbutur papunësinë në Kosovë, siç e përmenda Ministrinë për Planifikim, atë për Mirëqenie Sociale, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Tregtisë, Ministrinë e Financave edhe shumë të tjera.

Pas luftës, sektori i rinisë në shkallë të vendit ka pasur një zhvillim bukur të madh, duke u organizuar kështu në organizata joqeveritare rinore – qendra rinore, këshilla shkollore rinore dhe asociacione të ndryshme. Mirëpo, më vonë gjendja e tyre është përkeqësuar për shkak se janë tërhequr shumë organizata joqeveritare, ndërkombëtare dhe ka zënë të bie dukshëm përkrahja e donacioneve.

Rinia jonë sot duhet të jetë e informuar dhe pjesë aktive politike në vendimmarrje. Si bartëse kryesore e jetës dhe aktivitetet, duhen të kyçet në projekte të rëndësishme, siç ishte ai i vitit të kaluar lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë, me ç'rast mori pjesë në fushatë dhe u organizuan për këtë qëllim në 30 komuna të Kosovës, ku morën pjesë të rinjtë e të gjitha gjinive, etnive si dhe ekspertë të ndryshëm të kësaj fushe.

Faza e dytë e këtij projekti ka filluar edhe sivjet. Janë organizuar disa takime për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë në disa komuna të Kosovës. Qëllimi ynë është të nxisim një edukim të ri në këtë plan, sepse trashëgimia është e Kosovës, duke respektuar diversitetin kulturor të secilit në këto hapësira. Në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse komunale vazhdon të zhvillohet një bashkëpunim i kënaqshëm në fushën e sportit, kulturës dhe artit. Për rezultate në këtë plan, vjet kemi shpallur dhe shpërblyer katër komunat më të suksesshme, Vendin e parë e ka zënë komuna e Mitrovicës, e cila ka fituar 4 bursa për studentë vullnetarë të saj. Pastaj vendin tjetër ka zënë Peja, e cila po ashtu ka fituar 4 bursa, kurse vendin e dytë e ka zënë Prishtina me dy bursa, të tretin Istogu po ashtu me dy bursa, kurse me çmim special janë shpërblyer edhe 9 komuna të tjera me nga një bursë për studentë. Vlen të theksohet kontributi dhe ndihma që ka dhënë për rininë Banka Botërore për jetësimin e projekteve që kanë të bëjnë me përmirësimin dhe performancën dhe qëndrueshmërisë së qendrave ekzistuese rinore, themelimin e dy qendrave të resurseve për studentë, për zhvillimin e biznesit, për sipërmarrësit e rinj dhe fuqizimin e kapaciteteve implementuese të Departamentit të Rinisë. Këto projekte do të zgjasin 3 vjet, por që kanë mundësi të vazhdimin nëse tregohemi të suksesshëm. Mungesa e vendeve të reja të punës është për një arsye që jo rrallë t'i shtynjë të rinjtë t'i ndërpresin shkollimin, dhe për pasojë disa të marrin rrugë të gabuar siç janë: krimi, droga dhe prostitucioni. Është brengosëse edhe fakti se gjysma e atyre që kërkojnë punë janë të pakualifikuar dhe nuk janë gati që t'i përgjigjen ofertës së tregut.

Presim që në kuadër të planit aksionar të punësimit për të rinj nga kjo diskrepancë të zbutet me Organizatën Ndërkombëtare të Punës që ka nisur të mbështesë organizatat dhe institucionet qeveritare për hartimin e saj sa më të mirë të planit aksional të punësimit të rinisë për periudhën 2007-2010, duke koordinuar aktivitetet për ministrinë përkatëse, siç i përmenda më herët,

Të nderuar deputetë,

Plani i veprimit për rini në programin e vet përfshinë pjesëmarrjen e të rinjve, arsimimin dhe edukimin, punësimin, shëndetësinë, sigurinë njerëzore si dhe kulturën, sportin dhe rekreacionin. Ky plan ka për qëllim që t'i involvojë të gjitha organizatat qeveritare dhe joqeveritare në identifikimin dhe përmbushjen e nevojave të kërkesave të të rinjve. Plani

kosovar i veprimit për rini ka marrë një mbështetje të fuqishme, si nga Qeveria po ashtu edhe nga Kuvendi, i cili është i inkorporuar dhe në strategjinë zhvillimore të Kosovës. Për hartimin e këtij kontribut kanë dhënë OSBE-ja, GTZ-ja, UNICEF-i, NDP-ia, Banka Botërore dhe Rrjeti Rinor kosovar.

Ministria në planin e veprimit kundër trafikimit për qenien njerëzore në Kosovë ka pasur për objektiv strategjik parandalimin që përfshinë vetëdijesimin rreth pasojave të trafikimit, zvogëlimin e rrezikshmërisë ndaj trafikimit, zvogëlimin e kërkesave rreth trafikimit. Ne tashmë jemi bërë edhe pjesë e projektit ballkanik të quajtur Turi Rajonal Për parandalimin e fenomenit të trafikimit, projekt ky që ka financiar Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe ka filluar të zbatohet në Tiranë në shtator të vitit të kaluar, nën patronatin e z. Jozefina Topalli. Gjithashtu, kujdes të veçantë i kemi kushtuar edhe punës së fëmijëve dhe trafikimit të tyre.

Në Shkollën e Policisë në Vushtri është realizuar projekti: Ndal punës së fëmijëve dhe trafikimi. Ky projekt është mundësuar falë ndihmës së punës së fëmijëve sidomos të Shërimit Policor të Kosovës dhe Njësitit kundër trafikimit ,IOM-it, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe organizatave tjera. Mendojmë se në këtë plan të gjithë bashkë, edhe më tutje kemi se çka të punojmë, sepse pretendojmë të kemi një rini të pasur dhe të edukuar. Në vazhdim më lejoni të them se viti i kaluar edhe ky në të cilin ndodhemi ka qenë mjaft i suksesshëm, për sa i përket lidhjes së marrëveshjeve me institucionet e ndryshme ndërkombëtare, Përtëritjen e donacioneve në sferën e rinisë. Duhet me përmendë me këtë rast marrëveshjen me Bankën Botërore për projektin: Zhvillimi i rinisë në Kosovë, i cili pritet të zgjatë tri vjet, gjithashtu një marrëveshje me OSBE-në, me titullin: Fuqizimi i rinisë dhe nisma e dialogut. Po ashtu me marrëveshje prapë me OSBE-në për planin e veprimit për rini 2007-2010 që do të zgjas për një vit, po ashtu edhe në marrëveshje me GTZ-në: Dëgjo rini me KOLËzgjatje prej tri vjet Vjet, gjithashtu ,UNDIP-ia ka përkrah edhe planin kosovar për rini me shumta të ndryshme. Njëherit edhe UNICEF-i ka përkrahur planin për hartimin dhe veprimin për rini. Gjithashtu , IOM-i për programin e ambasadorëve të rij për të drejtat e njeriut dhe për programin e asistencës reintegruese të viktimave të trafikimit ka ndarë shumë të konsiderueshme.

Ditë më parë UNDP- ia për periudhën dyvjeçare ka ndarë një shumë nga 340 mijë dollarë për implementimin për planin kosovar për rini. Vitin që shkoi, për aktivitetet rinore dhe politikat e të rinjve, nga buxheti janë ndarë rreth 250 mijë euro ku bëjnë pjesë promovimi dhe zhvillimi i rinisë. zhvillimi i politikave rinore, mbrojtja dhe integrimi i rinisë. Ndërkaq, siç thamë edhe më herët duke iu falënderuar donatorët kemi kaluar shumë mbi 1 milion e 300 mijë euro.

Secili prej nesh sot këtu mund të pyes se cilat janë sfidat në fushën e rinisë. Unë po them se ato janë buxheti shumë i limituar për rininë, zvogëlimi i donacioneve të huaja, përkrahja e ulët, mungesa e shërbimeve për të rinj , si dhe përvoja e limituar e shoqërisë civile për ofrimin e shërbimeve cilësore për rininë, sidomos për aktivitete të grupeve të marginalizuara. Besoj se pajtohem të gjithë se në një vend i cili ka popullsinë më të re në Evropë, është e hidhur të jetë vendi më i varfër në Ballkan dhe nga më të varfëritë në

Evropë. Të gjithë e dimë se në një vend, për një vend pune për rini të arsimuar është garancë dhe një ardhmëri e sigurt për të përparuar, por për të qenë kështu duhet të bëhet me tepër, të rritet shkalla e punësimit, ku për një vend të punës sot konkurrojnë 530 të rinj, të papunë konkurrojnë. Sipas disa të dhënave papunësia e të rinjve arrin mbi 50% dhe ky është një fakt shumë brengosës. Punësimi i të rinjve në ekonominë informate bënë pjesë rreth 50%. Në Kosovë ekziston një vlerësim i përgjithshëm dhe pjesëmarrja reale e të rinjve të shoqëri, veçanërisht në vendimmarrje është tepër e ulët. Prandaj, duhet rritur këtë shkallë për t'u bërë të rinjtë pjesë e gjithë procesit të përgjithshëm. Gjithashtu edhe në jetën politike të rinjtë nuk janë gjithaq të përfaqësuar, prandaj ky duhet të jetë një alarm për gjithë shoqërisë tonë. Me qëllim që rinisë tonë t'i ofrojmë kushte dhe mundësi për të zhvilluar aktivitete sportive, brenda mundësive tona kemi ndarë mjete për infrastrukturën sportive për vazhdimin e punimeve të ndërtimit të palestrave të sporteve, siç janë komuna e Besjanës, Kamenicës, Klinës, Fushë Kosovës. Po ashtu së shpejti do ta fillojmë ndërtimin edhe të palestrës sportive në Istog, në të njëjtën KOLË edhe renovimin e palestrave në Pejë, Ferizaj, Gjiilan, Mitrovicë, Prizren dhe Gjakovë.

Me qenë se infrastruktura kulturore jo vetëm në kryeqytetin e Kosovës, por edhe në gjithë vendin është jo e kënaqshme, ne tashmë kemi shpallur konkursin dhe fituesin e projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë së Operës dhe Baletit me emrin e doktor Ibrahim Rugovës. Ky objekt i përmasave të mëdha fizike do të kushtojë disa milion euro. Për realizimin e tij duhet të involvohen të gjitha institucionet e vendit, duke siguruar donatorët brenda dhe jashtë vendit. Aktiviteti i Ministrisë, sidomos në fushën e rinisë është i ngushtë i lidhur edhe me Ministrinë e Arsimit. Jo rrallë strategjitë tona gjejnë pikë-pjekje. Gjatë këtyre viteve janë bërë përpjekjet e mëdha për përmirësimin e infrastrukturës shkollore e sidomos vitin që shkoi dhe këta muajt e parë të këtij viti ku janë përfshirë e disa shkollave të reja dhe renovimi i të vjetrave dhe shtimi i hapësirës shkollore për rreth 60 mijë metra katrorë.

Po përmendi këtë të dhënë, të nderuar deputetë për të pasqyruar një fakt i cili dëshmon për tendencën e krijimit të kushteve më të mira të mësimi për të rinjtë, kushtet e mira për arsimimin e të rinjve po ashtu edhe minoritar kanë ndryshuar pozitivisht. Qeveria deri në fund të vitit 2006 ka rinovuar dhe pajisur me inventar shkollor mbi 15 shkolla dhe të minoriteteve për një shumë rreth 1 milion euro. Qeveria e Kosovës ka rinovuar edhe shumë shkolla të tjera të dëmtuara gjatë 6 marsit 2004. edhe për këtë vit është paraparë të investohet në objektet dhe shkollat e tjera.

Ndërkaq shkollat dhe ndërtim e sipër që kapin një sipërfaqe prej 36 mijë metra katrorë e ndërsa hapësirat shkollore në rinovim janë 4700 metra katrorë. Nëse më lejohet të përmendi do ti marrë disa shifra të marra nga Ministria e Arsimit kanë që të bëjnë me renovimin e ndërtimit të shkollave në Kosovë. Vetëm nga renovimi 2003 e kënde janë investuar 233.387 euro, kurse për ndërtimin e shkollave 7 milion e 300 mijë euro. Për nevojat e të rinjve që i përkasin botës akademike dhe universitare deri më tash janë investuar 4 milion e 700 mijë euro.

Dhe fare në fund, besoj se pajtohemi të gjithë se zgjidhja e statusit final të Kosovës do të krijonte kushte dhe mundësi të reja për afirmimin e të rinjve, përfaqësimin e tyre në jetën

politike dhe shoqërore, punësim më të madh dhe mirëqenie sociale. Po e mbylli këtë paraqitje para jush për t'i lënë hapësirë debatit për këtë çështje shumë të rëndësishme. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në sallë janë 64 deputetë. Fjalën e ka Gjylshene Berisha në emër të LDK-së.

DEPUTETJA GJYLSHEN BERISHA – Ju faleminderit i nderuari kryetar, të nderuar deputetë, ministra.

Grupi Parlamentar i LDK-së si gjithnjë mirëpret debatet që mbahen në Kuvendin e Kosovës, mirëpo është ithtar më tepër i miratimit të ligjeve për të cilët ne kemi nevojë në këtë kohë dhe për temën përkatëse që e kemi.

Debati për rininë, do të flasësh për një vlerë të madhe të Kosovës. Kosova është një vend me popullsi më të re në Evropë, ku mbi gjysma e saj është në moshën 25 vjeç. Te ne në Kosovë, si në shumicën e Evropës Juglindore të rinj konsiderohen ata që e bëjnë pjesë në grup moshën 15-24 vjeç. Kjo grupmoshë në Kosovë përmban 21 të popullsisë së saj edhe me këtë tregues Kosova del vendi me popullsi më të re në Evropë. Kujtojmë se të gjithë jemi të një mendje se rinia është pasuria më e madhe e një vendi. Por, ky konstatim është i saktë vetëm atëherë kur të rinjtë janë të arsimuar, të punësuar, kur të rinjtë marrin pjesë në vendimmarrje në institucione dhe në politikë, dhe kur ata janë të pavarur ekonomikisht nga familja. Përndryshe, një rini e paarsimuar, e papunësuar, e lënë jashtë rolit të zhvillimit ekonomik e politik të një vendi nuk është vlerë, por është barrë e një shoqërie. Natyrisht rini është ajo grupmoshë, e cila sot në Kosovë u shtrohet sfidave të një tranzicioni shumë kompleks e shumë dimensionsal, sepse kjo është grupmosha kur ata e bëjnë kapërcimin nga shkolla në punë, nga familja në jetën e pavarur, kur ata synojnë të bëhen pjesë aktive e të gjitha zhvillimeve në shoqëri, pra kur dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën dhe përgjegjësitë e tyre në shoqëri.

Baza e vrytitit të vërtetë është synimi i çdo individi për t'i kontribuar lumturisë së tërë shoqërisë, Prandaj, menaxhimi i këtij tranzicioni të të rinjve që quhet tranzicion i moshës, sipas Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, duhet të jetë prioritet për shtetin e Kosovës. Vendi që nuk e trajton këtë tranzicion të të rinjve, nuk ka trajtuar të ardhmen e tij, e rinia ka edhe të tashmen e vet. Grupi Parlamentar i LDK-së konsideron se krijimi i mundësive për rininë që të marrë pjesë aktive në punën e gjithanshme për transformimin e vendit, duhet të jetë objektivë kryesore i politikave shumësektoriale të zhvillimit të Kosovës.

Qeveria e Kosovës, sidomos Ministria e Arsimit dhe ajo e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kanë hartuar një varg dokumentesh, që të cilat fokusohen në fusha të ndryshme për rininë siç janë: arsimi, punësimi, shëndeti, kultura e tjerë, dhe për secilën fushë ka paraparë masa konkrete. Kemi këtu parasysh strategjinë për arsimin parauniversitar dhe strategjinë për arsimin universitar të Ministrisë së Arsimit. Planin aksional të punësimit të të rinjve në Kosovë 2007-2010, planin kosovar të veprimtimit për rininë 2007-2010, fuqizimin dhe zhvillimin e rinisë në Kosovë e tjerë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Nuk ka dyshim se efikasiteti i këtyre politikave dhe projekteve do të varet

nga mjetet financiare e mjetet financiare të ndara për këto probleme të rinisë varen nga Buxheti i Kosovës gjithaq i varfër. Prandaj, ne konstatojmë se tranzicioni i moshës së rinisë kosovare është i vështirë, sepse bëhet gjer tani në një tranzicion të Kosovës pa status dhe me qëndrueshmëri të brishtë ekonomike. Prandaj konstatimi ynë i parë është se pozita e palakueshme e të rinjve të Kosovës nuk është rezultat vetëm i mospërkushtimit të Qeverisë për te, por në radhë të parë është rezultat i pozitës së rëndë ekonomike të Kosovës në tranzicionin pa status.

Grupi Parlamentar i LDK-së veçon tri fusha që duhet të ishin prioritet për politikën e Kosovës në favor të të rinjve që përputhen me objektivat e zhvillimit të mileniumit. Nën një, realizimi i të drejtës dhe mundësia për arsim dhe edukim. Mendojmë se të gjithë pajtoheni se investimi i arsimimit të të rinjve është investim për përparim të Kosovës. Nuk ka dyshim se ky përparim i vendit realizohet vetëm me të rinj, cilësisht të arsimuar dhe të pajisur me njohuri, aftësi dhe kompetenca bashkëkohore. Se fundi, pajisja e të rinjve me njohuri, aftësi dhe kompetenca bashkëkohore për të përballuar me sukses jetën dhe punën, është e drejtë dhe detyrim për shoqërinë dhe institucionet e Kosovës. Ne konsiderojmë se me gjithë angazhimin e madh deri sot nuk kemi arritur ta përmbushim këtë detyrim në tërësi. Këtë e argumentojmë me disa statistika që për frekuentimin të rinjve në arsim Kosovën e nxjerr në vendin e shtatë në dhjetë shtetet e Evropës Juglindore. Dihet se indeksi i frekuentimit të të rinjve në shkollë përcakton nivelin e zhvillimit njerëzor të një vendi. Shkaqet e këtij niveli, në radhë të parë janë rezultat i shumë faktorëve që e karakterizojnë Kosovën e dal nga lufta.

Ministria e Arsimit ka një strategji shumë të mirë për shkollimin universitar dhe pasuniversitar, por lypset gjetur format që ajo strategji të ketë mbështetje financiare dhe të krijojnë kushte që do të mundësonin që çdo i ri ta ketë mundësinë e shkollimit. Nën dy, e drejta dhe mundësia për punësim. Disa të dhëna për papunësinë e të rinjve janë shumë rrënqethëse. Për shembull, të rinjtë e grupmoshës 20 – 24 vjeç 64% janë të interesuar për punë, kurse 43% presin punë më tepër se një vit. Kjo grupmoshë është mosha e kalimit nga mosha e shkollimit në tregun e punës. Edhe kjo gjendje në radhë të parë e ka arsyetimin të shkallë e ulët e zhvillimit ekonomik, të zhvillimi ngadalhtë i biznesit privat dhe të mundësitë e limituara të punësimit në sektorin publik. Synim kryesor i institucioneve të Kosovës duhet të jetë aftësimi profesional, i cili konsiderohet si urë lidhëse mes shkollës dhe punës. Ky sistem i cili përgatit të rinjtë për tregun e punës në sektorin privat, nuk ekziston fare, kurse në atë publik nuk është i mjaftueshëm. Në mungesë të këtij sistemi, në të gjitha konkurset për punësim kërkohet përvoja e punës 2 deri 3 vjet. Konkursët e tilla diskriminojnë rininë tonë.

Grupi Parlamentar i LDK-së konsideron se, nëse nuk hartohen strategji serioze për tranzicionin e të rinjve nga shkolla në punë, të rinjtë tanë të vetmen rrugë e zgjedhin - largimin nga Kosova.

Nën tre, e drejta e të rinjve për procesin e vendimmarrjes ose rinia dhe demokracia (kryetari: keni parasysh kohen ju lutem) është fakt se rinia jonë në Kosovë nuk e gëzon në mënyrë të duhur të drejtën e pjesëmarrjes në vendimmarrje. Kjo shihet jo vetëm nga numri i vogël i të rinjve e institucione, por edhe në strukturat drejtuese të partive.

Grupi Parlamentar i LDK-së konsideron se është i nevojshëm një kuadër ligjor, rregullues, i cili pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje jo vetëm që do ta konsideronte të drejtë të tyre të pamohueshme, por do t'i caktonte edhe rregullat e realizimit dhe përgjegjësi të kësaj të drejte. Andaj ,mendojmë të fuqizohet dhe të inkurajohet rinia që sa më mirë ta kuptojë nocionin e pjesëmarrjes në jetën publike, të fuqizohet rinia në fshatra, ajo pjesë e marginalizuar përmes rrjeteve rinore lokale në komunat përkatëse, por edhe këto rrjete kanë nevojë që të vetëdijesohen edhe më tutje për rolin që e kanë ndërmarrë. Me këtë nënkuptohet fuqizimi dhe edukimi i rrjeteve rinore, trajnimi , roli i tyre në politikë dhe në proceset vendimmarrëse, por assesi politizimi i tyre. Pjesëmarrja e tyre duhet të jetë e organizuar dhe pushteti lokal dhe ai qendror duhet t'i kenë dyert e hapura që ata të marrin pjesë në strukturat ku merren vendimet në komunat përkatëse. Trajnimi i tyre i vazhdueshëm për aftësimin e tyre në përpilimin e projekteve, shkruarjen e raporteve, menaxhimin e projekteve, menaxhimin e punës ekipore, arrihet nëse rrjetet rinore janë në gjendje të përpilojnë strategjitë e tyre vepruese përmes planeve të veprimit komunal. Prandaj, nëse rinia aftësohet pa shkëputje nga shkolla dhe studimet, atëherë do të dilnin plane vepruese konkrete. Është urgjente që në planifikimet buxhetore komunale dhe qendrore, objektiv i vazhdueshëm të jetë ndërtimi i lokaleve, shtëpive apo i qendrave fokusuese.

Ndërtimi i qendrave fokusuese ku rinia do të përqendrohej dhe do të ngriste edhe ndjenjën e vullnetarizmit edhe të profesionalizmi.por kërkohet një nxitje që energjia e akumuluar të gjejë shprehje në ndërtim të asaj që na mungon. Një vendtakim i tillë i rinisë do të shërbente si qendër përmes së cilës rinia do t'i ikte ecejakeve të kota në rrugë, kafiteri dhe trysnive shpirtërore në një gjendje pa perspektivë.Ne kete shtëpi apo qendër të rinjtë tanë do të zhvillonin trajnime që do t'ua sqaronin nocionin dhe realitetin e dhunës familjare, shoqërore, trafikimin, si dukuri shqetësuese etj. Me një fjalë do t'ua sqaronte kuptimin e plotë të demokracisë.Do t'u mundësohej të rinjve të talentuar marrja e subvencioneve nga administrata lokale dhe qendrore. Kjo do të ngjallte frymën garuese në krijimin e profesionistëve të të gjitha profileve apo fushave për të cilat Kosova ka shumë nevojë. Kjo do të ngjallte shpresën se në Kosovë fillon të zhvillohet meritokracia. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të AAK-së Gjylnaze Syla

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA - I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra, deputetë të nderuar

Dëshiroj që në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën time t'ia filloj me shprehjen e ndjenjës së respektit për rininë e Kosovës dhe të besimit të thellë në prosperitetin e popullit të Kosovës. Respekti ynë bazohet në rikujtimin e të vërtetës së rëndë për sakrificat e rinisë, me humbjen e jetërave të tyre në luftën për liri, kurse besimin tonë e mbështesim në rolin kyç të të rinjve për avancimin e demokracisë në Kosovë dhe pjesëmarrjen në familjen evropiane dhe evropatlantike. Kosova ka popullatë të re. Ky është tregues i rëndësishëm se të rinjtë janë burim i madh i zhvillimit njerëzor, energji dhe potencial i vlefshëm për Kosovën, por njëkohesisht janë edhe burim kyç për ndryshimet sociale, ekonomike dhe teknologjike. Prandaj, duhet

investuar në rininë ashtu që të fuqizohet dhe aftësohet për bartjen e sfidave të së sotmes dhe përgjegjësitë e së ardhmes.

Sfidat e sotme të tranzicionit Kosovës janë sfidat e sotme të rinisë. Prandaj, menaxhimi i tranzicionit të të rinjve është i rëndësishëm dhe lidhet ngushtë me shoqërinë, ekonominë, familjen dhe shtetin. Megjithatë, për fuqizimin e rinisë së pari duhet të identifikohen problemet që janë shenja shqetësuese për perspektivën e të rinjve nga të cilat veçojmë:

1. Situata politike në pritje të njohjes së shtetit të Kosovës nga bashkësia ndërkombëtare ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e të rinjve, por më tepër proceset e reformave të zhvillimit të shoqërisë së hapur në Kosovë po ashtu ushtrojnë ndikimin e vet.

2. Zbatimi i ngadalshëm i reformave në arsim ende i paorientuar kah tregu i punës, nuk i pajis të rinjtë me dijeni dhe aftësi të nevojshme për punësim dhe konkurrencë në rajon, Evropë dhe më gjerë.

3. Për shkak të moszhvillimit ekonomik, mundësitë e punësimit janë të kufizuara, si në sektorin privat, ashtu edhe në atë publik, kurse në disa sektorë, si në atë të bujqësisë të rinjtë kanë humbur plotësisht interesimin.

4. Rinia është e orientuar kah emigrimi, të cilin e sheh si mjet për zgjidhjen e problemeve ekonomike.

5. Ekziston shkalla e lartë e analfabetizmit të vajzat e moshës 16 gjer në 19 vjeç, sidomos në zonat rurale. Numri i vajzave të regjistruara në shkollën fillore është më i vogël se sa i djemve, kurse shkalla e papunësisë të gratë është më e lartë se sa të meshkujt. 60% e grave janë të papunë krahasuar me 38% të meshkujve të papunë. Trafikimi i vajzave nga Kosova, kryesisht përfshinë moshën 24 vjeç.

6. Sidomos shqetësuese është fenomeni i paraqitur pas luftës i përdorimit të lëndëve narkotike nga të rinjtë e moshës prej 15 deri 35 vjeç.

Të gjitha këto shqetësime kërkojnë trajtim serioz. Nga ana e saj Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zhvillimin e Rinisë ka hartuar dy strategji që paraqesin politikat afatmesme për rininë. Duke e mbështetur Ministrinë në punën e saj për rininë dhe për ta inkurajuar angazhimin e mëtijmë të saj, por edhe të gjithë ne. Grupi Parlamentar i Aleancës propozon veprimet e përgjithshme dhe të veçanta, që i konsiderojmë parakushte të domosdoshme për fuqizimin e rinisë.

Veprimet e përgjithshme – zhvillimi i politikave dhe i strategjive efektive afatmesme dhe afatgjata për rininë, promovimi i vazhdueshëm i mbështetjes për rininë, mobilizimi i të rinjve nga diaspora, duke i motivuar për kthimin në Kosovë, qasja multisektoriale dhe koordinimi i përbashkët i sektorëve të ndryshëm qeveritar dhe joqeveritar.

Veprimet e veçanta:

1. Avancimi legjislativ me formimin e mekanizmave për pjesëmarrje të rinisë në vendimmarrje.

2. Përsheptimi i reformave në arsim. Shkollimi është esencial për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe zbutjen e varfërisë.

Shkollat nuk duhet të jenë vetëm vend për fitimin e dijenisë akademike, por edhe për krijimin e aftësive të caktuara që ju ndihmojnë punësimin më të lehtë të rinjve. Besojmë se shkollimi dhe trajnimi janë përgjigjet e nevojshme, në veçanti edukimi dhe aftësimi i rinisë në fushën e teknologjisë informatike është i dobishëm. Përvoja e Irlandës është tregues i qartë i këtij fenomeni sidomos duke marrë parasysh se sot jetojmë në botën e globalizuar. Për hapjen e perspektivës globale, duhet të zhvillohen programe për studime ndërkombëtare, e cila kërkon mësimin e gjuhëve të huaja.

3. Krijimi i lidhjeve të ngushta ndërmjet biznesit dhe industrisë, nxitja e vetëpunësimit.

4. Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave është i nevojshëm për financimin e rinisë nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës.

5. Sigurimi i qasjes së barabartë të vajzave dhe meshkujve në arsimim dhe punësim, si dhe masat për shkollimin e vajzave, zhdukjen e plotë të analfabetizmit, parandalimi dhe luftimi i fenomenit të trafikimit të vajzave.

6. Përkujdesja për shëndetin e të rinjve, përmes veprimeve miqësore si mbështetja e qendrave të rinisë, sidomos atyre këshilluese për trajtimin e problemeve psikike, të shëndetit riprodhues, të varësisë nga substanca psikoaktive, por edhe OJQ-ve rinore, aktivitet sportive dhe programet e veçanta për zhvillimin e rinisë. Përpjekjet e posaçme duhet të ndërmerren për parandalimin e përhapjes së dukurisë së narkomanisë.

Rinia duhet të shihet si partner i denjë në ndërtimin e shtetit dhe zhvillimin e shoqërisë. Zhvillimi i saj varet nga paqartësia e rrugës politike dhe perspektiva integruese, rinia nga ana e saj tani më është deklaruar për zgjedhjen e saj për Kosovën shtet demokratik, të lirë, modern dhe sovran, prandaj është koha për njohjen ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, ky është sukses i përbashkët dhe zhvillim pozitiv për rajonin Evropën dhe botën.

Shpresat tona dhe besimin tonë të plotë e kemi te mbështetja e SHBA-ve dhe Uniteti në BE, NATO, dhe aktorët tjerë ndërkombëtar. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Teuta Sahatqija nga ORA.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – I nderuari kryetar, të nderuar ministra edhe kolegë deputetë.

Duke ardhur nga vendi im dëgjova shumë kolege të mij që kërkuan të jem e shkurtër, edhe do ta respektoj atë kërkesë. Gjithashtu, prej diskutimeve që i dëgjova deri më tash pata rast të konkludoj se UENDPI-a me të vërtetë ka bërë një punë jashtëzakonisht të

mirë, që na shtyri me fol gjatë e gjatë, edhe që të gjithë i mësuam që 50% e popullsisë është nën moshën 25 vjeç e tjera. Prandaj, unë i fshira ato të mijat çka i shkruva për këtë.

Tjetër gjë e cila më bëri përshtypje prej kësaj bisede që dëgjova deri më tash ishte fjala: Rinia do respekt, rinia është pjesë e rëndësishme e shoqërisë sonë, buxheti është i limituar, 1 milion e 300 mijë kanë dhënë donatorët në ndërkohe në buxhet 1 milion e 243 723 euro kanë qenë shpenzime, mallra dhe shpenzime. prej atyre për udhëtim 145 mijë euro, për telefonat 216 mijë euro, marketing 82541 euro. Po të kishte firmë kishte qenë me të vërtetë firmë internacionale shumë e fortë me prodhime shumë të forta që bënë marketing 80 e kusur mijë euro. Prandaj, në qoftë se flasim për rininë mos t'i derdhim lotët e krokodilit të kërkojmë respekt edhe të ngritim lartë. Rinia e ka vendin aty ku e kanë pensionistët, ku e kanë arsimtarët, ku e kanë mjekët, ku e ka gjithë shoqëria jonë.

Nuk mundet me u trajtua rinia si një pjesë e veçantë diku në hapësirë e izoluar nga të tjerët. Rinia është kjo ku është shoqëria jonë, ku jemi ne. Prandaj, kur flasim për rininë flasim për çështje e cila nuk ka të bëjë vetëm me **Ministrinë**, e cila nuk ka të bëjë vetëm me një segment. Kjo ka të bëjë me të gjitha ministritë, me të gjithë qeverinë, me prioritetet të cilat po i rekomandojmë që të jetë prioritet, po i rekomandojmë dikujt atje lartë që të jetë prioritet rinia.

Ajo është prioritet, do të duhet të jetë i të gjithë neve, si në të kaluarën tashmë edhe në të ardhmen, sidomos e atyre që e kanë qeverinë, që i kanë ministrat, që i kanë prioritet në letër.

Prandaj, për të treguar këtë kujdesin, për të treguar atë dëgjimin e problemeve të rinisë, duhet të tregoj që edhe grupi ynë parlamentar edhe grupet tjera që kanë organizuar konferenca, kemi organizuar konferencë në tetor 2006 për rini. Pastaj kemi organizuar konferenca edhe nëpër komuna: në Prizren, Gjiilan, Prishtinë, Mitrovicë e kemi përfunduar prapë në Prishtinë, të cilat, u mirëpritën me interesim të konsiderueshëm nga ana e të rinjve. Gjatë këtyre konferencave morën pjesë të rinjtë e partive të ndryshme të rrjetit rinor, pjesëmarrës nga Ministria, nga shoqëria civile, deputetë, u diskutua për problemet e të rinjve për Ligjin për rininë, ligji i cili edhe për përkundër mbështetjes së rezervave në çdo aspekt nga organizatat e ndryshme ende nuk e gjeti rrugën për në Kuvend për në aprovim.

Të rinjtë u njoftuan edhe me dokumentin, planin kosovar të veprimit për rini. Gjatë këtyre konferencave të rinjve të gjithë partive ishin njëzëri. Nuk kishte opozitë mes tyre, sepse, problemet me të cilët ballafaqoheshin të rinjtë ishin mbi interesat partiake, ishin interesat e tyre jetike. Sot të rinjtë të cilët vetëm me fjalë konsiderohen pasuri e Kosovës në të vërtetë janë pjesë e rrezikuar e shoqërisë.

Rinia edhe pas shkollimit ka pak gjasa të punësohet arsimin të cilin e kryejnë nuk është kompatibil me kërkesat e tregut për profil adekuat. Shkalla e ulët e zhvillimit ekonomik nuk mundëson absorbimi në një numri më të madh të rinjve të cilët çdo vit dalin në tregun e punës, t'i shfrytëzojë vetëm disa prej UNDP-së, 530 të pa punë për një vend të

punës, 50% të rinjve do të emigronin po të kishin mundësi, normalisht, privatisht, sepse nuk ka përpjekje për ndonjë emigracion të kontrolluar, punësim sezonal apo mënyra tjera të organizuara të cilët do të zbutnin në një mënyrë shkallën e papunësisë të rinjtë. Alarmante si u cek edhe përpara prej diskutuesve tjerë është situatat të vajzat e reja. Analfabetizmi të cilin gati e çrrënjësin këta pensionerë që sot po përbuzen, sot paraqet rrezik real për të rinjtë e sidomos për vajzat e reja, mungesa e perspektivës e tash rreziku i madh i cili përcjellë analfabetizmin e papunësinë është trafikimi i vajzave.

Të rinjtë janë lënë tërësisht pas dore pa kujdes institucional pa respekt, jo respekt verbal, por respekt të mbështetur në veprime. Disa prej masave që do të duhej të ndërmernte Ministria sepse ka shumë probleme të cilat kanë të bëjnë me çdo problem me ministrinë e tjera, por të koncentrohemi në ato masa të cilat duhet ministria për rini që është e thirr të ndërmerr. Janë ligji për rini, ligji për të cilin shumë organizata kanë dhënë ndihmat e ndryshme që sa vjet si përmes ekspertëve po ashtu edhe ndihma financiare ende nuk vjen në Kuvend për miratim, me siguri ka humbur diku nëpër fjoka e ka vështirë me dalë nga aty e me ardhur deri këtu.

Plani kosovar i veprimit për rini assesi nuk po mundet me u ndarë nga prezantimi në Pauer point dhe të transferohet prej realitetit virtual në realitet për rini.

Qendrat rinore të cilat pa kujdesin institucional po mbyllen çdo ditë e mëshomë marginalizojnë edhe më tepër rolin e të rinjve dhe i largojnë ata nga pjesëmarrja në vendimmarrje. Të rinjve nuk u mundësohet të marrin pjesë në aktivitete e organizuara vullnetare përmes të cilave do të fitonin përvoja praktika do të ndiheshin pjesë e rëndësishme e shoqërisë me çrrastë do të kishin ndjenjën e përkatësisë në komunitet. Faktet nuk do t'i përmendi se u përmendën, po i kalojë, por të gjitha ato fakte të gjitha këto informata janë të mjaftueshme që të tregojnë qasjen e gabuar të institucioneve ndaj rinisë. Dhe dëshpërimin e thellë të rinjve në këto institucione. A nuk është detyra e jonë të ndiejmë këto sinjale paralajmëruese dhe të veprojmë. Të gjitha këto që u cekën dhe shumë të tjera janë detyrë e Qeverisë në rend të parë, të Ministrisë për Rini, Kulturë dhe Sport dhe detyrat e juaja z. ministër. Fatkeqësia e cila sot u ka ndodhur të rinjve është përveç të tjerave edhe vetë **Ministria për Kulturë**, ministri i cili nuk e lëshon asnjë herë të përmend se a i ri është përdor pak raste të tregojë kujdes për të rinjtë tjerë, kujdes i cili ështësipas detyrës pritët prej tij, kujdes për të cilin paguhet dhe gëzon privilegje. Prandaj, rekomandojmë që Qeveria, kryeministri, të intervenojë urgjentisht dhe të sjellë Ligjin për pjesëmarrje dhe fuqizim të rinisë në Kuvendin e Kosovës. që të ndalet keqmenaxhimi dhe kaosi, i cili mbretëron në këtë Ministri, që të sigurohen fondet. Pamë që paska fonde por janë të shpërndara pak si keq, që të sigurohen fondet për implementimin e planit për veprim rinor, që të ngritët në nivel më të lartë bashkëpunimi ndër ministror për implementimin e planit të veprimit rinor. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Grupi për 6+ Xhezair Murat.

DEPUTETI XHEZAIR MURATI – Hvala g. predsedniče. Još jednom pozdrav kolegama. Ako svi danas kažemo da je omladina važan deo društva i ako ona čini njegovu budućnost kako to jeste onda ne verujem da možemo da mnogo da se pohvalimo

da smo za nju mnogo šta učinili pogotovo nakon rata. Hvalimo se da smo u tom pogledu naj bogatiji u Evropi, ali je ostavljamo da odlazi u tu istu Evropu. A kako na je onda to bogatstvo kojim se hvalimo a kojim drugi raspolaže. Mislim da je ovo za nas jedan veliki gubitak a mislimo ovaj da se pohvaljujemo više zaslužujemo prekor, izveštaju koje je pred nama poklonjeno je dosta truda da se pripremi, u njemu ima dosta pokazatelja, anketa istraživanja i opet kažemo da smo dosta uradili ali opet omladina odlazi. Ja se dakle ofim fenomenom bavim. Oboje isto koje kada se lekari hvale da je im operacija uspela a na žalost pacient je umro.

Šta ja da kažem, nijednu istraživanje nije obuhvatilko omladinu bošnjaka, turaka uvijek paralela između samo dveju zajednica. Da li su onda te ankete i koliko su objektivne, a uvek govorimo u ime multietničnosti. Kako se kod manje brojnih zajednica udražavaju odlasci, još boljnije nego kod svi sigurno. Mnogo mladih bošnjaci i turci završe fakultete, u njih se ulože tolika sredstva i onda ne mogu ni da voluntiraju a kamo li da rade.

O kakvoj to perspektivi govorimo, kolege, poznato je da Prizren centar manjih zajednica, ja ću reći ovom prilikom bošnjaka turaka da se ne bi gospodin Merđa i Roma ću reći a nemaju ama baš nijednog kvadratnog mjesta prostora u kojem bi mogli da se okupljaju, da se druže da razvijaju svoje mnogo pozitivne odlike da prošire, dakle da nastavljaju da razvijaju kulturne tekovine, da se bave sportovima i tako dalje i tako dalje. Mnogi naši pokušaji da ovaj problem riješimo na lokalnom nivou nije uspio, nije dakle usjeo. Šta dalje, trebali i dalje da čekamo sadaku nekih međunarodnih donatora. Mladi u sredinama agde žive bošnjaci nemaju još uvek elementarno pravo da koriste radiotelevizijski signal Kosova, a u anketama se govori da je televizija mediji kojoj oni najviše vjeruju. Kakva jeto anketa, ako jedan deo mladli njom nije obuhvaćen. Takodje govorim da ne postoje ni ti glasila niti časopisi kojima bi posvetili da tematiku mladih. O kojem povjerenje, o kojem povjerenju mi moramo da govorimo da oni imaju prema nama. Ja mogu ovde takodje da kažem oni što svi primećujete pred nekoliko kancelarija u Prištini, gde mogu da se regulišu papiri, vidite i sami kakvi su redovi, na žalost svih nas, šta mislite kada rešimo status i kada dobijemo više ambasada kakvi će tek onda redovi biti, i u njima najveći broj mladih.

Gospodo ja bih ovde kazao da mi moramo ekonomski oporavak da oslanjamo na mlade i moramo da razmišljamo kako to da regulišemo i brojnim zakonskim odredbama jer smo institucija koja donosimo zakone. Moramo da poredvidimo takve olakškce, i sasvim na karaju, koji nam je odgovor gospodo na brtojne ankete koje se objvaljuju ne samo u brojnim listovima u kojima mladi u jednom najvećem procentu ignorišu nas političare, ignorišu zanimanje koja se zove politika a mi tako ravnodušno na sve to gledamo. Hvala!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! në emër të Grupit për Integrim deputeti Ferid Agani

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryetar. Ky debat është me të vërtetë në vend, por njëkohësisht duhet të shpreh brengën që në fillim se do t'u përngjajë shumë

debateve në këtë Kuvend që kanë përfunduar pa asnjë rezultat konkret. Do të jetë rast i mirë që deputetët të përsëritin njohuritë për problemet aktuale, por sa do të ndikojë ky debat në përmirësimin e situatës jam skeptik.

Qasja e institucioneve tona politike ndaj çështjes së rinisë si dhe ndaj shumë çështjeve të tjera me rëndësinë në shoqërinë tonë është cilësuar me një jo seriozitet, më vjen keq që duhet të them dhe me një mungesë të kreativitetit.

Kosova sot e ka indeksin e zhvillimit njerëzor për 0.74 dhe me këtë indeks renditet në fund të vendeve të Ballkanit. Ky është realiteti jonë. Si mund të kualifikojmë ndryshe, jo seriozitetin në qoftë se në shtetin ku më, se gjysma e qytetarëve janë në moshën 25 vjeçare për mirëqenien e kësaj kategorie të qytetarëve nga buxheti ndahen 251 mijë euro ose 0.033% e buxhetit të përgjithshëm.

Për mua 0.033% është shkalla e brengosjes reale të institucioneve qendrore politike të Kosovës për rininë e saj. Të gjitha të tjerat për mua janë demagogji, ne mund të flasim se çka dom por planet strategjike dhe programet operative që i prezantoi ministri pa mbështetje financiare është shumë vështirë që të realizohet dhe tingëllojnë pazbatueshëm.

Është mirë i njohur fakti se buxheti i Kosovës nuk e reflekton realitetin e nevojave të popullatës dhe shembulli i buxhetit për Departamentin e Rinisë është njëri prej argumenteve më të qarta në këtë drejtim. Unë do t'i kisha thanë vetëm disa fjalë lidhur me disa dukuri negative në mesin e rinisë. Të gjithë jemi koshtetë për procesin e shpejtë dhe të tranzicionit kulturor, një tranzicion i ardhshëm kulturor, i cili është ka e prek çdo pore të jetës shoqërore ,duke filluar nga familjet tona dhe më gjerë. Kur e ke një popullatë kaç të re, atëherë nga njohuritë themelore profesionale është e qartë se të rinjtë kanë një nevojë të madhe për identifikim sekondar dhe natyrisht kur ky identifikim zhvillohet në suazat të një kornize të kulturës kombëtare, atëherë shumë harmon, më i rrjedhshëm dhe pa pasoja anësore. Në të kundërtën mund të kemi kriza të ndryshme të identitetit në rafshe të personaliteteve individuale, gjë që në mes tjerash është duke u manifestuar në shumë dukuri negative në shoqërinë tonë. Të përmendi vetëm trendin në rritje të vetëvrasjeve në Kosovë ,30% prej të cilave ndodhin në mesin e të rinjve tonë, ose për valencën e lartë të sëmundjeve të varësisë, sëmundjeve me përcjellshmëri seksuale ose rrezikun kërcënues të HIV-esit .

Vështirësitë e vet realizimit të të rinjve nëpër mjet arsimimit kualitativ dhe punësimit të shpejtë, krahas stimulimit të pa kontrolluar të sferës së tyre epshore ,veçanërisht nëpërmjet programeve televizive që nuk kanë asnjë vlerë edukative ,rezultojnë në shumë raste edhe me çrregullimin në rrafshin emocional dhe më të gjerë psikik.

Njëra prej formave të manifestimit të këtyre çrregullimeve është edhe dhuna e shtuar në shkolla në terrene sportive, ku protagonistë të shumtën janë të rinjtë.Kkjo dhunë është shprehje e pamundësisë së disa të rinjve për të kontrolluar agresivitetin e tyre që në shumicën e rasteve gjenerohet nga konfliktet e brendshme psikike , si dhe nga shpërputhja e synimeve të tyre normale me mundësitë e familjeve të mjedisit ku jetojnë. Programet parandaluese në këtë aspekt paraqesin domosdoshmëri të KOLËs. Veçanërisht

janë me rëndësi programet parandaluese dhe programet që kanë për synim arritjen e ekuilibrit emocional trupor dhe kongnitiv si dhe ndërtimin e moralit të shëndoshë tek nxënësit, siç është zbatimi i programit i edukatës fetare në shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës. Ajo që në periudhën afatshkurtër mund të bëhet është edhe gjetja e mundësive financiare për punësimin e psikologëve të licencuar në shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës dhe atë që nga fillimi i vitit 2008 në pajtim me aktin përkatës nënligjor që është në fuqi. Ofrimi i diagnostifikimit dhe Këshillimit Profesional Psikologjik në shkollat tona me siguri se do të ndihmojë në funksionimin më të mirë psikosocial të të rinjve tonë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ramanda Kelmendi LDD.

DEPUTETI RAMANDAN KELMENDI I nderuari kryetar, të nderuar ministra prezent. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë debatin për rininë e shëh dhe e konsideron si të qëlluar, ndonëse mund të flasim se kjo mund bisedohet në të ardhmen, por është i vonuar. Ndonëse jemi të vetëdijshëm se gjendja në të cilën ndodhemi në është e rëndë në kuptimin politik dhe ekonomik dhe atë institucional, Kosova në të gjitha nivelet dhe në të gjitha segmentet e saj për rininë duhet të ketë kujdes të shtuar më të madh dhe më të angazhuar në problemet e zgjidhjes së tyre. Grupmosha prej asaj 16 deri 24 ,gjegjësisht 25 deri në 29 përbën pjesën më vitale të shoqërisë kosovare dhe pikërisht ky kontingjent i rinisë më i çmuari i çdo shoqërie duhet trajtuar në pajtueshmëri me mundësitë tona materiale morale, politike e tjera.

Grupi Parlamentar i LDD-së kërkon që në kuadër të mundësive përmes projekteve të shikohet dhe analizohet, gjegjësisht zgjidhet çështja e rinisë.

1. Duhet pasur projekte për rininë jashtëshkollore,
2. Për rininë e shkolluar dhe papunësuar. Unë asnjë herë nuk do të elaboroj më tepër, për rininë e shkolluar dhe e pa punësuar. Projekte për punësimin e rinisë, projekte për ritrajnimin dhe shkollimin e rinisë në pajtueshmëri me nevojat e tregut të punës, sepse ne vërtetë shkollohem dhe një kontingjent i madh i rinisë është duke u shkolluar, ata kanë përfunduar në qendrat për punësim me diploma universitare por nuk janë adekuat me tregun e punës. Duhet bërë përpjekje me projekte konkrete se si të ruajmë rininë nga dukuritë negative dhe ato të bartura nga Perëndimi. Dy, të krijojmë kushte që rinia të mbetet këtu ku e ka vendin si dëshirë e tyre dhe jona duke pasur dhe duke parë perspektivën në vend dhe jo krah pune nëpër Perëndim. Të stimulohet rinia për tu ndalë migrimi i tyre i gjeneratës së re.

Të rinjtë, truri i Kosovës të ruhet si begati kombëtare dhe jo të marrë rrugën e kurbetit. Rinia fshatare të ketë mbrojtje më të shtuar dhe përpjekje më të gjerë si domosdoshmëri e shoqërisë. Mosndarja e bursave dhe kredive për shkollim individual të atyre që shprehin dëshirë shkakton probleme të mëdha të rinia. Mospërkrahja e rinisë femërore dhe në veçanti deklaratimet formale, ndalimi i punës së rëndë të të rinjtë dhe gjitha format e diskriminimit të punëmarrësit, të gjenerata e rinj deri te ato të kushtëzimet. Lënia e rinisë në eksperimentet, duke filluar që nga arsimi e deri te punësimi e deri tani te regjistrimi që bëhet sot në fakultete të ndryshme. Nxitja dhe stimulimi i punëdhënësve privat për

punësimin e të rinjve, por jo me kontrata fiktive dhe pa to, por në punë të rregullt dhe duke çmuar djersën punën e tyre.

Në tërësi rinia jonë e shëndoshë duhet mbrojtur me ligj dhe jo me fjalë si begati e madhe. Projektet parandaluese në programet e TV-ve ,të cilat do të kenë karakter edukues dhe kombëtar në projektet rinore. Kriteret për punësimin e rinisë janë kritere diskriminuese, duke filluar nga përvoja e punës dhe kritere tjera që nuk u mundësohen. Unë po e përfundoj me një fjali që e kam nxjerrë nga literatura politike ku thuhet dhe nuk dëshiroj që kjo të jetë ashtu si është në realitet.-Rinia do t'i gëzojë të gjitha ato që i kërkon dhe ia njohim ne vetëm kur vije në mesin tonë apo kur të plakët" Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka profesor Enver Hoxhaj, le të përgatitet profesor Ymer Halimi.

DEPUTETI ENVER HOXHAI – I nderuari z. kryetar, i nderuari z. ministër, të nderuar deputetë, të nderuar zonja dhe zotërinj. Më lejoni që të përmend arsyen kryesore pse Partia Demokratike e Kosovës dhe grupi i saj parlamentar kanë insistuar që ta kenë këtë debat në këtë ditë të nxehtë. U përmend raporti i UNDP-is i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, po su përmend njëra nga konstatimeve kryesore të cilin konstatim njerëzit që e kanë bërë raportin e kanë përmendur para Komisionit për Arsim, dhe ai konstatim thotë kështu: 50% e të rinjve dëshirojnë të emigrojnë nga Kosova. Mendoj se një konkluzë e tillë është argument i fuqishëm për ta pasur një debat në Kuvendin e Kosovës dhe për të qenë arsye e fortë se duhet të mendohet ma intenzivisht për rininë. Arsyja pse është hartuar raporti është e thjeshtë ,po të njëjtën KOLË është edhe shumë serioze. Prej mënyrës se si duhet të menaxhohen problemet që kanë të bëjnë me rininë, prej asaj varet edhe si do të menaxhohen sfidat politike ekonomike dhe sociale në Kosovë.

Unë nuk e kam ndërmend vërtet të polemizojë sot që me punën ose mos punën e Ministrisë së Kulturës, së Sportit dhe të Rinisë e kanë ndërmend vetëm tu t'ju tërheq vëmendjen në një fenomen shumë më interesant, raportin që ju e keni marrë e cila është bërë falë kërkesës së Kryesisë së Kuvendit, raporti ministrisë dhe raporti i UNDP-is janë teksti i njëjtë. Është po thuajse paragraf për paragraf plagjiat. Nëse na shpesh herë kësaj ministrie mund t'ia përshkruajmë detyrën e plagjiatorit. Do të thotë edhe këtu shtrohet dilema, Ministria ka aktivitetet e saja apo ministria përshkruan një gjendje imagjinare në bazë asaj se si të tjerët e përshkruajnë. Kështu që në atë drejtim mua ma merr mendja se nuk është e nevojshme fare të debatojë sa i përket punës apo mospunës së Ministrisë. Ne flasim për rini në Kuvend të Kosovës pa definuar kush është rinia, t'u mendua që rinia e Kosovës është e njëjtë me rininë perëndimore. Më lejoni vetëm tu bëjë me dije që këta njerëz që sot janë të rinj kanë lindur pas vitit 1980 e kanë përjetuar konfliktin, luftën, spastrimet etnike. Pse janë të rëndësishme këto ngjarje? Këto ngjarje atyre ju kanë frymëzuar personalitetin e tyre, botëkuptimet për të kaluarën botëkuptimet për të ardhmen. Arsyja e dytë që u përmend edhe nga një parafolës.

Kosova është vendi më i ri për nga mosha në Evropë, por për nga indeksi i të ardhurave dhe i jetëgjatësisë.,Kosova është në vendin e fundit. Do të thotë Kosova është vendi më i

varfër edhe pse është ma i ri, njerëzit jetojnë ma shkurt në Kosovë se çdo kund në rajon dhe në Evropë . Mendoj që këto janë arsyet që çdo kend duhet ta bindin që duhet të debatohet për çështjet e rinisë.

Problemet janë krijuar për shkaqe shumë të thjeshta, Qeveria e Kosovës e ka injoruar rininë, rinia nuk reflekton në as programin e saj qeveritar. 250 mijë euro është buxheti për këtë vit që po e lëmë, ndërsa investimet kapitale po thuaj se janë simbolike. U përmendën edhe mungesa e ligjeve, të cilat do të duhet të sillen sa më shpejtë në Kuvendin e Kosovës. U përmend nga ana e ministrit dhe për mendimin tim dokumentet që i përmendi ministri definitivisht janë të mira dhe të hartuara dhe reflektojnë një vizion afatgjatë. Problemi është i kësaj natyre. Strategjitë të cilat ofrojnë nga Ministria sa i përket problemeve të rinisë fare nuk janë të harmonizuara me strategjinë në fushën e arsimit, nuk janë të harmonizuara me strategjinë në fushën e punësimit, nuk janë të harmonizuara me planin dhe strategjinë për zhvillimin nacional të Kosovës. Nëse ju e lexoni planin për zhvillim nacional të Kosovës e krijoni përshtypjen që Kosova është një vend e cila do të jetojë prej burimeve natyrore dhe të energjetikës sikurse jeton Norvegjia, çka është absurde. Përveç kësaj për ma tepër këto strategji nuk janë as në kornizën e shpenzimeve afatmesme të përgatitur nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, do të thotë nëse kemi këto dokumente cili është roli i tyre.

Unë s'e kam ndërmend t'i përmendi gjitha ato argumente që u përmendën nga kolegët e mij deputetë, sa i përket arsimit, punësimit, fushave të tjera. Po përmend edhe përfaqësimi politik .Nëse ju e shihni përbërjen e Kuvendit të Kosovës, atëherë Kuvendi i Kosovës më tepër e meriton titullin e një senati se sa të një Parlamentit ,se fjala senat vjen nga fjala latine seneks dhe pjesa më e madhe ju e dini se çfarë nënkupton, dhe këtu duhet ta shtroni dilemën cili është përfaqësimi politik i rinisë. Nëse shihni Qeverinë e Kosovës këtu duhet ta shtroni pyetjen cili është përfaqësimi politik i rinisë. Prandaj, ideja jonë për një debat të tillë ka qenë dhe mbetet.

Duhet të ndryshohet qasja që një departament në kuadër të Ministrisë së Kulturës është gjendje t'i zgjedhë problemet e rinisë. Problemet e rinisë janë ndërsektoriale dhe duhet të ketë bashkëpunim në mes ministrive të caktuara. Gjitha rekomandimet që u përmendën nga kolegët e tjerë me qëllim që mos i përsëris, për mendimin tim janë ma se të nevojshme. Po përveç kësaj, ne kemi nevojë për një hartim të një politike kombëtare për rininë dhe harmonizimin e kësaj politike për rininë me planin dhe për strategjinë për zhvillimin kombëtar. Në rrafshin afat shkurtër liberalizimi i vizave, ju lexoni çdo ditë shtypin rajonal se cilat vende të rajonit kanë mundur të sigurojnë viza, punëtorët sezonal, fenomeni i emigracionit të kualifikuara, gjitha këto janë probleme të cilat për mendimin tim do të jenë në gjendje t'i zgjedhë Qeveria e Kosovës.

Më lenoni në fund t'i bëjë dy rekomandime- njëri konkret i cili ka të bëjë që prej kësaj seance duhet të dalin disa rekomandime konkrete. Absolut nuk ka arsye për debat të thatë, të kotë, pa rekomandime konkrete, ndërsa ministrit të Kulturës t'ia bëj me dije se sa buxhet ai ndan për vitin. Ju e dini që çdo vit Qeveria e Kosovës 35 cent i ndanë buxhet për një të ri. Buxheti për një të ri është 35 cent në vit në formë simulle 35 cent ia

dhurojë ministrit të Kulturës ta ka të qartë se sa buxhet ndanë për një të rinj të Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ymer Halimi, le të përgatitet deputetja Sala Ahmeti.

DEPUTETI YMER HALIMI – Ju faleminderit kryetar, ju faleminderit që jemi sot prezentë.

Debati për rininë në Kosovë është diçka që duhet të na ulë në rrafshin e përgjegjësisë edhe si Kuvend edhe si Qeveri edhe si Ministri. Të flas për rininë në Kosovë pa u ndërlidhur në rrethanor; të tjerë dhe që janë mjaft të ndërlikuar është pak sa vështirë. Veçmas do ta theksoja fazën dhe zhvillimin nëpër të cilën po kalojmë dhe përfundimisht do ta thosha një të vërtetë, meqë vërteta e ka vetëm një emër.

Kjo rini ka fat se jeton në liri, por është fatkeqe se nuk e ka kujdesin e duhur institucional dhe është e getojizuar nga strukturat evropiane. I mungon hapësira e punës, hapësira e zëniës së dijes, Nuk ka qasje të mirëfilltë në politikë. Është nën ndikimin e vazhdueshëm të rrymimeve të ndryshme ekstreme politike fetare dhe të krimit të organizuar, veçmas shtresa e varfër e saj. Kështu është se në këto 8 vjet na mungoi vizioni i duhur për politikën ekonomike të sigurisë sociale, të arsimit, të shëndetësisë, të sportit, të punësimit, të emigrimit, të lirive fetare, ndalimin e ndryshimeve të gjendjeve sociale. Pse? Se në disa funksione politike kyçe u kyçën disa kuazi politikanë e kuazi intelektualë, që postet nuk i pranuan si nder e përgjegjësi, por privilegj për përfitime dhe u treguan mbiinstitucional dhe mbi ligj. Ky Kuvend e kjo Qeveri sot duhet të jenë të shqetësuara nga porosia që vjen nga shpirtëri rinor ku 50% e saj ëndërron ikjen nga Kosova e lirë, kjo është shumë domethënëse, e 70% e papunëve janë rini.

Ne sot kemi vetëm mjekë të rinj, 450 pa punë, e në vend, e vendi është në pozitën e fundit në Evropë me mjekë për kokë banori, pa krahasuar profesionet e tjera. Këto janë sinjale alarmi për të gjithë që merrmi me politikë nëse vërtet ndjejë ndonjë herë përgjegjësi politike. Para 25 vjetësh në laborator shkencor në Universitetin e Prishtinës, moshatarët e kësaj rinie kanë bërë edhe 25 lloj analiza, e sot as 7 dhe kjo gjendje sa duket edhe ka KOLË se nuk do të kalohet, se mungon vizioni udhëheqësve për të kuptuar se si funksionon UP-ja. UP-ja edhe pse proklamon të jetë e hapur është ma e mbyllur se kur një herë më parë, paradoks kohe, kështu është kur sundon autokracia.

Po e shihni sot stresin e rinisë për tu regjistruar në UP është e paimagjinueshme. Prandaj atje duhet hapur dyert për regjistrim në numrin më të madh studentësh të rinj, kjo politikisht është e drejtë dhe praktikisht është e mundur. Sot universitetet në veçanti disa nga ato private të licencuara, pa licencuara meqë ka mjerisht prodhojnë diploma për rininë si çeçe bankare pa mbulesë financiare, kjo është tepër e saktë, kjo nuk do koment, por do zgjidhje, pasojat do të shihen kur këto çeçe me vula universiteti do të përpiqen të aplikohen. Po pëson rinia dhe kombi në tërësi sepse rininë në Evropë do ta integrojmë krah pune fizike, e jo fuqi intelektuale e profesioniste. Kjo nuk është ma pak se krim mbi rininë. Cili është kahu i zhvillimeve akademike që i takon rinisë, ju lutem, për pesë bursa

të konkursit të këshillit amerikan për ngritje akademike në universitetet e SHBA-ve në Kosovë konkurruan 5 vetë, Maqedoni, 25 vetë, në Shqipëri 30 e në Tajikistan 100 konkurrent, a nuk deshifron kjo gjendjen tonë të cilën jemi, po të ishin udhëtime zyrtare për të marrë mëditje do tua kalonim sigurisht të tjerëve.

Deputetë të nderuar, sa duket edhe te ne sociolog dhe bashkëkohor se sistemet demokratike të brishta në kërkesë të ndërrimeve për udhëheqë të ri janë gjetë udhëheqës të tillë që ju mungojë përvoja institucionale shumë nga ata rrëshqitën në korrupsion dhe dëmtuan proceset demokratike, këto mostra i kemi me bollëk bile duke u nisur nga Kuvendi, kujtojë një KOLË më parë se ishte gjendja këtu, ju lutem analizoni vetëm pak sjelljen gjermane në ndërtimin shtetit pas luftës së dytë botërore në ndërtimin nëse ndonjë herë e keni lexuar, atëherë do të bindeni sa anti pod i trishtueshëm jemi në këtë rast, këtu është gjeneza e saj se si duhet të sillemi me rininë.

Të ndash sot mjete financiare për sportin që u takon 300 mijë të rinjve më pak se Zagrebi që mund ta ndihmojë klubin e basketbollit të Cibonës apo më pak se detergjente letra tualeti në Qeveri, kjo nuk do koment, çfarë mund të presë rinia nga ne, kur në arkën e shtetit ka suficit zhvillimi ngelë paradoksale është kjo, e më pastaj evazioni fiskal për çdo vit më pak se 1/3 e buxhetit shtetit.

Borxhi i parketuar ndaj shtetit është rreth 169 milion deri në vitin 2006, kështu është që 8 vite, kjo është alarm për Kuvendin dhe Qeverinë. Kemi administratë me mbi punësim, jo funksionale institucione hibride që nuk epin përgjegjësi askujt, shpenzimet dhe luks qeverisës enorm, enorm për ballë të varfërisë të theksuar të popullit, shteti burim mbijetese financiare ka taksën nga importi, e importi mbulon 90% të shtetit, përballë këtyre ka ministra që ka mendjen të thotë se është krenarë e pastaj i lumtur, të tillë do të ishin pacientë të Frojit po të ishte gjallë.

Këto gjera nuk ka të drejtë më askush më t'i fshehë në petkun e pavarësisë. Me këto edhe miqtë tanë u kemi vë kokëçarje, por rinia çka atëherë mund të presë nga ne, kur ne kemi bërë kaq lëshime, Vërtet një pjesë e udhëheqjes në politikën e shtetit, sa duket është aksident i ynë në këtë orë të madhe të fatit të historisë.

Debati për rininë në Kosovë është diçka që duhet të na sjellë përsëri në rrafshin e përgjegjësisë. Rinia do të shpie proceset përpara, ky është emisioni i saj jetësor. Ajo u priu dhe do tu prijë prapë proceseve, por do të ishte mirë që ne do të ishim ballë tyre. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Sala Ahmetaj, le të përgatitet deputeti Xhelal

DEPUTETJA SALA AHMETAJ – I nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar ministra dhe deputetë.

Kudo rinia është kapitali më i çmuar, por shtrohet pyetja: Sa ka arritur shoqëria jonë e Kosovës dhe institucionet tona që këtë kapital, këtë vlerë ta kultivojë dhe ta orientojë

mirëfilli. A ka Kosova politikë kombëtare për rininë e cila do të përfshinte parimet, strategjitë, nismat që do të mundësonin pjesëmarrje në jetën shoqërore dhe institucionale. Fatkeqësisht se jo. E kemi thënë edhe në diskutimin tonë për arsim se Kosova do të prosperojë vetëm në qoftë se investon në resurset njerëzore, në rininë në arsimimin e saj. Prandaj politika kombëtare për rininë duhet të hartohet në bashkëpunim në mes të Ministrisë së Arsimit, të Kulturës, të Punës ,në mes të Universitetit, shoqërisë civile tjerë, e cila , përveç tjerash ,do të promovonte disa vlera. Do të institucionalizonte përkushtimin për rininë dhe avancimin e statusit të saj.

Për rininë do të mund të diskutohej në shumë rrafshe, sepse problemet janë shumë dimensionale.

Po ndalemi tek ato më të rëndat. Për shumicën e të rinjve arsimimi i lartë dhe punësimi mbeten vetëm dëshirë. Kjo është e dhimbshme. Shifrat dhe statistikat për këtë janë tmerruese .P.sh. në Kosovë papunësia në përgjithësi, në bazë të dhënave që kemi marrë nga të tjerët, është dikur rreth 50% por kjo shifër e papunësisë për të rinjtë rritet dhe shkon deri në 70%. Prandaj ose në Universitet mund të regjistrohen vetëm 1 e treta e maturantëve, ndoshta edhe më pak. Prandaj ,Universiteti i Prishtinës mendojmë se duhet t'i hapë dyertë për të rinjtë, në mënyrë që tu krijohet mundësia të gjithë atyre që duhet të studiojnë. Mundësitë gjenden gjithmonë, kur punohet me përkushtim.

Këta janë parametrat e rrezikshmërisë. Ky është alarm për dështimin e shëndetit mental dhe fizik të fëmijëve tanë. Rinia jonë me të cilën krenoheshim dje, ajo e cila ishte në ballë të proceseve dhe në ballë të luftës sonë për liri, sot duket e shkujdesur. Prandaj ne duhet ta gjejmë arsyen pse pjesëmarrja e të rinjve në zgjedhje është e vogël. Pse 94% të të rinjve nuk u intereson politika ose pse pjesëmarrja e të rinjve në veprimtari shoqërore, në nisma qytetare, në aksione, në diskutime dhe në debate është vetëm 3%.?

Pse cilësia e arsimimit të tyre është e paktë dhe e zbehtë. Përgjigjen në këto pyetje duhet ta japim ne, duhet ta japin institucionet e Kosovës. A e kemi kultivuar a e kemi ne të kultivuar përgjegjësinë dhe ndërgjegjen qytetare që këtë t'ua bartim edhe fëmijëve tanë, pjesërisht mendoj. Unë shpreh frikën dhe drojën se rininë tonë po e humbim, po e ngufasim, po e përjashtojmë nga pjesëmarrja dhe me egoizëm të paparë po ia pamundësojmë angazhimin në ndërtimin e jetës shoqërore dhe institucionale. Shembuj për këtë ka shumë.

P.sh. përtëritja e kuadrit në Universitet është e pakënaqshme, madje ajo është për keqardhje. Statusi i asistentëve është i palakmueshëm dhe përbuzës. Paramendoni një student që ka mbaruar universitetin me notën 9 ose 10 si asistent merr pagën prej 230 eurosh. Kjo është përbuzja që u bëjmë ne të rinjve tanë.

Ose p.sh. në institutet shkencore, siç është Instituti Albanologjik, Instituti i Historisë, edhe institutet tjera ,me vite të tëra nuk është bërë pranimi i kuadrit të ri edhe pse ka studentë të shkëlqyeshëm që presin ta avancojnë vijën shkencore, që presin t'ua hapim dyert. Këto janë disa nga arsyet pse rinia jonë ka sjellje indiferente për proceset shoqërore dhe për vendin. A ia kemi kultivua përgjegjësinë qytetarëve dhe mundësinë që ajo të jetë

aktive dhe të kontribuojë në përparimin e shkencës dhe të artit, që të jetë aktive në jetën shoqërore e jo të jetë indiferente, që rinia ta dojë vendin e jo të ikë, që të rinjtë të besojnë se do të punësohen me kriterin e cilësisë, me kriterin e profesionalizmit e të arsimimit e jo me nepotizëm dhe korruptim. Idealja do të quhej kur çdo i ri do të ishte në shkollë, në aktivitet kulturor a sportiv ose në punë. Realiteti është tepër larg ideale. Realiteti është tejet brengosës, kur për një vend pune konkurrojnë mbi 500 kandidatë dhe fare rrallë pranohet më i miri, kjo dëshmon për lëkundjen e vlerave, ose kur për një indeks konkurrojnë së paku 10 kandidatë. Edhe kjo është shqetësuese.

Këto shifra tregojnë paperspektivën për rininë. Kjo është fashitja e ëndrrave dhe iluzioneve të tyre, ndërhyrja në këto raste është e domosdoshme. Prandaj, këtu mendojmë është burimi i indiferentizmit, sepse shpresa mbetet vetëm në ikje, në kërkim të parajsës. Zbutja e kësaj drame për rininë tonë e kësaj papërspektive do të bëhej edhe një herë e ritheksojmë duke investuar në arsim, duke e bërë arsimin prioritet kombëtar, duke e bërë rritjen e kapaciteteve dhe hapësirave për argëtim, për sport, për art, që do të ishin si mekanizmat më të fuqishëm ,që do ta shmangnin rininë ta sjelljet dhe veprimet devijonte. Investimi në rininë, në arsimimin e sajë, është investim në ardhmëri. Mos ta vrasim ardhmërinë tonë. Kur ka përkushtim shtigjet gjithmonë gjenden. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhelal Canziba, le të përgatitet deputeti Ragip Zekolli.

DEPUTETI XHELAL CANZIBA – Ju faleminderit .I nderuari kryetar, i nderuari ministër dhe ju kolegë deputetë.

Të rinjtë, si të gjithë të tjerët, i gëzojnë të drejtat dhe obligimet e tyre si qytetarë. Në rastin e Kosovës pjesëmarrja e tyre në proceset politike është e domosdoshme, meqë përjashtimi i tyre nga ato mund të rezultojë negativisht në zhvillimin e demokracisë dhe në mbajtjen e stabilitetit në vend. Një pjesë kaq e madhe e popullit nuk mund të lihet anash në aspektin e politikëbërjes dhe implementimit të politikave. Sot në Kosovë të rinjtë ndihen të papërfaqësuar, të padëshiruar dhe pandikim në rrjedhat politike.

Mospjesëmarrja e tyre në proceset politike tregon për rininë pakënaqësi dhe mosidentifikimin me politikat institucionale. Për të stimuluar të rinjtë në përmbushjen e të drejtave dhe obligimeve të tyre qytetare dhe politike duhet krijuar një ofertë adekuate për ta, një platformë politike, me të cilën ata mund të komunikojnë,veçanërisht për sferat e interesit rinor. Gjithashtu, pa pasur një përfaqësi më adekuate edhe në opozitë institucionale me peshë politike nuk mund të llogaritet në aktivizimin politik të të rinjëve. Edhe pse ai është mëse i nevojshëm, ka hapësirë për përmirësimin e pozitës sociale të të rinjëve, përmes një koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstitutional. Deri tash kanë munguar edhe vizioni edhe vullneti.

Trajtimit të çështjes së rinisë, kësaj kategorie të veçantë e vitale të shoqërisë kosovare, në komunën e Rahovecit fare nuk i është dhënë rëndësi. Është e ditur se komuna e Rahovecit hyn në radhën e komunave, që kanë natalitet të madh në Kosovë e krahas kësaj edhe strukturë të re të popullatës. Nga institucionet e komunës së Rahovecit kanë

munguar në të kaluarën, mungojnë edhe në të tashmen, projektet e mirëfillta, projektet konkrete rinore, projekte të cilat duhet të përmirësonin dukshëm pozitën e rinisë në komunën tonë. Projektet e bëra nga ana e sektorit për rini në vitet e kaluara kanë qenë kryesisht të karakterit teorik, si trajtim i temave që i kanë pamundësuar rinisë të ketë qasje në organet vendimmarrëse për çështje të saja në komunë e Rahovecit, derisa në praktikë situata aspak nuk merrte kahje të ndonjë aktiviteti ku do të shprehej kreativiteti dhe individualiteti rinor.

Rinia e Rahovecit në mungesë të kuadrit adekuat profesional, udhëheqës të sektorit të saj dhe pa aktivitete përmbajtëse të karakterit progresiv rinor, vazhdimisht është marrë me probleme të pazgjidhura që detyrimisht e orientojnë atë të bëjë veprime devijuese që bien ndesh me synimet e një shoqërie të shëndoshë e demokratike. Problemet me të cilat ballafaqohet rinia e Rahovecit janë të shumta. Pamundësia për punësim, mungesa e pjesëmarrjes së rinisë në organet e vendimmarrjes, që ka si pasojë rritjen e interesimit të madh për të emigruar jashtë Kosovës si një mundësi e zgjidhjes së problemit të mbijetesës.

Në Kuvendin komunal të Rahovecit, çdo konkurs që shpallet për punësim, fillimisht kushtëzohet me përvojën e punës 2-3 vjet. Posa të diplomuarit në Kosovë dhe jashtë saj për të aplikuar për vendin e cekur në bazë të konkursit automatikisht diskualifikohen për shkak të mospërvojës së punës. Këto dukuri duhet të jenë brengë e institucioneve komunale dhe preokupim i përhershëm i tyre. Si rrjedhojë e këtij pasiviteti të qeverisë komunale është edhe fakti se posti i zyrtarit për rini pranë Drejtorisë për Kulturë, Sport dhe Rini është shuar pa asnjë justifikim që nga janari 2006. Buxheti i komunës në aspektin formal edhe pse parashihet mjete të caktuara për aktivitete rinore në mungesë të këtyre aktiviteteve ato mjete të dedikuara për rini janë orientuar diku tjetër, që paraqet shkelje të politikave rinore të hartuara nga i njëjti Departament. Përpos këtyre mangësive të cekura më lartë nuk u kujtuan as Drejtoria për Kulturë, Sport e Rini as organet qeveritare të komunës, për kategori të veçantë të rinisë që së paku të hartojë projekte për mbrojtjen dhe përkrahjen e këtyre kategorive, për të rinjtë, studentët, për familjet e dëshmorëve dhe të invalidëve, për të rinjtë e personave të zhdukur, për të rinjtë me aftësi të kufizuara etj. Në këtë kontekst duhet theksuar mos mbështetjen e duhur financiare të Qeverisë komunale për aktivitete sportive, të cilat do të ishin mundësi e mirë për formimin e një rinie të shëndoshë e të aftë për t'u kyçur në rrjedhat e jetës normale dhe progresive.

Moszbatimi i ligjit për sport, ku parashihet krijimi i fondeve komunale për sporte, pastaj mos aplikimi i këtij ligji aty ku përfshihen vlerësimet tatimore, sponsorizuesit e sporteve, si dhe disa veprime jo të mira të bëra gjatë vitit 2005 me ç'rast mjetet e parapara buxhetore për sporte nuk i janë dhënë ekipeve sportive, dukshëm ka ndikuar në shuarjen e krimeve sportive dhe varfërimin e jetës sportive e me të zvogëlimin e mundësisë për rini, për t'u marrë në mënyrë të organizuar me sport.

Komuna e Rahovecit si duket ka mbetur ndër të rrallat që ende nuk ka arritur të ndërtojë hallën e sporteve, edhe pse për të projekti ekziston që disa vite. Për tejkalimin e kësaj e kësaj gjendje duhen ndërmarrë këto masa.

1. Të harton planet e veprimtarisë rinore e sportive që mund të jenë të realizueshme dhe aty të cekën cilat janë prioritetet.
2. Të plotësohet vendi i zyrtarit për rini, i cili është i pa plotësuar që nga janari i 2006. Të plotësohet vendi i koordinatorit për sport ,i cili është i zbrazët nga shkurti 2007.
3. Të bëhen investimet e duhura në infrastrukturën sportive, ngritja e hallës së sporteve në Rahovec, investimi në fushat e futbollit në Ratkoc e në Krushë të Madhe, të cilat kanë shkollë të mesme dhe rini numerike.
4. Të vihet një jetësim Ligji për sport dhe udhëzimet administrative si parakusht për zhvillimin e sportit të mirëfilltë
5. Të investohet në ngritjen profesionale të kuadrit sportiv si garancë për ngritjen e cilësisë në sporte etj. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ragip Zekolli, le të përgatitet deputetja Remzije Nimani.

DEPUTETI RAGIP ZEKOLLI – Ju faleminderit zoti kryetar, të nderuar ministra dhe kolegë.

Duke u munduar që mos t'i përsëris ato që u thanë dhe pasi kemi pasur edhe raportin në duar, dua që dy çështje t'i them këtu e që nuk janë përmendur fare . Mendoj që do të duhej që rinia për të ardhmen vërtet mund të jetë e lumtur nëse atëherë është gjithëpërfshirëse, me të gjithë pjestarët e saj. Çështja e parë është se nuk u tha asnjë fjali për të rinjtë me nevoja të veçanta, çka mendoj se do ta vlente e sidomos integrimi i tyre për arsye se unë di për një rast për të cilin ministri ka ndihmua aktivitetin dhe më vie keq pse ndoshta nuk ia kanë paraqitur këtu, ta zëmë siç është kampionati i shahut për të verbërit. Dua të them edhe një çështje tjetër që mendoj se do të ishte mirë të ndihmojmë gjithë ne në këtë sallë, duke përfshirë edhe ministrin edhe Qeverinë, se këta persona me aftësi të kufizuar në shtator do të kenë kampionatin e goll-balldit dhe ai do të mbahet në Itali, e praktikisht është mbajtur kampionati në nivel të Kosovës ,qoftë në Ferizaj dhe Pejë. Tani duhet gjithsesi që vërtet të bëjmë aktivizimin e këtyre personave dhe në një formë të jenë pjesë integruese e shoqërisë tonë.

Dhe çështja e dytë kur është fjala për rininë dhe Kuvendin, unë kisha me e lidhë me vetë ne deputetët dhe sidomos me Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini. Janë dy çështje që nuk u përmendën nga kolegët e mij e që jemi marrë vesh që t'i bisedonim me nënkryetarin e Kuvendit. E para është ideja e formimit të një fondacioni për rininë, që do të kemi përkrahjen e ish- sekretarit të shtetit gjerman, përkatësisht zotit Fortune dhe Fondacionit Konrada Daneuer dhe gjithsesi na duhet zoti kryetar edhe përkrahja e juaj,e kryetarit të Kosovës dhe gjithashtu e Ministrisë.

Dhe çështja e dytë ,mendoj se është shumë në interes të Kuvendit që të hartohen brenda kësaj periudhe dy dokumente zyrtare që ende janë të papërfunduara. E para është korniza kombëtare e kualifikimeve që është gjithëpërfshirëse dhe e dyta është ligji që është pjesë e jonë dhe mendojmë që me kornizën kombëtare të kualifikimeve dhe me nxjerrjen e

ligjit, atëherë do të ishte një bashkëpunim shumë më i mirë ndërministror, do të jepte rezultatet e veta dhe ato rezultate do të ishin të prekshme.

Hapi që ka bërë Ministria e Punës, Mirëqenies Sociale, Ministria e Kulturës, pastaj e Arsimit është tejet i rëndësishëm për qendrën e resurseve kombëtare për orientim në karrierë. Po ju lutem, po e jap vetëm një shembull, që ajo qendër punon vetëm në Prishtinë për orientimin e të rinjve tonë dhe me dy persona me gjysmë orari të punës .d.m.th. punëtor të ministrive. Do të ishte mirë që mundësisht në planin buxhetor, gjegjësisht me rishikimin që vërtetë kjo qendër të rritet edhe në 7 qendra tjera dhe të kemi rezultate konkrete edhe në këtë fushë. Ju faleminderit !

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Remzije Nimani, le të përgatitet deputetja Drita Statovci.

DEPUTETJA REMZIJE NIMANI – I nderuari kryetar i Kuvendit të Kosovës, të nderuar ministra, zonja dhe zotërinj deputetë dhe të pranishmit tjerë në sallë
Debat i rinisë është i një rëndësie të veçantë dhe mendoj se është dashur të debatohet më herët, sepse rinia është pjesa më e vitale e një populli dhe një shteti. Kosova është vendi me popullsi më të re në Ballkan dhe në Evropë. E thanë të gjithë, e them edhe unë, 50% e popullsisë në Kosovë është nën moshën 25 vjeç dhe 60% nën moshën 40 vjeçare. Nga kjo përqindje në Kosovë të rinjtë e grup-moshës 14 deri 24 vjeç zënë rreth 21% të popullsisë së saj.

Gjatë vitit 2006 Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve është fokusuar kryesisht në hartimin e dokumenteve strategjike në fushën e rinisë të cilat do të jenë udhërrëfyese të programeve dhe aktiviteteve të viteve në vijim. Po në vitin 2006 është arritur të përfundohen dy politika afatmesme si plani kosovar i veprimit për rini 2007-2010 dhe plani akcional i punësimit të të rinjve 2007-2010.

Nga statistikën e vitit të kaluar mësojmë se papunësia në Kosovë arrin shifrën afër 60% dhe kjo është brengosëse për shoqërinë në tërësi dhe rininë në veçanti. Papunësia në Kosovë është pjesë e rinisë që KOLËN më të madhe ta kalon në rrugë, kafiteri, ose të kryejnë një aktivitet të palakueshëm. Mendoj se për rininë duhet të investojmë më tepër. Tek investosh sot tek rinia do të thotë të mendoj për të nesërmen e secilit të nxitësh përparimin ekonomik e social të vendit dhe të përshpejtosh zbutjen e varfërisë në Kosovë.

Tri probleme kryesore që mendojnë rininë janë, arsimi, papunësia dhe pjesëmarrja në vendime. Të rinjtë e arsimuar janë garancia për të ardhmen e përparuar e të qytetëruar të Kosovës. Në këto kushte është i nevojshëm një ndërgjegjësim më i madh i shoqërisë dhe i vendimmarrësve mbi përgjegjësinë që kanë për arsimin e të rinjve. Dituria është pasqyra e emancipimit të përgjithshëm shoqëror të një vendi, prandaj arsimimi i të rinjve, para së gjithash duhet konsideruar si një çështje me rëndësi primare. Papunësia në Kosovë ka një nivelin më të lartë në gjithë rajonin e Ballkanit. Në krahasim me vlerën mesatare të shkallës së papunësisë në bashkimin evropian, papunësia në Kosovë është rreth 4.5 herë më e lartë. Pjesa më e madhe e rinisë në Kosovë, është vështirë të gjejë ndonjë vend pune, sepse ekonomia është në kollaps dhe nuk prodhohet pothuajse asgjë.

Të zhgënjyer dhe pa dëshirën e tyre shpeshherë janë të detyruar të migrojnë në shtetet e Evropës apo të botës për të siguruar ekzistencën, prandaj duhet bërë më shumë që të hapen vende pune për rininë që të mos largohet rinia jonë nga Kosova.

Në Kosovë ekziston një mendim i përgjithshëm që, pjesëmarrja reale e të rinjve në shoqëri, dhe veçanërisht në vendimmarrje është e paktë, si p.sh. në parti politike ashtu edhe në institucione. Në një anketë që është bërë, rreth 70% të të rinjve shprehen se rinia nuk është e përfaqësuar sa duhet në politikë. Rreth 93.5 e të rinjve shprehen se nuk kanë dëshirë dhe nuk janë të interesuar që me vullnetin e tyre të merren me politikë.

Dua të theksoj se rinia e Mitrovicës pa dallim etnie këto probleme i përjeton dhe i përballon me vështirësi e më vështirë se çdo i ri tjetër i Kosovës. Ata janë refugjat në qytetin e vetë sepse jetën ua imponon politika. Nuk kanë të drejtë të lëvizin lirshëm. Të ndjekin mësimet në tri shkolla fillore, dy të mesme dhe në fakultetin xehtaro-metalurgjik që janë të uzurpuara në pjesën veriore të Mitrovicës. U ndalohet shërimi në spitalin e qytetit në pjesën veriore.

Papunësia në shkallë të lartë e të rinjve e bënë që Mitrovica të ketë shkallën më të lartë të varfërisë së skajshme. Në çdo 4 njerëz që jetojnë në varfëri të skajshme në Kosovë, një banon në Mitrovicë. Për rininë e Mitrovicës së Kosovës mund të flitet me ditë të tëra sepse ka çka të flitet, por shpresoj se me njohjen e statusit të Kosovës dhe integrimin e sajë në bashkimin evropian do të ketë prosperitet për të gjithë shoqërinë dhe rininë e Kosovës Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Drita Statovci, le të përgatitet deputetja Sanije Aliaj

DEPUTETJA DRITA STATOVCI – I nderuari kryetar i Kuvendit, ministra të nderuar të gjithë të pranishëm

Nëse pajtohemi se rinia është pasuri, është resurs njerëzor dhe burim i të mirave ekonomike, atëherë të investojmë më tepër dhe më racionalisht në zhvillimin e kësaj të mire kapitale, përkatësisht në zhvillimin e së ardhmes tonë. Nëse jemi koshient për faktin se mbi 50% e popullatës sonë është nën moshën 25 vjeçare, dhe nëse e perceptojmë drejtë fuqinë e rinisë atëherë të tregojmë më tepër interesim dhe më tepër përkrahje për ta gëzuar së bashku këtë dhunti dhe pasuri shoqërore.

Nëse i kuptojmë drejtë fazat e tranzicionit jetësor, atëherë të tregojmë më shumë sens, më shumë ndiesi që ta dëgjojmë rininë dhe ta pranojmë gjerësisht dhe më meritueshëm në shoqërinë tonë. Shikuar këto çështje në rafshin e arritjes së qytetarisë dhe të demokracisë në vendin tonë, do të fitojmë njohuri dhe rezultate të ndryshme por jo mjaftë të kënaqshme në aspektet e raporteve shoqëria dhe përfshirja e rinisë në shoqëri.

Rinia jonë me punën dhe rezultatet e veta, na përcjellë sinjale se është shumë e vendosur të merr pjesë në ndërtimin e të gjitha zhvillimeve pozitive të shoqërisë tonë. Shtrohet pyetja, sa është përfshirë rinia jonë në pjesëmarrje, shikuar kjo mbi platformën e të drejtave dhe të obligimeve të tyre si qytetar. Statistikat nuk janë aq pak të favorshme. Po

të nisemi nga e drejta për shkollim parauniversitar, ose universitar ose universitar do të vijnë në përfundim se institucionet tona vazhdimisht i mbeten borxh rinisë. Nuk i ofrohen kushtet e nevojshme shkollimi e perfeksionimi për më tepër nuk i mundësohet as përfshirje e mjaftueshme për të zënë vend në shkollimin e mesëm ose universitar. Po ashtu fare pak punohet në krijimin e kushteve për vende të reja pune që do të dedikoheshin për rininë. Është obligim i organeve udhëheqëse që të bëjnë më shumë në këtë drejtim. Duhet të tregojmë shumë përkushtim në mënyrë që të mos e largojmë rininë tonë nga vetvetja dhe as nga vendi i vetë. Është shumë simpatike dhe domethënëse, madje printuese nga ana e rinisë, kur për shembull në organizatat e veta për slogan të logës së vet zgjedhin identifikimin.

Të rinjtë e të sotmes janë liderët e së nesërme, por çfarë po na ndodhë në realitet, pjesëmarrja e rinisë në pjesëmarrja e rinisë në politikëbërje nuk mund të thuhet se është e kënaqshme gadi se në asnjë fushë jetësore. Është vështirë të konstatohet arsyeja pse ndodhë kjo për arsye të varfërisë profesionale dhe operacionale të organeve dhe të institucioneve udhëheqëse qeveritare, apo për diçka tjetër, sido që të jetë është fakt i pamohueshëm se duhet treguar gatishmëri më të madhe institucionale për përfshirjen e rinisë, por ama institucionale dhe të mos ndodhë që rinia të mbetet në makina të vullnetarizmit.

Megjithatë dëshiroj të veçoj diçka, edhe nga veprimtaria vullnetare, dua të them botërisht se rinia jonë është e mrekullueshme, është rini e shëndoshë dhe se këtë mrekulli dhe këtë shëndet dëshiron ta investoj pikërisht në shoqërinë e vetë. Aktivitetet rinore të shtrira mbi bazat e organizimeve jo formale, si p.sh. rrjeti rinor i Kosovës, zhvillohen në forma të ndryshme. Diku në prill të këtij viti në Ferizaj, p.sh. të ritë organizojnë një performancë sa simpatike aq edhe domethënëse. Në momentin kur arrin treni pikërisht në qendër të qytetit dhe në pikë të ditës të rinjtë duke qëndruar mbi binarët e hapur hekurudhor me trupat e tyre për disa qaste ndaluan trenin, a thua kush do ta bënte këtë performancë më mirë dhe më efektshëm se sa rinia.

Ky demonstrim dhe njëherit edhe protestë ishte një thirrje për ndërgjegjësimin e institucioneve ministrive tona gjegjëse për ta rregulluar infrastrukturën hekurudhore që për arsye të të metave të shumta marrin edhe jetë të njerëzve. Rast tjetër i pjesëmarrjes dhe i përfshirjes së rinisë në jetën shoqërore por kryesisht mbi bazat e vullnetarizmit është fjala vjen projekti ta njohim Prishtinën. Ekspozita e këtij projekti la pas veti efekte të qëndrueshme vizive, ndërsa porositja për shoqërinë është, zhvillimi i ndjenjes për njohjen për prezantimin dhe për rruajtjen e trashëgimisë kulturore që aq shumë e trumbetojmë dhe aq shumë e pretendojmë.

Për fund duhet vërejtur se aktivitetet e përmendura rinore por edhe shumë të tjera pozitive dhe domethënëse na bëjnë të mendojmë thellë se është koha e fundit që të mendohet për angazhime dhe përfshirje institucionale të të rinjve dhe ta ndryshojmë qasjen ndaj fenomenit të quajtur rini. Tek e fundit ky është obligim i joni moral e prindorë ndaj rinisë tonë, por edhe obligim i institucioneve tona qeveritare ndaj qytetarëve të vetë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Sanije Alijaj, le të përgatitet deputetja Naxhije Doqi.

DEPUTETJA SANIJE ALIJAJ- I nderuar zoti kryetar, u nderuar Kuvend, zotëri ministra,

Debati për rininë e konsideroj qasje serioze institucionale se krijon mundësinë për tu njohur me gjendjen faktike të rinisë përmes informacionit të ofruar nga Ministria për Kulturë Rini dhe Sport, por dhe e ngritë përgjegjësinë dhe llogaridhënien në të gjitha nivelet e shoqërisë duke filluar nga familja shkolle dhe vetë të rinjtë deri te institucionet më të larta të Kosovës.

Në çdo shoqëri të rinjtë karakterizohen si komponent të rëndësishme të zhvillimeve shoqërore, si forcë shtytse në reformat politike dhe ekonomike të një vendi. Kjo fjalë edhe tregon edhe ngritjen e interesimit të shoqërisë dhe qeverisë për trajtimin e merituar të rinisë. Të rinjtë në Kosovë nuk janë trajtuar në nivelin e duhur si produkt i zhvillimeve politike ekonomike dhe sociale. Ata ndajnë fatin e përbashkët të zhvillimeve në Kosovë. Një pjesë dërmuese e të rinjve vështirë e gjejnë një vend pune. Ky problem përfshinë edhe të rinjtë me fakultet që megjithëse me titull akademik vazhdojnë të jenë të varur nga prindërit nga ana financiare. Por edhe ata perona fatbardhë që pas shumë vështirësive arrin të gjejnë një vend pune duhet të pajtohen me rroga tepër të ulëta.

Shumë të rijë në mungesë të perspektivës për të ardhmen të frustruar reagojnë në mënyra të ndryshme. Një pjesë emigrojnë në vendet perëndimore. Disa shumicën e KOLËs e kalojnë nëpër kafene ose aktivitete tjera. ndërsa një pjesë shikon angazhimin e aktivitetit ilegal, gjë që dëmton në radhë të parë ata por edhe shoqërinë në përgjithësi. Me këtë rast do të potencojë se një numër i madh i të rinjve janë të punësuar në sektorin privat, ku afaristët tanë brenda një kohe të shkurtër pasurohen në sajë të shfrytëzimit të mendjes dhe trupit të tyre me orar të gjatë të punës pa sigurim shëndetësor dhe me një pagë mujore që nuk mund ta siguron vetë veten se lere më familjen.

Të pa shpresë me këto kushte pune të vetmin shpëtim të rinjtë e kanë shkuarjen tani aktuale në Irak dhe Avganistan në vatrën më të rëndësishme të luftës, këtë shqetësim e kamë ngritur te zyra për qeverisje të mirë pranë Qeverisë, përmes mekanizmave përkatës të inspektionit të zbatojë nenin 2 dhe 4 të ligjit kundër diskriminimit për respektimin e të drejtave të punëtorit e në veçanti trajtimin adekuat të të rinjve në vende të punës nga afaristët tanë. Trajtim të duhur dhe merit të rinjtë duhet të kenë edhe gjatë studimeve por edhe pas përfundimit të tyre duke aplikuar politika për punësim dhe krijim të mundësive për shkollimin pas universitar. Pa punësia është një ndër problemet më serioze me të cilat ballafaqohet shoqëria kosovare. Rritja e shkallës së papunësisë ndodhë për shkak të problemeve të trashëguar nga e kaluara si dhe mos zhvillimi ekonomik në fazën e tranzicionit nëpër të cilën po kalon Kosova. Problemi i papunësisë bënë që të rinjtë mos të marrin rrolin aktiv në ndryshimet pozitive shoqërore. Mungesa e përvojës në punë bënë që të rinjtë të mos e gjejnë shpesh veten në tregun e punës ngase punëdhënësit janë të interesuar të punësojnë të rinjtë me përvojë.

Mendoj për derisa ekzistojnë argumentet krahasuese se ka qenë keq më herët e në disa aspekte dhe se sot ekziston në potencial i kënaqshëm i të rinjve me të cilët mund të krenohemi si vlerë, që mund të shfrytëzohen për zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit, këto burime njerëzore duhet të shndërrohen në kapitale njerëzore duke investuar në radhë të parë në arsimimin e tyre. Fillimi i zbatimit të reformës në arsim kërkon mjete të mëdha financiare dhe qasje serioze të mësimdhënies dhe mësimnxënies, sistemi i arsimit në Kosovë, ofron shumë informacione mësim teorik, por shumë pak në zhvillimin e metodave hulumtuese dhe mendimit kritik.

Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, gjysmën e popullsisë e përbëjnë të rinjtë, që është e tashmja dhe e ardhmja e Kosovës, prandaj investimet në rini rrisin zhvillimin shoqëror ekonomik dhe politik. Bazuar në këtë rinia duhet trajtuar si partner serioz në zgjidhjen e problemeve sociale ekonomike, politike e jo si problem i cili duhet zgjidhur. Plani kosovar i veprimit për rini nga Ministria e Kulturës 2007-2010 si dhe plani akcional i punësimit i po të njëjtës periudhë si dhe strategjia për arsim para-universitar 2007-2017, synon që të përmirësoj situatën e të rinjve. Duke përfshirë institucionet qeveritare dhe jo qeveritare në identifikimin dhe përmbushjen e nevojave të të rinjve. Duke gjetur mënyrën dhe mekanizma për pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje në Kosovë.

Këto janë plane shpresëdhënëse, por duke ditur se të rinjtë janë më afër rrjedhave të zhvillimeve botërore, fuqizimi i tyre në vendimmarrje dhe qeverisje ngritë shkallën e demokracisë në institucione dhe në jetën publike në përgjithësi. Do ta përmbylli, investove në rini, investove në ardhmëri, dhe natyrisht kërkohet që pas përfundimit të këtij debati për pjesën më të mirë të popullatës në Kosovë të përfundoj debati me rekomandime që obligojnë institucionet e Kosovës për një qasje shumë serioze dhe urgjente për krijimin e kushteve edhe për shkollimin e tyre dhe për punësimin e tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Naxhije Doqi, le të përgatitet deputetja Nuran Malta.

DEPUTETJA NAXHIJE DOQI – Ju faleminderit zoti kryetar, të nderuar ministra, kolegë të nderuar deputetë. Rinia është gëzimi, shpresa dhe ardhmëria gjithkund në botë, ndërsa për ne në Kosovë është edhe veçantia me specifikacione dalluese aktive dhe pozitive si rrallë kund tjetër. Dhe këto janë fjalët e bukura dhe të vërteta që janë dëgjuar në vazhdimësi nëpër gjenerata në mënyra të ndryshme sipas kohëve të ndryshme se vetë rinia për ne është bukuria natyrale e jetës që premt. Është përtrirja dhe vitaliteti i familjes sonë, i shoqërisë dhe i shtetit, për të cilin kemi sakrifikua shumë dhe që në vazhdimësi po gjakojmë që ta kemi të plotë.

Rinia është domosdoshmëria e një shoqërie që kërkon përkujdesje të domosdoshme dhe të vazhdueshme se ajo duhet të shkollohet dhe të arsimohet që të merr dituri dhe që të emancipohet. Vetëm kështu rinia mund të përjetojë ndryshime dhe përparime në jetë, si dhe mund ti tejkalojë me sukses ndieshmëritë e moshës intensive që i hap rrugë pastaj moshës së marrjes së vendimeve të hyrjes në tregun e punës dhe të krijimit të familjes. Duke kaluar nëpër këto periudha shumë të rëndësishme të energjisë së madhe te

entuziazmit dhe të krijimtarisë, i riu e krijon identitetin e tij si individ dhe si anëtar shoqërisë që të pranohet dhe që të ndërveprojë si i dobishëm edhe jashtë familjes së tij.

Në lidhje me përcaktimit të kufirit të moshës së rinisë nga fëmijëria në pjekuri përmes ndryshimesh fiziologjiko psikologjike dhe sociale të tij ka mendime të ndryshme sipas vendeve të ndryshme. Programi i Kombeve të Bashkuara për rininë si të rinj i përcaktojnë njerëzit e moshës 15 – 24 vjeç, ndërsa Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe UNICEF moshën 10 deri 24 vjet, ngase mendojnë se shumë politika që ndikojnë tek të rinjtë shpeshherë ndërmerren, duke filluar nga mosha 10 vjeçare. Që të mos bëhen vlerësime dhe interpretime të ndryshme dhe të vazhdueshme nëpër KOLË një çështje e tillë më së mirë do të duhej të përcaktohej në mënyrë gjithëpërfshirëse në mbarë botën me ligj.

Sipas të dhënave zyrtare mbi gjysma e popullsisë së Kosovës është e re, ndërsa mosha 15 deri 24 vjeç zë 21% të popullsisë. Këto shifra dhe këto përqindje të vitalitetit aktiv njerëzor të Kosovës janë dëshmi shpresmëdhja për një të ardhme të suksesshme të saj drejtë rrugës së finalizimit të statusit formal të shtetit. Kosova që nga pas lufta e vitit 1999 hyri në rrugën e zhvillimit emergjent për sanimin e pasojave katastrofale të luftës shkatërruese për zhvillimin e demokracisë. Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, me Rezolutën 1244 e krijoj administratën e përkohshme në Kosovë për krijim të rendit dhe të zhvillimit, ndërsa me kalimin e viteve u krijuan edhe institucionet e përkohshme në nivel qendror dhe lokal dhe kjo është një arritshmëri e suksesshme që duhet vlerësuar si e tillë.

Të gjitha këto faza të ndryshimi dhe të zhvillimi në Kosovë, e kishin rëndësinë për kohën e vet. Por statusi i Kosovës për secilën është sakrifikua, luftuar shpresuar dhe premtuar, është çështja më e rëndësishme që duhet realizuar.

Krijimi i shtetit të Kosovës jo vetëm që është ndarje me të kaluarën anakronike dhe trishtueshme nëpër breza, por është edhe kapërcimi i tranzicionit dhe zhvillimi ekonomik i tij. Pas statusit final të pranuar ndërkombëtarisht nuk mund të ketë investime të huaja dhe kreditim të biznesit, si dhe nuk mund të ketë shkollim dhe perspektiv të rinisë së vendit në veçanti. Jemi të vetëdijshëm se të rinjtë e Kosovës janë të lidhur tradicionalisht me familjen dhe kjo u bëhet ndër të tjera edhe për shkak të varësisë ekonomike. Politikat prioritare të shtetit të Kosovës duhet ta kenë parasysh këtë në mënyrë që të fokusohen më shumë që të rinjtë të jenë të përfshirë në nivelet e shkollimit, si dhe që të fokusohen për punësimin e tyre që ata ta të hyjnë në punë për ta mbajtur veten dhe për t'u avancuar më tutjeshëm nëpër fazat e jetës.

Familjet kosovare kanë mundësi deri diku që ta financojnë shkollimin e fëmijëve të tyre deri në shkollë të mesme, por që pastaj e kanë të vështirë për shkak të mundësive të pakta financiare që i kanë. Pamundësitë e tilla i atakojnë më së shumti të rinjtë e moshës 18 – 24 vjeçare, me banim jashtë Prishtinës, të cilët dëshirojnë për t'i ndjekur mësimet në Universitetin e Prishtinës, si universitet kryesor dhe i vetëm shtetëror në Kosovë. Kur është fjala për arsimimin e kësaj moshe duhet cekur ose KOLËt e fundit ka rënë

interesimi i të rinjve për t'u regjistruar në Universitet, krahasuar me vitet e mëparshme. Ndërsa me më se për gjysmë ka rënë diplomimi i tyre në universitet.

Krahasuar në shifra sipas statistikave të hulumtuara në vitet e mëhershme brenda viti diplomonin diku 2200 studentë, ndërsa tani diplomojnë përafërsisht diku 1000 studentë në vit. Kjo është një shifër alarmante për ne në Kosovë dhe kujtoj se ndikim në këtë rend e kanë bërë edhe kriteret rigoroze të tepruara të pranimit të studentëve në Universitet. Duhet të pranojmë më shumë student në Universitet pa marrë parasysh se pas diplomimit një herë për një herë nuk mund të gjejnë punë në Kosovë. Por si të diplomojnë mund të gjejnë më lehtë punë për KOLËsisht edhe jashtë Kosovës.

Në Kosovë ekziston vetëm një universitet publik, apo shtetëror dhe ai në Prishtinë, ndërsa në Shqipëri gjenden 11 universitete të tilla. Po ti kishim në Kosovë edhe 5-6 universitete nëpër qytetet e tjera, shumë studentë do të regjistroheshin në universitetin e tyre të afërt apo të qytetit të tyre më të përafërt me shpenzime më të vogla. Është e vërtetë se në Kosovë e sidomos në Prishtinë janë hapur edhe universitete private, por xhepi familjar i studentëve tanë është varfër që të mund të regjistroheshin në këto universitete. Një krizë e thellë e paarsyeshme mendoj se është edhe mosshkollimi i vajzave, duke filluar sidomos që nga shkolla e mesme e deri në Universitet, dallimi i shkollimit dhe I punësimit të vajzave gati me përgjysmë është më i ulët krahasuar me djemtë. Kjo mendoj se është një dukuri e keqe dhe një problem që ndikon dëmshëm në zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë sonë, është një përgjegjësi jona për të gjithë që në të ardhmen duhet ta kemi parasysh për ta përmirësuar.

Duhet theksuar edhe një dukuri tjetër për të rinjtë tani si dukuri e re tek ne në Kosovë, që konsiderohet jo vetëm shumë e dëmshme, por edhe për së tepërmi e dhëmbshme e që është trafikimi i qenieve njerëzore e sidomos trafikimi i vajzave të reja. Ne mundohemi që të themi se në Kosovë nuk ka trafikim, por në të vërtetë për çdo ditë e më tepër ka informime se një dukuri e tillë bile edhe është në rritje. Një dukuri mjaftë e keqe mendoj se është edhe çështja e kafeneve, e internetit dhe e lokaleve të tjera që punojnë ngjan edhe tërë natën. Në këto lokale të rinjtë e kalojnë tërë natën deri edhe në mëngjes, ku konsumojnë duhan, pije alkoolike, besa edhe lloje të ndryshme të drogës dhe të nesërmen normal si të lodhur që janë vetëm flejnë dhe nuk mësojnë. Kjo çështje mendoj se duhet të rregullohet me ligj apo me ndonjë rregullore dhe me udhëzim administrativ nga institucionet tona dhe konkretisht nga Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës, që këto lokale publike të natës të punojnë si në shumë shtete demokratike deri në orën 24, ose eventualisht deri në orën një pas mesnate e më vonë jo.

Mbikëqyrje dhe masa duhet marrë edhe për luftimin e prostitucionit që vepron ndër ne edhe që sikur është e lënë pas dore në këtë aspekt. Lokalet ku ka prostitucionin, ose duhet marrë masa të rrepta ndëshkuese që të ndalohen ose në to duhet të ketë kujdes që ato të jenë higjienike si edhe në vendet tjera perëndimore demokratike. Po them kështu nga dhëmbja dhe jo nga arsyeshmëria që të jenë ato ekzistuese, ngase nga prostitucioni rinia jonë është në rrezik nga sëmundjet e ndryshme të pashërueshme e sidomos nga sëmundja famëkeqe e sidës.

Është për t'u përshëndetur puna dhe angazhimi i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, apo më mirë të themi puna dhe angazhimi i Departamentit të Rinisë së kësaj ministrie, sa i përket bashkëpunimit me organizatat e shumta nga Kosova në të mirë të rinisë.

Ministri anë fjalë ka ndihmuar rininë e Kosovës, me buxhetin e vetë (ndërhyrje kryetari – keni parasysh KOLËN ju lutem) – përmes planit aksionar të mbështetjes së Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe të shtatë organizatave të tjera të interesuara me përkushtim për rininë. Ka dalë, ka edhe aktivitete të tjera të Ministrisë në fjalë, ngase edhe vërehet një gjallëri e dukshme e të rinjve në Kosovë në këtë aspekt dhe nuk mund të mohojmë as ta injorojmë, kur dihet se mjetet janë shumë të kufizuara për avancim edhe më të mirë. Do të kisha përmendur muajin e rinisë, Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, Planin aksional të punësimit të rinjve 2007-2010, përkrahjen e shumtë projekteve nëpër disa komuna të Kosovës me financime edhe me trajnime na organizata qeveritare ndërkombëtare dhe të atyre joqeveritare.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, ose duhet me i bë nga 20 minuta. Fjalën e ka deputetja Nuran Malta. Dhe deputeti Hajredin Hyseni

MILLETVEKILI NURAN MALTA – MUHACERI - Sayın başkan, bakanlar ve değerli milletvekilleri

Gençlere ve Eğitim yatırım, aslında geleceğe yatırım yapmak olduğunu hepimiz biliriz. Kosova gençlerinin % 50'sinin 25 yaştan aşağı ve % 21'sinin 15-24 yaşları arasında olması bu yatırımın önemini daha fazla artırmaktadır.

Yaşadığımız yerin ekonomik durumu, eğitim ve sağlık sistemleri en çok gençleri etkilediği için ilerdeki dönemlerde olası krizleri engellemek için bütün enstitü ve kurumların bu konuyla ilgilenmesi ve çalışması gerekmektedir.

Kültür, Gençlik ve Spor Bakanlığının sunmuş olduğu raporda Gençlik departmanlığının gençlerle birlikte yaptığı çalışmaları ve projeleri inceledim, bu rapora bazı eleştirilerim ve önerilerim olacaktır.

Söz konusu raporda Gençlerle ilgili Uluslararası kuruluşlarla birlikte gerçekleştirilen projelerde azınlıklarla ilgili hiç bir bilgi verilmemektedir.

-Gençlik, Kültür ve Spor Bakanlığı Gençlik Dairesi'nin himayesinde 2006 yılında düzenlenen "Gençlerin Kültürel Miras hakkında bilinçlendirilmeleri" konulu kampanya Kosova çapında olumlu geçmiştir ve amaca ulaşmıştır. Ancak konuyla ilgili kampanya toplantılara Türkçe tercüme olmamış, broşürlerde, afişlerde Türkçe yazılar ve ibareler yer almamıştır. Oysa eğitimlerini Türk dilinde gören Kosova Türk gençleri Kosova kültürel mirası hakkında bilgilendirilmeyi kendi ana dillerinde arzulamaktadır.

-Kimi kamu ve özel kuruluşlar, Türk gençleri adında aslında onları temsil etmeyen sadece proje bazında maddi kaynak kazanmak amaçlı onları mensup

kişiler tarafından kurulmuş gençlik derneklerinin projelerini kabul etmektedirler. Bu da bizim gençlerini derinden üzmektedir. Bu konuda Türk Gençlik Derneklerinin kayıtlarını yapan Kamu bakanlığı bu konuya bir el koymalıdır.

Yerel kurum ve kuruluşların uluslararası kurum ve kuruluşlarla, Kosova gençlerine yönelik düzenledikleri çeçitli okul, panel, seminer ve genç lider yetiştirme programlarının kimine Türk gençleri de davet edilmektedir. Ancak ister "Avrupa Bölge Diller Kartı, ister "Kosova Diller Kullanımı Yasası" göz önünde bulundurulmayan, ders dilleri İngilizce dışında sadece Arnavutça ve Sırpça olmaktadır. Bu dilleri iyi tanımayan bizim gençler maalesef bu tür projelerde kendilerini ifade etmekte zorlanmaktadırlar.

-Gençler devlet destekli Türklerin yoğun olarak yaşadıkları belediyelerde Arnavutça dil kursu düzenlenmesini istemektedirler. Okullarda Türk eğitimine yönelik Arnavutça ders programı ve buna göre uyarlanmış Arnavutça ders kitapları olmadığı için, bu gençleri Arnavutçayı öğrenmekte zorluk çekmektedirler. Bu durumda devlet destekli Arnavutça dil kurslarıyla yine Arnavutça dilini kuvvetlendirecek Türk gençleri, Priştine Üniversitesinde bu dilinde, Türk topluluğuna ayrılmış Üniversite kontenjanlarından yararlanabilecek ve fakültelere daha kabarık bir sayıda burda okuyacaklardır.

Yerel ve uluslararası kurum ve kuruluşlar öncelikle Sırp ve Rom topluluklarının gençlerine yönelik projeleri desteklemektedir. Maalesef Türk, Boşnak, Eciptas ve Aşkali projelerini pojelerini üçüncü veya dördüncü planda ele alınmaktadır. Bu da bizi derinden üzmektedir.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Hajredin Hyseni. Në vazhdim janë edhe 11 deputetë që kanë kërkuar fjalën.

DEPUTETI HAJREDIN HYSENI – Faleminderit z. kryetar. Se sa serioz është ky debat tregon edhe vetë prania e kabinetit qeveritar. Unë mendoj që do të ishte mirë të mos zhvillohej debati pa prezencën e ministrit të Kulturës, i cili doli dhe nuk është prezent. Sigurisht po ministri dhe Qeveria e Kabinetit është ajo e cila duhet të implementoj politikat për rininë dhe ajo duhet të dëgjoj këtu.

Deputetë të nderuar .Debati që sot po zhvillojmë lidhur me rininë është një debat i cili vërtet është dashur që të shtrohet në Kuvendin e Kosovës shumë më shpesh dhe shumë më seriozisht. Ky debat do të duhej të shtrohej nga Qeveria në qoftë se vërtet do të kishim një Qeveri të përgjegjshme dhe përgjegjëse ndaj qytetarëve dhe nuk do të duhej prituri kërkimi i tij për të debatuar. Ky debat dhe jo vetëm debati është i nevojshëm nëse kemi parasysh se Kosova bën pjesë ndër vendet më të varfura të Ballkanit ,i cili ka 50% të popullsisë nën moshën 25 vjeçare . Kur kësaj të dhëne i shtojmë edhe faktin se Kosova është vendi i cili ka papunësinë më të lartë të rajonit, e cila është mbi 40% nga statistikat e dhëna apo që një shifër e tillë mund të jetë edhe më e lartë ,sepse një numër i madh ash që është i regjistruar, mund të themi se Kuvendi i Kosovës dhe institucionet e tjera do të duhej dhe duhet t'i kenë në agjenden e vetë vazhdimisht këto tema për të ndërruar

politikat zhvillimore ,sepse kemi të bëjmë me gjysmën e popullsisë ,e cila e përcakton të ardhmen e një vendi dhe trajektoren e zhvillimit të tij.

Znj. dhe zotërinj deputetë. Vendet që kanë treguar zhvillim ekonomik, që kanë ndërtuar institucione demokratike, janë ato vende që rinia e tyre ka qenë pjesë përbërëse e vendimmarrjeve e ndërtimeve të politikave dhe katalizator i ndryshimit të mentaliteteve të vjetra. Këto vende mund të themi se kanë përjetuar të ardhmen e tyre prosperuese dhe demokratike ku raporti Qeveri dhe qytetar është respektimi i normave të kodifikuara. Por si është kjo gjendje në Kosovë? Sa është pjesëmarrëse në vendimmarrje rinia? Si trajtohet ajo nga institucionet e Kosovës? Në qoftë se e shikojmë të ardhmen nga ky kënd mund të themi se nuk është shumë premtuese.

Znj. dhe zotërinj. Në cilindo qytet të Kosovës që të shkoni, në cilëndo kOhË qoftë, në mbrëmje apo në mesditë, do të shihni të rinjë që mbushin rrugët ,parqet, kafenetë, Do të takoni të rinj që kanë mbaruar fakultetet dhe enden këtyre rrugëve me shpresë se mos u buzqesh fati, shpresa e vetme e tyre mbetur. Do të takosh të rinjë të zhgënjyer nga institucionet ,qoftë ai Kuvendi apo Qeveria, qoftë i nivelit qendror apo lokal, të zhgënjyer nga politika, nga premtimet e përditshme që nuk ua ndryshojnë atyre jetën. Do të takoni të rinj që çdo ditë e më shumë dëshirojnë ta braktisin vendin, sepse nuk shohin perspektivë dhe realizim të synimeve dhe dëshirave të tyre të projektuar në Kosovë. Kjo gjendje e të rinjëve e cila sot është në Kosovë, përpos që është për shkak të shumë rrethanave të ndryshme është krijuar edhe për shkak të paaftësisë së institucioneve dhe politikave të tyre ndaj të rinjëve dhe qasjes së këtyre institucioneve në trajtimin e kësaj çështjeje, e cila kërkon politika të qarta vepruese në raport me kohën dhe rrethanat. Në qoftë se i referohemi këtij raporti të Ministrisë që na ka sjell sot në Kuvend do të mund vërtet që të konstatojmë se me çfarë serioziteti e trajtojnë rininë institucionet e Kosovës dhe çka është për këto institucione rinia. Po citoj: “Në fillim të raportit thuhet se rinia është fushë komplekse” Jo zotërinj, rinia nuk është fushë komplekse, është pjesë shoqërore, e cila do përkushtim më të madh për t’i krijuar mundësi dhe shprehjes së potencialit të tyre apo kur flet për planin e punësimit thotë se e kemi bërë, por cili është ai plan nga ky raport nuk mund të kuptojmë. Është në tabelë-thotë raporti, po ku janë ato tabela, as ne këtu dhe as rinia nuk i dinë, nuk i shohim. Në fund ky raport në shumicën e tij është një kopje e organizatave si UENDIP-is e të tjera dhe nuk është një raport i punës i Qeverisë apo i planeve të saj. Thuhet se 50% të të rinjve do të dilnin jashtë vendit. Kjo është e vërtetë. Po cilat janë politikat zhvillimore të Qeverisë për të ndalur këtë dëshirë të të rinjve, nuk thuhet. Le të marrim vetëm çështjen e punësimit të të rinjve dhe të shohim se si institucionet e trajtojnë këtë çështje, ndonse ato thirren vazhdimisht në profesionalizëm dhe në krijimin e hapësirës për të rinjtë, Ju lutem lexoni konkuset . Në të gjitha ato konkurse do të shihni se kërkohet përvojë pune 3- 4 apo më shumë vjet, një mentalitet i vjetruar, sepse përvoja nuk e përcakton profesionalizmin, por kjo bëhet pengesë e punësimit të të rinjëve. Ky është pragu për t’i penguar ata në punësim. Profesionalizmi përcaktohet nga dijet e zëna në fakultet e jo nga përvoja. Mësimnxënies duhet kushtuar vëmendje të duhur. Institucionet qofshin ato lokale apo qendrore bëjnë shumë pak në ndihmën edhe të atyre të rinjëve që kanë iniciativa dhe vullnet në krijimin artistik apo në zhvillimin e sporteve të atyre të rinjëve që me gjithë atë e begatojnë jetën tonë të varfur është se këto institucione bëhen penges e këtyre zhvillimeve, duke ua mbyllur qendrat e kulturës këtyre të rinjëve në vend që t’u hapen ato dhe duke i detyruar

që këtë veprimtari ta zhvillojnë në ambientet e lokaleve apo bodrumeve, ndërsa shtëpitë e kulturës rrinë të mbyllura, shtëpi të ndërtuara nga buxheti i këtij populli.

Të rinjtë tanë krijojnë vepra artistike si drama, vepra artistike të skulpturës, por udhëheqësit e kultursë nuk i lejojnë që t'i ekspozojnë këto vepra në ambientet institucionale. A është se institucionet janë të plakura dhe nuk mund ta përballojnë energjinë rinore apo është se ata vërtetë nuk kanë politika dhe vizion kohor se çka kërkon e ardhmja. Mendoj se që të dyja gërshetohen te institucionet tona.

Qasja institucionale ndaj të rinjëve është një qasje inferiore, duke i shikuar ata vetëm si pjesë e shoqërisë që duhet t'i shërbejë Qeverisë për propagandë dhe jo si pjesë burimore e një zhvillimi të qëndrueshëm të shtetit. Potenciali rinor që posedon Kosova është bazë e qëndrueshme e një zhvillimi premtues dhe institucionet e saj mund ta përcaktojnë këtë zhvillim ,varësisht se si ata do t'i qasen kësaj pjese të popullsisë dhe si e trajtojnë atë. Ndryshimi i një mentaliteti të tillë qeverisë që është sot në Kosovë është premtim i një të ardhme zhvilluese të Kosovës. Parlamenti ka obligim moral dhe ligjor ta ndryshojë këtë mentalitet qeverisë, sepse nga Parlamenti ka dalë kjo Qeveri. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Kemi dhe 9 kandidatë që janë paraqitur për diskutim.A doni pak pauzë apo të vazhdojmë? Vazhdojmë. Emrush Xhemajli e ka fjalën, kurse le të përgatitet deputetja Hatixhe Hoxha.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – I respektuari kryetar i Kuvendit z. ministër Haraqija, kolegë deputetë dhe ju të pranishëm. Të nderuara znj. dhe z. Ne si institucione, por edhe si bartës të proceseve të vendit duhet të pranojmë singlerisht para rinisë se nuk kemi arritur që asaj t'i sjellim një perspektivë që i takon. Kjo është e para dhe pastaj mund të flasim se çka mund të bëjmë në të ardhmen . Mos të harrojmë kurrë atë që u tha këtu disa herë se rinia ishte bartëse e barrës së rënd të Luftës Çlirimtare në Kosovë. Në konkurrencën me të tjerët ,Kosova ,si çdo vend tjetër, në radhë të parë do të hyjë në këtë konkurrencë me njerëz të përgatitur, të edukuar dhe të aftë. Çka është duke bërë shoqëria jonë për rininë? Rinisë së Kosovës sot i servohet një shkollim publik jo cilësor, ndërsa pas shkollimit pjesa më e madhe mbetet rrugëve dhe pa punë. Si pasoj e kësaj gjendje një pjesë jo e vogël e rinisë së Kosovës sillet e pa shpresë. Atyre që u jepet mundësia në kërkim të një perspektive për jetë pa hezitim ikin jashtë vendit pa ndonjë plan për kthim në kohën kur Qeveria banorët i ka objekt politik, merret me teori e andralla të kthimit të atyre që nuk dëshirojnë të kthehen, ndërsa nuk po mund t'i ndal edhe ata që janë këtu. Në kohën kur ndërton shtëpi politike për kthim të cilat shtëpi mbeten jo rrallë herë të zbrazta. Një pjesë tjetër e rinisë ka mbetur në mëshirën e trafikeve dhe krimit të organizuar për çka tregojnë çdo ditë kronikat e zezë të mediave në Kosovë dhe hulumtimet e ndryshme, ndërsa me ata që guxojnë të rezistojnë në formë demokratike në padrejtësitë që mendojnë se duhet të vëhen në vend apo për shkak të shqetësimeve të ligjshme për shtyerje të njëpasnjëshme për të ardhmen politike të vendit merren Ministria e Punëve të Brendshme, Shërbimi Policor i Kosovës, Shërbimi Policor i UNMIK-ut, gjykatat vendore e ndërkombëtare. Ata madje jo rrallë rrahen dhe fatkeqësisht ka pasur edhe raste tragjike të vrasjeve, burgosen dhe dënohen jashtëligjshëm. Ata nuk kalojnë lehtë as nëpër debate që i thërret opozita, që në fakt është oponentë në Kosovë. Po të shfaqeshin mendimet jashtë klisheve politike të lejueshme për paraqitje publike mund të nxirren zhagë edhe jashtë, mund edhe të grushtohen. Kjo është

pasqyra e gjendjes së rinisë në Kosovë, Vetëm për një mund të mburret Kosova, me gjithë atë, me gjithë këtë gjendje jashtëzakonisht të vështirë të rinisë ajo duket se ka pretendime dhe synimet e veta që e tejkalojnë vizionin zyrtar për të ardhmen e vendit. Unë znj. dhe z. e kam lexuar me vëmendje raportin e ministrit Haraqija dhe më vjen keq që përpjekjet e tij nuk janë shumë të dukshme, për shkaqe që këtu u thanë disa herë dhe me siguri se do të thuhën. Duke pasur parasysh atë që thuhet në raport se Kosova është vendi me popullsi më të re në Evropë ku mbi gjysma e popullsisë është nën moshën 25 vjeç pasi që ne e kemi një Ministri për Kthim dhe kisha me thënë një ministri tematike, atëherë pse jo duhet krijuar edhe është shumë e domosdoshme në mandatin e ardhshëm një ministri e veçantë për Rini dhe për Sport dhe kjo të ndahet nga Ministria e Kulturës. Mendoj se këtë do ta kishte bërë çdo vend i Evropës që do ta kishte pasur një strukturë të popullsisë çfarë e kemi ne. Nëse në fund nuk miratohen rekomandime konkrete dhe nëse nuk ndërmerren masa konkrete për kapërcimin e gjendjes më mirë të mos ishte thirrur fare ky debat ,sepse për ndryshe do të ishte debat demagogjik i natyrës së debatit për emigracionin, që u folën fjalë të mëdhaja, por kur erdhi puna me bë programin për ligjet që do të aprovohej për këtë vit, u hoq nga programi pikërisht ligji që ishte parapa për emigracionin. Disa thanë këtu se rinia është indiferente për politikë dhe proceset në vend. Për këtë unë nuk pajtohem personalisht, por me gjithë atë po mbetet ta shikojmë të shtunën protestën që është organizuar se çfarë lloj interesimi ka rinia për politikë dhe për procese. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputetja Hatixhe Hoxha , kurse le të përgatitet deputeti Mark Krasniqi.

DEPUTETJA HATIXHE HOXHA – Z. kryetar, koleg deputet. Ministria e Kulturës, përkatësisht Departamenti i Rinisë brenda saj, problemet e rinisë duhet t'i ngrisin në nivel më të lartë, gjegjësisht që rinia të jetë ndër prioritetet e Qeverisë, sepse pozita e rinisë mund të përmirësohet vetëm me një angazhim të përgjithshëm qeveritar. Përkrahja e të rinjve mendojmë se do të duhej të rregullohet përmes politikave rinore, sepse rinia nuk duhet të shikohet si barrë e shoqërisë, por përkundrazi si pjesa më vitale e saj. Prandaj, vend me rëndësi duhet t'i kushtohet ndër të tjera arsimimit, punësimit, si dhe kyqjes së të rinjve në të gjitha segmentet e jetës. Arsimimi i të rinjve ka rëndësi të jashtëzakonshme, sepse vetëm me një shkollim adekuat do të arrijnë që të rinjtë tanë të mund të ecin në hap me të arriturat ,si dhe do të ishte lehtësi në të ardhmen për punësimin e tyre. Ministria e Punës dhe Rinisë kanë bërë pak apo shumë pak apo shumë pak për të zbutur këtë problem dhe për këtë arsye pozita sociale e të rinjve është mjaft e vështirë, pra për shkak të kujdesit të pamjaftueshëm institucional. Sipas statistikave 70% e të rinjve janë të pa punë dhe tregut të punës për çdo vit i shtohet numër i madh i të rinjve, ndërsa sipas këtyre statistikave vetëm 20% e këtyre të rinjve arrinë të zenë punë. Sa i përket politikave për rininë mendojmë se është shumë e rëndësishme dhe e domosdoshme që politikat për rininë Ministria t'i bëjë në harmoni me nevojat dhe kërkesat e rinisë. Ministria duhet të ketë kujdes, ndër të tjera, që mjetet e dedikuara për Departamentin e Rinisë të mos orientohen dhe shpenzohen për nevoja të tjera të Ministrisë së Kulturës . Ministria duhet të ndajë mjete, të mbështet programet, projektet dhe aktivitetet e rinisë. Ministria duhet të angazhohet ndër të tjera edhe për renovimin, ndërtimin e objekteve si dhe hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve rinore, edukative, kulturore, sportive dhe

kreative. Prandaj, për një jetë më të mirë të të rinjëve, për një të ardhme më të mirë të tyre, po ritheksoj se rinia duhet të jetë ndër prioritetet e Qeverisë, sepse investimi në rininë është investim në të ardhmen.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Profesor Mark Krasniqi e ka fjalën, le të përgatitet deputetja Myrvete Dreshaj-Baliu.

DEPUTETI MARK KRASNIQI –I nderuar kryetar, të nderuar ministra, të nderuar deputetë. Për rininë ne të gjithë kemi fjalë të mira ,sepse rinia i meriton fjalët e mira dhe është kudo në çdo popull por te ne pasi është gjysma e popullit të rinj, atëherë edhe lëvdata të kemi më shumë dhe të jemi krenar që e kemi këtë strukturë. Mirëpo, me fjalë tonat të cilat janë të gjitha të mira, edhe propozime të mira, nuk hecin përpara. Ministri në paraqitjen e vet tregoj vështirësitë që i ka pasur dhe sukseset që janë mbërri në Ministrinë e Kulturës. Ai ka bërë çka ka mund, por me 250.000 € që u përmendën këtu nuk mund të ecet shumë përpara. Shpresojmë se do të përmirësohet buxheti i Ministrisë së Kulturës, me qenë se e gjetem një donator të fuqishëm këtu që i dha 35 cent për Ministrinë e Kulturës dhe besoj se kjo do të ndikojë në punën e mbarë të Ministrisë. I urojmë sukses. Shpresojmë se buxheti do të përmirësohet në të gjitha ministrinë, por jo me 35 cent, sepse kjo ishte një mahi nga ana e deputetit Hoxhaj dhe e falënderojmë, por ndoshta me investimet që i presim ne të gjithë ,se pa investime nuk mund të ecim përpara, investime të huaja. Me këta donatorë që i kemi brenda në Kosovë është vështirë që të bëjmë ndonjë punë të madhe dhe të përmirësohet edhe pozita e rinisë. Rinia është ardhmëria e kombit, rinia është një problem i shoqërisë, mirëpo rinia i ka dy probleme kryesore. E ka problemin e shkollimit dhe problemin e punësimit. Në shkollim është bërë një punë e madhe në Kosovë, me gjithë se jo deri në fund . Është për t'u brengosur kur dëgjuam se 1/3 e maturantëve mund të hyjë në Universitet ,sepse nuk ka mundësi tjera materiale, nuk ka hapësirë ose buxhet, ose nuk di që s'ka ,ajo është një brengë e madhe, d.m.th. vetëm 1/3, 2/3 e rinisë sonë mbetet pa të drejtën e përparimit shkollor e ndoshta në ato 2/3 janë njerëzit ma të orientuar se kjo e 1/3 që është në këtë anë që ju ka dhënë mundësia me hy në Universitet. Prandaj ,duhet të bëjmë çmos që kjo barrierë të thehet, sepse edhe provimi pranues nuk është një argument vendimtar. Ajo është një formë për t'i klasifikuar njerëzit, por ka njerëz në 2/3 që janë shumë më të aftë dhe më të mirë dhe ma me perspektiv më shumë se ata që janë hy në Universitet. Puna e punësimit, ne nuk mund të bëjmë asgjë, ndoshta reflektohet një përshtypje shumë e gabuar se ne nuk kemi kujdes për rininë. Kemi të gjithë kujdes dhe dashurinë ndaj rinisë, sepse janë djemtë tanë, vajzat tona, vëllezërit etj. por mundësitë janë të tilla, gjithmonë njeriu duhet me qenë shumë realist. Si thotë populli, sa të jetë jorgani shtrihen edhe këmbët, por këmbët duhet të rrudhen nganjëherë, por mundësisht të bëjmë atë çka mund të bëjmë, pa buxhet, pa mjete financiare janë të qala të gjitha ministrinë tona dhe të gjitha institucionet tona.

Përveç kësaj edhe çështja e punësimit që këtu u përmend dhe është diçka për t'u diskutuar ndoshta se gjithmonë po kërkohet edhe përvoja e punës. Ajo është e mirë nga një aspekt, sepse puna shkon më shpejtë, më mirë, por pa iu dhanë mundësia dikujt me hy në hapin e parë në punë ai nuk mund të tregoj se a është i aftë apo nuk është. Përvoja është shkolla më e mirë, prandaj edhe këto 5, 3, 10 vjet përvojë pune mund të hiqen për shumë vende të punës dhe pas një kohe të shihet se a është kandidati që ka hyrë aty dhe të merret si në prov disa muaj dhe a është apo nuk është i aftë për të përparuar. Unë nuk

kisha me zgjat shumë, sepse është diskutuar sot tërë ditën dhe janë të mira këto diskutime se po tregojnë se ne kemi një dashuri, një kujdes për rininë tonë, por edhe rinia duhet ta kuptojë se nuk janë mundësitë ato që duhet të jenë për përparimin e saj. Përveç kësaj desha ta përmend edhe këtë. Rinia duhet të edukohet para së gjithash si profesionistë, për profesione të ndryshme, por të edukohet edhe në pikëpamje të edukatës njerëzore dhe kombëtare. Të kemi një rini të shëndosh, një rini që është e edukuar që të ecën në rrugën e mbarë. Kjo është në interesin e rinisë para së gjithash, por është edhe në interesin e kombit. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit profesor. Fjalën e ka deputetja Myrvete Dreshaj-Baliu, kurse le të përgatitet deputeti Mazllum Kumnova.

DEPUTETJA MYRVETE DRESHAJ – Z. kryetar, ministra dhe kolegë deputetë. Tema për të cilën po diskutojmë më duket mjaft komplekse në trajtimin e saj dhe shumë dimensionale në aspektin e përgjegjësi që na takojnë. Diskutimi për rininë, d.m.th. diskutim për pjesën më të ndjeshme të qytetarëve të Kosovës. Rrjedha e debatit na dikton që këtij problemi t'i qasemi ndryshe dhe të zhvillojmë një diskurs të shprehjeve të problemeve të tyre i cili edhe do të reflektonte rezultate të ndjeshme. Nuk mund të bisedojmë për rininë si për një pjesë të shoqërisë që duhet të përdoret për organizimin e jetës kulturore, përvjetorëve dhe për shënimin e datave historike. Për rininë na duhet të mendojmë dhe të sillemi si me atë pjesë të shoqërisë të Kosovës të cilët intelektualisht, shpirtërisht dhe materialisht duhet të përgatiten për ndërtimin dhe drejtimin e shtetit të Kosovës. Për fat të keqë angazhimi ynë i deritashëm dhe sidomos dokumentet që na janë ofruar nuk e dëshmojnë këtë orientim. Ato përshkruajnë dhe dëshmojnë se brezi i ri ende është pjesë e angazhimeve partiake dhe pjesë e strukturave marginale qeveritare, se ky brez po ballafaqohet me nivel të ulët arsimimi, me papunësi me përpjekje imigrimi në zhgënjim. Në këto materiale do të duhej të kishim edhe një dokument po kaq shqetësues, regjistrin e vetëvrasjeve si dukuri e shtuar në radhët e këtij brezi. Statistikat e bëra për periudhën e paraluftës flasin për nivel të ulët, më të ultin në Evropë, ndërsa në regjionin e Drenicës është niveli 0, ndërsa pas luftës shkon ky numër edhe deri në 200 të vetëvrasës. Me këtë i referohem raportit të hulumtimit shkencor të dr. Arif Biringjikut. Ministrai e Kultursë, Rinisë dhe Sportit ka hartuar dy plane të veprimtë të cilat deri tash kanë kaluar fazën e diagnostifikimit të situatës së tashme sikur të thuhet në këto materiale të Minisdrisë dhe fillimi i zbatimit të tyre jashtë përshkrimit të veprimeve që i thashë më lartë, do të sillte rezultate të mira të pritshme për rininë dhe ardhmërinë e përgjithshme të shoqërisë tonë. Këto politika zhvillimore për rininë do të duhej të jenë më gjithëpërfshirëse dhe në to të fokusohen, pos Ministrisë së Kulturës edhe institucionet e tjera relevante, të cilat do të reflektonin qëllime të qarta për investime dhe zhvillime në këtë fushë. Është e pamohueshme nevoja për një strategji afatgjate të integruar, e cila në radhë të parë do të jepte prioritet nevojave të ndryshme të zhvillimit për rininë me theks të veçantë në sistemin arsimor dhe aftësimin profesional, si përpjekje për arritjen e shkallës gjithëpërfshirëse, së pari në arsimin e mesëm, të lartë dhe ofrimin e mundësive të barabarta për gjininë femërore. Zëvendësimi i strukturës tradicionale të sistemit të arsimimit 4 + 4 + 4 e shoqëruar me ndryshimet e nevojshme por ende e kemi prezencën, nevojën për pasurimin përmbajtësor dhe ngritjen cilësore me realizimin e të cilave të rinjve do të ju ofronim përgatitje më të mirë për të hyrë në tregun e punës, dhe

2. Rritja e kapacitetit të institucioneve të arsimit të lartë para së gjithash në Universitetin e Prishtinës, përmirësimi i cilësisë dhe integrimi në sistemin evropian të arsimit të lartë do të nënkuptonte prosperitetin dhe trajtimin më të mirë që mund t'i bëjë rinisë dhe vendit tonë. Faleminderit..

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit . Fjalën e ka deputeti **Mazllom Kumnova**, le të përgatitet deputeti Ymer Muhaxherri.

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA – Z. kryetar e ministra. Unë e përgëzoj Partinë Demokratike që ka ngritur për diskutim këtë çështje. Në proceset e zhvillimit nëpër të cilat ka kaluar Kosova pas luftës dhe deri më sot, mendoj se më së paku i kemi kushtuar kujdes rinisë. Edhe ato format e organizimit të misionit të rinisë edhe ato forma të organizimit të misionit të rinisë që i kemi zbatuar më tepër kanë qenë improvizime se sa një zhvillim i planifikuar dhe i qëndrueshëm. Dhe gjithnjë kur kemi bërë përpjekje që rininë ta integrojmë në zhvillime politike më tepër jemi anuar nga interesi partiak për të fituar vota, qoftë gjatë kohës së fushatave zgjedhore ose nëpërmjet stereotipeve të strukturave të formësuar partiake për të rinjtë se sa një konceptim ndërmarrje e nisma që promovojnë parimet e ndërtimit të shoqërie të hapur civile dhe demokratike që i jep rëndësi prioritare rinisë. Është iluzion se këtë strategji të veprimit dhe të bashkërendimit të politikave rinore mund ta kryejnë një departament i një ministrie. Çështja është më e gjerë. Së pari, duke u nisur nga fusha e legjislacionit për një mbështetje deri te institucionet e arsimit. Po kërkohet një koordinim i veprimit i planifikuar mirë, duke u nisur nga bashkëveprimi ndërministror. organet e qeverisjes lokale, organizatat ndërkombëtare dhe rajonale OJQ-ët rinore, përfaqësuesit e mediave, fushat e veprimit akademik, Universiteti, shkollat e mesme, donatorët e huaj dhe vendorë që kanë mundësi të operimit në fushën e rinisë.

Te ne mungojnë strategjitë të nxitjes së bizneseve rinore, krimi i një fondi të veçantë për biznese rinor ose lehtësi për të rinjtë nëpërmjet kredive afatgjata dhe me interesa të ulëta nga bankat. Pa dyshim kjo e obligon Ministrinë e Financave. Në anën tjetër për këtë çështje edhe Ministria për Mirëqenies Sociale dhe e Punës i takon për krijimin e disa programeve dhe nxitjen e punësimit të rinjve pranë bizneseve. Sa di unë format të tilla të aftësimit janë të ngritura nëpër komuna dhe po funksionojnë. Ne nuk kemi ende njësi të informacione për të rinj në nivele rajonale dhe komunale ku do të mbahej një lidhje e ngushtë me sektorin e biznesit dhe me të gjitha shkollat sidomos ato profesionale dhe fakultet. Na mungon promovimi i projekteve dhe programeve që e rrisin pjesëmarrjen e studentëve që shkollohen nëpër botë. Edhe temat e mbrojtjes së diplomave në disa fakultet tona mbesin si teza akademike dhe jo mundësi e inkuadrimit në punë e punësimit të studentëve tanë pas kryerjes së studimeve. Edhe në fushën e ndërgjegjësimit të rinisë për rolin e saj në ndërtimin e shoqërisë sonë, duke filluar nga sfera e edukimit kombëtarë, shëndetësisë, arsimit, kulturës, sport si dhe në sferat e ekonomike duke i dhënë asaj rinisë në përgjithësi të drejtpërdrejta në zhvillimet e sotme dhe ndërtimin e të ardhmes. Unë e di se gatishmëria e tyre ekziston por i duhet një mbështetje e planifikuar për të fuqizuar rolin aktiv të të rinjve në një shoqëri demokratike dhe shtet ligjor, pjesëmarrje dhe vendimmarrje të të rinjve në nivelet e pushteteve ekzekutive, legjislative, gjyqësore dhe

media. Për këtë na duhet një dokument themeltar i politikave rinore. Nëse kemi mundësi të bëjmë një sondazh me siguri aktualisht zhgënjimi i të rinjve për realitetin e krijuar është shqetësues. Mungesa e përspektivës dhe shumë halle e probleme të tjera që për ne duhet të jetë një alarm se duhet të filluar seriozisht të punojmë për rininë e këtë nuk mund ta bëjë një departament i një ministrie, por të gjithë ne si institucione ,si parti si OJQ, si media e të tjera e mbi të gjitha unë mendoj se një zhvillim i qëndrueshëm ekonomik që fatkeqësisht neve na mungon. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit . Fjalën e ka profesor Ymer Muhaxheri, le të përgatitet deputeti Rodina Bukoshi.

DEPUTETI YMER MUHAXHERI - Kuvend i nderuar, z. kryetar. Debati vuri në dukje pozitën, rolin dhe rëndësinë e rinisë si shtresë e ndjeshme dhe shoqërore. Pozita dhe roli i kësaj shtrese varet drejtpërdrejtë prej shkallës së zhvillimit ekonomik. Është pjesë tejet e ndjeshme, kërkon kujdes dhe interesim institucional. Për me e zbutë këtë problem që me ashpërsinë u paraqitë gjatë këtij debati, Nëse bëhen përpjekje dhe bëhet proukopim i mendjes e gjithë atyre që janë në Ministri këshilltarë, komisionet pranë Kuvendit që përfshira e maturantëve në studime bëhet problem proukopim ,atëherë edhe në këto kushte me angazhim dhe me një mobilizim munden me u racionalizua me u bë një riorganizim në kuadër të trupit arsimues, ekzistues , universitar. Në vend që ky trup arsimues me e shit dijen e vet nëpër universitete private komerciale, me një organizim të punës së tyre në dy turne dhe me një mundësi që jo 5 edhe 7 mijë me u pranua ,por me e shtua numrin edhe 10 mijë me një pagesë simbolike prej 1000 euro. Në këtë mënyrë kishte me u përmirësua pozita financiare, kishte me u ruajtur dinjiteti i arsimtarit ai i cili e kultivon dijen. E në anën tjetër kishte me ndikua në këtë komercializëm të universiteteve private, të gjitha nuk janë por shumica e tyre ku për një vit shkollor duhet të paguajnë 6 mijë euro dhe ku ky vend nuk është ku kultivohet dija e që ajo dije në shumë raste mundet me qenë problematike për kah kuantiteti dhe kualiteti. Ato me siguri kishin me ra sikur të kishte me ekzistua një gatishmëri institucionale që me e ba këtë organizim. Nuk është bërë për këtë vit shkollor. Me i përfshirë edhe 10 mijë tash 10 mijë kësaj janë në gjendje për semestër me i pagua 1000 euro e arsimtari kishte me pas një rrogë dinjitoze 500-600 euro perspektiva e asistentëve, përtëritja e kuadritKjo është vetëm mungesë e kujdesit dhe interesimit institucional. Këto munden me u bë kur nuk është vonë. Për atë edhe sugjerimi i im si rekomandim i këtij Kuvendi që këto komisione, dy ministrinë dhe gjithë ai mekanizëm që ekziston mu angazhuar dhe nuk i kushton kërkujt në këto kushte me ato kapacitete hapësinore të këtyre objekteve, mundet me u organizuar në dy turne, tri turne edhe me e zbutë këtë problem. Duhet me kontribuar me iniciativa konkrete e jo me u vu në dukje problemet të cilat shihen, janë të pranishme, por nuk kemi mundësi. Faleminderit kaq.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit profesor. Fjalën e ka deputetja Rodina Bukoshi, le të përgatitet deputetja Zyfyje Hundozi.

DEPUTETJA RUDINA BUKOSHI – Ju faleminderit z. kryetar. Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë. Nga diskutimet e ndryshme në lidhje me këtë debat u pa se çështja e rinisë nuk është vetëm çështje e një departamenti në kuadër të një ministrie, por është një

çështje ndërministrrore që i përket edhe Ministrisë së Arsimit edhe Ministrisë së Punës edhe Ministrisë së Shëndetësisë, pra disa ministrive. Megjithatë këtu kemi vetëm ministrin e Kulturës i cili na dha një rezymë të punës së Departamentit të Rinisë në kuadër të kësaj Ministrie dhe me këtë rast unë do të shprehja tri rekomandime ,pikërisht për Departamentin e Rinisë, për Ministrinë për Kulturë,Rini dhe Sport

Çështja e parë apo rekomandimi i parë është infrastruktura rinore ,qoftë ajo ligjore apo edhe fizike. Sa më parë që të plotësohet infrastruktura rinore, kuadri ligjor, aq më mirë dhe aq më i plotë do të jetë realizimi i projekteve të ndryshme apo programeve të ndryshme që ka ky Departament i rinisë në kuadër të kësaj Ministrie. Po ashtu edhe infrastruktura fizike e cila veç ekziston në Kosovë, mirëpo që nuk ka mbështetje apo nuk ka përkrahje financiare të duhur qoftë nga Ministria apo nga ministrinë e tjera. Pra, kërkohet që në alokim të buxhetit për Departamentin e Rinisë të kihet parasysh që infrastruktura fizike të mbrohet sa më shumë, sepse ajo veç ekziston, kështu që përkrahja sa më e madhe për këtë infrastrukturë fizike do të jetë një mundësi më shumë për aktivitete të ndryshme të rinisë në vendin tonë.

Një çështje tjetër rekomandim do të ishte vullnetarizmi, puna vullnetare. Në qoftë se llogarisim se përfitimi kryesor i punës vullnetare është aftësimi dhe fitimi i përvojës, atëherë do të kërkonim, duhet që pikërisht punën vullnetare ta certifikojmë me qëllim që të njihet kjo punë vullnetare, me qëllim që të njihet ky aftësim profesional që merr kjo rini dhe në qoftë se ne do të arrijmë certifikimin e punës vullnetare, atëherë do të kemi edhe një rini e cila është e aftësuar për fushat e ndryshme për sfera të ndryshme të jetës të punës këtu në vendin tonë.

Dhe rekomandimi i fundit është trafikimi si rrezik i periudhës së tranzicionit. Në kuadër të Departamentit të Rinisë është Divizioni për parandalim, pjesëmarrje dhe integritet sociale. Ndër programe të ndryshme që ka ky divizion është edhe programi për antitrafikim. Ministri na i përmendi shumë bukur programin për antitrafikim dhe na tregoi se çfarë është bërë gjatë vitit 2006 në kuadër të këtij programi. Mirëpo, mendoj se ky program ka qenë thjesht vetëm një fasadë apo nuk ka qenë një program intensiv ,sepse në atë rast do kishim edhe një vetëdisim më të madh të rinisë sonë apo të sektorëve të ndryshëm, qoftë ata komunal, ndërkomunal dhe ministrorë në lidhje me çështjen e antitrafikimit.

Dhe për fund fare unë do të doja që të shprehja një falënderim të fuqishëm për Departamentin e Rinisë, për ata djemë dhe ato vajza që punojnë me përkushtim në këtë Departament,pavarësisht problemeve të ndryshme me të cilat përballen ata. Po ashtu falënderim shkon edhe për zyrtarët rinorë të komunave. Ju faleminderit z. kryetar.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi, le të përgatitet deputeti Zylfi Merxha.

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI – Z. kryetar, z. ministra kolegë deputetë. Gjatë diskutimit të vet deputeti Enver Hoxhaj tha se rinia jonë nuk është e njëjtë si ajo në perëndim, për arsye se ka kaluar nëpër ngjarje traumatike të represionit të viteve të 90-ta

dhe traumës së luftës. Është e vertetë se rinia jonë ka kaluar nëpër shumë ngjarje traumatike, por si ka në dale nga ato, të stresuar apo të forcuar. Gjatë viteve 90 kemi pasur kontakte me shumë organizata për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga vendet e ndryshme të botës dhe pas bisedave që i kemi bërë me ta, duke treguar për keqtrajtime që i ka përjetuar populli jonë për një kohë të gjatë na thanë që qenkemi popull rezistent ose fleksibil. Nëse kështu mund të përkthehet fjala anglishte rizajellën me e përkthye bukvalisht është si llastiku dhe kjo e ka ruajtur kombin e juaj nga similimi. Një kohë të gjatë pas luftës është fol për stresin dhe traumën dhe në fakultetin e mjekësisë janë dëgjuar ligjërata nga profesorë të psikiatrisë nga universitete më eminente të botës dhe nga ata kemi dëgjuar se sa ndikim do të ketë ngjarja traumatike në psikikën e njeriut varet prej personalitetit të tij. Dikush nga ngjarjet traumatike del si yll e dikush si qenie e thyer dhe e merrni shembullin e Nelsol Mendelës, i cili pas 30 vjet burgu ka dal si yll dhe formues i një rendi të ri në shtetin e tij e unë e merrja shembullin e Adem Demaqit dhe shumë personaliteteve që kanë kaluar nëpër burgje dhe shumë situata traumatike e që sot ulen këtu në Kuvendin e Kosovës. Egoja e njeriut ka mekanizma mbrojtës për ngjarjet traumatike, sidomos ato janë më të theksuara te fëmiju, sidomos nëse është

i rrethuar nga familja e shëndoshë, e cila edhe në momente më të vështira ka mbet së bashku, Edhe një herë po them se pajtohem se rinia jonë ka kaluar nëpër ngjarjet traumatike, por ata kanë dalur si personalitete komplete e jo si persona të stresuar. Shihni se sa luftë po bëjnë që të regjistrohen nëpër fakultete, sa shumë ambicie që të magjistrojnë në universitete janë vendit dhe mund të gjejë edhe 1000 argumente që ta vërtetoj këtë dhe nuk është e ndershme që të justifikojë mosveprimet tona në raport me ta, me stresin dhe traumën nëpër të cilat kanë kaluar ata. Unë nuk desha të diskutoj sot se mjaft u tha për rininë e Kosovës. Arsyeja e vetme ishte që mos të manipulohet me stresin dhe traumën dhe të futet aty ku nuk e ka vendin. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Zylfi Merxha.

DEPUTETI ZYLFI MERXHA – Faleminderit z. kryetar i Parlamentit të Kosovës. Ju përsëritesha juve dhe stafin e juaj që jeni lodhur sot, po ashtu edhe ministrat që nuk janë mësuar aq shumë me nejtë. Kolegë të nderuar, zonja dhe zotërinj deputetë. Sot nuk kisha ndërmend me fol, mirëpo më qitën disa problemet vërtet që duhet të flas. Ka pas vytë një debat shumë shumë më herët m'u ba, mirëpo nuk kishte atëherë kush ta qon atë debat sikur që e bëri para disa ditëve edhe sot që po e bën debati në opozita në krye me PDK-ën. Mirëpo, nuk ishte sot vetëm këtu opozita edhe pozita edhe opozita jemi bërë një se e pamë vetveten sa kemi gabuar dhe ku jemi, ku e kemi lanë rininë që tjetër kush të punon me to, kurrsesi na kosovarët që po thomë e dojmë e respektojmë e bëjmë, por e kemi lënë anash. Na nuk kemi punuar që ky Parlament aspak nuk ka punuar me rininë, po ka punua dikush tjetër, kush krejt e dimë. Të kishim punua me rininë nuk do të kishte me u bë trafikimi i femrave. Po të kishim me punua me rininë nuk do të kishim mbushun përnatë kafeteritë gjithë natën. Të kishim punua me rininë nuk do të kishim me pas drogat shitje, blerës, ku ta di unë çka po ndodh natën se po flej herët.

Mirëpo, një send jam i bindur që për këtë sot ka pas shumë referate të mira, shumë fjalime të mira. Tha z. akademiku Mark Krasniqi -e kemi rininë. Po, e kemi një rini të

shëndoshë edhe shumë të mençur që hala s'na ka kap prej fytit me na i çkye teshat me thanë ku jeni ju deputetë që nuk po interesoheni për ne, nafaka jonë.

E tjetra na tashti ta akuzojmë vetëm këtë ministrin për rini me 250 mijë euro një darsëm një zengjin po e bënë, a ky për një vjet duhet për krejt Kosovën me i da, çka me da- 250 mijë euro, kurxho hiq nuk është. Na po të kishim punuar me rininë nuk do të kishim 200 që kanë vra vetveten ose kanë vjerrë. Nuk do të kishim shumë sende, po i kemi lënë jashtë dorës tonë. Deri kur kështu edhe Qeveria mos ta kujtojmë që edhe Qeveria ka mujtë me bë diçka më tepër, kurxho nuk ka mujtë edhe ata me një buxhet të vogël çka kanë mujt me ba, që po shohim çka po bojnë. Edhe për këtë nuk duhet ta themi vetëm ministri i Rinisë është gabim. Janë tre ministra- tha kjo zonjusha para meje që foli, të tre duhet edhe ministri për të rinjtë edhe Ministria e Punës.. edhe Ministria për Financa, po ashtu edhe ata po i mbajnë paret tani po i dalin shumicë edhe këta për arsim, krejt jemi fajtorë . Ky ministri i ri nuk e ka shtagën- shtapiqin “qiri ba -qiri bu” t'i zbukurojë krejt sendet. Ai i shkreti po mundohet shumë, por kuxho s'mund po bënë se shumë janë papunësia, shumë janë telashet e mëdha në Kosovë. Mirëpo kam një shpresë shumë të madhe -ishalla o Zot po i lutna, shpejt do ta marrim statutin ,të gjitha sendet do të rregullohen. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Ministër urdhëroni.

MINISTRI ASTRIT HARAQIJA – Së pari desha ta përshëndes Partinë Demokratike për iniciativë për këtë debat për rininë, për një çështje shumë të rëndësishme, siç e thatë edhe ju të gjithë edhe për rekomandimet, siç filluan nga Partia Demokratike ku ishin 13 e duke vazhduar edhe me subjekte të tjera politike. Unë desha të them një së pari për mikun tim profesorin Hoxhën se këto 35 cent është e vërtetë se ne kemi propozua si Qeveri, por ju jeni deputetë të nderuar që miratoni buxhetin e Kosovës edhe ju keni mujtë ta ndërroni atë, kurse ne Ministria edhe pse ka qenë 35 cent e kemi bërë 2 euro e gjysmë me donacionet të ndryshme edhe kemi vendos që të jetë shuma më tepër.

Sa i përket rinisë na e thamë që 50% e popullatës është nën moshën 25 vjeçare ,por duhet ta përfshini nga mosha një vjeçare deri në 25, kështu që nuk është gjithë që janë mbi moshën 25 vjeçare, por janë nga mosha 1 vjeçare deri 25 ose një ditësh ,siç thoni ju zotëri. Sa i përket punësimit të të rinjve në institucionet e Kosovës unë ju garantoj që janë mbi 27% të rinj që punojnë. Sa i përket minoriteteve që e tha z. Xhezair më herët në të gjitha ministrinë e Kosovës që janë mbi 9.3% të minoriteteve që janë të punësuar, jo vetëm minoriteti serb, por të gjitha minoriteteve, në bazë të dokumentacioneve statistikave që i marrin rrogat nuk di sa dalin në punë po sa marrin rrogat.

Sa i përket këtu që tha ka edhe plagjiat. bashkë me UNDP-in, unë thashë që kemi në bashkëpunim me UNDP-in të gjitha projektet i kemi krye edhe duke i falënderuar ata na kanë ndihmuar. Ju e dini, të qartë e keni të gjithë që Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport e ka buxhetin 6 milion e 300 mijë euro, 3 milion shkojnë në të ardhura personale. Dikush tha që Ministria ka udhëtime diku 1 milion e 200 mijë euro .Ato udhëtime përfshinë për të gjitha strukturat. Duhet ta keni të qartë që mbi 80 shoqëri kulturore artistike ekzistojnë në Kosovë edhe llogarite gjatë vitit shkojnë mbi 30 që marrin pjesë nëpër festivale të

ndryshme ndërkombëtare , të gjitha ato shpenzime i tërheqë i kryen Ministria e Kulturës. Duhet ta kemi të qartë se sporti çdo gjë që është mbajtur për sport për ndërkombëtarizim të sportit gjitha shpenzimet i ka tërheqë Ministria e Kulturës, Rini dhe Sport. Kështu që aty është një kod i buxhetit edhe të gjitha paraqiten si shpenzime të udhëtimit. Nuk i ka shpenzuar Haraqija vetëm 1 milion e 200 mijë për arsye se kisha duhte me fjet në aeroplan gjatë gjithë vitit.

Këtu u përmend edhe statistika të tjera, çështja e telefonave. Në qoftë se nuk e dini ka shpenzuar njëqind e njëzet e sa mijë euro thanë telefona Ministria e Kulturës. Ministria e Kulturës i ka 34 institucione të kulturës, kurse administrata brenda Ministrisë janë vetëm 12 telefona ruring. Mund t'ju japi statistikën dhe të keni qasje në dokumentacion. Por mos harroni se janë 34 institucione. Por këto propaganda i kam të qarta që moti sidomos nga subjekti i juaj që i takoni, për arsye se 18 mijë euro më keni akuzuar që kam ble veshmbathje. Kurrë Astrit Haraqija nuk ka ble veshmbathje, as për Ministrinë as për butigardat, por janë ble për Filarmoninë edhe për Teatrin. Kur paraqitet kodi për veshmbathje, kështu është mirë që ka nevojë to të ju mbajë edhe një trajnim për këto çështje të shpenzimeve.

Nuk dua ta zgjas më tepër, sinjerisht to t'i marrë parasysh të gjitha vërejtjet. Këtë problem nuk mund ta zgjidh një individ ose një department, por veç bashkërisht. Kisha kërkuar edhe nga PDK-ja me sinjeritetin më të madh po ju them se besoj që do ta keni Kuvendin e partisë shumë shpejt. Ju lutna që bini të rinj edhe ju në Parlament shumë më tepër se shumë pak jeni ose subjekti tjetër që ka moshën mesatare 55 vjeçare atje. Na prapëseprapë në Lidhja Demokratike kemi jashtëzakonisht mjaftë të rinj. Unë e di që 29 vjeçar kam qenë kryetar i Qeverisë. Zëvendëskryeministri është i moshës së re. Ministria ka të rinj, deputetë ka të rinj, ka pushtete lokale që udhëheqin nëpër komuna kështu që në subjektin që i takoj unë është e përfaqësues rinia.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Propozuesi i mocionit e ka fjalën.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar. Debat i zhvilluar sot është debat, i cili inkadroi fuqishëm si pozitën ashtu edhe opozitën dhe ju falënderoj të gjithëve që murët pjesë në debat me këtë nivel të seriozitetit. Por ky debat duhet të na obligoj të gjithëve, pozitën dhe opozitën, Ministrinë e Qeverisë dhe gjithë shoqërinë kosovare për të bërë diçka të mirë për rininë dhe jo vetëm me fjalë. Kjo kërkon vendosmëri përgjegjësi e përkushtim dhe obligim serioz para së gjithash të Qeverisë së Kosovës. Ne mendoj që edhe në fjalën tonë të parë nuk u morëm aspak me ministrin e as Ministrinë e Kulturës, pasi çështja e rinisë nuk është çështje vetëm e ministrit apo e Ministrisë së Kulturës. Mendoj që nuk ka çështje më të rëndësishme për shoqërinë kosovare se rinia për të ndryshuar kualitetin e jetës, të edukimit të arsimit të punësimit për këtë gjeneratë që i takon jo vetëm e ardhmja. Ne në fjalën e Grupit Parlamentar folëm për 12 rekomandime, por mendoj që njëri është kryesori - hartimi dhe miratimi i një strategjie kombëtare për rininë, për edukimin, për arsimin, për shëndetësinë, për punësimin dhe për krijimin e mundësive të kësaj gjenerate për të krijuar familje të re. Kështu në këtë gjendje ekonomike që e ka Kosova, unë jam i bindur shumë të rinj heqin dorë dorë nga krijimi i familjeve të reja për shkak të kushteve dhe mungesës edhe të banimit.

Nëse Qeveria nuk ka kapacitete , nuk po flas për Ministrinë, për të hartuar strategjinë kombëtare për rininë të kërkoj ndihmë nga institucionet ndërkombëtare që dinë ta bëjnë këtë. Por, unë mendoj që para se Kosova ta ketë një strategji për shfrytëzimin e linjitet që e ndot ambientin ,unë mendoj që duhet ta bëjmë këtë strategji dhe pastaj mendoj që hartimi i gjithë strategjive tjera do të ishte në harmonizim me strategjinë për rininë.

Nëse nuk jemi sot në gjendje të votojmë dhe ta autorizojmë Qeverinë për të hartuar këtë strategji ku pastaj do të hynin gjithë rekomandimet tjera, ndoshta është mirë që ta ngarkojmë Komisionin përkatës funksional të përgatit rekomandimin mbi bazën e këtij debati që është zhvilluar sot. Do të thotë këtu janë dy kërkesa të mia: Një që të votojmë rekomandimin për hartimin e strategjisë kombëtare për rini.Nëse këtë nuk jemi të gatshëm ta bëjmë sot, atëherë të autorizojmë Komisionin funksional të përgatit rekomandimet mbi bazën e debatit që është zhvilluar sot. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni z. Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar. Mendojmë se ashtu siç tha edhe parafolësi debati ka qenë serioz, i frytshëm me shumë porosi, të cilat mund të përpunohen dhe të përgatiten për një dokument që miratohet në Kuvend. Ne e mbështesim idenë apo propozimin që Komisioni funksional ta analizojë debatin dhe t'i ofrojë seancës rekomandime në një prej seancave të ardhshme. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit për kontributin që keni dhënë. Nesër takohemi në orën 10,00.

SEANCA PLENARE, DATË 29.6.2007 (vazhdim)

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju lutem zini vendet dhe fillojmë me punë.

Vazhdojmë me pikën 5 të rendit të ditës.

5. Debat për zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit, datë 7 korrik 2005, për çështjen e pensionistëve të Kosovës

Në pajtim me Rregulloren e punës Komisioni Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka kërkuar debat lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit, datë 7 korrik 2005, për çështjen e pensionistëve të Kosovës. Për ta përgatitur sa më mirë këtë debat Kryesia e Kuvendit e ka ngarkuar Qeverinë, përkatësisht Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale të përgatitë një informatë si material bazë për debat. Informata e Ministrisë lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit të Kosovës të dt. 7 korrik 2005 për çështjen e pensionistëve në Kosovë që u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj përfaqësuesin e mocionit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenies Sociale që ta marrë fjalën.

Në sallë janë 65 deputetë, d.m.th janë plotësuar kushtet që të fillojmë me punë.

Fjalën e ka deputetja Fatmire Mulhaxha – Kollçaku , kryetare e Komisionit.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA – KOLLÇAKU – Faleminderit z. kryetar, ministra, koleg deputet të nderuar.

Dëshiroj ta informoj Kuvendin që Komisioni Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka kërkuar që sot të diskutohet lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit të Kosovës të dala më 7 korrik të vitit 2005, d.m.th kjo ka qenë një kërkesë disa muaj më parë dhe ju falënderoj që më në fund është radhitur si pikë e rendit të ditës, meqenëse nevoja ka qenë shumë më herët, sepse tash jemi 2 vite më vonë prej atyre rekomandimeve të cilat fillimisht kanë qenë të hartuara nga Komisioni Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie -përveç rekomandimit të pestë i cili ka dalë direkt nga seanca plenare dhe më pastaj ato rekomandime janë votuar njëzëri në Kuvend të Kosovës dhe është e qartë që praktika më në fund të fillojë në këtë Kuvend që t'u rikthehemi vendimeve që i marrim vetë, të shqyrtojmë në kontinuitet. Jo vetëm për pensione, por edhe shumë vendime të tjera, ta thërrasim Qeverinë dhe të shohim se ku jemi në zbatimin e vendimeve dhe të rekomandimeve që i merr ky Kuvend. Ne si Komision kemi marrë vendim që të gjithë të shprehemi në emër të grupeve tona parlamentare, prandaj unë me që e kam marrë fjalën do ta shfrytëzoj të drejtën që të vazhdoj të diskutoj për këtë temë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ftoj ministrin Ibrahim Selmanaj të paraqesë qëndrimin e Qeverisë, përkatësisht qëndrimin e Ministrisë.

MINISTRI IBRAHIM SELMANAJ – Faleminderit z. kryetar, deputet përshëndetje të gjithëve.

Më lejon të paraqes qëndrimet e Qeverisë dhe zhvillimet të cilat kanë ndodhur deri më tash rreth pyetjeve, të cilat i janë parashtruar Ministrisë së Mirëqenies dhe Punë Sociale. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në kuadër të kompetencës dhe përgjegjësisë të veta të përcaktuar me akte ligjore dhe nënligjore që nga themelimi i saj prioritet të veçantë ka pasur krijimin e aplikimit të skemave pensionale për kategori të caktuara të qytetarëve të Kosovës. Skemat pensionale të krijuara në periudhën e pasluftës dhe të cilat aktualisht janë të aplikueshme, janë të karakterit të përkohshëm duke pasur për qëllim themelor uljen e varfërisë në vendin tonë dhe duke pasur parasysh karakterin e përkohshëm të këtyre skemave si dhe moskrijimit e sistemit të sigurimit pensional dhe invalidor të detyrueshëm në këto skema, Ministria në vazhdimësi ka insistuar në krijimin e sistemit të qëndrueshëm të sigurimit pensional dhe invalidor. Në këtë aspekt Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në vitin 2005 ka përgatitur projektligjin për sigurimin pensional dhe invalidor i cili ka qenë i përfshirë në planin legjislativ të MPMS-së dhe në strategjinë legjislative të Qeverisë së Kosovës për vitin 2005.

Qëllim kryesor i nxjerrjes së këtij Projektligji ka qenë krijimi i infrastrukturës së mirëfilltë ligjore nga fusha e sigurimit pensional dhe invalidor. Në vazhdim jua prezantojmë ecuritë e procedurave të hartimit, shqyrtimit dhe procedimit të Projektligjit të sigurimit pensional dhe invalidor si dhe rekomandimet e dala nga mbledhjet e mbajtura të

Qeverisë. Pas rekomandimeve të nxjerra nga Kuvendi i Kosovës me dt. 5.07.2005 Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i kishte filluar aktivitetet e saj përkatëse për plotësimin e këtyre rekomandimeve. Fillimisht është bërë analizimi i funksionimit të sistemit për sigurimin pensional dhe invalidor në vendet e rajonit. Pas shumë përpjekjeve të bëra MPMS ka hartuar draftin fillestar të Projektligjit për sigurimin pensional dhe invalidor dhe e ka dërguar për miratim në Qeveri. Në mbledhjen e mbajtur më dt. 29.11.2006 Qeveria e Kosovës mori vendimin nr. 04/227 që të shtyjë miratimin e Projektligjit për sigurimin pensional dhe invalidor për shkak të kostos së lartë financiare të këtij Projektligji dhe kishte kërkuar nga MPMS , është bërë kërkesë që të filloj rishqyrtimi i të njëjtit projektligj duke pasur parasysh edhe rekomandimet që kanë dalë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. Pas vendimit të Qeverisë MPMS ka filluar shqyrtimin e kostos financiare të këtij Projektligji dhe ka eliminuar disa nga nenet dhe aktet ligjore që kishin të paraparë pagesa retroaktive me qëllim të zvogëlimit të Kostos financiare për implementimin e këtij Projektligji dhe që ta sqaroj më mirë. Me disa nene të Projektligjit është paraparë që nga viti 1990 kur një numër i punëtorëve shqiptar të Kosovës janë larguar në mënyrë të organizuar nga Qeveria e Serbisë në mënyrë retroaktive t'u bëhet pagesa për 10 vite që e ka rënduar ligjin dhe ka qenë një kosto shumë e lartë, një prej atyre neneve ka qenë ajo që është larguar.

Pas përfundimit të rivlerësimit të kostos financiare MPMS i ka propozuar Qeverisë së Kosovës që të miratoj Projektligjin por Qeveria në mbledhjen e mbajtur më dt. 7 .03. 2007 me vendimin e saj nr. 02/242 ka vendos që përsëri të shtyhet miratimi i këtij Projektligji. Në rivlerësimin e dytë të bërë MPMS kishte arritur ta zvogëloj koston implementuese brenda një viti rreth 100 milion euro. Në mosmiratimin e këtij Projektligji, ndikim më të madh kanë pasur edhe rekomandimet e vazhdueshme nga organizatat ndërkombëtare si FMN dhe Banka Botërore të cilat në vazhdimësi kanë sugjeruar që ky Projektligj të mos miratohet për shkak të kostos së lartë financiare. Qeveria e Kosovës prapë me dt. 19.04.2007 me vendimin e saj nr. 5246 ka vendosur për themelimin e një komisioni në përbërje të gjerë të udhëhequr nga zyra ligjore e Kryeministrit dhe Komisioni obligohet që të rishqyrtoj në tërësi këtë Projektligj në mënyrë që t'i ofrohet Qeverisë së Kosovës një version që zvogëlon ndikimin negativ në buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Aktualisht ky komision është duke punuar në rishqyrtimin e Projektligjit të përmendur dhe shpreson që puna e tij në këtë drejtim do të jetë më e suksesshme duke pasur parasysh edhe përvojën edhe ndikimet e larta financiare dhe koston e Projektligjit. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes hartimit dhe procedimit të Projektligjit për sigurimin pensional dhe Invalidorë objektiv ka pikërisht edhe formimin e skemave pensionale të cilat aktualisht zbatohen në Kosovë, pra reformimi i sistemit pensional në Kosovë është i lidhur ngusht me miratimin e Projektligjit për sigurimin pensional dhe invalidor. Kur janë në pyetje personat të cilët kanë kontribuar në ish fondin pensional dhe invalidorë të Kosovës me dispozitat e këtij Projektligji të drejtat e tyre do të jenë shumë më të avancuara se sa personave të cilët nuk kanë kontribuar në ish fondin pensional të Kosovës. Personat jo kontributdhënës të cilët janë shfrytëzues të pensioneve bazë nuk mund të barten në skemën e ndihma sociale për shkak se kriter të përfitimit të pensionit bazë është mosha e pensionale prej 65 vjet e jo pozita socio-materiale e personit apo e familjes.

Qeveria e Kosovës , çështjen e fondit pensional të Kosovës të grabitur të cilit ende nuk i dihet fati dhe nëse kemi të drejtë të themi të fondit të grabitur nga shteti i Serbisë e ka

ngritur disa herë në takime të ndryshme, në takimet që i kemi pasur qoftë në nivelin qeveritar ose në nivelin jashtë qeveritarë, në takime me diplomatë, në takime me organizatën ndërkombëtare të punës dhe mekanizmat tjerë që janë në Kosovë, në të gjitha takimet ende nuk e kemi marë një përgjigje të saktë se cili do të jetë roli dhe sa do të jetë ndikimi dhe cili do të jetë pozicioni i Qeverisë së Kosovës në këtë drejtim dhe në një prej rekomandimeve që e kam thënë edhe më herët në bisedimet e Vjenës është kërkuar të bëhen decentralizimi dhe bartja e përgjegjësi nga niveli qendror në nivelin lokal dhe jo të bisedohet për pensione dhe kjo është mundësia jonë, por prapë se prapë në të gjitha takimet që i kemi pasur e kemi trajtuar si problem, por asnjëherë nuk e kemi një rrugë orientuese përmes të cilës ne do të dimë fatin e atij fondi i cili ka qenë me vite i krijuar. Të supozojmë se në zhvillimet e mëtutjeshme me zhvillimin e statusit, me bartjen e përgjegjësi në nivelin e Qeverisë së Kosovës do të hapet si debat dhe si çështje në mënyrë që ai fond tju kthehet njerëzve që ju takon dhe Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministra e Punës dhe Mirëqenies Sociale asnjëherë nuk jemi ndarë të kënaqur me shumën e cila destinohet dhe u dedikohet pensionistëve në Kosovë, mirëpo disa herë është analizuar situata shumë e rëndë e shfrytëzuesve të këtyre pensioneve të cilët kanë kontribuar me vite të tëra në fondin pensional të mëparshëm për shkak të kufizimeve buxhetore nuk ka ekzistuar një mundësi për rritjen e pensioneve dhe rekomandimi në pikën e 5 është i ndërlidhur ngushtë me mundësitë buxhetore ku për shkak propozimi nuk ka mund të realizohet sipas rekomandimeve të Kuvendit të Kosovës të mbajtur me 7.07.2005. Unë jam përpjekur shkurtimisht ta bëj një pasqyrim të rekomandimeve, ju ftoj për një debat. Ju faleminderit për durimin.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së fjalën e ka Naim Jerliu.

DEPUTETI NAIM JERLIU – Faleminderit z. kryetar, të nderuar ministra, kolegë deputet. Mendoj se nuk është e nevojshme të thuhet dhe të ripërsëritet se cili është prioriteti i veçantë i të gjitha qeverive edhe i këtij institucioni që nga themelimi i vetë ka qenë krijimi dhe aplikimi i skemave pensionale për kategori të caktuara të qytetarit të Kosovës që kanë pasur për qëllim që të krijojnë kushte më të mira për jetë dhe të ngritjes së cilësisë së jetës dhe mirëqenies së qytetarëve të Kosovës. Komisioni për Shëndetësi i Parlamentit të Kosovës e kishte ngritur çështjen e pensionistëve dhe po ashtu kishte arritur që pas diskutimeve dhe propozimeve të veta, rekomandimet e propozuara të gjejnë përkrahje në Parlamentin e Kosovës në një seancë plenare. Kjo seancë e sotshme është në vazhden e punës që bën komisioni për të monitoruar dhe mbikëqyrur, punën që bën Qeveria në implementimin e rekomandimeve dhe të prioritetëve që sugjerohen nga Parlamenti e në këtë rast nga Komisioni për Shëndetësi. Me atë që dëgjuam nga ministri dhe angazhimin që po bën Qeveria në përmirësimin e kushteve për pensionistët si dhe në plotësimin e rekomandimeve të Kuvendit dua të them se ne presim shumë shpejtë ashtu siç e tha ministri që në Parlament të procedohet ligji për sigurimin pensional dhe invalidor në mënyrë që të krijohet një bazë e qëndrueshme e këtij sistemi dhe të kalohet nga zgjedhjet ad-hoc në zgjedhjet e përkohshme për skemat pensionale në skema të qëndrueshme që do sigurojnë kushte më të mira dhe mirëqenie të plotë të kësaj kategorie sociale në Kosovë. Është e qartë se ashtu siç tha edhe ministri çështjet që kanë të bëjnë me këtë sektor dhe këtë fushë, po ashtu përmbajnë implikime të cilat janë ngritur nga

organizatat ndërkombëtare mbështetëse të institucioneve të Kosovës, me këtë rast Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore dhe sigurisht që ato implikime nuk mund të mënjahen dhe të mos merren parasysh, prandaj ne presim që shumë shpejt ashtu siç u tha në Parlament të vijë projektligji pas rishqyrtimit dhe rivlerësimit që i është bërë kostos financiare dhe që shumë shpejt të procedoj me nxjerrjen e këtij ligji i cili në fakt ka qenë rekomandimi kryesor i Komisionit dhe i këtij Kuvendi. Dua të theksoj se gjendja e pensionistëve është breng permanente e të gjithë neve që dëshmon edhe fakti se në Komision në mënyrë konsensuale kemi mbështetur rekomandimet, sikur që rekomandimet e Parlamentit kanë qenë të mbështetura nga të gjitha grupet parlamentare. Më lejoni që në përfundim të theksoj se Grupi Parlamentar i LDK-së i mbështet përpjekjet e Qeverisë dhe kërkon zbatim të plot të rekomandimeve të Parlamentit lidhur me pensionistët, po ashtu Grupi Parlamentar i LDK-së kërkon që sa më parë të sillët Projektligji për sigurimin pensional dhe invalidor në Parlament në mënyrë që të adresohemi në mënyrë të drejtë dhe të sigurohet baza për ndërtim të një sistemi të qëndrueshëm pensional dhe invalidor në Kosovë, po ashtu Grupi Parlamentar i LDK-së kërkon nga Qeveria që gjatë rishikimit të buxhetit të kërkojë të gjitha mundësitë për të vepruar në përmirësim të gjendjes së pensionistëve dhe në përmbushje të plotë të rekomandimeve të këtij Kuvendi.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të PDK-së Zahrije Jusufi.

DEPUTETJA ZAHRIJE JUSUFI - Faleminderit z. kryetar. Të nderuar ministra dhe deputet.

Qeveria edhe pse premtoi se do të ketë kujdes për gjendjen e pensionistëve ajo përpos përkrahjes morale nuk punoj në përkushtimin e duhur për zgjidhjen adekuate dhe afatgjatë të sistemit pensional. Ligji nr. 2002/1 mbi metodologjinë e caktimit të lartësisë së caktimit bazë ka hyrë në fuqi me 26 korrik 2002. Sipas ligjit pensionet paguhën nga data 1 korrik 2002 me shumë fillestare 28€ në muaj e pastaj shuma ndryshon në 40€, me urdhëresën administrative 7/2004 ku kriter themelor merret moshë 65- vjeçare. Me ligjin në fuqi kjo shumë improvizon ndihmë sociale për pensionet e pleqërisë që nuk u mjafton as për barna. Kërkesën e sindikatës së pensionistëve për shqyrtim të mohimit të së drejtës të pensionistëve të pleqërisë, invalidor e familjar të ftuar me punë dhe në bazë të punës e konsideruan të arsyeshme me 7 korrik 2005, mirëpo rekomandimet e Kuvendit nuk u kuptuan seriozisht nga Qeveria, asnjë nga rekomandimet nuk u plotësua. Qeveria arsyetohet se politikat monetare u imponohen nga FMN-ja dhe Banka Botërore, veç se ato nuk lejojnë krijimin e fondit pensional, Fondi Monetar Ndërkombëtar propozon të mos rritet masa, që të mos tejkalohen kufijtë buxhetorë, por si ta shpenzojë buxhetin vendos Qeveria, ajo ka kompetencë për zgjidhjen afatgjatë edhe të pensionistëve, edhe pse ministri për Punë dhe Mirëqenie Sociale i ftuar nga ana e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale më 1 nëntor 2005 për mosrealizimin e rekomandimeve të Kuvendit të datës 7 korrik 2005, premtoi se Projektligjin për sigurimin pensional do ta kemi shumë shpejt në shqyrtim të harmonizuar me ligjet tjera, Projektligji edhe afro 2 vjetëve nuk ka arritur në shqyrtim. Ministri arsyetohet se Projektligji nuk do të shqyrtohet për shkak të mungesës së fondit dhe se është në shqyrtim të kostos financiare. Me sistemin aktual të pensioneve nuk mund të jetë i kënaqur askush pos menaxherëve të trustit, trusti mund të jetë model për vendet e pasura, por nuk e zgjedh problemin e

kontribut-dhënësve të mëparshëm. Trusti përgjigjet për kontribut-dhënësit prej kur ata kanë filluar të kontribuojnë, por nuk e zgjidh dhe dëmton ata që kanë kontribuar para formimit të tij, nuk mund ta zgjidhë problemin e qytetarëve që janë afër moshës 65 vjeçare. Është e kuptueshme që trusti është në menaxhim privat dhe Qeveria nuk vendos për mjetet e Trustit, por Qeveria mund të bëjë rekomandime. Propozoj të definohet statusi i pensionistit të pleqërisë dhe atij të kontributeve. Projektligji për pensionet të shqyrtohet sa më shpejtë, propozojmë që Qeveria të angazhohet së bashku me UNMIK-un përsëri për kthimin e fondit të grabitur të sigurimit pensional dhe mjetet e Trustit të kthehen në vend. Propozojmë që Qeveria të bëjë përpjekje për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut për akciza në Kosovë, për të zgjeruar shtrirjen e tatimeve për prodhimet vendore që importohen dhe këto mjete të grumbullohen për formim të fondit, po ashtu edhe një përqindje e mjeteve të privatizimit përpos tjerash të shqyrtohen për formimin e fondit të pensionit. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të AAK-së.

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI – Z. kryetar, z. ministra deputet të nderuar.

Shumë debate janë bërë për çështje të pensionistëve të Kosovës dhe atë duke filluar nga arritja e Projektligjit të parë në Parlament për pensionet themelore. Komisioni i atëhershëm për Punë dhe Mirëqenie Sociale ka reaguar ashpër kundër shumës prej 28 € për pensionet bazë duke ofruar 1100 argumente se shporta mujore në bazë të së cilës është caktuar kjo vlerë është shumë fish më e shtrenjtë dhe sidomos ka reaguar ndaj faktit se nuk janë përfshirë pensionet të cilat kanë paguar kontributin e tyre gjatë punës shumëvjeçare që në fund të saj të kenë pensionin e merituar. Me shpresë se Buxheti i konsoliduar i Kosovës gjatë viteve të ardhshme do të ndryshoj, si dhe rrethanat politike, Komisioni e ka amendamentuar ligjin në vitin 2004, pensioni themelor është bërë 40€ dhe prej asaj kohe asnjëherë nuk është bërë revidimi i shumës gjegjësisht nuk është bërë llogaritja e kostos mujore të shportës dhe nuk është gjetur zgjidhja për pensionistët kontribut-dhënës. Në bisedimet për statusin e Kosovës çështja e kthimit të fondit të plaçkitur të pensioneve të Kosovës nga ana e Serbisë nuk e ka pasur rëndësinë e duhur ose nuk është biseduar fare për të, pasi deri më sot gjendja ka mbetur e njëjtë si në vitin 1999. Kosova është i vetmi vend në rajon e cila nuk e ka zgjedhur çështjen e pensionistëve. Me aprovimin e ligjit për pensionet themelore është blerë qetësi sociale relative, por kjo nuk është zgjidhje e vërtetë se edhe më tutje ekzistojnë disa anomali në këtë sistem. Pensionet bazë që janë shumë të ulëta dhe nuk i plotësojnë nevojat themelore të personave që i marrin, kështu që ata nuk janë në gjendje të çojnë një jetë të pavarur dhe sikurse të mos ishte ndihma e familjes mund t'i paramendojmë pasojat. Grupi i të moshuarve prej moshës 60 deri në moshën 65 vjet të cilët nuk i merr askush në punë se janë të moshuar e nga ana tjetër nuk janë mjaft të vjetër që të marrin pensione bazë. Grupi i pensionistëve që ka paguar kontribut gjatë punës së tyre për fondin pensional, i cili është plaçkitur nga Serbia dhe deri më sot nuk e ka gëzuar të drejtën e tyre. Trusti i pensioneve i cili ndan të hollat nga rroga duke kualifikuar si veprim vullnetar të qytetarëve të Kosovës, por i cili të hollat i dërgon në banka jashtë vendit që të qarkullojnë në bizneset e huaja, duke e rritur zhvillimin ekonomik të tyre dhe kjo nuk mund të jetë vullneti jonë dhe neve na mbetet që edhe më tutje të debatojmë duke kërkuar zgjidhje më të mirë. Për shkak të të gjithave që u thanë më lart Komisioni Parlamentar për punë dhe

mirëqenie sociale kërkon në vitin 2005 debat për çështjen e pensionistëve në këtë Kuvend dhe me 7 korrik u aprovuan rekomandimet e njohura. Premtimet vazhdojnë në fjalimin e vetë të përjavshëm në radio kryeministri premtan edhe një investim shtesë prej 12 milionëve në vit për kategoritë sociale duke i përfshirë edhe pensionistët, për të cilët mund të parashihet një rritje prej 20%. Është e vërtetë që institucionet vetëqeverisëse të Kosovës e kanë edhe një pushtet tjetër mbi to, por ne nuk duhet ta harrojmë kurrë se themelet e shtetit tonë duhet të bazohen në humanistet dhe moral, përndryshe do të krijojmë monstrum, është koha e fundit që të gjinden rrugë dhe zgjidhje adekuate për pensionistët sepse ato ekzistojnë. Për zgjidhjen e situatës së pensionistëve Grupi Parlamentar i AAK-së i jep këto rekomandime: Të gjinden mundësitë që të paguhet 6 milion të premtuara në seancën plenare të 7 korrikut të vitit 2005, të krijohet një sistem i qëndrueshëm i sigurimit pensional dhe invalidor, gjegjësisht të punohet nga ana e Qeverisë ligji për pensione edhe njëherë dhe të gjej rrugë që ta përshtatë si është më së miri për interesat e pensionistëve me kërkesat e Fondit Monetar ndërkombëtar dhe ta sjell në Parlament për amendamentim. Deri sa të miratohet ligji të nxirren akte nënligjore nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë që pensionistët t'i marrin falas barnat kryesisht për sëmundje kronike, prej të cilave shumica e tyre vuajnë, siç janë barërat për diabet, tensionin e rritur arterial, sëmundjet kronike të zemrës ose listës së barërave të cilën do ta hartojnë ata vetë. Të kenë lehtësime gjatë pagesës së komunalive ose të lirohen nga to, edhe pse këto veprime nuk do ta zgjedhin përfundimisht problemin material me të cilin ballafaqohen pensionistët ato me siguri se do ta lehtësojnë.

Të gjitha këto rekomandime nuk mund të zbatohen pa pasur mbulesë në buxhetin e konsoliduar të Kosovës, mirëpo Qeveria mund të fillojë të punojë seriozisht që t'i vjelë tatimet të cilat nuk i ka marrë deri më tani. Mijëra ekonomi familjare të cilat nuk janë regjistruar fare e cila gjë në vendet tjera do të ishte e paimagjinueshme, duhet të regjistrohen urgjentisht dhe kështu do të dihet vendi se ku do të kërkohej tatimi dhe të paguhet komunal. Cili shtet mund të ekzistoj ekonomikisht nëse nuk merr tatime dhe nuk i paguan shërbimet e veta. Në Kosovë pas lufte janë ndërtuar shumë objekte pa leje, pa u ndalur nga askush për shkak se pronarët e tyre ua kanë mbushur xhepat zyrtarëve komunal dhe duke mos paguar çmimin paraparë për leje ndërtimi, tatimi në pronë, ujin, rrymën në mënyrë indirekte i kanë zbrazur arkat e buxhetit të Kosovës dhe duke penguar zhvillimin ekonomik të vendit, sikurse institucionet vetëqeverisëse të ekzekutivit ta kishin kryer punën e tyre si duhet sot nuk do të kishim këtë debat për pensionistët, për mjekët, për punëtorë të arsimit do t'i kishim të kënaqur duke d hënë maksimumin në punën e vetë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Deputetja Fatmire Mulhaxha Kollçaku-Kollçaku në emër të Orës.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA – KOLLÇAKU – Faleminderit z. kryetar. Fatkeqësisht në momentin kur kemi filluar debatin sot dy vite më vonë jemi në një moment kur veç tash zyra ligjore e UNMIK-ut e ka kthyer një ligj shumë të rëndësishëm që është ligji për sigurim shëndetësor të cilit nuk do t'i dihet tash fati. Çështja tjetër është se Qeveria i ka hy hartimit të Projektligjit pa e bërë paraprakisht parakushtet për ligje të tjera që bazohen në krijimin e fondeve publike, pa e bërë paraprakisht amendamentimin e ligjit mbi menaxhimin e financave politike dhe përgjegjësitë, prandaj edhe ky Kuvend 2

vite më vonë po bëhet pjesë e një loje të papërgjegjshme, sepse po debatojmë për diçka, për çka realisht nuk ka kushte për zbatim sot në Kosovë. Me gjithë atë po kthehem dy vite më parë ku rekomandimet e Kuvendit të Kosovës lidhur me pensione u përqaftuan nga të gjithë pensionistët e Kosovës të cilët e panë dhe përfunduan se rekomandimet e Kuvendit të Kosovës rrahën shtegun për vendosjen e ligjshmërisë përkitazi me realizimin e të drejtave socio-ekonomike të fituara me punë dhe në bazë të punës së tejshkuar, të përcaktuara me të gjitha instrumentet dhe aktet juridike ekzistuese. Institucionin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor të cilët kanë paguar kontribute nga të ardhurat personale dhe nga të ardhurat e organizatës ose institucionit ku kanë punuar si dhe reformën e sigurimit pensional dhe invalidor që duhet të përfshijë personat që kanë paguar kontributet për sigurimin pensional invalidor, shfrytëzuesit e pensionit të pleqërisë, invalidor dhe familjar dhe njerëzit që i kanë plotësuar kushtet për pensionim, kursimin e obligueshëm dhe vullnetar individual të pensionit si dhe përfituesit e pensionit bazë sipas moshës 65 vjeçare, këto janë diçka çka dëgjuam nga ministri janë disa propozime që të barten eventualisht te njerëzit që kanë nevojë me skema sociale apo të mbetet ky pension bazë. Gjithashtu ka qenë dashur nëpërmjet reformën e kontributdhënies për sigurim të obligueshëm pensional invalidor. D.m.th rekomandimet e Kuvendit të Kosovës kanë paraqitur një platformë të mirë për të bërë reformën e sigurimit pensional invalidor dhe reformën e financimit të tij, përkatësisht vetë punonjësit dhe punëdhënësit dhe asociacionet e tyre të përcaktohen në mënyrë demokratike për modalitetin e sistemit të sigurimit pensional invalidor të Kosovës i cili duhet të jetë koherent me sistemet e vendeve të rajonit, të Bashkësisë Evropiane dhe më gjërë, për sistemin e finansimit të sigurimit pensional dhe invalidor dhe për formimin e fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Kosovës dhe vetëqeverisjen e tij nga kontributdhënësit nën mbikëqyrjen dhe garancionin ligjor të shtetit. Ku jemi ne sot dy vite më vonë pas gëzimit të pensionistëve, pas pas gëzimit të pensionistëve,

përqaftimit nga të gjithë ata të cilët padrejtësisht janë privuar nga e drejta e garantuar dhe e fituar njëherë. Të gjitha qeveritë e pasluftës, çka ka ndodhur në fakt padrejtësi e regjimit serb, pas luftës si është menaxhuar në periudhën e pasluftës, me vendime që është vendosur pensioni bazë që nuk është asgjë tjetër përveç një ndihme sociale prej 40€ që tani më është përfolur aq shumë dhe e dimë se sa mjafton as për medikamentet të cilat çdo njeriu pas moshës 65 vjeçare i nevojiten. Trusti i kursimeve pensionale që ne nuk e kundërshtojmë, mirëpo për rrethanat e Kosovës si dhe në shumë shtete tjera ajo është trust i kursimeve i bazuar në vullnetin, e dimë mirë se sa janë mundësitë sot në Kosovë që dikush të kursej nga pagat e veta, çfarë nevojë duhet të shtrohet nga kjo seancë. Përveq rekomandimit të 5 i cili ka dalë nga seanca plenare dhe ka qenë i propozuar nga kryetari i Komisionit për buxhet dhe financa i Kuvendit të Kosovës lidhur me dhënin e 6 milion eurove për çdo muaj të periudhës prej muajit të 7 deri në fund të vitit 2005 nga një milion euro si ndihmë emergjente pensionistëve asnjë nuk është realizuar përkundër faktit që kemi pasur edhe suficite në fund të vitit, kemi pasur ndoshta mundësi që ta rishikojmë ndonjë formë se si të realizohet ai rekomandim, ajo nuk ka ndodhur dhe ka qenë në të gjitha bisedimet me pensionit kërkesë e përsëritur që të shikohet se çka ka ndodhur dhe pse nuk është zbatuar, mirë ajo çka ne sot duhet të vendosim dhe duhet ta pyesim Qeverinë cili është modeli për të cilin është përcaktuar dhe për të cilin do të luftoj. Nëqoftëse i kanë hy hartimit të ligjit dhe kanë menduar ta

procedojnë në Kuvend pa i krijuar parakushtet për implementim Kuvendi duhet tia marrë më në fund rrolin e vet dhe t'i thotë stop këtyre vendimeve të cilat jo që nuk janë të harmonizuara brenda Qeverisë, sepse ne kemi qenë dëshmitarë në seancë kur vjen ministri i një ministrie dhe e propozon një projektligj dhe çohet ministri i financave dhe i thotë nuk ka kosto për këtë ligj dhe për këtë ligj nuk ka mbulesë. Unë mendoj se një Qeveri e përgjithshme këto i harmonizon brendapërbrenda Qeverisë dhe kur e bjen ligjin këtu ai ligj duhet të jetë një ligj i cili brenda 2 muajve i kalon procedurat në Kuvend dhe kur të miratohet duhet të jetë i implementueshëm .ne jemi fatmir që qytetarët e Kosovës nuk kërkojnë nen për nen zbatimin e ligjit të cilët ne i kemi sjellë dhe janë nënshkruar nga zyra ligjore e UNMIK-ut sepse nuk do të kishim asi probleme me të cilat sigurisht nuk do të ballafaqoheshim, prandaj është koha e fundit që Kuvendi ta marrë rolin e vetë dhe t'i thotë stop një praktike të sjelljes së projektligjeve të pa implementueshme që në fillim janë me dështim se nuk kanë mbulesë financiare. D.m.th Qeveria duhet të jetë e qartë se cilin model e përqafon, sigurim apo kursim. Ne dëshirojmë të dimë se ligjin të cilin e kanë hartuar për të cilin nme gjithë atë ka pasur pajtueshmëri edhe pse nuk i ka parapri dialogu social para fazës së hartimit, ai u është servuar grupeve të interesit ashtu siç është hasrtuar nga Qeveria, megjithatë ka hasur në përshëndetje te grupet e ndryshme të interesit, d.m.th mos të harrojmë se ligjet nuk hartohen vetëm për gjeneratën aktuale të pensionistëve, por për të gjithë neve, mos harroni të gjithë ata që janë 35 -40 vjeçar nuk do ta kenë të zgjidhur situatën as me pensionin bazë e as me trustin e kursimeve pensionale, ndoshta një njeri 20 vjeçar që fillon të punoj do ta ketë të ardhmen aty, por mos t'i harrojmë kushtet kur ai do të jetë i detyruar të shkoj me një pension invalidor, kur do t'i ndodh ndonjë aksident ai ja siguron trusti ndonjë siguri që ai do të mund të mbijetoj nesër dhe të mos jetë i mvarur.

Çështja tjetër që është shumë me rëndësi, paralajmërimi për rritjen e pensionit bazë është një fakt një dëshmi që Qeveria nuk ka strategji dhe dëshiron me ngushtimin e skemës sociale që kemi qenë të gjithë dëshmitarë këtu kur mjeken 6.30) përfitues nga skema t'i lëviz pozicionet, aty ku e kemi një të moshuar 65 vjeçar t'ia ngushtoj dhe ta rangoj më poshtë t'ia heq 25€ e më shumë dhe me ato mjete të arrij pensionin bazë, d.m.th asgjë tjetër përveq lëvizjes së pozicioneve nuk ka aty, duhet ta dinë qytetarët e Kosovës në momentin që do të gëzohen kur t'ju rritet pensioni për 10€ se me ato nuk zgjidhet asgjë. Qeveria duhet të jetë e qartë a do ta ndërrojë modelin për të cilin do të përcaktohet, për ta mbrojtur një model duhet ta ketë koncenzusin politik është dashur të hyjë në dialog social dhe kur e ka mbështetjen e popullit të vet atëherë edhe para Fondit Monetar edhe para Bankës Botërore ta mbroj modelin për të cilin ky popull është përcaktuar. Mos harroni shumë qytetarë të Kosovës që punojnë në botën e jashtme nuk kanë mundësi të qesin mjete për sigurim dhe nuk do të kenë mundësi ta përfitojnë pensionin për të cilin kanë punuar me vite në botën e jashtme, problemet, moskoordinimi i sigurimeve shoqërore, ne nuk kemi sigurime shoqërore, është rrënuar nga Serbia, asgjë nuk kanë bërë Qeveritë që ta rimëkëmbin, ta riinstalojnë me gjithë atë kanë qenë ligjet e aplikueshme të cilat nuk kanë qenë diskriminuese, pse asnjëherë nuk janë thirrë në ato ligje deri sa u nxorën ligje nga ky Kuvend, por janë përqafuar modelet të cilat nuk janë të aplikueshme aktualisht për Kosovë. D. M. Th Grupi Parlamentar i Orës kërkon që Qeveria të na prezantoj modelin për të cilin është përcaktuar dhe të shohim se a do ta mbron deri në fund atë model të cilin edhe në ligj i cili asnjëherë nuk e ka pa dritën dhe nuk do ta sheh po ju siguroj në këtë Kuvend para se t'i krijoj parakushtet për implementim.

Çështja e dytë, çështja e trustit për kundër faktit që është përmend edhe në pakon e Ahtisarit për të cilin kam dhënë vërejtje edhe në seancë plenare kur është debatuar për pakon e Ahtisarit. Trustet, të gjitha trustet nuk duhet që asnjëra ta ketë primatin të gjitha trustet që janë të bazuara në .dëshirën.....vullnetare do të jenë private dhe do të jenë të barabarta. Trusti i kursimeve pensionale, jo vetëm që duhet të jetë vullnetar për momentin, por të gjitha mjetet, me të gjitha mjetet, me të gjitha përpjekjet e Qeverisë duhet t'i kthejë në vend për menaxhim, këtu ku ka më së shumti nevojë.

Ligji, në qoftë se ligji vjen në Kuvend duhet ta thërrasë Kuvendin që ta sigurojë plementimin e tij, përndryshe asnjë ligj të mos e miratojë më pa mbështetje financiare dhe kjo është përfundimi i asaj dhe qëllimi i debatit, mos të debatojmë pa kurrfarë përfundimesh sa debatojmë sa për të debatuar, sa për të na dëgjuar dikush por të debatojmë që të sjellim vendime të cilat ky Kuvend jo rekomandime, por vendime për të cilat do ta thërret Qeverinë më vonë për përgjegjësi në Kuvend. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të grupit 6+ Nuran Malta

DEPUTETJA NURAN MALTA - Sayin Bakanlar, Sayin Baskan degerli Milletvekileri Tartistigimiz Yolculuk Dokumanlari yasa tasarisinin , Kosova hukumeti ve vatandaslari icin onemli oldugu tartisilmazdir.

Onemli olmasinin tartismasiz en onemli sebebi bu dokumanlarin ve bunlarla ilgili yasaninin eksikligidir.

Yasayla ilgili olarak uyari ve onerilerimizi 6 + olarak az once arkadisimiz illeti. Ancak Kosova Demokratik Turk Partisi olarak 15 maddeye onerimizi , daha dogrusu uyarimizi bir daha tekrarlamak istiyorum.

Yasanin 15 maddesine gore; Yolculuk dokumanlarinin diller yasasina gore verilecegi ifade edilmektedir.

Avrupa bolgesel diller kartina gore her topluluk kendi dilinde istedigi dokuman ve pasaporttu alabilicegi gorulmektedir. Buna gore bizim bu maddeye onerimiz; belediyelerde bu gibi dokumanlarin verilecegi icin bu paragrafa “ belediyelerdeki kullanan resmi diller” ekinin katilmasini onermekteyiz. Ayrica dokumanlarla ilgili verilen formlarin ve dilekcelerin bu kuralla uymasi gerekmektedir.

Butun bunlari goz onunde bulundurarak KDTP’ I olarak onergelerimizi {amandament} yasanin proseduru sirasinda verecegiz soz vernek istoyoruz.

Dikkatinize tesekkur ederim

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! në emër të grupit për Integrim doktor Ferid Agani.

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar ministra, të nderuar z. ministresh, i nderuar koleg deputetë.

Përgjegjësia jonë para pensionistëve është e madhe, me këtë mendoj se nuk kam thënë jeç të re, por njëkohësisht edhe neglizhenca e mëtutjeshme ndaj kësaj çështje është mendoj e palejueshme.

Është fakt se pjesa më e rëndësishme e rekomandimeve të Kuvendit të 7 korrikut 2005 nuk është zbatuar. Në këtë mënyrë Kuvendi i Kosovës po luan me kredibilitetin e tij politik para qytetarëve të Kosovës. Pasojat e mos përmbushjes së premtimeve dhe rekomandimeve, përgjegjësi të cilat i merr mund të shihen edhe në ditët e sotme. Është për t'u habitur se si tek shumica e bartësve të funksioneve politike u zbeh përkushtimi për solidaritetin. Ka ekzistuar dikur një princip një parim që është quajtur parimi i solidaritetit dhe reciprocitetit. Në kohë të sodit u zbeh ky përkushtim ndonëse e konsideroj si njërën prej vlerave shumë të çmuara të popullit tonë. Në përgjithësi është për analizë largimi shumë i lehtë dhe shumë i shpejtë prej sistemit të vlerave të cilat janë dëshmuar si vlera të cilat kanë mundësuar mbijetesën e këtij populli pas katrahurës së fundit kombëtare që përjetuan prej vitit 1990 deri në pranverën e vitit 1999. prej një shoqërie që një dekadë e tërë me sukses të madh zhvilloj mekanizmat e mbijetesës të mbështetur në parimin e solidaritetit dhe të ndihmës reciproke brenda natës përqaftim konceptet e një kapitalizmi të parregulluar, u shndërruam në individualist të preokupuar vetëm me interesin personal. Kjo zgjidhje politike shoqërinë tonë e ballafaqoi me sfida të mëdha të ristrukturimit etik, ekonomik dhe legjislativ duke shkaktuar tensione të mëdha për të cilat ishim dhe jemi të papërgatitur. Fitohet përshtypja nga ata që çdo muaj dhe më shpesh ishin në gjendje të ndanim për ata që s'kishim pjesë të pagave tona të varfra u shndërrua në individ të cilëve më shumë u intereson vlera e kursimeve pensionale në trustin pensional invalidor. Shtroj pyetjen a është kjo zgjidhja jonë, të nderuar deputetë, apo është zgjidhje e dikujt tjetër, kush e merr këtë vendim në emër të popullit të Kosovës.

Neglizhenca e deritanishme ndaj zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit të Kosovës të datës 7 korrik 2005 le përshtypjen se jemi shndërruar në njerëz që nuk u intereson fati më se 76000 pensionistëve dhe invalidëve të punës të cilët me dekada të tëra e depozituan punën dhe shëndetin e tyre dhe themelet e të mirave që sot po i gëzojmë.

Unë jam i bindur që ndjenjat dhe përkushtimi i juaj për mirëqenien e kësaj kategorie të popullit tonë janë më të sinqertat, mirëpo, është fakt se edhe 8 vite pas luftës nuk jemi në gjendje ta nxjerrim ligjin për sigurimet pensionale dhe invalidore dhe shtrohet pyetja se si deputetë dhe Qeveri e Kosovës, a i keni shfrytëzuar të gjithë mekanizmat e mbikëqyrjes dhe ekzekutimit të fuqisë politike të institucioneve tona në funksion të zgjidhjes së drejtë të kësaj çështjeje madhore, unë jam i mendimit se jo.

I kam shumë të qarta brengat dhe kufizimet që i venë institucionet financiare, ndërkombëtare siç janë Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. Mirëpo njëkohësisht janë kosienca e hapësirat për dialog me këto institucione nuk janë shfrytëzuar në mënyrën më të mirë.

Konsideroj se nuk u mobilizua tërë potenciali politik i udhëheqësit të Kosovës për të ndikuar në përfaqësuar special të sekretarit të përgjithshëm dhe në zyrën përkatëse në Nju Jork me qëllim të realizimit të këtij projekti ligjor. Pa mundësimi i formimit të fondeve publike në Kosovë nuk mund të arsyetohet në asnjë mënyrë veçanërisht kur të kihen parasysh vështirësitë e mëdha në sektorin e sigurimeve pensionale, si dhe në sektorin e shëndetësisë, si dhe kur të kihen parasysh një specifikë e veçantë e Kosovës se ma shumë se ¼ e popullatës jeton dhe punon në diasporë, në mërgatë në shtetet e BE, dhe shtetet e

tjera përëndimore dhe është mu kjo pjesë vitale e qendrës sonë kombëtare që mundësojnë mbijetesën ekonomike pas vitit 1990. Është i papranueshëm edhe argumentimi se arsye për mos miratimin e legjislacionit përkatës është kostoja e tij e lartë financiare. Në kohën ku në trustin pensional invalidor janë të grumbulluara mbi 200 milion euro parat e qytetarët e Kosovës. Unë shtrojë pyetjen prapë: Kush mund të ndalojë që paratë tona t'i vejë në funksion të zgjidhjes së njerëzve për çështjen më të dhimbshme të shoqërisë. Mendoj se këtu bëhet fjalë për mjetet tona, nuk bëhet fjalë për mjetet e institucioneve financiare ndërkombëtare.

Pavarësia e Qeverisë për të miratuar Projektligjin për sigurime pensionale dhe invalidore do të mjaftonte për rënien e saj në shumicën e shteteve Evropiane, por për fat të keq çdo ditë e më shumë po na bëhet e qartë se në Kosovë është më lehtë të rrëzohen në dy gjunjë qytetarët e Kosovës se sa Qeveria.

Dikujt mund t'i tingëllojnë shumë të ashpra këto fjalë, por krahasuar me fjalët që përshkruan dhimbjet dhe vuajtjet e mijëra pensionistëve të Kosovës këto fjalë duken shumë të buta dhe madje figura letrare.

Më lejoni që në këtë moment prej këtyre shkresave të shumta të organizatave të pensionistëve, të lidhjes së shoqatave komunale pensionistëve të Kosovës, të sindikatës së pavarur të pensionistëve të Kosovës, të organizatave të shumta komunale të pensionistëve, të veçojë vetëm një, citat nga shkresa e kryetarit të organizatës komunale të pensionistëve të Lipjanit: Ai thotë se shtyrja e propozimit të Projektligjit për sigurimin pensional dhe invalidor të Kosovës ka shkaktuar revoltë dhe pakënaqësi të mëdha tek pensionistët dhe invalidët e Kosovës, dhe me plotë përgjegjësi deklarojmë se pensionistët janë në gjendje alarmante sociale ekonomike, dhe shëndetësore të cilëve ju mungojnë barërat, kafshata e gojës e çka jo tjetër, andaj kërkojmë nga ju z. delegatë gjegjësisht shefat e grupeve parlamentare që të na përfaqësoni në Parlament dhe të luftoni për zgjidhjen e kësaj çështjeje sa të dhimbshme humane aq obligative e ligjore.

Unë shpresoj që ne do të jemi në nivel të kësaj përgjegjësie dhe që të fillojmë që me një seriozitet dhe vendosmëri më të madhe ta trajtojmë këtë çështje. Grupi Parlamentar për Integritet pret që kjo seancë plenare do të kërkojë nga Qeveria e Kosovës që në një periudhë sa më të shkurtër kohore dhe atë jo më të gjatë se 3 muaj të dorëzojë në procedurë parlamentare projektligjin për sigurimet pensionale dhe invalidore, si dhe që Qeveria e Kosovës të organizojë një takim urgjent me përfaqësuesin special të sekretarit të përgjithshëm përkitazi me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për menaxhimin e financave publike që është duke u paraqitur si pengesa kryesore për zgjidhjen e problemeve të shtuara në lëmin e shëndetësisë dhe sigurimeve pensionale dhe invalidore.

Kryetarja e komisionit funksional e përmendi se ligji për sigurime shëndetësore është kthyer nga PSSP-ja në Kuvend të Kosovës, pra nuk kemi asnjë shpresë se ne do të jemi në gjendje të gjenerojmë burimet plotësuese financiare për sektorin e shëndetësisë, dhe në qoftë se e vazhdojmë me këtë apati dhe me këtë pasivitet në këtë relacion atëherë unë mendoj se problemet do të na grumbullohen dhe nuk do të jemi në gjendje t'u përgjigjemi sfidave të kohës që kemi. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit ! Ramadan Kelmendi LDD.

DEPUTETI RAMANDAN KELMENDI – Ju faleminderit, i nderuari kryetar, të nderuar ministra të pranishëm, kolegë deputetë të nderuar.

Grupi Parlamentar i LD-së vlerëson se gjendja e pensionistëve është shumë e rëndë. Në kuptimin financiar ndonëse është e vetëdijshme edhe për gjendjen ekonomike dhe politike ekzistuese në Kosovë dhe në tërësi me gjendjen financiare që ne gjendemi, ndonëse është një çështje mjaft komplekse që varet nga trashëgimia politike dhe ekonomike dhe shtetit të Kosovës dhe e varur nga disa faktor determinues për zgjidhjen e çështjes së pensioneve të kontribut dhënësve. Ne mendojmë se këta qytetarë shumë të nderuar kanë dhënë një kontribut të madh për të cilin të gjithë këtu ne jemi të vetëdijshëm për të sotmen dhe për ardhmërinë e Kosovës, dhe të gjithë ne jemi të vetëdijshëm se ata duhet ta gëzojnë atë që e kanë dhënë për ne, andaj ne kemi obligim jo vetëm ligjor por edhe moral që të bëjmë të mundur ta gëzojmë djersën e tyre të dhënë më parë.

Në tërësi rekomandimet e 7.7.2005 të Kuvendit të Kosovës janë të qarta, por janë edhe të varura, sepse ishin të varura për t'u zbatuar, çka do thotë se cila është mënyra e aplikimit dhe zbatimit të këtyre rekomandimeve. Jo duke kërkuar përgjegjësi, por duke propozuar mundësi zgjedhore konkrete nga ato. Nuk është aq me rëndësi që të theksohet gjendja e tyre e rëndë sa është me rëndësi si të dilet nga kjo situatë, natyrisht duke përkrahur vlerësimet e ministrit, ne mendojmë se hartimi i ligjit për sigurimin pensional të kontribut- dhënësve duhet të ketë një prioritet të përfitojnë së pari qytetarët që kanë dhënë kontributin në fondin pensional dhe ne vetë jemi dëshmitarë për fondin pensional të cilin tani ne nuk mund ta shfrytëzojmë

Të ndahen pensionistët e pleqërisë nga kontributdhënësit me qëllim për të krijuar mundësi reale për të vlerësuar gjendjen faktike të tyre.

Nën 4. ne vlerësojmë se nuk janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë për kthimin e fondit të pensioneve të grabitura nga Serbia dhe kjo është një pengesë e madhe, gjegjësisht edhe në negociatat dhe gjatë procesit negociator me Serbinë nuk janë trajtuar në nivelin e duhur çështjet e fondeve të grabitura.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në kuadër të mundësive financiare ka aplikuar masat e përkohshme të skemave sociale dhe ato realizohen në praktikë dhe vërtetë si të tilla mbajnë gjendjen ekonomike dhe sociale të kategorive të prekura apo të debatuarat sot. Dhe ne përkrahim iniciativën e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale për rishiqërimin e formave të rregullimit ligjor dhe pozicionit të kontribut dhënësve.

Mendojmë se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si pjesë e Qeverisë nuk krijon të hyra, pra na është e qartë të gjithëve, por shpërndan ato mjete të dedikuara nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, Grupi Parlamentar i LDD-së përkrah angazhimin permanent të Qeverisë së Kosovës dhe të ministrisë konkrete për përmirësimin e gjendjes së pensionistëve dhe këtë e kërkon pikërisht nga ne deputetët jo për të folur, por me rastin e

miratimit të buxhetit për vitin 2008 të ndalemi dhe të mendojmë pikërisht për këtë fond dhe për ndarjen e mjeteve financiare për pensionistët dhe kategoritë e sistemeve sociale.

Dhe duke propozuar zgjidhje konkrete për benificionet që vërtet doktoresha i paraqiti me mjaft saktësi, vlerësojmë se, përveç kësaj kategorie, që duhet ta gëzojë të drejtën është një kategori e qytetarëve që është tërësisht e pambrojtur dhe ajo është grup-mosha 55 deri 65 as nuk është e përfshirë në skemën sociale dhe as nuk ka mundësi të pensionohet dhe ajo më e keqja është që as nuk mund të punësohet, duhet të gjejmë formë edhe për këtë kategori të grup moshës së shoqërisë sonë në këtë mënyrë që vërtet gjendja sociale të jetë nën kontrollin e Qeverisë së Kosovës. Ju faleminderit për mirëkuptim.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit fjalën e ka deputetja Teuta Hadri le të përgatitet Nafije Berisha.

DEPUTETJA TEUTA HADRI – Ju faleminderit. të nderuar deputetë, i nderuar z. kryetar. Si po shihet çështja e pensionistëve dhe debati i sotëm mbetet vetëm si pikë e rendit të ditës, jo për t'u zgjidhur një herë përfundimisht, çështja e rëndësishme e pensioneve, por kjo mbetet si çështje vetëm për të bërë gara për fushatë, se fryma e zgjedhjeve po nuhatet dhe po afrohet dhe deputetët duhet secili të paraqitet sa më i fortë për ta shprehur fjalën e tij.

Si gjithmonë edhe vitet tjera u diskutua mjaft u debatua për pensionet dhe pensionistët por asnjë konkluzion dhe vendim përfundimtar nuk ka rrjedhë nga të gjitha ato takime të mbajtura si ato të komisionit shëndetësor ato të Kuvendit të Kosovës dhe të Qeverisë. Ato mbeten vetëm fjalë të pa realizuara, vitet po kalojnë dhe jeta po ecën e Qeveria jonë pensionistët po i le në mëshirën e fatit të përballuar me varfërinë me sëmundjen dhe pamundësinë për të siguruar kafshatën e fundit që u ka mbetur për të ngrënë në jetë.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka përgatitur qysh në vitin 2005 projektligjin për sigurimin pensional dhe invalidor i ka paraparë dhe hartuar ka shqyrtuar dhe proceduar. Për këtë projekt ligj të sigurimit pensional dhe nëse fundit ka bërë aktivitetin e saj për t'i nxjerrë e plotësuar rekomandimet e nxjerra nga Qeveria e Kosovës për këtë Projektligj, ndërsa Qeveria po fle. Nuk është e zonja për ta përfunduar këtë çështje, ajo ka shtyr disa herë për miratimin e këtij ligji gjojase për shkak të kostos financiare, janë bërë disa rivlerësime të postës financiare për këtë Projektligj, por pa sukses, prandaj themi që Qeveria e Kosovës nuk ka bërë angazhim të duhur sa i takon dhe është përgjegjëse si qeveri për ta mbuluar këtë kosto financiare, ka mund t'i përballonte këto shpenzime po të ishte angazhuar më tepër në të gjitha ato takime që ka pasur për t'ia rikthyer Kosovës fondin e grabitur pensional nga shteti i Serbisë, sepse ky fond ishte i kosovarëve dhe djersë e punëtorëve tanë me vite të tëra pune dhe qeveria jonë në të gjitha ato takime që sa vite nuk që e zonja për të drejtuar për të qeverisur dhe kanalizuar prioritetet, ka pasur dhe ka mundur që në ato takime të caktojë edhe kushte që ishin aq të panumërta për ta realizuar kthimin e këtij fondi, ajo nuk ka sakrifikuar asgjë sepse qeveritarët kanë luftuar për karrigen e vet dhe interesat e veta dhe nga frika se humbin këto pozicione nuk kanë paraqitur dhe realizuar kërkesat më legjitime të qytetarëve tanë për të kërkuar djersën dhe mundin e vet.

Të shpresojmë se ky Kuvend i Kosovës e ka herën e fundit dhe mandatin të vendosë përfundimisht për të drejtën legjitime të pensionistëve, por sa u përket fondeve ato do të sigurohen nëse angazhohet Qeveria dhe jep maksimumin për t'u dhënë përparësi prioritetëve. Por nëse qeveritarët nuk dinë le t'ua lëshojnë vendin të tjerëve, atyre që dinë, mjaft me padituri dhe të paditur. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Nafije Berisha, le të përgatitet deputetja Teuta

DEPUTETJA NAFIJE BERISHA - I nderuari kryetar, të nderuar ministra kolegë deputetë. Para se të fillojë fjalën time dëshiroj të përshëndes të gjithë pensionistët e Kosovës dhe të falënderoj ata në durimin që kanë pasur deri më sot deri sa Kosova të gjejë një modalitet të sistemit pensional të përshtatshëm për këtë kohë tranzicionale. Pra ky Kuvend i Kosovës me 7 korrik 2005 aprovoi disa rekomandime të cilat komisioni funksional mendonte se do të ishin një zgjidhje e gjendjes së paqëndrueshme të pensionistëve dhe të invalidëve të punës në Kosovë.

Sistemi social në përgjithësi e posaçërisht sistemi i sigurimit pensional dhe invalidor tash 8 vite ende nuk kanë arritur të mëkëmben. Sot sigurimi pensional emërohet si aktrim i obliguar i të punësuarve ose si trust pensional në vend dhe një sigurimi të sistemuar pensional dhe invalidor, ndërsa termi pension përdoret për një ndihmë linare që u ndahet personave të moshuar mbi moshën 65 vjet pa përfshirë kontributet dhe stazhin e sigurimit social.

Në këtë mënyrë nuk janë përfillë mjaftueshëm kërkesat e pensionistëve dhe krejt thjesht dhe pa u diktuar fare e kemi formuar një grup të intersit që herët a vonë do të kërkojë rend edhe përgjegjësi nga Qeveria dhe nga ne për t'u zgjidhur kjo çështje. Sigurimi pensional dhe invalidor nuk ka filluar të funksionuar sepse nuk janë bërë disa përpjekje që psh. të ringjallet sistemi i mëhershëm i solidaritetit i cili është zhdukur dhe plaçkitur nga Serbia pastaj ambienti politik dhe ekonomik ka qenë i pa përshtatshëm për të startuar me skemën sociale dhe pensionale të sotme në procesin e privatizimit, nuk është menduar në ndonjë fond ose me ndonjë përqindje për fondin pensional, pastaj llojllojshmëria e masave dhe reformave të sistemeve pensionale në rajon dhe për Kosovën nuk është zgjedhur një model i përshtatshëm në këtë fazë të tranzicionit si dhe ka munguar dialogu social për miratimin social tri palesh për miratimin dhe krijimin e një sistemi pensional të sotëm ose një krijimin e trustit pensional.

Ne gjithashtu, unë gjithashtu dëshiroj që ministrin dhe juve kolegë të nderuar deputetë tua paraqes edhe disa të meta të trustit pensional të sotëm. Deri më sot ne nuk kemi ndonjë vlerësim ose nga Qeveria ose nga UNMIK-u ose nga vetë trusti mbi funksionimin e tij, sepse nga përvoja e vendeve të ndryshme që kanë filluar me privatizim të pensioneve sikurse trusti në Kosovë tregon se kostoja e administrimit të tyre është shumë e lartë. Psh. nga një vlerësim i viteve 99 në Hungari është vërtetuar se shpenzimet operative të administrimit të pensioneve private silleshin diku nga 8% të ardhurave të kontribuuesve ose 4 herë më shumë se shpenzimet administrative të

skemave të mëparshme se të skemave publike, psh. në Poloni 13% administrimi merrte të parave të kontribuuesve, andaj për ne kishte me qenë shumë e rëndësishme se sa para të kontribuuesve shkojnë në administrimin e trustit që funksionon sot në Kosovë.

Pastaj nga ky trust nuk ka ndonjë garant as mbrojtje në rast të ndonjë inflacioni, të humbjes së parave në treg ose në ndonjë berzë, ku ato investohen.

Ka informata jo të mjaftueshme për vetëkontribuuesit lidhur me mënyrën e kthimit të atyre kursimeve të aplikuara të punëtorëve në pension ose shpenzimeve përcjellëse të tyre gjatë aludimit të tyre. A do të merret parasysh pastaj mosha mesatare e meshkujve dhe e femrave gjatë llogaritjes së pensionit, si do të indeksohen benificionet e këtij pensioni e kështu me radhë, pastaj e metë tjetër sidomos për Kosovën është sepse pjesa më e madhe dhe përqindja më e madhe e popullatës në Kosovë është e vërtetë që është e re, por është një problem tjetër se kjo rini e Kosovës nuk mund të punësohet deri në moshat ma të shtyra 35 ose 40 edhe kështu që parat e grumbulluara në këtë trust me siguri se nuk do të ishin zgjidhje për një pension të tyre.

Gjithashtu është një problem tjetër, dalja nga tregu i punës i të rinjve, shumë prej tyre arrijnë të punësohen por shumë shpejtë për një kohë të caktuar dalin nga puna dhe për një kohë prap relativisht të gjatë nuk mund të punësohen shkaku i zhvillimit të ngadalshëm ekonomik dhe hapjes së ngadalshëm të vendeve të reja të punës.

Gjithashtu problem tjetër është se punësimi në sektorin privat dhe në tregun jo formal të tyre, si psh. sipas disa statistikave që nuk jam e sigurt se ndoshta janë plotësisht të sakta vetëm diku 88% të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të regjistruar në Kosovë kanë deri në 5 punëtorë, e që është shumë reale që këto ndërmarrje shumicën e këtyre punëtorëve të tyre as që paguajnë tatim për këtë trust do të thotë ata punojnë por nuk paguajnë kurrfarë kontributesh. Megjithatë për mua mu duk e rëndësishme t'i paraqes disa të meta të këtij trusti me shpresë që Qeveria dhe ministria do të bëjë përpjekje të vazhdojë punën në ligjin të cilin e ka filluar dhe të gjejë një modalitet të përshtatshëm për Kosovën, dhe gjithashtu të përkrahë kërkesat e pensionistëve që megjithatë në Kosovë të fillojmë me implementimin e sistemit solidar ose sistemit: Unë paguajë t'i merr, në mënyrë që gradualisht me kalimin e kohës ne do të bënim edhe reformimin e sistemit pensional sikurse edhe shumë vende të tjera në regjion, andaj z. ministër ju e dini sepse keni pasur një diskutim publik edhe me vetë pensionistët lidhur me projektligjin që e cekët dhe e keni përkrahjen e tyre që të bëni përpjekje maksimale që ai projektligj të vijë sa më shpejtë në Kuvend sepse nëpërmes tij Kosova do të fillonte me një sistem pensional të qëndrueshëm në të cilin çdo qytetarë i Kosovës do të mund të vendoste dhe do ta dinte se cilit pjesë i takon. Është e drejtë e çdo qytetari në botë t'i sigurohet një sistem një pension elementar edhe pastaj truste ose pensionet private të cilat kanë filluar të implementohen edhe në vende të ndryshme të Evropës që qytetarët të zgjedhin vetë atëherë në bazë të mundësive materiale të tyre se ku do të kontribuojnë për ato.

Me të vërtetë është qasja e reformimit të sistemit pensional përgjithësi në 10 vitet e fundit në Evropë, ka filluar shkaku se vetë fondi pensional ka filluar të bëhet ngarkesë për buxhetet e shumë qeverive, andaj, duhet të mendojmë edhe ne sepse ky fondi i pensioni

moshës i cili ka filluar të paguhet tek ne sot në Kosovë për një kohë shumë të shkurtër mund të bëhet edhe për buxhetin tonë ngarkesë shumë e madhe sepse është një fond nga i cili vetëm duhet të jepet edhe numrit të të moshuarve, ku gradualisht në vitet e ardhshme pritet të shtohet edhe më shumë.

Andaj, është shumë e domosdoshme të gjendet një zgjidhje ma fatlume që me kontribute dhe nëpër mes sistemit të kombinuar të zgjidhet kjo çështje. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqiu, le të përgatitet deputeti Mazllum Kumnova.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Ju faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit, e nderuara Qeveri, dhe të respektuar kolegë deputetë. Në seancën plenare të 7 korrikut 2005 konstatohen se gjendja e pensionistëve është e vështirë dhe se urgjent duhet të ndërmerren masat për përmirësimin e kësaj gjendjeje, me të gjithë votat për dhe asnjë kundër u miratuan rekomandimet për Qeverinë për ndryshimin e kësaj gjendjeje të pensionistëve. Edhe pak bëhen dy vjet të plota nga kjo ditë, rekomandimet nuk janë realizuar, sot do të duhej që Qeveria do të na tregojë për arsyet gjë që patëm rast të dëgjomë ministrin sepse ato nuk janë realizuar, cilat ishin problemet që pengojnë realizimin, pse nuk është informuar Kuvendi për dy vjet, por problemet eventuale të cilat nuk lejuan zbatimin e rekomandimeve.

Dhe në fund, çka duhet të ndërmerr për të realizuar këto rekomandime apo duan edhe rekomandimet tjera shtesë. Për të analizuar këtë gjendje Grupi Parlamentar i ORA me 11 qershor ka organizuar një konferencë sigurimet shoqërore, sigurimet pensionale invalide, të ftuar në këtë konferencë ishin deputetë, pjesëmarrës nga ministria për mirëqenie sociale anëtarë të sindikatës të pensionistëve të shoqatës së pensionistëve të trustit të fondit slloven të shoqërisë civile dhe gjithashtu edhe shumë të rijë.

Diskutuam për probleme me të cilat ballafaqohemi dhe kërkojmë të gjejmë zgjidhje dhe të ofrojmë rekomandime institucioneve relevante për përmirësimin e pensionistëve të punës. Diskutimet mund të karakterizoheshin në shumë mënyra, ishin emocionale të shumta, nisemi prej akuzimit të gjeneratës së re e deri te akuzimi i gjeneratës së vet e cila ndodhet në pushtet e nuk bënë asgjë për ta.

Niseshim prej kërcënimeve të ndryshme dhe shkojmë deri në shpresën e zbehët për një ndryshim, për një respekt të dëshiruar aq shumë e të munguar tmerrësisht, një zhgënjim dhe mos përfillje dilte prej asaj konference. Deklarimet e fundit për rritjen e pensioneve për 20% edhe një herë përgjithmonë do të fundosnin shanset e penzionerëve të punës për trajtim adekuat dhe për respektim të punës së tyre, ishalla nuk e kanë atë fatin e atyre 6 milionëve të ofruar dy vjet më parë/

Me rritjen e ndihmave të moshës, me rritjen e buxhetit vazhdon politika nënçmuese ndaj pensionistëve të punës. Gjatë një emisioni jeta në Kosovë më bëri përshtypje diskutimi i një punëtori nga ministria emri i të cilit nuk po më kujtohet, ai arsyetojë se pse

pensionistët e punës nuk kanë pensione, tha se ju keni punuar mjaft keni pasur privilegje dhe i keni penguar të tjerët të punojnë, prandaj arsyetonte pozitën e njëjtë të pensionistëve të punës me ata të moshës, normalisht nuk do t'ia kisha vërë veshin fjalëve të tij, pasi ai nuk është faktor i cili vendos për politikat sociale, por, fjalët e tij ishin si thënja: E qet fëmija çka ka shtëpia, ai fliste fjalët të cilët i kishte dëgjuar nga ata të cilët vendosin për politikat sociale.

Pozita e vështirë e pensionistëve të punës është çështje e kulluar politike, është hakmarrje ndaj atyre që kanë punuar sepse kanë marrë rrogat atëherë. Ky gjykim merr parasysh pak parametra, prandaj edhe vendimi është i lehtë dhe i gabuar, kjo politikë e sotme harron se këta pensionistët e sotëm kanë ndërguar Kosovën, rrugët nëpër të cilat po qarkullojnë sot janë të ndërtuar nga ata ne as me i mirëmbajtë nuk po jemi në gjendje, i pamë dje arsyetimet e ministrit të transportit për gjendjen e rrugëve ku na këshillojë të ecim ma ngadalë të nisemi për mbrëmje nga Gjakova e të mbërrijmë në mëngjes në Prishtinë.

Këta pensionistë e kanë ndërtuar feronikelin, Trepçën, fabrikat. Universitetin të cilin shumica e madhe prej nesh e kemi marrë edukimin e lartë, këta pensionistë kanë ndërtuar hidrosistemet, termocentralet të cilët ne nuk po mundemi me i mbajtur në funksion, bile edhe këtë ndërtesën këtu ku jemi mbledhur sot, vetëm e kemi rregulluar pak.

Këta pensionistë mund të krenohen me pasuritë të cilët na dhanë në trashëgimi, atë pasuri të cilën gjenerata jonë i bëri rrush e kumbulla, përmes AKM-së ne e shitëm arrin 10 euro bile diku edhe hektarin për një euro, fabrikat të cilat ata i ndërtuan i shitëm, me çmim të një shpie, dhe në fund as nuk i kemi lënë asnjë grosh nga shitja e pasurisë të cilën ata e ndërtuan, vërtet hakmarrje e tmerrshme.

Me këtë logjik do të duhej të mendojmë mirë se gjenerata që vjen pas nesh ka të drejtë të na trajtojë në mënyrë të njëjtë, nesër do të na thonë se ne kemi marrë roga, e ata nuk kanë pasur mundësi të punojnë sepse ne nuk kemi krijuar kushtet për punësimin e tyre, prandaj ne kur të plakemi nuk do të na japin pensionet me këtë logjikë tonën të sotme.

Bile ata do të kenë më tepër të drejtë se ne, sepse ne po u lamë fabrikat e shndërruara në parkingje në universitete private, hidrosistemet e termosistemet në gjendje të tmerrueshme, ambientin e degraduar, rrugët e shkatërruara dhe papunësinë e

Thonë çka mbjellë, korr. Çka do të korrim ne me këtë mbledhje, a thua ka mundësi për përmirësim a ka vullnet politik për përmirësim, kjo kategori në fakt është kategori nga e cila vetëm pritet marrja e votave në fushata elektorale por kësaj kategorie nuk i jepet asgjë, bile as respekti. Përndryshe si të interpretohet mos përmbushja e rekomandimeve të Kuvendit për dy vjet radhazi. Prandaj, dyshoj edhe në sinqeritetin e këtyre deklarimeve për rritje të pensioneve. Pa marrë parasysh këtë, ne po i paraqesim rekomandimet, rekomandime të cilat nga kjo Konferencë dolën dhe të cilat deputetja jonë veç i paraqiti dhe i bashkohemi rekomandimeve, të cilat kolegja jonë i ka paraqitur. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Mazlloom Kumnova le të përgatitet deputeti Fetah Berisha

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA - Z. kryetar, ministër nuk është hera e parë që po e shqyrtojmë këtë çështje e cila është mjaft e rëndësishme dhe kërkon një qasje shumë serioze, sepse mesatarisht çdo familje në Kosovë ka së paku një pensionist, prandaj edhe problemi është i ndeshëm. Në rastet e tilla mund të shqyrtojmë përvojat e shteteve tjera, një sistem pensionesh me katër kolona, i pari shpesh nis si shtylla zero, që do të thotë njëfarë mbështetje për të moshuarit pavarësisht sa kanë kontribuar ose vetëm për ata që janë të varfër ose për të gjithë të moshuarit model që po zbatohet i improvizuar dhe në Kosovë. Pastaj, shtylla e parë që është një pension i detyrueshëm i administruar publikisht, tipikisht një përfitim i përcaktuar. Shtylla e dytë është një kontribut pensioni i detyrueshëm i menaxhuar, privatisht dhe shtylla e tretë është kontribut vullnetar. Shumica e vendeve të botës nuk i ka të gjitha këto shtylla të ndryshme, ndërsa forma ma predominante e pensionit në botë ka të bëjë me një sistem të përfitimit të detyrueshëm të menaxhuar publikisht. Ne e kemi vetëm improvizimet e dy shtyllave dhe këtë nuk e ka hartuar as kjo Qeveri dhe as e kaluar, por e kemi marrë si të tillë. Shtrohet çështja se a duhet të mbesim në këtë përvojë që e kemi apo duhet bërë ndryshime. Nëse deri më sot kjo zgjidhje që po zbatohet nuk ka treguar sukses, ka diskriminuar strukturën .. kontribuues, atëherë duhet një qasje e re e kujdesshme, e pranueshme qoftë edhe me një faturë buxhetore ashtu si e kanë planifikuar edhe Ministria me Projektligj.

Padyshim se duhet të jemi të shqetësuar për një strukturë të popullit, kryesisht pensionistët që nuk kanë burime tjera alternative të jetës, e cila po përjeton ankthin për bukën e përditshme dhe askush nuk mund ta arsyetoj një qëndrim indiferent ndaj kësaj varfërie të skajshme.

Ministria në fjalë e vetmuar nuk mund ta zgjidhë këtë problem, apo më mirë të themi të fillojë një zgjidhje konkrete, për këtë kërkohet një angazhim edhe i këtij Kuvendi. Unë diskutimin tim, z. kryetar e kisha drejtuar me këto pyetje Ministrat:

1. Cila është faza e procedimit të Projektligjit për sigurimin pensional dhe invalidor dhe angazhimi i juaj konkretë në këtë fazë,
 2. Duke marrë parasysh nevoja të domosdoshëm për këtë Projektligj, a keni arritur që të bëni përmirësimet e këtij Projektligji duke angazhuar ekspertë të huaj dhe vendor,
 3. Cilat janë rekomandimet kompetente të partnerëve FMN dhe Banka Botërore lidhur me mundësitë e zbatimit të këtij ligji, shikoni kostot që aktualisht thuhet se është e pa përballueshme, a do të mbetet një situatë e tillë që e kemi apo ka shansa reale për të lëvizur këtë çështje drejt një zgjidhjeje definitive.
- Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fetah Berisha, Nekibe Kelmendi

DEPUTETI FETAH BERISHA – I nderuari z. Kryetar, i nderuar z. Ministër, të çmuar kolegë kuvendar, nga ky vend është shumë me rëndësi t'i përshëndesim të gjithë pensionistët kudo që janë.

Sot secili prej nesh ka para vetes një informatë të shkurtër, të përpiluar nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie sociale lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit të Kosovës, të cilën e patë nxjerrë me 7 korrik 2005, e për të cilën po debatojmë ne sot në këtë seancë. Është mirë që po debatohet për një çështje me rëndësi të veçantë, për çështjen e pensionistëve kontribut-dhënës dhe invalidët e punës në Kosovë. Ky debat është mjaft i vonuar nga se pensionistët e Kosovës tash e tetë vite ende nuk marrin pensionet për punën e tyre të merituar disavjeçare.

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, pas luftës ka bërë një skemë pensionale me karakter të përkohshëm, mirëpo edhe pas përpjekjeve Ministria nuk arriti të krijojë një sistem të qëndrueshëm për pensionistët kontribut dhënës dhe invalidor të Kosovës.

Ministria për Punë dhe Mirëqenies Sociale pas rekomandimeve të Kuvendit të Kosovës bëri përpjekje për plotësimin e tyre. Mirëpo kjo Ministri dy- tri here e kishte tërhequr Projektligjin për sigurimin pensional dhe invalidor për shkak të kostos së lartë financiare. Për këtë shkak thuhet në informatë paska intervenuar edhe FMN-ja edhe Banka Botërore, të cilat paskan sugjeruar që ky projektligj të mos të miratohet për shkaqe financiare. Pastaj, Qeveria e Kosovës në prill të vitit 2007, vendosi të formoj një komision i cili do ta shqyrtojë në tërësi këtë projektligj me të cilin do të zvogëlohen implikimet e larta buxhetore në Buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Shuma mujore që u jepet pensionistëve është shumë e ulët, prandaj pensionistët sot jetojnë në varfëri të skajshme dhe kërkojnë të ndahen nga 40 euro, të cilët i marrin ata që kanë mbushur mbi 65 vjet

Kryesia e Pensionistëve të Kosovës dhe organizatat e pensionistëve komunal kanë kontaktuar me të gjitha organet shtetërore, vendore dhe ndërkombëtare. Ata kanë kontaktuar me Presidentin Fatmir Sejdiun, kanë kontaktuar me ish kryeministrin Bajram Kosumi, ata kanë kontaktuar edhe me z. Stiven Shuk, ministrin Haki Shatrin, ministrin Selmanaj, Jesen Peteresenin, e të tjerë. Kështu ata thanë në një takim me të cilin kishim të bënim bashkërisht.

Pensionistët vazhdimisht kanë prezantuar në takimet me burrështetasit e Kosovës se pensionet dhe vështirësitë, mos marrja e pensioneve dhe vështirësitë e të moshuarëve kontribut -dhënës dhe i invalidëve të punës, kështu ata kanë kërkuar përgjigje të shkurtër pse Projektligji për pensione ende paraqitet Kuvendit të Kosovës. Të gjithë këta në takime që kanë pasur, kanë marrë vazhdimisht përgjigje se do të gjendet një zgjidhje e mundshme për të gjithë pensionistët e Kosovës. Po ashtu në fillim të vitit 2006, është organizuar një takim me shoqatat e pensionistëve të Kosovës dhe pensionistët e 5 komunave; të Prizrenit, Rahovecit, Dragashit, Suharekës, dhe Malishevës në Prizren,

në të cilën morën pjesë edhe deputetët e këtij regjioni. Në këtë takim u bë një bisedë e hollësishme për pozitën e pensionistëve, mirëpo gjendja e pensionistëve ngeli e pandryshuar, pensionistët edhe më tej nuk i marrin pensionet e tyre të merituara.

Në prill të vitit 2007, Organizata e Pensionistëve dhe e Invalidëve të Punës të Komunës së Rahovecit e mbajti Kuvendin e vet të rregullt, aty u paraqitë gjendja e vështirë e pensionistëve dhe se si mbijetojnë ata materialisht. Ne jetojmë në varfëri të skajshme thanë ata në këtë Kuvend. Ata falënderuan KFOR-in Turk në Prizren, i cili kujdeset për shëndetin e pensionistëve dhe invalidëve të punës të Komunës së Rahovecit. Mjekët e KFOR-it Turk, sipas marrëveshjes që paskan pasur ata për 2006, 510 pensionistëve të kësaj komune u kanë bërë vizitë sistematike mjekësore, u kanë siguruar edhe barërat falas. Kështu u kanë ndihmuar duke ua lehtësuar pozitën e tyre materiale dhe shëruese. Po ashtu edhe dërgimi i disa pensionistëve për t'u shëruar në Banjë të Pejës dhe në bazë të kësaj, ata kanë gjetur pak shërim. Ma merr mendja se të dy palëve duhet falënderuar këtu në këtë Kuvend.

Pensionistët dhe invalidët e punës të Komunës së Rahovecit, si dhe komunave tjera të Kosovës kanë strukturë heterogjene. Ata janë njerëz të profileve të ndryshme, ata janë profesor, mjekë, inxhinier, doktor shkencash etj. që dikur mbase 40 vite kanë kryer punë me rëndësi, kanë dhënë ndihmë të çmuar dhe çdo gjë e arritur në të kaluarën është edhe pjesë e djersës së tyre. Pensionistët sot e tetë vite nuk marrin pensionet e merituara, ata kërkojnë ndihmë, por jo lëmoshë për ta dhe për familjet e tyre. Pensionistët, pensioni i tyre është dhe djersa e punës së tyre 40 vjeçare. Ma thotë mendja që qëndrojnë edhe këto propozime: nën

1. Të gjendet një zgjidhje sidomos për pensionistët kontributdhënës, pagesa e pensionistëve është e drejtë e tyre e siguruar edhe me Konventën ndërkombëtare. Çështja e fondit pensional të Kosovës e grabitur nga Qeveria e Serbisë, Qeveria e Kosovës duhet ngritur sërish këtë çështje. Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale ngutshëm duhet të paraqesë miratimin e Projektligjit për sigurimin pensional dhe invalidor. Të bëhet zbatimi i rekomandimeve të Kuvendit të Kosovës, të bëhet rishikim i Buxhetit të konsoliduar të Kosovës për vitin që vjen edhe të bëhet diç për pensionistët tonë. Tani nuk dihet se kush nuk e di më e kush nuk e ka të qartë se gjendja e pensionistëve të Kosovës është e rëndë, se statusi i humbur i pensionistëve duhet t'ju kthehet. Kjo do të thotë shpërblimi i punës dhe djersës disavjeçare, këtë e meriton pensionisti ynë, natyrisht duhet lidhur me mundësinë financiare të Kosovës, megjithatë, fare në fund i përkrahim dhe i mbështesim përpjekjet e vazhdueshme të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale që të gjendet një mundësi për pagimin e pensioneve të pensionistëve tanë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi, le të përgatitet deputeti Nazim Jashari

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI - I nderuari z. kryetar, i nderuar z. Ministër, të nderuar deputetë, më duket se dolëm pak nga rendi i ditës dhe u zgjeruam me diskutimet

tona dhe deshëm që brenda një kohe shumë të shkurtër t'i rrahim të gjitha problemet sociale që e rëndojnë sot Kosovën, përkatësisht një kategori të popullatës së saj.

Unë e shoh këtu si pikë të rendit të ditës, është shqyrtimi - debat për zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit të datës 7. korrik 2005. E kam në dorë këtë rekomandim. Në këtë Rekomandim i kemi 5 pika. Mendoj se nga ky rekomandim dalin dy çështje apo mund të ngritën dy çështje: çështja e të drejtës apo çështja humanitare. Kur them çështja e të drejtës e kam fjalën për rregullimin institucional të së drejtës në pension qoftë ai invalidor, qoftë pension i plotë, qoftë pension i pleqërisë, por pension, çështja tjetër është çështja humanitare që do të thotë se kemi të bëjmë me kategorinë e cila nuk i përket kategorisë së pensionistëve të cilët kanë kontribuar dhe duhet ta gëzojnë të drejtën në pensione, por i përket një kategorie tjetër, kategorisë sociale dhe lidhet me të, konsiderohet çështje humanitare. Ndërmjet këtyre dy kategorive, ne me skemën e mëparshme kemi krijuar një kategori të ndërmjetme dhe kemi vendosur jo ne por me një Rregullore të UNMIK-ut që të gjithë ata që arrijnë moshën 65 vjeçare, të marrin nga 28, përkatësisht më vonë 40 – 45 euro. Çka do të thotë kjo, kjo do të thotë se kjo kategori e ndërmjetme e krijuar artificialisht dhe që unë perkund nuk kam hasur deri më tani, duhet ose të trajtohet si kategori sociale, nëse i plotëson kushtet për ndihmë sociale, nëse nuk i plotëson kushtet për ndihmë sociale të hiqet nga kategoria e marrjes së ndihmës përkatësisht kompensimit prej 40 eurosh. Me këtë rast, me siguri se do të krijohet një sasi e madhe parash dhe kjo do të shkonte në kontribut edhe të kategorisë së pensionistëve, por edhe të kategorisë së shfrytëzuesve të ndihmës sociale.

Pika e dytë e këtyre rekomandimeve i sugjeron Ministrisë për Mirëqenie Sociale të ndërmerr masa konkrete për reformimin e skemës së pensioneve, pikërisht ishte ajo që diskutova se duhet të jetë reformimi i skemës së pensioneve dhe të hiqet kategoria e ndërmjetme ose të vendoset në kategori sociale ose krejt të fshihet, sepse kemi raste kur në një familje ka njerëz aq të pasur që kanë fabrikat e veta, prindërit e tyre marrin ndihmën prej 40 euro, pse i kanë 65 vjet. A duhet t'i marrin ata e të tjerët që nuk kanë kurrfarë personi tjetër që punon në familje jetojnë prej 40 eurove, për mendimin tim kjo nuk është as drejtësi, as drejtshmëri.

Pika e tretë e këtyre rekomandimeve ka të bëjë me rekomandimin që të bashkëpunohet me UNMIK-un, për kthimin e fondit të pensioneve të grabitura nga Qeveria. Për këtë pikë që nuk është realizuar gjithashtu, unë kam propozim konkret që të kërkohet ose nga Zyra ligjore e UNMIK-ut, ose nga vetë përfaqësuesi special një raport ose të vijnë këtu ta informojë Kuvendin e Kosovës se çka ka ndërmarrë gjer më tani, kur kanë ndërmarrë dhe çfarë përgjigje kanë ndërmarrë, sepse nëse Serbia refuzon që t'i kthejë ato pensione, ne kemi të drejtë t'i drejtohem Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë dhe të kërkojmë që të na kthehen ato fonde të pensioneve.

Pika e katërt – thuhet i është rekomanduar qeverisë të shqyrtojë mundësinë e rritjes së pensioneve për personat që kanë kontribuar në Fondin e pensioneve të mëparshme. Kjo duhet të rishqyrtohet, kjo duhet të realizohet, kjo mund të bëhet, sepse shumë mirë, të gjithë jemi dëshmitarë se disa ministri në fund të vitit kanë suficit prej mjeteve buxhetore që u është ndarë për vitin buxhetor, për vitin fiskal, dhe nëse ato të holla nuk i kanë

shpenzuar deri në dhjetor, ato le t'i kthejnë në fondin, le t'ia kthejnë Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, në mënyrë që këto rekomandime të zbatohen, sepse nëse marrim vetëm rekomandime në mënyrë deklarative pa i zbatuar ato, atëherë nuk kemi nevojë as t'i marrim rekomandimet. Rekomandimi e ka qëllimin e vet për të arritur diçka e jo sa për të ekzistuar, dhe në fund kur mund të ndihmohet KEK-u me miliona para të Buxhetit të Kosovës nga Ministria e Financave dhe kur mund të ndërtohen shtëpi për një kategori të personave të caktuar, që gjithashtu shpenzojnë miliona para, pse nuk mund të gjendet rrugë edhe për ndarjen e këtyre 6 milionëve të premtuar. Ne kemi dëgjuar nga Ministri i Financave që është shumë i kënaqur se ka suficit në këtë kohë, nëse ka suficit le të urdhëroj ose le të propozoj rebalanc buxheti ose le ta gjejë një mënyrë që këto të holla përkatësisht ky Rekomandim të realizohet.

Mbrëmë, pikërisht unë nuk e di nga janë informuar, sigurisht kanë dike në shtëpi pensionistët për këtë çështje dhe kam pasur disa telefonata – ju lutem na ndihmoni. Është mirë t'iu ndihmohet, është mirë t'iu ndihmohet që mos t'i shohim më ata nëpër kanta të bërrilokut tu gjetur ushqim, të cilin e kanë hedhur ata që e kanë stomakun plot, dhe si duket edhe Rregulloren për skemën e mëparshme e kanë hartuar ata që e kanë pasur stomakun plot dhe nuk kanë menduar mirë për ata që nuk e kanë stomakun plot, dhe këtu, atëherë mund të përdoret ajo thënia popullore se ngiti të untit nuk ia di. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit! Nazim Jashari, le të përgatitet Shaban Halimi

DEPUTETI NAZIM JASHARI - I nderuar kryetar i Kuvendit, të nderuar pensionistë. Duhet ta vendosim një komunikim me ju sepse shpeshherë në këtë Kuvend të Kosovës e kam ndier veten keq lidhur me çështjet e ndryshme të cilat i kemi diskutuar në këtë Kuvend, por rrallëherë, të mos them asnjëherë më keq sesa kur është hapur tema e gjendjes së pensionistëve në shoqërinë tonë edhe statusit të pensionistit në shoqërinë tonë.

Ligji i parë i miratuar në Kuvend të Kosovës, Ligji për skemën e pensioneve bazë ka qenë një ligj i cili i ka gëzuar të gjithë, edhe ata të cilët e kanë pasur moshën e pleqërisë edhe të cilët nuk e kanë pasur atë moshë, sepse në njëfarë mënyre ka qenë sadsifakcion për një brez i cili punoi nuk punoi në lirinë e Kosovës ia doli ta realizojë një të drejtë elementare për ta pasur një përkrahje nga shoqëria, nga shteti. Mirëpo, ky lgj, Ligji i parë i miratuar në institucionin më të rëndësishëm të Kosovës në Kuvendin e Kosovës pas luftës nuk u pasua nga ligji tjetër, i cili do të duhej ta rregullonte çështjen e atyre të cilët e kanë shkrirë shekullin e tyre të punës dhe të jetës, duke punuar për këtë vend, për këtë vend, për këtë popull dhe për këtë brez i cili sot është ardhur në këto institucione dhe po e shfaq një pandjeshmëri absolute për nevojat, të cilat detyrimisht koha i bie para moshës së shtyrë, nevojat për barëra, nevojat për shërim, nevojat për ekzistencë shkurt e shqip me një fjalë. Tash e thash që po e ndiej veten keq, po e ndiej veten shumë keq sepse mënyra se qysh ky Kuvend apatik po i qaset këtij problemi dhe mënyra se si kjo Qeveri impotente po merret me këtë problem, më bënë ta ndiej veten keq. Nuk mundet një shoqëri e organizuar, një shoqëri e civilizuar ta trajtojë problemin e pensionistëve me një pandjeshmëri, me këtë injorim.

Pensionistët janë struktura e pafuqishme ashtu siç janë edhe fëmijët e mitur strukturë e pafuqishme e një shoqërie, dhe këtu ne bile, madje në popullin tonë ekziston thënia që plaku është si femja, pra absolutisht populli me përvojën e vet historike e ka ndërtuar konceptin që moshë e shtyrë e pleqërisë është e baras vlefshëm me moshën e njomë të rinisë, dhe duke qenë e tillë moshë e pafuqishme, mënyra se si është anashkaluar, është ikë nga përgjegjësia për ta institucionalizuar ndihmën, solidaritetin e kësaj shoqërie me atë brez të pafuqishëm është skandaloze, prandaj edhe një herë po e theksoj, po e ndiej veten shumë keq që nuk kemi fuqi më shumë, që të bëjmë më shumë. Ne si Grup parlamentar, që ky Kuvend ta rritë efektivitetin e vet dhe që ato 6 milion që janë miratuar para dy vjetëve, dhe të cilat mënyrë triumfale kryetari i komisionit tim të buxhetit u qua, në këtë sallë, në këtë foltore dhe i proklamojë me bujë dhe fatmirësisht nuk di se si mu dha fjala dhe shprehja menjëherë rezervën që ky premtim do të mbetet flluskë sapuni, ashtu edhe siç doli. Pa e ndryshuar qasjen, ky Kuvend ndaj kësaj strukture, të jeni të sigurt se askush në botë nuk do ta merr seriozisht gatishmërinë tonë për t'i përgjegjësitë lidhur me çështjet e tjera, të cilat realisht i takojnë një shoqërie të organizuar, një pushteti të organizuar. Gjërat janë të lidhura, janë të ndërvarura. Në qoftë se ne i trajtojmë në këtë mënyrë pensionistët, nuk do të jemi në gjendje t'i trajtojmë, që sigurisht janë pjesë ta quaja ashtu minorancë moshore e shoqërisë sonë, nuk do të jemi në gjendje t'i trajtojmë minorancat tjera strukturore të shoqërisë sonë në mënyrë të ndryshme, në mënyrë të ndryshme. Do të jemi të këtillë të pandjeshëm, do të jemi të këtillë injorues dhe është edhe ky element i cili e dëshmon gatishmërinë tonë për të marrë përgjegjësi, edhe ky është element që gjithmonë ndërlidhet me gatishmërinë e të tjerëve për të na e rritur masën e përgjegjësisë lidhur me vetëqeverisjen. Të gjitha këto momente bëjnë që Kosovës t'i shtyhet statusi në pafundësi t'i shtyhet, t'i shtyhet e t'i shtyhet, dhe fatkeqësisht nuk ekziston vetëdija që gjithçka që ne bëjmë lidhet me statusin dhe jo vetëm bisedimet, jo vetëm Grupi i Unitetit, jo vetëm atje disa njerëz që vendosin për, ta quaj ashtu çështje madhore. Do të kemi shtyrje dhe pas shtyrjesh gjithmonë derisa ne nuk ngritemi në përgjegjësinë e duhur, fatkeqësisht unë e kam humbur shpresën, jemi në fund të mandatit tonë, nuk i kemi edhe 4-5 muaj, nuk e kam as iluzionin, por shpresoj shumë që edhe pensionistët do të duhet t'i çelin sytë e lodhur dhe ta ndëshkojnë këtë garniturë të papërgjegjshme politike, këtë qeveri impotente. Ju faleminderit.

KRYTARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Shaban Halimi, le të përgatitet deputeti Hydajet Hyseni

DEPUTETI SHABAN HALIMI - Ju faleminderit z. Kryetar, z. Ministër, të nderuar kolegë deputetë.

Çështja e pensionistëve dhe e pensioneve në përgjithësi në Kosovë është një çështje aktuale që në këtë Parlament diskutohet shumë edhe si çështje e veçantë, por edhe gjithmonë kur i kemi buxhetet e viteve në vijim, por edhe rishikime të buxheteve dhe në këtë drejtim shumë prej nesh përdorim pensionistët për ta avancuar vetveten ose për të treguar se vërtet jemi të interesuar për të zgjidhë problemet e pensionit, dhe në një far forme nuk japim alternativa se si këto duhet të zgjidhen, gjithashtu duke mos pasur parasysh absolutisht faktet dhe rrethanat me të cilat ballafaqohet Kosova. Në këtë

drejtim unë duhet them se në bazë të deklaratës së Kuvendit, Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale ka bërë përpjekjet e veta për të vënë në funksion këto pesë pikat të cilat i ka rekomanduar Kuvendi, është vetëm pika e pestë ajo që Ministria nuk ka mundur të vërë atë në funksion.

Çështja e pensioneve ose skemës sociale, ose pensionale në përgjithësi në Buxhetin e Kosovës e kemi një skemë e cila shpenzon ose ka mjete mbi 150 milion, dhe të gjitha pretendimet për të rritur këtë pozicion në 100% do të thotë në 300 milion. Duhet të dalim me propozime, me qëndrime se nga do t'i marrim këto 150 milion të tjera për t'i rritur këto pensione, në realitet këto ndihma që i kemi në 40 euro me 80 euro. Unë për vete, pensionistëve të mi në komunën time ju kam thanë se ka mundësi për lëvizje të vogla në përgjithësi, por mos ëndërroni për lëvizje të mëdha duke patur parasysh rrethanat momentale të zhvillimit ekonomik të Kosovës, duke pasur parasysh gjendjen e statusit të Kosovës, duke pasur parasysh në përgjithësi zhvillimin e bizneseve në territorin tonë.

Nuk është se në këtë drejtim nuk mund të ndërmerren masa të cilat sado pak mund të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së pensionistëve tonë në Kosovë, dhe në këtë drejtim edhe gjatë diskutimit të buxheteve kam propozuar, që ajo fatmirësisht tani me Projektligjin për sigurimin pensional dhe invalidor është në rishikim skema sociale dhe skema e pensioneve në përgjithësi në Kosovë, dhe kam thënë se në këtë drejtim mund të kursehen mjete, por jo mjete me masë dhe sasi të mjaftueshme sa për të kënaqur ashtu siç po flasim neve këtu në Parlament. Këtu është çështja se kemi në rishikimin e kësaj skeme, sidomos të pensioneve që nga disa parafolës u tha se kemi kategori të njerëzve që marrin këtë pension ose këtë ndihmë nga 40 euro, që absolutisht nuk kanë nevojë ta marrin, e dimë se është skemë e trashëguar, por skemë për shembull që ne mund të intervenojmë, ta përmirësojmë dhe të përfitojmë mjete për të përmirësuar gjendjen e tanishme të pensioneve.

Në anën tjetër, kemi po ashtu skemën sociale ose kemi për shembull njerëzit të cilët janë të vdekur, dhe kjo është duke dhënë rezultate nga ana e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale ku veç kanë filluar të hulumtohen këto dhe të kemi mjete. Por këto mjete të gjitha të cilat për shembull kursehen duhet absolutisht të shërbejnë vetëm për fondin pensional dhe invalidor. Në anën tjetër po ashtu kemi edhe qytetarë të Kosovës të regjistruar në Kosovë, tani nuk jetojnë në Kosovë jetojnë nëpër vende të tjera, ndërsa pensionin ose këtë ndihmë për shembull e marrin në Kosovë. Në këtë aspekt, ose në këtë drejtim unë mendoj se kemi edhe disa kategori të cilat janë të rrezikuara dhe ato kemi për shembull qytetarët tanë të cilët në mënyrë të dhunshme në ish sistemin kanë qenë të pensionuar kurse tani nuk marrin kurrfarë ndihme pensionale ose ndihmë sociale. Gjithashtu në këtë drejtim unë mendoj se sa i përket trustit të pensioneve që flasin mjaftë për këtë trustë i cili mund të shfrytëzohet unë mendoj se ka vend që Qeveria të bëjë atë trysinë për të marrë kompetencat rreth menaxhimit të trustit të pensioneve për të pa se këto mjete të cilat kursehen nga qytetarët tanë a menaxhohen mirë, a investohen mirë, a rruhen mirë dhe këto mjete duhet ta dimë se nuk mund të shërbejnë për gjeneratat të cilat kanë dhënë kontributet e tyre për këto janë kursimet të cilat duhet të shërbejnë për

gjenerata të cilat kursejnë dhe efekt e këtyre janë pas 10 viteve ashtu siç është e paraparë me Rregulloren e trustit të kursimeve të pensioneve.

Prandaj, edhe rreth kësaj nuk mund të ketë shumë manipulime. Në anën tjetër unë them se trustit nuk janë për shembull por janë obligative që i ndajmë neve në këtë fond. Në anën tjetër këtu mund të kontribuohet po ashtu nëse neve insistojmë pakës më tepër me marrjen e disa kompetencave nga ana e Shtyllës së katërt të UNMIK-ut për menaxhimin e ndërmarrjeve publike, ndërmarrje të cilët punëtorët e tyre i vënë në pozicion shumë të favorshëm krahasim në të gjithë punëtorët tjerë të punësuar nëpër agjencitë tjera buxhetore sepse ata për punëtorët e tyre ndajnë dyfishin për punëtorët ndërsa edhe si kompani ndajë dyfishin e këtyre mjeteve dhe këto mjete për shembull i vënë në këta punëtorë.

Në anën tjetër kemi po ashtu edhe një shoqëri tjetër të rrezikuar-të kompanive shoqërore frikë të privatizuara dhe të kompanive shoqërore të cilat ende nuk janë privatizuar. Punëtorët të cilët punojnë në ato kompani nga mjetet e veta ju ndalen nga kompania për pension po ashtu edhe kompania është e obliguar që të ndajë mjete për pension dhe këto mjete kur punëtorëve nuk iu paguhen ose nuk iu inkasohen ose nuk u deponohen në banka të cilat p.sh. duhet të ... atyre. Prandaj unë mendoj se çështja e pensioneve nuk duhet të jetë një çështje shumë euforike, çështje në të cilën mund të manipulohet shumë, është çështje me të vërtetë që duhet të komunikojmë me pensionistët por të ju tregojmë të vërtetën se çka ka mundësi në këto kohë të bëhet dhe çka s'ka mundësi të bëhet. Kuptohet, se ka edhe papërgjegjësi, kuptohet se ka edhe ndoshta defekte që mund të bëhet më mirë por gjendja momentale unë e shoh se edhe për dy, tri vite nuk mund të kemi gjendje shumë më të mirë të këtyre kategorive. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit z. deputet. Fjalën e ka Hydajet Hyseni, le të përgatitet deputetja Sanije Alijaj.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Faleminderit z. kryesues. Më lejoni zonja e zotërinj deputetë që duke ju përshëndetur ju të përshëndes veçanërisht ministrin Selமானaj i cili si duket është i vetmi që e konsideron vetën të obliguar për të mos dhënë të dënuar që të rri këtu në këtë debat për një çështje aq të ndjeshme siç është pensionistët. Dikush tha ndihem keq, besoni edhe unë ndihem keq sot kush o në këtë qëndrim të Qeverisë. Në një mënyrë turpërohem unë pse nuk turpërohet Qeveria për gjendjen në të cilën ndodhet dhe sidomos për qasjen që në vazhdimësi mbahet ndaj kategorisë shumë të dëmtuar e shumë të merituar për realitetin që kemi sot në Kosovë.

Ndihem keq edhe për një aspekt. Nga një anë kjo çështje po trajtohet si çështje thjeshtë sociale si mëshirimi (gjynah) edhe tonet e diskutimit shpesh janë të tilla. A meritojnë pensionistët një qasje të tillë. Për më tepër ndihem keq kur dëgjoj nga një herë edhe lot krokodili të atyre që bash mirë koxha rrastë si thuash i kanë kontribuar edhe zhvatjes së pasurisë së siguruar me ndjerës nga gjeneratat e ndryshme të pensionistëve që tani trajtohen si problem social.

Unë e përgëzoj megjithatë edhe ministrin edhe Qeverinë për ato përpjekje që i kanë bërë. Unë kërkoj pse jam tash në opozitë që Qeveria të bëjë edhe atë që s'mund ta bëjë që është e pamundur. Por megjithatë mendoj se kemi të drejtë të kërkojmë pse nuk bëhet së paku ajo që është e mundshme. P.sh. nëse nuk paska para për të rritur pensionet a ka mundësi që ajo të organizohet më mirë z. ministër, a ka mundësi të mos lejohen debalance të tilla që ta zëmë ndoshta ish ministri ose ish akademiku i dikurshëm të marrë sot 40 euro në muaj, kurse një ministër për një mëditje të marrë 1000 euro, kjo mund të rregullohet. A ka mundësi ta zëmë që qasja jonë të jetë pak më gjithëpërfshirëse p.sh. a ka pasur mundësi që në këtë debat të ftohen përfaqësuesit e shoqatave të pensionistëve, përfaqësuesit e sindikatës, pensionistëve dhe ata le të jenë këtu të pranishëm bashkë me ne, të dëgjojmë ne edhe qëndrimet e tyre.

Megjithatë, unë duke mbështetur diskutimet e mëparshme shumicën dërmuese prej tyre po heq ndonjë që kishte më shumë byk e fjalë të thata por dua të nënvizoj dy kategori që konsideroj se zakonisht harrohet injorohen. Çështjen e mërgimtarëve edhe pensioneve të tyre pa u lëshuar sa janë të merituar mërgimtarët për realitetin që kemi etj. gjithë jemi dëshmitarë se është një çështje e madhe e pazgjidhur. Një çështje me të cilën abuzohet me të madhe për pasojë fonde të shumta shkojnë nëpër Beograd e ndalen në Beograd, dëmtohen mërgimtarët tanë, dëmtohet edhe ekonomia e Kosovës, dëmtohen edhe gjasat për ta përmirësuar edhe pozitën ose mundësitë, aftësitë e Qeverisë së Kosovës për një zgjidhje pak më të kënaqshme të çështjes së pensionistëve.

Dhe kategoria e dytë që zakonisht harrohet, injorohet kur flitet për kategori të ndryshme që kanë kontribuar, harrohet se ka pasur edhe një armatë e tërë e njerëzve që pa fajin e tyre dhe pa dëshirën e tyre kanë kaluar vite të tëra nëpër burgje të ndryshme anekënd Jugosllavisë ku janë detyruar të bëjnë punë nga më të rëndat nga më të rrezikshmet dhe nga ma poshtërueset. Me çdo kriter ata duhet edhe të përfshihen në skemat sociale pensionale. Vendet e tjera për rreth kanë siguruar zgjidhje që janë shumë si thuash të avancuara kurse Kosova nuk ka bërë asgjë në këtë drejtim. E Kosova ka arsye të veçanta për t'i kushtuar kujdes të veçantë kësaj kategorie. E shtroj këtë çështje z. ministër edhe si një nevojë për ta pasur veçanërisht parasysh.

Unë theksova edhe një herë po kthehem edhe te çështja e pensionistëve tanë, nëse nuk ka mundësi të zgjidhet problemi i pensionistëve, siç duhet i kuptojmë vështirësitë. A ka mundësi që të jetë një trajtim pak më dinjetozë së paku në menaxhimin e as shumë të vogël 40 eurove që u ndanë. Gjithë ne i kemi parë radhët e pensionistëve që presin skaj rrugës rreth do bankave që s'di si krijohen e s'di kush i drejton krejt presin në shi në borë për të marrë 40 euro. Edhe për më tepër dërgohet prej Prishtinës në Matican, si të thuash edhe vendi ku ata i realizojnë të drejtat e tyre e tjera. Duhet të paguajnë taksi kurse Qeveria nuk ka mundësi të krijoj do lehtësi të krijoj një strehë për ta tjera. Këto së paku mund të realizohet apo jo z. ministër?

Më lejoni që ndoshta si kontribut edhe krijimit të tablosë reale pse na ndodh kjo të theksoj edhe dy shqetësime që edhe u theksua në një mënyrë më përpara. Çështja e Trustit Pensional gjithë në një farë mënyre i hasim ato, por asnjëherë nuk morëm përgjigje e si u krijua ky i famshmi trust pensional, kush e krijoi, si, me çfarë kriterë, a ishte e vetmja zgjidhje, çka ndodh atje, pse drejtuesit e tij duhet të kenë paga të tilla që si

ka askush në Kosovë, pse drejtuesit e tij duhet të kenë paga që janë dhjetëra qindra herë më i madh sesa pensioni prej të cilit ata i realizojnë të ardhurat e tyre. nëse është përgjegjësi e UNMIK-ut se e di kështu do të thuhet, a mund të ia shtrojmë këtë pyetje edhe UNMIK-ut e pse na imponohen zgjidhje të tilla, dhe çka ka bërë Qeveria që t'i korrigjojë këto anomali.

Ose çështja e dytë të cilën unë dua ta nënvizojë veçanërisht e ka të bëjë me rekomandimin numër tre të këtij Kuvendi. Parafolësja pak më para, s'po ja përmendi emri se nuk qenka këtu iu referua këtij rekomandimi për një mënyrë duke haruar atë pjesën që thoshte gjatë procesit të negociatave me Qeverinë e Serbisë.

Zonja e zotërinj para kaq kohe do të thotë kur flitej se Kosova nuk do të lejoj negociata me Serbinë e tjera megjithatë është paraparë edhe nga ky Kuvend është kërkuar që në procesin e negociatave të përfshihet kjo çështje dhe të korrigjohet kjo çështje. A kemi të drejtë të kërkojmë pse nuk është respektuar kjo, dhe të informohet Kuvendi çka ka bërë Qeveria për ta realizuar këtë rekomandim edhe gjatë procesit të deritashëm të negocimit me Beogradin.

Pse nuk ishte ajo sa duhet e si duhet në tavolinën e bisedimeve? Pse nuk u informua opinionin kosovar për gjithë rrjedhën dhe ndoshta edhe një pyetje meriton përgjigje, pse nuk u angazhuan ata që ishin më të lidhurit në këtë çështje, ata që ishin edhe më të informuarit, më të përgatiturit ekspertët përfaqësuesit edhe të Shoqatave të Pensionistëve dhe Sindikatës së Pensionistëve, ata kanë takuar shumicën prej nesh dhe na kanë sjellë fakte të shumta edhe rekomandime edhe zgjidhje shpesh, janë injoruar zotëri, janë injoruar zotëri të Qeverisë. Pse të injorohen? Prandaj edhe kemi këtë gjendje, unë nuk kam iluzione se mund ta zgjidhim ne fët e fët e lehtë si ndonjëherë mund të dëshirohet. Por megjithatë se mund të përmirësojmë më mirë se mund të kem më shumë dritë, më shumë transparencë dhe të bisedojmë shakë me të gjitha kategoritë dhe me një drejtësi më të madhe edhe në menaxhimin e fondeve që kemi ne jam i sigurt që së paku do të evitonim keqkuptimet, tensionet edhe nga pak këtë demagogjinë më fal sot që është e vërtetë të bënë të ndihesh keq. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit z. deputet. Fjalën e ka Sanije Alijaj, le të përgatitet Milazim Haliti.

DEPUTETJA SANIJE ALIAJ- I nderuar z. kryesues, të nderuar ministrat, të respektuar kolegë deputetë. Në këtë debat për pensionistët e Kosovës e mora fjalën jo për të thënë diçka të veçantë nga ajo që është e njohur shoqëria e Kosovës, institucionet e Kosovës dhe nga ajo që u tha nga kolegët deputetë në këtë Kuvend por jam lajmëruar për të shtruar disa shqetësime të pensionistëve të komunës së Ferizajt nga përgjegjësia që ndiej për ta dhe nga premtimi që u kam dhënë që do të jem zëri i tyre në Kuvend. Sot dhe dje në rend dite në seancën plenare janë shtruar dy çështje sa të rëndësishme aq të domosdoshme sepse si shoqëri dhe institucione kemi obligime për një trajtim më të mirë për të rinjtë dhe për të moshuarit. Për të rinjtë hapësirë e kushte më të mira për prosperitetin e tyre. për të moshuarit një pleqëri të denjë.

Pika e rendit të ditës debat për zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit të datës 7 korrik 2006 për çështjen e pensionistëve të Kosovës tregon se institucionet e Kosovës jo që nuk e kanë begatuar këto rekomandime në interes të pensionistëve por nuk i kanë realizuar edhe ato që janë miratuar në Kuvend. Ndoshta janë nisur nga fakti se rekomandimet janë akte nënligjore që nuk i obligojnë detyrimisht me i zbatua. Por pas këtij debati shpresoj se veprimet konkrete në të mirë të pensionistëve do të jenë sepse më mirë vonë se kurë.

Ne të gjithë kemi kontakte me pensionistët e unë drejtpërdrejt edhe në shtëpi dhe e di në çfarë stresi e përballojnë ata çdo muaj që vjen. Prandaj mirëqenia e pensionistëve kërkon vëmendje dhe mirëkuptimin tonë të vazhdueshëm. Por njëkohësisht edhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete dhe përmirësimin e gjendjes së tyre financiare. Pensionistët kanë kontribuar dhe me punën e tyre dhe me të drejtë kërkojnë t'u vlerësohet munda dhe puna për të ardh për një të ardhme më të mirë.

Sa i përket ekzekutimit të politikave për pensionistët kishte hapa konkretë për zgjidhjen e kësaj çështje shumë të ndjeshme në mënyrë institucionale në fazën e tranzicionit nëpër të cilën po kalon Kosova por jo masën e dëshiruar. Me këtë rast është e rëndësishme të përmendet se ekzistojnë dy administrata të pensionistëve, është administrata e pensionistëve dhe benificioni me të cilat administron Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe fondi i kursimeve pensionale të Kosovës apo trusti i kursimeve pensionale të cilat duhet të rregullohen me ligj. Edhe për kundër asaj që Qeveria tri herë ka proceduar Projektligjin për miratim në seancë plenare. Kërkoj që Qeveria t'i referohet rekomandimit të parë të miratuar në këtë Kuvend të rrumbullakoj përgatitjen e projektligjit gjithëpërfshirës për sigurimet pensionale që e konsideroj hap të rëndësishëm për reformim të mëtejme të sistemit pensional në Kosovë ku do të përfshihen edhe politikat për menaxhimin e politikave të trusteve të kursimeve pensionale.

Në takim me pensionistët e komunës së Ferizajt ndër të tjera kërkojnë të hiqen nga skema sociale e duan pensionin si rezultat të punës dhe nga puna. kërkojnë që vendimi i marrë në Kuvendin e Kosovës për një intervenim financiar që për ne dhe shoqërinë e Kosovës është i njohur të implementohet sa më parë se zbutë sado pak gjendjen e tyre të rëndë financiare. Duke u nisur nga deklarata universale për të drejtat e njeriut dhe qytetarit dhe duke u bazuar në të drejtën materiale të fituar me punë dhe në bazë të punës së kryer kërkoj që Qeveria e Kosovës të propozojë: strategjinë dhe vizionin konkret për çështjen e pensionistëve në Kosovë për t'u miratuar në këtë Kuvend ku të përfshihet edhe çështja e të drejtës së pensionistëve të Kosovës nga fondet që i ka uzurpuar Serbia. Qeveria të hulumtojë mundësinë për rritjen e pensioneve ashtu siç kanë gjetur zgjidhje shtetet e rajonit që kanë kaluar në fazën e tranzicionit. Sepse kur ka vullnet e mundësi mund të gjinden, ku përveç implementimit të ligjit të hulumtojë mundësitë përcaktimin e benificioneve të tjera që lehtësojnë jetën e kësaj shtrese të popullsisë të pa - përkrahur , po gatuan megjithë hallet jo të vogla, që të sikur i mënjanon shumëpërkrahur sa duhet për momentin sidomos në fushën e mbrojtjes dhe të shëndetësisë tësore. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit. Fjalën e ka Milazim Haliti, le të përgatitet deputeti Afrim Arzuallgjiu.

DEPUTETI MILAZIM HALITI – Faleminderit kryesues, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë. Rekomandimet e Kuvendit të Kosovës të miratuara më 5 korrik 2005 kanë qenë obligative për Qeverinë përkatësisht për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale që të punohet në drejtim të zbatimit të tyre e që kanë të bëjnë me pensionistët në Kosovë.

Duke pas parasysh obligimin por edhe rekomandimin e veçantë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka punuar në këtë drejtim dhe ka hartuar Projektligjin për sigurimin pensional dhe invalidor me qëllim që të krijohet para së gjithash infrastruktura ligjore e kësaj fushe, por Qeveria për shkak të kostos së lartë financiare të këtij projektligji dhe në mungesë të mjeteve financiare për implementim ka vendosur për shtyerjen e këtij projektligji. Rekomandimi i sistemit pensional është i lidhur ngushtë me miratimin e këtij projektligji nga Kuvendi i Kosovës tani në Kosovë bëhet një përkujdesje në mënyrë të barabartë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për të gjithë personat e moshuar si për ata që kanë kontribuar në ish fondin pensional dhe invalidorë si edhe për ata që nuk kanë kontribuar në këtë fond. Kriter për fitimin e pensionit bazë është mosha 65 vjeçare ku përfitojnë të gjithë në formë të barabartë me nga 40 euro që vlerësuar realisht është shumë e ulët. Zbatimi i rekomandimit të tretë që është çështje e fondeve të grabitura nga Serbia nuk është në mundësi për momentin që të zbatohet sepse sipas informacionit që na është ofruar nga Ministria kjo çështje është ngritur disa herë por nuk ka qenë e mundur që të bëhet më tepër në këtë drejtim. Kjo çështje është më tepër i takon sferës politike dhe fati i fondit të pensioneve të Kosovës mbetet të zgjidhet pas vendosjes për statusin e Kosovës që është afër e me këtë do të merren organet e niveleve më të larta shtetërore. Duke pas parasysh gjendjen shumë të rëndë të kësaj kategorie të qytetarëve - të pensionistëve pa pensione të merituar dhe me këtë pension bazë shumë të ulët na angazhohet që Kuvendi i Kosovës të miratoj Projektligjin për sigurimin pensional dhe invalidor dhe njëkohësisht Qeveria të angazhohet për sigurimin e mjeteve për implementimin e këtij Projektligji shumë të rëndësishëm dhe siguri i mjeteve të parashihet drejtë dhe me kohë me rastin e miratimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit. Deputeti Arzuallxhiu, të përgatitet deputeti Brajshori.

DEPUTETI AFRIM ARZUALLXHIU – Faleminderit z. kryesues i nderuari z. kryesues, z. ministër, kolegë të nderuar. Ndihej me të vërtetë shumë keq që prapë dua të diskutoj për diçka që kemi diskutuar më përpara dhe faktikisht asgjë nuk kemi realizuar prej asaj. Mirëpo vetë fakti i prezencës së qeveritarëve sot dëshmon për atë se me çfarë serioziteti Qeveria merret me këtë problematikë prandaj edhe e kemi këtë situatë, me të cilën sot po ballafaqohemi. Po frikohem se në fund të këtij debati prapë pensionistët do të ngelin të zhgënjyer dhe të mashtruar.

U përmendën shumë gjëra. Unë do të mundohem të jem shumë i shkurtër. U përmend Ligji për sigurimin pensional që mendoj se është diçka për të ardhmen mirëpo problemi qëndron në atë se çka të bëjmë me ata njerëz të cilët janë pensionistë e për të ardhmen do të vendoset më vonë.

Prandaj duhet të shikojmë rrugët për zgjidhjen e problemit. Zgjidhje momentale të problemit mendoj se për të Qeveria u dëshmuar se nuk ka fare strategji për zgjidhjen e këtij problemi. Ka arsye të ndryshme, arsye të se nuk ekzistojnë mjete, nuk ka fond, ato po i dimë, fondi nuk ekziston, është i plaçkitur apo sistemi i financimit ka qenë tjetër atë për atë duhet të diskutohet. Edhe si i tillë ky fond nuk ekziston duhet të jemi të vetëdijshëm dhe nuk do të ekzistojë prandaj mendoj se është koha të orientohejmë dhe të mundohemi me gjetë zgjidhje për këtë gjendje të rëndë edhe të mos fshihemi mbrapa fondit monetar ndërkombëtarë apo Bankës Botërore e kështu me arsye të ndryshme. Sepse askush nuk mund të na detyrojë të lejojmë që një pjesë bukur e madhe e popullatës të jetojë me një varfëri të skajshme edhe ato pa meritë.

I kemi shpronësuar, u përmend edhe në diskutimet e parafolësve se në fakt i kemi shpronësuar së pari pensionistët edhe pse janë pronar i gjithë pasurisë në Kosovë. Gjatë privatizimit faktikisht ata janë shpronësuar deri në fund.

Pastaj ua kemi marrë të drejtën për jetë, sepse faktikisht ekzistenca e tyre fizike varet prej medikamenteve e si të sigurojmë ata medikamentet me 40 euro me të cilën çka u epet. Mendoj se është koha të them boll më këtyre premtime të kota dhe të orientohejmë të mundohemi të gjejmë zgjidhjen.

Zgjidhjet ekzistojnë, nuk mund të qëndroj fakti se nuk ka mjete, përderisa në buxhetin e Kosovës ka diku rreth 105 milion suficit të planifikuar është e pakuptimit të thuhet nuk ka mjete për pensionistë dhe në anën tjetër të kemi në buxhet suficit të planifikuar në masën prej 105 milion, të lëmë anash a, ka mundësi edhe të tjera. Mirëpo është çështja a dimë dhe a dojmë, janë dy pyetje që shtrohen mendojmë se dinë, ka njerëz që dinë, që dinë me zgjidhë probleme. Mirëpo është fakti a dëshirojmë me zgjidhë problema.

Unë do të propozoj do të jem konkret dhe do të propozoj disa zgjidhje konkrete. janë diku rreth 100 mijë pensionistë nga 100 euro në muaj në fakt në vjet vënë diku 120 milion euro tash për tash për afërsisht sigurohet rreth 40 milion.

Nga TVSH-ja me 15% që është, realizohen të hyra diku rreth 300 milion euro. Nëse TVSH-ja ngritet prej 15 deri në 20% që në regjion është ka mundësi të realizohen rreth 100 milion shtesë të hyra që do të zgjidhte këtë problem të pensionistëve. Mirëpo është çështja a duam.

Nga karburantet nëse 20% ngritët çmimi i karburanteve 300 milion litra karburant shpenzohet brenda vitit në Kosovë nga 20 cent automatikisht mund të sigurohen 60 milion euro. Nëse cigareve u shtohen 50 cent në një pako do të realizohen mbi 42 milion euro shtesë. Alkooli, telefonja celulare, automjetet e kështu me radhë. Pra mundësitë për zgjidhjen e problemit ekzistojnë, problemi është në atë se a dom, me zgjidhë problemin. Mendoj se me kaq kisha përfundua. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit z. deputet. Z. Brajshori, le të përgatitet deputetja Gjylnaze Sylaj.

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI – Faleminderit z. kryesues. të nderuar kolegë deputetë, i nderuari ministër. duke mbështetë shumicën e kolegëve deputetë diskutimin e tyre të mëparshme natyrisht duke pas konsideratën nga njëra dhe aty ... këto emocione të paraqitura në raste të këtilla mendoj se sot po bisedojmë për një çështje tepër të rëndësishme sikur që është çështja e përmirësimit të pozitës materiale të pensionistëve të Kosovës dhe do të doja që Kuvendi i Kosovës në këtë debat me gjithë rolin e vet parlamentar që mund ta ketë ndoshta do të duhej të ishte vërtet një Kuvend ku pozita dhe opozita bashkërisht do të trajtonin çështjet pa bërë ndonjë ndarje ndoshta nga ai kuptimi se kush këtu do të flasë më shumë në kuptim të përcaktimit të ndjenjës ose edhe të përafrimit të ndjenjës me gjendjen e rëndë materiale të pensionistëve të Kosovës. Është një obligim yni i përbashkët edhe i Kuvendit të Kosovës edhe i Qeverisë së Kosovës të bëjmë përmirësimin e pozitës materiale dhe sikur paka shumë u tha nga dikush nga parafolësit ne kemi rrëshqitur pak nga tema përkatësisht nga ajo që është paraqitur si temë si pikë e rendit të ditës për këtë seancë e ajo ishte rekomandimet e Kuvendit të Kosovës të datës 7 korrik 2005 në lidhje me një ndihmë do të thoja, por atëherë është konsideruar si ndihmë ad-hok në pjesën e dytë të vitit 2005 në shumën prej 6 milion euro për një kategori të pensionistëve. Megjithatë diskutimet ishin të frytshme, unë mendoj se kanë bazën e qëndrueshme dhe duhet pas parasysh se çka në të vërtetë ne mund të bëjmë në përgjithësi që të arrijmë një qëndrueshmëri pensionale po e them këtë për të gjitha kategoritë e pensionistëve. Unë nuk do të doja që këtu të bëjmë ndonjë përjashtim të ndonjë kategorie, qoftë edhe kategorive që kanë dhënë kontributet e veta në pensione, qoftë edhe kategorive tjera që mbinë në moshën 65 vjeç ose edhe të ndihmave sociale, sepse të gjithë kanë nevojë. Çështja duhet shtruar ndryshe ne duhet të bëjmë

përmirësimin e pozitës materiale të pensionistëve në përgjithësi dhe atë gjithsesi. Nuk e them se këtë mund të bëhet në masën tepër të madhe, por mendoj se mund të ketë përmirësime. Dhe në këtë drejtim janë zhvilluar debate edhe për këtë rekomandim edhe në kuadër të institucioneve të caktuara të institucioneve brenda vendit edhe me UNMIK-un edhe në zyrat e ndryshme të çështjeve fiskale se kanë të bëjnë me këto çështje në atë kohë është konsiderua se ky rekomandim, sidomos rekomandimi i pestë, në atë kohë them se është konsideruar se ndoshta nuk ka pasur mundësi të implementohet, them për atë kohë.

Megjithatë tani duhet t'i qasemi këtij rekomandimi dhe unë mendoj se mund të bëhet një përmirësim i caktuar për vitin 2008 dhe në planifikimet buxhetore 2008-2010. është paraparë të ketë një përmirësim të pozitës materiale të pensionistëve për një shumë të caktuar dhe për një kategori të caktuar. Do të thotë, jo për të gjitha kategoritë që marrin pjesë nga 40 €, por sidomos për kategorinë që janë kontribut – dhënës. Dhe kjo do të jetë një bazë edhe për vitet tjera. Kjo është marrëveshje e përbashkët për Fondin Monetar Ndërkombëtar, të cilët kanë pasur parasysh këtë gjendje dhe unë mendoj se biseda duhet të vazhdojë më tutje. Do të thotë nëse arrijmë të sigurojmë një qëndrueshmëri të mirë pensionale nëpërmes sigurimit të infrastrukturës ligjore, ligjin të cilin gjithë po e themi, ligji duhet të jetë i përmbajtshëm dhe të jetë i implementueshëm.

Ne si Kuvend nuk mendoj se duhet të kemi ligj i cili duhet të na fletë si ... por ligj sipas takatit tonë që e kemi për ta implementuar dhe ai ligj i cili del në këtë Kuvend dhe del nga ky Kuvend, natyrisht se jemi të obligueshëm të gjithë ta implementojmë, sepse kemi marrë pjesë do të thosha në hartimin e tij, në amendamentimin e tij dhe në aprovimin e tij. Dhe për këtë e thashë atë nevojën e hershme se nuk është çështje vetëm e Qeverisë po e gjithë neve të bëjmë përpjekje për të implementuar ligjet të cilat vërtet po kushtojnë.

Sidomos ligjet sociale në përgjithësi kanë një kosto financiare të madhe që nganjëherë po nxjerrin vështirësi për t'u implementua por mendoj se për ligjin konkret i cili duhet të vijë shumë shpejt në Parlament, me korrigjime të bëra që disa herë brenda Qeverisë, duhet të fillojë së implementuari ashtu qysh kalon nga Kuvendi dhe nëse këto dy komponente i harmonizojmë ne, nxjerrjen e ligjit dhe sigurimin e mundësive financiare që mendoj prapë po them se ka mundësi për përmirësime të caktuara, kërkesat janë reale të pensionistëve të Kosovës dhe jo sa për ti thënë, por ka nevojë për përmirësime të caktuara sikur edhe në fusha tjera të shoqërisë tonë. Debate të cilat i patëm edhe në ditët e kaluara edhe cilat vërtetë duhet mbështetë.

Çështja e trustit të kursimeve pensionale e tjera unë nuk dua të hy të shkoqis tash, se çka në të vërtetë ai është, u tha edhe nga parafolësit, sa do të ketë mundësi që të shfrytëzojmë atë fond, sa do të ketë mundësi të shfrytëzojmë edhe tepricat buxhetore në përgjithësi, mbetet që Qeveria të hartojë strategji për një menaxhim të suksesshëm të fondeve publike në përgjithësi dhe shfrytëzim efikas për të plotësuar nevojat reale qytetare. Natyrisht duke pasur parasysh gjithmonë edhe nevojën e rritjes së investimeve në ato fusha të cilat nxjerrin të hyra në vazhdim, të hyra me cilat pastaj ne do të financonim veprimtaritë sociale, edukative, shoqërore etj., pa të cilat natyrisht se ne nuk mund të bëjmë hapa tjerë në përgjithësi.

Prandaj duke i mbështetur kërkesën dhe nevojën reale të pensionistëve për një përmirësim të pozitës materiale të tyre të shpejtë natyrisht edhe diskutimet e kolegëve, mendoj se Kuvendi duhet ta luajë rolin e vet, të kalojë ligjin sa më shpejt në Parlament dhe të krijojë një bazë të qëndrueshme financiare për financimin e veprimtarive sociale në përgjithësi dhe të tjerave. Ju faleminderit zotëri!

KRYESUESEI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, deputetja Gjylnaze Sylja, i fundit deputeti Ilaz Pireva.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit i nderuari zotëri kryesues, i nderuari zotëri ministër, të nderuar deputetë.

Vetë fakti që njëzëri janë votuar rekomandimet në Kuvendin e Kosovës në korrik të vitit 2005 flet se ka ekzistuar vullneti i plotë politik i të gjitha grupeve.

Megjithatë është e qartë se realizimi i tyre ka hasur në vështirësi dhe se realizimi i këtyre rekomandimeve kërkon një vëmendje të vazhdueshme punë e përkushtim të të gjithë neve edhe të ekzekutivit por edhe të Kuvendit të Kosovës. Prandaj që rekomandimet të gjejnë zbatimin e tyre në praktikë, propozoj tri veprime.

Veprimi i parë është veprimi legjislativ që ka të bëjë me përpunimin e mëtejshëm të Projektligjit për sigurimin pensional dhe invalidor nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies

Sociale, ashtu që ai ligj të jetë i aplikueshëm në këtë kontekst sidomos konsideroj se duhet vënë përqendrimin në konston e ligjeve. Për këtë arsye nevojitet bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, por në marrëveshje me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Veprimi i dytë në nivelin politik duhet të bëhet gjithnjë në vazhdimësi në rritje të presionit ndaj Serbisë për kthimin e Fondit të grabitur.

Ky fond pastaj duhet të derdhet në skemën e përgjithshme të pensioneve.

Veprimi i tretë ka të bëjë me sigurinë sociale, gjegjësisht krijimin ashtu siç e tha edhe ministri. të sistemit të qëndrueshëm pensional. Masa që duhet ndërmarrë ose hapi i parë që tani duhet të jetë në krijimin e sistemit të integruar pensional, do të thotë të fondit dhe të trustit, si dhe më vonë reformimi i trustit. Këto janë rekomandime të cilat besoj se janë veprime që do të ndihmojnë realizimin e rekomandimeve të Kuvendit.

Më tej zoti ministër e keni përkrahjen tonë që të ndihmojmë në këtë çështje që sa më shpejt të përmirësohet gjendja e pensionistëve. Ju faleminderit!.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, zoti Pireva,

DEPUTETI ILAZ PIREVA- I nderuari zoti kryesues, i nderuari zoti ministër, të nderuar kolegë,

Kemi edhe sot një çështje mjaft të ndjeshme e cila duke pasur parasysh edhe debatin e djeshëm për rininë dhe debatet e mëhershme nga fushat e tjera, na del që vërtet në Kosovë të gjitha çështjet të cilat po i shtrojmë në Kuvend janë çështje të një rëndësie të veçantë dhe me një ndjeshmëri që vërtet nganjëherë mund të nxisin te ne edhe emocione. Unë pas pak do ta kam edhe një qasje pak më tjetër për me bë pak edhe këtë debat jo-uniform. Që në mandatin e parë kur kemi pasur për shqyrtim të parë ligjin për pensionet themelore kamë bërë vërejtje me atë shportë që na është paraqitur si vlerësuese për gjendjen materiale, bazë për të cilën do të jenë pastaj pensionet dhe dua të ua them të drejtën qesharake. Dimë që në fillim ka qenë ajo e propozuar për 24 €, pastaj u bë 28 e pastaj erdhi deri te 40€.

Megjithatë, këtu u thanë fjalë konsiderate për gjendjen e vështirë të pensionistëve e cila është edhe e tillë, por duke pasur parasysh që gjendjen e tillë edhe e kemi në të gjitha fushat e tjera, kemi edhe te ndihmat sociale unë e kamë këtë para vetes edhe ligjin për ndihma sociale ku një familje edhe më shumë se 7 anëtarë fillon prej 35 tash prej 40 dhe na mbërrin diku në 70 € ndihma sociale, për një familje, jo për një person. Kem pastaj debatuar para sa ditësh edhe lidhur me pensionet e personave me aftësi të kufizuara dhe aty e kemi gjendjen e njëjtë të rëndë.

Biseduam edhe për gjendjen në arsim e konsideruam të rëndë, biseduam përgjendjen shëndetësi të rëndë, dhe çka më pengon në këtë rast, çdo herë u fol për dinjitetin, dinjiteti në raport me para dhe sikur tash na del që askush nuk paska prej krejt këtyre kategorive dinjitet sepse pagat janë të vogla apo pensionet apo ndihmat sociale. Mund të dalim në dinjitet shumë lehtë këtu që kemi paga apo ministrat apo një kategori e veçantë apo një

shtresë e atyre që merren me biznese. Të tjerët po dalin të pa dinjitetshëm. Kisha dashtë pakë një kursim të kësaj fjale sepse me shumë kënaqësi po thuhet kjo. Është e vërtetë se ne kemi pasur edhe takime me shumë struktura të pensionistëve dhe në një rast është thënë mendoni ju që jeni këtu, sepse kjo është djersa dhe mundi jonë dhe sa nuk na është thënë se është edhe gjaku ynë.

Një po jua them, pak ka një, unë po them ka një qasje këtu se sot për kontribuuesit e fondit i cili është grabitë thuhet se që vetëm fondi i pensioneve na qenka grabitë nga Serbia. Të tjerat qenkan krejt në rregull. Mos të harrojmë edhe në gjë, po them sikur na del një keqkuptim këtu te pensionistët, që kanë kontribuar për fondin e tyre, se dikush nga ata që nuk kanë kontribua po ua merr hisen e tyre. Unë po ju them vetëm një, ka qenë fat atëherë që edhe për ata që kanë punua, kemi pjesë, tash na dil sikur ai pushtet i atëhershëm, ai nuk di si ta them tash i paska pasur dyert e hapura për të gjithë ata që donë të punojnë dhe dikush nuk paska dashtë të punojë.

Dhe mos harroni edhe një, edhe bujku ynë ka paguar një kontribut në emër të, edhe të sigurimit shëndetësor po është mendua edhe në emër të pensionit nesër të pleqërisë dhe tash na del që nuk ka njeri tash, po është ajo mosha mbi 65 vjeç që marrin, u tha edhe këtu nga parafolësit, nuk do të duhej se na i kemi edhe një kategori që po na i marrkan edhe nga shtetet që kanë punuar jashtë dhe na i marrin atë 40 €, u tha edhe për një kategori tjetër të keqpërdorimeve të cilët duhet të mbaj përgjegjësi Ministria, faktikisht strukturat e saj nëpër komuna, mirëpo, duhet bërë- na u tha- një kronologji këtu për përpjekje që po bënë Ministria për të zgjidhur këtë problem, i cili nuk është i vogël duke bërë që ata që nuk kanë dhënë vetëkontribute për pensione të ndahen veçantë, ndërsa personat e punësuar dhe ata që e kanë mbërri të drejtën e pensionimit të jenë kategori e veçantë, por edhe unë konsideroj bile me përjashtim më duket kështu pak që ishte më konkret zoti Afrim që na e dha edhe një propozim në mënyrë se si të dilet prej marrjes të një pjese të TVSH-së, të karburanteve, alkoolit, duhanit, dhe ato do të thotë duhet bërë përpjekje gjat mënyrë dhe unë fort nuk pajtohem me atë që Fondi Monetar dhe Banka Botërore është çdo herë pengesë, mos-punën tonë.

Unë edhe një herë po them, unë besoj që edhe Ju zoti Afrim e keni derën çelë të kontribuoni, të jepni mendime, ide, që të gjendet zgjidhja jo vetëm për këtë rast për pensionet. Por edhe për fushat e tjera. sepse edhe jemi, e kemi edhe atë votë sot, e kemi edhe atë obligim ta quaj kështu. Prandaj edhe unë mbështes të gjitha ato kërkesa të drejta dhe atë përpjekje edhe të ministrisë dhe të këtij Kuvendi dhe nuk kisha dashur të jemi peng nesër i një vendimi apo i një emocioni siç është rasti më herët që u përmend këtu dhe siç do të kemi prapë çështje të tjera, na ka ardhur edhe ligji për punën dhe ai na është ndalë një herë, dhe ligje të tjera, dhe kemi ligjin për pjesëtar të UÇK-së, ju lutem vetëm një gjë, është hequr më së pari na ka ardhur edhe me të burgosur politik, e përmendi Hydajeti, janë heqë fare prej ati ligji, janë heqë edhe viktimat civile të luftës dhe tash nuk di zoti ministër sa po arrini që së paku të një kategorie të invalidëve dhe të familjeve të dëshmorëve t'u dilni krah, prandaj këtu duhet parë sendet pak më komplekse në të gjitha fushat dhe të mos flasim fortë shlireshëm dhe mos ta përmendim atë dinjitet që po na del që asnjë nuk kemi dinjitet. Ju faleminderit për konsideratën!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit zoti deputet, tani fjalën e ka ministri Ibrahim Selmanaj, i cili për 10 minuta do të përpiqet ta përmbledhë debatin e sotëm dhe t'u japë përgjigje kërkesave të deputetëve. Urdhëroni.

MINISTRI IBRAHIM SELMANAJ- Ju faleminderit zoti kryesues, ju faleminderit të gjithë juve deputetë, posaçërisht ata deputetë që ishin më konkret, edhe rekomandimet e tyre ishin edhe të qëndrueshme edhe serioze. Unë do ta shfrytëzoj rastin me i thënë Hydajet Hysenit se nuk jam i dënuar me nderjtë këtu, po jam i nderuar shumë, por pse nuk e ka durimin deputeti tash me nderjtë pak këtu, po e shfrytëzoj, po e keqpërdor këtë mundësi por nuk është këtu.

Si do që të jetë, ligji tri herë është kthyer në Qeveri, së fundi në kërkesën tonë përmes UNDP e kemi edhe një këshilltar që është ish ministri i punës, Sllovenisë dhe merr pjesë aktive në eliminimin ose heqjen e disa neneve që kanë një ndikim më të lartë financiar. Kur është fjala për Bankën Botërore dhe për Fondin Monetar Ndërkombëtar, duhet me pranue një fakt, Kosova pretendon të jetë anëtare e organizatave buxhetore, rekomandimet që dalin nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe banka botërore reflektojnë të drejtën e Kosovës që të jetë anëtare e organizatave buxhetore dhe detyrimisht jemi përcaktuar që sugjerimet profesionale t'i kemi para vetes. Kjo është një prej detyrave që del para nesh. Ju faleminderit Hydajet që ke ardhur,

Tash i qes pak në terezi unë, po, Qeveria është sponzoruese e ligjeve dhe unë kam pasur një bashkëpunim tepër të ngushtë me Komisionin parlamentar, bashkëpunimi ju lutem në mes të komisioneve që janë në parlament. Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në bashkëpunim mund t'i harmonizojnë qëndrimet të ju japin përparësi sepse kështu bashkërisht e kemi kaluar edhe ligjin që ka qenë shumë i diskutueshëm, shumë i politizuar, mirëpo ka filluar së implementuari. Do ta bëj edhe një sqarim. Në 6 milion të cilat janë me një vendim të posaçëm në Kuvend janë nda, asnjëherë Qeveria e Kosovës nuk i ka pasur këto mjete para vetes. T'jua them faktin se vetëm për muajin maj janë paguar 5.245.000 €, për një muaj për pensionistë.

Ne i kemi 118 mijë pensionist që paguhen, dhe përafërsisht janë 6 milion € që shkojnë në çdo muaj. Dhe ai 6 milionsh për 6 muaj do ta kishte vlerën 40 €, dhe kemi një skemë të cilën duhet ta zbatojmë detyrimisht është një skemë e cila është e aprovuar dhe duhet ta ndërrojmë komplet skemën, vetëm me një përkrahje shumë politike, vetëm me një unifikim ne mund ta kalojmë ligjin për sigurimin pensional invalidor, ndryshe do ta kemi shumë vështirë ta përballojmë në aspektin financiar, këto janë rekomandimet që dalin në të gjitha konsultimet që kemi pasur gjer tash.

Është edhe në fakt tjetër, deri në vitin 2004 përafërsisht 13 mijë pensionist të Kosovës i kanë marrë pensionet të cilat kanë qenë në Serbi, dhe këtu sillet shifra 12 – 13 mijë pensionist i kanë marrë ato fonde. Në të gjitha kërkesat, në të gjitha tendencat tona që të bisedohet konkretisht për fondin i cili ka qenë kontribut i pensionistëve të Kosovës, nuk kemi pasur asnjë mundësi që drejtpërdrejtë të kemi një kontakt dhe nuk kemi zhvillua kontakte drejtpërdrejta me Qeverinë e Serbisë, po gjithëherë kemi kërkuar përmes mekanizmave që janë në Kosovë, që të trajtohet si problem në vete. Asnjëherë nuk kemi

mbërri që ta kemi si temë diskutimi dhe gjithëherë është anashkalua dhe në moment kur definohet statusi i Kosovës atëherë do të jenë bisedë relevante edhe për shumë tema të tjera nuk do të jetë vetëm çështja e pensioneve.

Votat- jo problem,- nuk është ky problem politik, kjo është mundësia e buxhetit, janë 120.000 njerëz të moshuar, që marrin këtë shumë. Në vitin 1998 kanë qenë 68.000 pensionist kontributdhënës, nuk janë më ajo shumë, sepse nga viti 98 deri sa kemi një numër krejt ndryshe, kanë vdekur një numër i konsideruar i pensionistëve, nuk bëhet fjalë- vote- nuk duhet të flasim për qejfi, duhet të jemi shumë realë në këtë drejtim, sa kisha me humbur unë sikur sot ta kishim ligjin për sigurimin pensional e invalidor dhe pensionistët tanë ti kenë nga 100 €. Do të thotë do të ishte një sukses i Qeverisë së Kosovës dhe nuk bëhet lojë me njerz, sepse secili ka brengë, secili ka njerzit e vetë që janë pensionist dhe ashtu presim se të jem pensionist edhe na nesër.

Duhet vepruar sikurse veprojnë shtetet në rajon, jemi pjesë ose Kosova orientimisht pretendon të jetë anëtare e Bashkimit Evropian dhe duhet ta shohim si kanë vepruar shtetet tjera, Maqedonia, Mali i Zi, Shqipëria dhe shtetet tjera të cilat janë, kanë kaluar fazën e transicionit e sidomos Mali i Zi, që ka një përvojë krejt të re dhe për fat të mirë ka buxhet më të mirë sesa ne, mirëpo ne duhet orientimisht ta kemi këtë si bazë dhe si koncept.

Trusti nuk është kompetencat e Qeverisë, trusti pensional, sikurse organet rregullative, sikurse shtylla e IV, sikurse agjensionet dhe absolutisht asnjë qasje asnjë të drejtë nuk e kemi mbi trustin pensional e krejtë çka mund të bëjmë informata me shkrim, dhe kjo është e tëra, sikurse edhe për ju deputetët, sikurse edhe për qytetarët e Kosovës është e njëjta situatë.

Ishte edhe një fjalë jo m e mira, pra dituria e të pa diturve, Ministria e punës vetëm ministria në gjithë Kosovën i ka 1328 punëtor, diku 50% të punëtorëve kanë kualifikime të larta, asnjëherë nuk ... si ligjin donë, janë ekspert që punojnë pikërisht njerëz që hartojnë ligje, që implementojnë skema ka të gjitha subjekteve politike, ka të gjitha nacionaliteteve dhe nëse 1300 punëtor janë të paditur kjo nuk e vlen thuhet në parlament. Unë do të jem i gatshëm të bashkëpunoj ngushtë dhe do të jem shumë i nderuar në qoftë se ligji do të kalojë në Qeveri dhe të sillet në Parlament.

Prapë duke pasur parasysh faktin dhe gjendjen që e kanë pensionistët të Kosovës, unë kërkoj përkrahje të gjitha subjekteve politike sepse është moment i favorshëm, është moment i përshtatshëm dhe për vitin 2008, sipas të gjitha gjasave do të kemi një shumë, sepse kemi një marrëveshje me Fondin monetar ndërkombëtar, do të jenë 16 milion €, që do të jenë në shumën e, në konton e pensionistëve të Kosovës dhe ne duhet ta bëjmë një dallim, sado të ngushtë, mirëpo ajo do të jetë ai fillimi i parë që ta bëjmë dallimin në mes të pensionistëve bazik dhe pensionistëve të pleqërisë. Ju faleminderit në qoftë se keni ndonjë pyetje shtesë jam i gatshëm me u përgjigjes.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit zoti ministër, sipas Rregullores propozuesi i mocionit ka 5 minuta.

PROPOZUESI I MOCIONIT – Ju faleminderit zoti kryesues, besoj që meqenëse jam kryetare e Komisionit, e dëgjuam gjithë debatin, e dëgjuam edhe fjalën e ministrit. Mendojmë se edhe ne jemi dashtë të shikojmë shtetet në regjion mirëpo nuk i kemi shikuar dhe ajo çka ka ndodhur në Kosovë ka qenë presedon do të thotë ka qenë rast unik ku kemi kaluar është bërë shkaputje prej një sistemi dhe kalim tentime të improvizimit të sistemit tjetër, por një periudhë transicioni dhe është bërë një dëm që është vështirë të riparohet. Mirëpo nuk është kjo vetëm e kësaj Qeverie aktuale, por të gjitha qeverive të pasluftës.

Atëherë problemi është shumë më i madh se vetëm sistemi pensional, do të thotë nuk kemi strategji të sigurimeve shoqërore dhe këtë duhet pranua, e ritheksova në fillim që ligji për sigurinë shëndetësor fatit më nuk do ti dihet, sepse është riktye në Qeveri. Do të thotë, në bazë të debatit del që rekomandimet Qeveria duhet t'i zbatojë, por si. Së pari me hartimin e strategjisë për sigurime shoqërore, si parakusht për zbatimin e rekomandimeve. Nën 2. siç u pa nga debati sistemi pensional i cili preferohet, do të jetë i bazuar në krijimin e fondeve publike, ajo ka vlejte edhe për sigurimin shëndetësor, atëherë parakushti i dytë është iniciimi i amendamentimit të ligjit për financat publike, që lidhur me krijimin e fondeve publike dhe tek atëherë sjellja e ligjit në Kuvend.

Prandaj kërkesa e komisionit që në këtë debat të jetë prezent edhe kryeministri nuk ka qenë e rastësishme se Komisioni është marrë shumë edhe problemin e ligjit për sigurim shëndetësor, prandaj mendojmë që e vetmja rrugë, tash po flas si kryetare e Komisionit në emër tim personal, mirëpo besoj që është si një përfundim edhe i debatit edhe të gjitha diskutimeve në Komision që duhet të hartohet një strategji sepse është e kurtë që në mënyrë parciale nuk mund të zgjidhet këto probleme, do ta ketë fatin ligji përkundër faktit që gjithë kemi dëshirë ta sjellim ligjin këtu, se është rekomandim dy vite më herët.

Mirëpo, pa strategji, pa përcaktim të qartë të Qeverisë do ta ketë fatin e Ligjit për sigurim shëndetësor. Prandaj është mirë që ky Kuvend ta merr vendimin, Qeveria besoj që e ka përafërsisht në bazë të ligjeve që i ka hartua, mund ta përmbledhë, ta ketë një strategji atëherë së paku një opsion të strategjisë, ta hartojë ta qesë së pari për miratim në Kuvend. nëse dom të jemi serioz që ligji kur të vijë përbrenda dy muajve ta miratojmë dhe ta implementojmë, përndryshe krejt do të jetë lojë e fjalëve, lojë e dëshirave të mira por nuk do të ketë realizim. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, zonja deputete, unë desha që të marr mendimin e juaj për ta vazhdua apo jo, megjithatë konstatoj që debati është kryer, me u votua sipas rregullores nuk kemi çka të votojmë dhe atë ne i kemi edhe dy pika të cilat mund t'i kryejmë, besoj brenda gjysmë ore në qoftë se jeni dakord, vazhdojmë në qoftë se jo, i kemi edhe dy-tre deputet jashtë ju kisha lutë që ti thirrni të futen në sallë sepse kuorumi duhet të jetë 58, - kuorumi mungon.

Lus deputetët që nuk janë në sallë të kthehen,
Atëherë po më vjen keq, por duket se ka ndonjë solidaritet në mes nesh, deputetët janë korridoreve dhe nuk po futen në sallë, unë nuk kam të drejtë.

Atëherë konstatoj se kuorumi..... thirre Salën qatë. Konstatoj që ka kuorum. Në sallë janë 61 deputetë. Po vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimin hapësinor.

Miratimi në parim i këtij ligji është bërë më 16 mars 2007. Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar dhe Kuvendi i kanë paraqitur raporte dhe rekomandime si vijon:

Komisioni për Çështje Gjyqësore Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimin hapësinorë ka bazë juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimin hapësinor nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimin hapësinor nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe njëherit ka propozuar një amendament që do të procedohet.

Në vazhdim po fillojmë me miratimin e amendamenteve të propozuara regjinë e kisha lutur që ta shkurtoj kohën, nuk ka nevojë 10 sekonda le të jetë 6 sekonda, mjaftojnë për me vota. Faleminderit.

Amendamenti 1

Kush është për, Votojmë tani:

Për 54, një me dorë 55;

Kundër 1.

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë tani:

Për 50;

Kundër..... 2.

Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë tani:

Për

Hydajet Hyseni ka një vërejtje.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI - Unë kërkoj falje nuk dua të marr kohë po ju lutem të shikoni vetëm amendamenti i propozuar ka do formulime që nuk është mirë të jenë në ligj kërkoj falje prej kolegëve mendoj që ka qenë pa kujdesi, p.sh. për vendbanimin jo formal janë futur kategori si p.sh. zotërim jo i sigurt i pronësisë, çka është zotërim jo i

sigurt, propozoj të hiqet kjo, vetëm të thuhet jo -formal. Dhe kjo rrezikshmëri deri në diskriminim, si është rrezikshmëria deri në diskriminim nuk ka logjikë, prandaj propozoj që të jetë rrezikshmëria e lartë vetëm që të evitohet mundësia të jetë në ligj një formulim që është vërtet jo juridik, jo i zakonshëm. Faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – A jeni për t’i miratuar vërejtjet e z. Hyseni. atëherë votojmë tani për vërejtjet e deputetit Hydajet Hyseni, votojmë tani. Regjia.

Amendamenti 3

Me vërejtjet e z. Hyseni, votojmë tani:

Për 54;

Kundër..... 2.

Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Regjia tani votojmë:

Për 53, një me dorë 54 vota

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 5

Votojmë tani:

Për 56;

Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë tani:

Për 53;

Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë tani:

Hydajet Hyseni ka, të lutem Hyd paraqitu më herët për vërejtjet që i ke, jo pasi t’i votojmë. Për amendamentin 7 Hydajet Hyseni ka vërejtje. Sa për njoftim në sallë janë 63 deputetë. Faleminderit.

Ju lutem mikrofonit Hydajet Hysenit.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Unë sërish, vërtet kërkoj mirëkuptim. Do të mund edhe ta heshtja, por megjithatë është një formulim që mendoj bën të rishikohet. Komisioni për buxhet ka sugjeruar që aplikimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të këtij Ligji fillon pas sigurimit të mjeteve potenciale buxhetore të donatorëve në shumën e pasqyruar në deklaratën financiare të Departamentit të buxhetit etj.

Së pari kjo dispozitë duhet të jetë dispozitat përfundimtare, por edhe çështja është si mund të miratojmë një dispozitë të tillë aq relative pas sigurimit të donacioneve. Donacionet janë gjithmonë relative a mund të sigurohen tërësisht a mund të sigurohen pjesërisht, kur sigurohen. Mendoj që një sqarim prej përfaqësuesve të Komisionit do të

ndihmonte eventualisht saktësimin mendoj se do të ishte mirë sepse ligji bëhet për t'u zbatuar dhe nuk e kuptoj si mund të zbatohet kështu në Faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit. Unë me sa i kam lexuar këto janë të sqarume këta e kanë shqyrtuar dhe kanë konstatuar për së dyti nuk mund të fusim në diskutim këtë çështje. Prandaj votojmë amendamentin 7. Dy konstatime s'mund t'i ketë Komisioni për buxhet.

Votojmë amendamentin 7

Votojmë tani:

Për 41;

Kundër 9;

Abstenim..... 5.

Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë tani:

Për 55;

Kundër..... 2.

Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë tani:

Për 48;

Kundër..... 1.

Miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Votojmë tani:

Për 58;

Kundër..... 1.

Miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Votojmë tani:

Për 50;

Kundër..... 1.

Miratohet amendamenti 11.

Amendamenti i fundit

Amendamenti 12

Votojmë tani:

Për 45;

Kundër..... 1.

Miratohet amendamenti 12.

Konstatohet që në sallë janë 64 deputetë dhe lus deputetët që të përgatiten për votim për Ligjin.

Votojmë tani:

Konstatohet që me amendamentet e miratuara me 56 vota për është miratuar Ligji për planifikimin hapësinoë. Faleminderit.

Vazhdojmë me pikën e nëntë

9. Miratimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe Telekomunikacion lidhur me dhënien e licencës për hulumtime minerare kompanisë “Kosovo Resorce Company L.L.C.”

Në pajtim me përfundimin e seancës së datës 21 qershor 2007 Komisioni për Ekonomi, Tregti dhe Energjetikë në konsultim me shefat e grupeve parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ja ka prezantuar Raportin me rekomandime.

Ftoj kryetarin e Komisionit, Ibush Jonuzi që nëse e sheh të arsyeshme ta marrë fjalën.

DEPUTETI IBUSH JONUZI – Faleminderit i nderuari kryesues, deputetë të respektuar. Bazuar në Rregulloren 49 të punës së Kuvendit të Kosovës përfundimi i seancës së Kuvendit të Kosovës më 21. 6.2007 si dhe përfundimit të grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës Komisioni funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion më 26.06.2007 shqyrtoi përsëri kërkesën e Ministrisë të Energjetikës dhe të Minierave dhe ndërmarrje shoqërore Trepça lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së dhënies së licencës kompanisë “Kosovo Resorce” nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Në bazë të deklaratave dhe të fakteve të parashtruara nga palët Komisioni KPMM-ja NSH Trepça dhe Ministria e Energjetikës dhe e Minierave, si dhe interpelanca e ministrit për Energjetikë dhe Miniera të datës 21.06.2007 në Kuvendin e Kosovës Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion i propozon Kuvendit të Kosovës që të miratojë Rekomandimet.

Nën 1 Auditori i përgjithshëm të vlerësojë ligjshmërinë dhe konflikt interesasin me rastin e dhënies së licencës për hulumtim eksplorim në lokacionin e Drazhnjës kompanisë Kosovo Resorce nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Nëse vërtetohet se ka pasur shkelje të legjislacionit në fuqi apo konflikt interesi Kryesia e Kuvendit të Kosovës lëndët t’ia procedoj Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për anulim. Obligohet auditori i përgjithshëm që vlerësimin ta bëjë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të rekomandimit. Nëse auditori i përgjithshëm brenda afatit të caktuar nuk përfundon me vlerësim Kryesia e Kuvendit obligohet që kërkesën për anulimin e licencës t’ia dërgoj Përfaqësuesit Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Nën 2. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të shpall Ligjin për Miniera, Minerale i miratuar më 19 janar 2006 dhe Ligjin për hulumtime gjeologjike i miratuar

më 10 tetor 2006 në Kuvendin e Kosovës, në të kundërtën ta arsyetojë mos shpalljen e këtyre dy ligjeve.

Nën 3. Kuvendi i Kosovës me akt juridik, resurset natyrore të Kosovës t'i shpall pasuri nacionale të menaxhojnë nga Kuvendi i Kosovës

Nën 4. Komisioni i Pavarur për Miniera, Minerale të hartojë plane për menaxhimin e resurseve minerale në Kosovë dhe para se t'ia procedojë për miratim Ministrisë për Energjetikë dhe Miniera sipas nenit 61 të rregullores 2005/3 i njëjti të debatohet në Kuvendin e Kosovës.

Nën 5. Qeveria e Kosovës hartoi politikë të qartë koncesuale Qeveri – Kuvend për të ardhmen e minierave në Kosovë e në veçanti të Minierave të Trepçës,

Nën 6. ..Të... intensifikohet bashkëpunimi ndërinstitucional Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me Ministrinë për Energjetikë dhe Miniera, kurse Kuvendi i Kosovës përmes Komisionit funksional të mbikëqyrë zbatimin e politikave dhe të planit për menaxhimin dhe shfrytëzimin e mineraleve në Kosovë. Ju faleminderit. një herë shfrytëzoj rastin për fund të falënderoj tërë Komisionin për një angazhim shumë të sinqertë dhe serioz e në veçanti një falënderim në emër të Komisionit të gjithë deputetëve në seancën e 21 të këtij muajit që dhanë kontribut të qmuar rreth debatit që u shtrua, përkatësisht interpelancën e ministrit Çeku për këtë çështje. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit z. Jonuzi. Tani sipas Rregullores rekomandimet i nënshtrohen votimit. Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim.

A jeni për ta miratuar këtë rekomandim.

Regjia gati për votim tani:

Konstatoj që me 66 vota për dhe 2 abstenime.

Miratojen rekomandimet e dhëna nga Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion. Ju faleminderit.

Seancën e konsideroj të mbyllur, mirë u pafshim në seancën e ardhshme.

